

BIBLIOTEKA

E

SHTETIT

DH-93-32

59 97

GJIROKASTËR

**DHIMITËR S.
SHUTERIQI**

**Kur rëndte hëna
nëpër re**

tregime

154-P3-32

54.97

DHIMITËR S. SHUTERIQI

KUR RENDTE HËNA
NËPËR RE

tregime



Njeriu rrjedh nga majmuni

Pas pak ditësh që kthyem nga Mokra unë dhe babai, zbriti në Pogradec përsëri xha Markoja dhe erdhi të lahej me ne në liqen, andej nga Guri i Mëllozhit, në të dalë të qytetit, kur merr udhën për Elbasan. Atë ditë, që ta dini ju, unë kam mësuar për herë të parë se njeriu na rrjedhka nga majmuni!

Nuk isha akoma pesë vjeç dhe majmun nuk kisha parë, ndonëse për majmunin kisha dëgjuar, kur më bërtiste gjyshja e më shante «majmun!». Majmunin e merrja me mend si ndonjë soj maçoku, se gjyshja e kishte zakon që të më bërtiste e të më shante edhe «maçok», kur zemërohej me mua, bile «maçok pa bisht!» Ky soj maçoku, përveç bishtit që nuk e kishte, të tëra të tjerat i kishte si gjithë maçokët — edhe kokën, edhe mjaullimat e çirrat, edhe huqet, edhe dinakërinë. Ishte shamatar e zihej me majmunët e tjerë, si zihen maçokët midis tyre. Ne kishim plot maçokë të tillë në lagjen tonë Kala të Elbasanit dhe ishin të të gjitha ngjyrave e të të gjitha huqeve ose zakoneve, në daçi. Se, siç e dini, maçokët kanë kaq zakone, sa kanë edhe huqe. Ka prej tyre që të hanë mishin në kusi, tek është akoma duke vuar mbi zjarr. Të tillë guximtarë dhe trimoshë të prapë!

Një maçok i Haxhinushes, një plakë përballë shtë-

pisë sonë — për të cilën ju kam treguar se ishte ebe, domethënë mami — rrugicat e lagjes i kalonte me një hop nga njëra anë në tjetrën, pullaz më pullaz dhe s'kishte rast që të mos thyente tjegulla. Njerëzve iu fok¹⁾ një ditë prej ditësh dhe maçokun e gjetëm të helmuar në një vijë uji, tek kishte vajtur të shuante zjarrin me turirin në baltë e me bishtin bigë. Ai ishte i bardhë dëborë, po kishte në noçka ca grimëza të kuqërremta, si ta kishte surratin një folezë grerash. Mustaqet i kishte të rralla, sa mund t'i numëroje qimet, ashtu si të një shkurtabiqi të lagjes sonë, që emrin ia thoshin Trifon. Kështu që unë, kur mora vesh se njeriu na rrjedhka nga majmuni, e përfytyrova së pari majmunin si një maçok të Haxhinushes, po edhe si njëfarë Trifoni.

Xha Markoja, edhe pse njeri me shkollë, që kishte bërë edhe ndonjë mot mësues, me sa kujtohem unë nga ajo moshë fort e njomë, nuk besonte dot që njeriu të kishte rrjedhur nga majmuni, kur im atë përpiqej t'ia shpjegonte dhe t'i mbushte mendjen atë ditë që po la-heshim të tre te Guri i Mëllozhit. Babai, mund të them sot, nuk qe i thelluar në shkencën e prejardhjes së njeriut, por edhe xha Markoja e ndiente veten të fyer si njeri: njeriu, që bënte kaq e kaq mrekullira, të rrjedhka nga një soj majmuni, si ngulte këmbë zoti Filip?! Majmuni na ecte me katër këmbë, — njeriu me dy; majmuni na kishte bisht, — njeriu nuk na kishte; njeriu fliste, — majmuni bërtiste etj. etj.

— Lermë, aman more zoti Filip, se po më tromaks!²⁾ — e marr me mend unë tani se i thoshte xha Markoja tim eti, i tromaksur vërtet, ndërsa më kujtohet mirë se i tha: — Majmuni është një egërsirë tërë lesh!

Ai tha «tërë lesh» dhe unë atë çast vura re se xha Markoja, ashtu i zhveshur siç ishte brez e për-pjetë dhe po thekej në diell, na kishte kaq shumë lesh, sa ia kalonte edhe maçokut të Haxhinushes! A ishte kaq

1) U erdhi në majë të hundës.

2) Tremb, frikëson.

leshitor edhe Trifon shkurtabiqi atje në Elbasan? Maçoku e kishte leshin rudë e të bardhë dëborë; xha Markoja e kishte të kuqërremtë e të trazuar.

Im atë thoshte të vërtetën: ja, xha Markoja rridhte nga majmuni!

Unë t'anë ia kisha parë atje në Podgozhan. Ai ishte një plak i bardhë dëborë, me një kokë të vogël, që i humbiste në një bashkë të madhe flokësh e mjekre, si tjetër herë s'kisha parë njeri. M'u përfytyrua tani xha Markoja që do të bëhej i tillë kur të plakej, dhe kështu do të ngjante edhe më shumë me maçokun e bardhë të Haxhinushes. Pra, me mendjen time të vogël, i dhashë plotësisht të drejtë babait, që ngulfe këmbë e thoshte se njeriu na rrjedh prej majmunit, dhe nisa t'i shqyeja sytë nga xha Markoja. Kurse im atë, nga ana e tij, më çudiste dhe më ngjallte dyshime, sepse ai më s'kishte asnjë fije floku në kokë dhe nëpër trup ndonjë të rrallë fare. Mos kishte dhe njerëz që nuk rridhnin nga majmuni? Mundet që po. Ja dhe unë, nuk më dukej se ngjaja me ndonjë maçok.

M'u ngatërruan tërë këto gjëra në kokë si leshtë e majmunit.

Xha Markoja, i zemëruar sigurisht me veten, se, me arsyetimet e tim eti, ai duhej të pranonte të papranueshmen, kërceu në këmbë dhe nisi të rrëmbente zaje e t'i vërviste tutje me tërë forcën e krahut, aq sa kraharori i bënte guf. Gurët binin larg në liqen. Kishte krahë të fortë ustai. Im atë zuri të qeshte edhe më shumë me të dhe e marr me mend t'i ketë thënë një gjë të tillë: se ata njerëzit e parë, që rridhnin nga majmuni, ishin të fuqishëm shumë, sidomos në të flakurit e gurit, se ata me një gur e linin në vend një ari ose një elefant, po ta qëllonin në ballë, kurse prit kur liqeni të mbushej me klenë e me krapë të vrarë nga gurët që hidhte me aq tërsëllim ky ustai i inatosur i Podgozhanit.

Qeshi xha Markoja dhe u turr e kërceu e u zhyt në liqen për të dalë kushedi sa dhjetëra metra tutje, duke

turfulluar e duke notuar me forcë, kurse im atë u tall e i bërtiti:

— Tamam si një nga ata stërgjyshërit e parë të njeriut m'i çan zotrote ujërat, po noto, noto dhe nxito e na sill ata peshqit që vrave, sa pa t'i rrëmbyer zgalemët!

Unë atëherë e pyeta tim atë:

— Po mirë, more baba, ky xha Markoja, që ka lindur nga ai plaku i bardhë i Podgozhanit, që kur ka nisur të bëhet njeri, që ditën që lindi apo pastaj?

Kështu më ka treguar më pas im atë, që s'u kishte besuar veshëve dhe që kishte shtangur nga pyetja ime.

Babai nisi të më shpjegonte se kjo histori e rrjedhjes së njeriut nga majmuni na qenkësh një histori e gjatë, e gjatë shumë-shumë. Po ec e t'i tregosh një fëmije as pesë vjeç akoma se kur fillon një histori e gjatë shumë-shumë.

Për mua, domosdo, gjatësia e kohës matej me ditët që kisha. Ehu! Sa kohë kishte kaluar që kur më thoshin «Vuv i lalës»!¹⁾ Më dukej se nuk kishte dy javë a tri që kisha zënë të parën gurneckë në liqenin e Pogradecit dhe që kisha parë mbretin e koranëve të atij liqeni, që kisha zënë një koshariqe²⁾ me trofta në një rremë mulliri të Mokrës, që kisha pirë ujin e akullt të Leqinames dhe kisha shijuar dardhët e Velçanit, po sikur kisha vite! Këto tanimë nuk bënë pjesë në kohë, po në «histori», në përrallë: ishin larg, larg shumë-shumë.

Vështrova tim atë me habi e dyshim edhe një herë, meqë ai s'kishte gati asnjë qime në kokë e në trup, u ngushëllova ndoshta — ku ta dish? — se nuk isha dhe unë drejtpërdrejt, si xha Markoja, një këlysh majmuni dhe m'u deshën akoma shumë vjet që të kuptoja atë historinë e gjatë shumë-shumë të zhvillimit të lëmshit të dheut e të qenieve të gjalla që lindën përmbi të,

1) Memec i vëllait të madh.

2) Kosh i vogël.

historinë së fundi të prejardhjes dhe të njeriut «nga një lloj majmuni», si shkruante në një copëz të librave tona të leximit edhe Naim Frashëri vetë. Dhe kur i kujtoj këto, mund të qesh me vete me zë të lartë, sepse më del përpara fytyra dhe trupi i xha Markos nga Podgozhani, që ishte një burrë i hijshëm, dhe shoh plakun e tij në Podgozhan, të bardhë si dëborë, me atë fytyrë të kuqezë e të rrudhur si të një të porsalinduri.

Një tjetër tregim për Vangjushin

Për Vangjushin, shokun tim të fëmijërisë në Korçë, do t'ju tregoj edhe diçka tjetër.

Ju kam treguar se ai ishte një djalë i gjallë shumë, por edhe ca i sertë, edhe ca i llastuar, veç ama shok me besë e me zemër në dorë. Më donte dhe e doja shumë. Bashkë me Mihallaqin, ne, si të thuash, plotësonim njëri-tjetrin: Vangjushi me guximin, unë me maturinë, Mihallaqi me butësinë. Guximi i Vangjushit le ta kalonte ndonjëherë masën, matura ime le të mos ishte përherë model, kurse butësia e Mihallaqit le ta bënte më se një herë shokun tonë «qull». Sidoqoftë, treshja qëndronte.

Porse një ditë, unë e Vangjushi u zumë, «u prishëm». Ai s'deshi të më jepte fugën e vet që të lozja një çikë, një fugë të re, që nuk e lëshonte fare nga dora dhe kishte frikë se mos ia dëmtonim majën, apo s'desha unë t'i huaja një a dy prej detkavë të çelikut, që sapo m'i kishte gjetur im atë dhe që ishin të mrekullueshme. S'më kujtohet tani se kush u bë shkak zemërngushtësie nga ne të dy. Këmbyem ndonjë fjalë të thartë, pastaj desh u kacafytëm si dy kacagjela, po hyri Mihallaqi në mes. Vangjushi u zemërua keq edhe me të dhe na ktheu shpinën me një «mos ju pafsha sytë!» duke premtuar se do të na «zhdëpte» ndonjë ditë, njërin dhe tje-

trin. Mihallaqi heshti, kuptohet; unë s'e lashë pa një përgjigje të kripur.

Por edhe pse i zemëruar, shpejt nisa të ndieja një pezmatim ndaj vetes. Vangjushit ia njihja rrëmbimet, duhej të kisha lëshuar udhë. Mihallaqi, me sytë në lot, erdhi pas meje në shtëpinë time, që të mos më linte vetëm, por edhe që të mos mbetej vetëm, sigurisht.

Në shtëpi kishim një drekë të mirë, nuk di për çfarë feste. Mos kishte mbushur daja të pesëmbëdhjetë vjetët? Mundet. Por ajo drekë e pasur nuk na vajti mirë aspak, as mua, as Mihallaqit, të cilin nëna s'e la të shkonte në shtëpi.

Të gjithë e kuptuan shpejt se diç na kishte ngjarë, po ne s'rrëfenim. Gjyshja, si më e zonja, nuk më kandisi dot as ajo që të zbuloja të keqin. Mihallaqi i kishte ngrënë lotët dhe e mbante veten. Daja mbaj mend se tha:

— Punë çiliminjsh!

Ja dhe ky! «I madhi» ky! Dirsur mustaqja!

«Punë çiliminjsh!» mezi e përmbajta veten unë. Të dinte ai se ç'na kishte ngjarë! Ishim prishur me shokun më të besës. E përse? Për hiçmosgjë! Po edhe ai kokëshkëmbi Vangjush! Kisha faj unë? Le të më brente përbrenda se nuk isha pa faj, vetes nuk ia pohoja plot gojën. Ç'faj kishte Mihallaqi kaq i butë?

Tanimë dreka nuk po na shkonte të gjithëve. Dikush tha se pula nuk ishte pjekur sa duhej dhe se patatet nuk ishin fërguar mirë. Dikush tha se djathi i lakrorit mbante erë. Njëri nuk pëlqeu sultiashin, ku orizi nuk ndihej fare, se na qenkësh bërë bullumaç¹⁾. Mua, përkundrazi, më dukej se nëna dhe gjyshja s'kishin gatuar më mirë asnjëherë, tjetër se nuk më shkonte asgjë asaj dite fatkeqe. Mihallaqi sa mezi cimbiste pak nga të gjitha ngëc-ngëc.

E ndieja se domosdo do të më merrte vaji dhe kjo nuk vonoi, kur nëna foli, këtë radhë qortueshëm:

1) Squllur keq.

— More, po si i ke punët zotrote? Do rrëfesh se ç'ke? Po ty, more Mihallaq, nuk të vjen zor që hesht? Po mirë, Vangjushin ç'e bëtë, se me të ishit? Pse nuk e sollët edhe atë me vete, që ta mbanim për drekë? Të paktën ai edhe do të na rrëfente se ç'ju ka ngjarë, se Vangjushi është trim.

Është trim Vangjushi! Posi!

Unë, e dini se ç'proçkë bëra?

— Vdiq Vangjushi! — thashë.

Njerëzit u mbërthyen në vend, me pulë dhe lakror që u ra nga dora. Mihallaqi ngriti nga unë një palë sy të tmerruar. Nëna ia pat më në fund:

— Bo-o-bo-o!

Gjyshja në lot ia pat:

— Pa trego se si, mor i zi!

Unë lahesha në lot e dënësja, ndërsa Mihallaqit lotët i ishin bërë zhur nën qepalla.

— Pa trego ti, mor Mihallaq! — e shkundi im atë me të dy duart shokun tim të ngrirë.

Shoku seç mërmërinte nëpër dhëmbë, aq sa' s'e merrte vesh njeri. Ai u ngrit me rrëmbim nga sofa, ku u rrëzuan e kërcitën ç'kishte përpara, u derdh uji e u thye gota ku pinte, dhe u zhduk aq shpejt, sa s'u pa se si.

Kaq e çuditshme sa mund t'ju duket, kaq e vërtetë është: ne të tre, Vangjushi, Mihallaqi dhe unë, ishim shokë me besë e të pandarë, po prindërit tanë as që njiheshin midis tyre. Shokët e mi banonin në lagje të largëta prej lagjes së Lumit, njëri rrëzë Shëndëllisë, në fund të qytetit, tjetri matanë lumit, përtej pazarit, nga Radaneci. Ne na kishte lidhur shkolla dhe ky shoqërim i largët na pëlqente të treve, se bridhnim anët më të ndryshme të qytetit. Vendbanimet tona qenë nga më të lakmuarat, si për shëtitje, si për lodra, dimër e verë. Dimrit, kolovajzet!) më të mira ku mund të ishin, veçse në lumë dhe faqeve të kodrinave, për

1) Skitë në akull.

shembull të Shëndëllisë? Dhe vendi më i freskët i verës ku mund të ishte, veçse pranë mullinjve ose në lartësitë?

Ishte dita e dytë dhe im atë me nënën s'u bënë mbarë — shyqyr, nuk thua? — të vinin për «ngushëllim», për «nëkim»¹⁾, te prindërit e Vangjushit, kurse unë s'flisja, s'tregoja se ç'gafë kisha bërë, po nxija dhe nxinte shtëpia. Atë ditë, Mihallaqi nuk u duk nga ne. Në shkollë, ne të tre shokët, që kishim ndenjtur në një bankë, ishim ndarë dhe mësuesi na kishte qortuar dhe s'kishte zbuluar dot shkakun e kësaj ftohjeje të papritur.

Po ditën e dytë, pasi hëngrëm drekë dhe nëna sapo kishte ngritur sofrën, trokiti dera e udhës e gjyshja doli të shihte se kush kishte ardhur në atë orë. Në dhomë ne dëgjuam një britmë të madhe gëzimi, të përcjellë me «të keqen nëna!», me «kurban nëna!», me «dashi i nënës!», me «trimi i nënës!», me të puthura që kërcitnin dhe, së fundi, me një klithmë drejt nesh:

— Po është Vangjushi, Vangjushi, që iu bëfsha!

Nënës mirë që nuk i mbeti zemra: ajo nuk lëvizi dot për të dalë në dritare. Unë u mblodha grusht në një cep të dhomës.

Të tjerat ju i merrni me mend, dhe jo vetëm gëzimin. Qe gjyshja ajo që më zhdëpi këtë radhë. Kurse, nga turpi, Mihallaqi nuk u duk nga ne tërë një javë. Im atë, kur më rrahën, tha:

— Drunë e duam ne! Ne nuk e sqaruam që dje këtë çështje!

1) Rënkim, ngushëllim.

Përrallë me keca

Nuk e di kush më ka treguar së pari këtë përrallë, gjyshja a babai. Them «i pari», se përrallat m'i kanë treguar e përsëritur më se një herë dhe, kur m'i ka treguar gjyshja, i ka treguar edhe babai e, kur m'i ka treguar babai, i ka treguar dhe gjyshja. Sidoqoftë, babai tregonte përralla ca si të rënda, që mua nuk më tërhiqnin dhe kaq. Ja një shembull:

— Na ishte një fil¹⁾. Fili ishte i mençur si gjithë filët. Ishte i butë si një mëshqerrë, dhe filër të butë ka. Kur pëlliste, ai zërin e kishte ledhatar, kurse filët e kanë të çjerrë. Ai fil ishte lozonjar...

I besoni ju kësaj përralle? Unë vazhdimin s'e mbaj mend.

Edhe gjyshja qëllonte të tregonte përralla të rënda, me kafshë kaba gjithashtu, për shembull me arinj. Ja një përrallë e tillë:

Na ishte një ari. Këtij ariut na i ishte malcuar²⁾ këmba, na i ishte enjtur e mbushur tërë qelb. Gjeti ariu një gjahtar, që po flinte nën një lis, rrëzë një pylli. Dhe e dini ç'bëri ariu? I lëpiu pushkën atij gjahtarit. Gjahtari e mbante pushkën pranë. Ariu e lëpiu

1) Elefant.

2) Mahisur, infektuar.

pushkën dhe e tundi me putrën e tij të shëndoshë gjahtarin. U zgjua ky që flinte dhe — bobo! — u tmer-rua. Po ariu, me atë goxha turi dhe me atë goxha panxhë, i dha të kuptonte se nuk i bënte gjë, po pa shih se si na ishte enjtur këmba e na ishte mbushur tërë qelb! Një gjemb i madh sa një gjilpëror¹⁾ i kishte hyrë në putër dhe e kishte bërë këmbën e ariut për faqe të zezë. I mençuri gjahtar ia nxori gjembin ariut nga putra, ia shtrydhi plagën, ia pastroi qelbin, ia lidhi këmbën me shaminë që kishte, kurse mirënjohësi ari e shpuri te një zgërbonjë lisi, ku kishte bërë folenë një bletë, dhe e gostiti jo me një koshere, po me një kosh të madh me mjaltë...

Dhe që unë t'i besoja përrallës, ime gjyshe më siguronte se ai gjahtar na paskësh qenë gjyshi i saj, prej të cilit ajo vetë e kishte dëgjuar historinë e habitshme. Gjyshja e mbante mend si sot atë pushkën me të cilën pati shkuar për gjah i gjyshi, një pushkë e gjatë tri pash, që mbushej nga gryka e që i thoshin, nëse nuk gabohem, shishane.

Më pas, kur jam rritur, unë kam mësuar se gjahtarët janë disa herë të lëvdatave dhe për atë gjyshin e sime gjysheje unë isha bindur se kishte qenë gënjeshtar. Gjyshja më kot përpiquej të më mbushte mendjen se historia na qe e vërtetë.

Por ju pritni përrallën, një përrallë me keca. Dëgjojeni siç e mbaj mend unë dhe e tregonte ime gjyshe:

Nëna dhi na kishte pjellë dy keca, dy binjakë. Të dy me rrezhda²⁾ te qafa, si vathë të xhevahirtë. Njëri kec ishte i bardhë e me pulla të kuqe, tjetri i kuqërremtë e me pulla të bardha. Njëri shyt, tjetri me brirë. Mashkulli qe shyt, femra qe me brirë, ndryshe nga ç'ngjet zakonisht. Po dhe kecat në fjalë nuk qenë si gjithë kecat: ishin të jashtëzakonshëm. Të jashtëzakonshëm jo vetëm se ishin të bukur shumë, por edhe se ishin përmbi

1) Gjilpërë e madhe.

2) Kokërrza prej mishi.

të zgjuar. Kecat janë të zgjuar, bile dhe të djallëzuar. Kecat tanë ishin trima, jo fjalë. Se ç'trima ishin, e merrni me mend ju vetë, po të kujtoj se, që ditën që dolën nga barku i nënës, morën edhe arratinë. Nëna, e lodhur shumë se i polli, i lëpiu sa i lëpiu dhe e kapiti gjumi. Shyti i tha motrës me briërë:

— Si thua, moj motër, dalim e shohim njëherë se ç'bëhet jashtë njishës? (Njishë i thonë kasolles së dhive.) Pa shih ç'diell i ndritur hyn që nga kjo e çarë!

Dhe ata kishin dalë pa bërë zhurmë. Nëna dhi s'kishte ndier fare. S'u ishin marrë këmbët aspak kecave.

Dielli ndrinte me të madhe jashtë. Te porta e njishës ishte një dëllinjë. Dëllinja s'kishte asnjë fletë në degët e saj poshtë, po vetëm në një degë në maj. I tha briarja shytit, të vëllait:

— Vëllacko, e di ti përse kjo dëllinjë s'ka fletë veg në majë?

— E di, — tha shyti. — Ia kanë ngrënë, motërz. Po unë do të ngjitem e do t'ia ha edhe ato fletët atje lart. Do të hash edhe ti, se ta ul degën unë.

Dhe një të thënë e një të bërë.

Ju e kuptoni shqetësimin e nënës dhi kur u zgjua dhe s'i kishte kecat e saj pranë. — Bobo! Bobo! Një të kërcyer bëri nëna jashtë. Kecat i gjeti, po ku? Tek po pinin ujë në një përrua shamatar, me ujë qelibar e të ftohtë akull. Atë ditë bënte ngrohtë dhe fletët si gjemba të dëllinjës kishin qenë të shijshme fort. Ca nga etja, ca nga shija, kecat tanë nxituan të pinin te përroi, midis gurëve, midis shkëmbinjve, ku llapashitej drita e diellit me shkëlqime një mijë, ku lëviznin edhe trofta si shigjeta.

I qortoi nëna të vegjlit e saj.

— Pa çelur mirë sytë në jetë, more, — i tha kecja briare të vëllait, shytit, — dhe të na qortojnë? Po kur të rritemi dhe ca?

— E ç'bëmë, të lutem? — e pyeti binjaku binjaken. Sidoqoftë, nëna dhi, si gjithë nënat, bëhej domosdo merak për të vegjlit e saj.

— Ja, — tregonte nëna, për t'i trembur ata, që, pa

çelur mirë sytë, kishin marrë arratinë gjer te përroi i rrëmbyer. — Ka edhe ujk! Dhe ujku këtej vërtitet, rrotull njishës! Ujku s'i bën dot ballë as capi ynë përçor, që është vetë sa një ujk dhe me ata brirët si hej, dhe jo t'i bësh ballë ti, more trimosh, e ti, moj trimoshe!

Kecat duhej të kishin shumë kujdes, thoshte nëna. Pa nënën, kurrë të mos dilnin. Dhe kur të ishin në kasolle vetëm, askujt të mos ia çelnin derën, se ujku është i djallëzuar shumë. Ai vjen, hollon zërin, e bën si të nënës dhi, ti gënjehesh dhe hap portën, ai fap të kap dhe hop të kullufit!

— Po me ty, thua se s'na kap e s'na kullufit ujku? — i tha shtyti s'emës dhe i shkeli syrin së motrës. — Ujku që s'do t'ia dijë as për cjamin përçor, që është vetë sa një ujk dhe me brirë si hej, si do t'ia dijë për ty, makar dhe për ne të tre bashkë!

Nëna bëri të flasë, po nuk diti ç'të thotë. Briarja ia pat:

— Nënë, — tha, — ky është frikaman, se është shty. Po unë dhe ti jemi të armatosura me brirë. Bamp ti në kokë ujkut, bamp dhe unë në bark, e copëtojmë të ligun!

I hyri frika së tepërmi nënës për këta dy guximtarë të këqij, i këshilloi prapë dhe, kur i linte vetëm në kasolle e dilte për punë, rrinte me zemër të ngrirë. Por ajo që do të ngjiste, ngjau. Ujku vërtet ia çatisi një ditë, kur nëna dhi nuk ishte, dhe u shtri si nëna. Kecat e njohën se kush ishte dhe bënë sikur s'e njohën.

— Unë jam zemëruar me ty, moj nënë! — i tha briarja ujkut. — Ti atë përrallën me ujk e me qengj nuk na e ke treguar e nuk e ke mbajtur fjalën! Po nuk mbajte fjalën, ne derën s'ta çelim.

Nisi ujku të tregonte përrallën, nisën kecat ta pyesnin për këtë e për atë, — si e kishte ujku zërin (dhe ujku bëj zërin si ujk), si e kishte bishtin (dhe ujku nxirr nga fustani bishtin që ka fshehur), si e çante qengjin (dhe ujku skërmit dhembët e zgurdullo sytë). U zgjat kështu përralla që nga Elbasani e gjer në

32704

80660

Godolesh. Po sado që zgjati ajo përrallë, prapë mori fund.

— Çeleni derën, bijtë e mi, — u tha kecape ujkut i shtirë si nëna dhi.

— Unë jam zemëruar me ty, moj nënë, — iu kthye shyti, — se ti nuk na ke treguar atë përrallën e ariut që e hëngrën grerat; nuk e ke mbajtur fjalën. Po nuk mbajte fjalën, edhe ne derën s'ta hapim.

Nisi ujkut të tregonte përrallën. Nisën kecat të pyesnin për këtë e për atë, — si i ka turinjtë ariu dhe si i ka putrat, si janë grerat e si s'janë, si kafshojnë ato dhe... dhe fundin ju e gjeni vetë. Në mos e dini, prapë po jua tregoj: ia behu bariu. Bariu kishte pushkë, pushka bëri bam dhe e vrau ujkun.

Kur erdhi nëna dhi, ajo i gjeti kecat e saj tek goditnin — me brirë njëri e me kokë tjetri — lëkurën e ujkut, që bariu e kishte rrjepur dhe e kishte varur jashtë njishës. Ata iu lëvduan nënës se e kishin vrarë vetë ujkun dhe ia molloisën kaq bukur historinë, sa nëna e besoi.

Kështu duhej ta tregonte përrallën ime gjyshe, se babai duhej ta tregonte ndryshe, por unë nuk e mbaj mend ashtu.

Im gjysh nga nëna

Ai emrin e ka pasur Stasi dhe ky emër ne na bënte ca të qeshnim, se edhe sime gjysheje nga nëna i thoshin Stasie. Bota e thërritnin Stasia e Stasit. Kështu që edhe unë, kur doja të lozja me të — dhe asaj i pëlqente të lozja me të, se edhe ajo lozte shumë me mua — i thosha:

— Më griu për bukë, o moj Stasia e Stasit!

Ajo më sillte bukën e më thoshte:

— Na, që mos u ngopsh kurrë, që ke mbetur dhe si një shkop e nuk po vë tul fare.

Unë ia ktheja për ta ngacmuar:

— Stasit, tim givshi, i kam ngjarë.

— I ke ngjarë? — hidhej ajo. — Pa shih se çfarë hunde që më ke ti!

— E kam si të Skënderbeut, — ia ktheja unë, gjoja krenar për hundën kërrute që kam, kurse ajo lëvdonte Stasin e saj, i cili kishte qenë «i bukuri i shokëve».

Gjyshja nuk e tepronte: e vetmja fotografi që kishte nga i shoqi, Stasin e paraqiste të pashëm fort.

Ai kishte pasur tipare gjysmë bionde, kurse unë, korrozi dhe kaçurrel si arap. Mustaqja i varej hijshëm mbi dy buzë as të holla as të trasha. Kishte sy të çelët dhe ëndërrtarë. Dukej i hajthëm në fytyrë, si në shtat. I veshur me benevrekë të bardha e me xhaketë

prej kadifeje, ai mbante qeleshe të zezë. Mbi këmishë a mbi mitan një qostek të hollë e të pangarkuar. Dukej se kishte ditur të vishej dhe gjyshja thoshte se ishte sqimatar. Vdiq në të mbushur 30 vjetët. Po në fotografi dukej edhe më i ri.

Unë s'kam qenë një fëmijë i shëmtuar, por ah! Ti kisha ngjarë Stasit. Dhe, meqë s'isha dhe kaq i shka-thët nga duart, ime gjyshe më thoshte se kisha lindur për mullis si Kovi, im gjysh nga babai. I shoqi i saj kishte qenë sahatçi.

— Po mirë, — s'e lija unë pa ngacmuar gjyshen, — s'more dot një tjetër ti, moj, po more një Stas?

— M'u bëfsh kurban! — më hidhej ajo. — Unë mora atë farë burri!

— Në fillim e pata pak zor, — tregonte ime gjyshe, — se nisën shoqet të më vinin në lojë: Stasia e Stasit! Më vinte edhe më shumë inat kur mendoja se dhe atë e vinin shokët në lojë: Stasi i Stasisë! Po u mësova, siç u mësua edhe ai, siç u mësuan dhe bota. Dhe kjo na shkante punemadhe të dyve.

Aq duhej t'u shkante, sa unë s'e merrja dot me mend që sime gjysheje t'i thoshin, bie fjala, Stasia e Sotirit ose Stasia e Mimës.

Im gjysh, Stasi, kishte qenë sahatçi dhe bir sahatçiu. Kur e ngritën kullën e madhe të gurtë, që ka sot sahati i qytetit të Elbasanit, Stasi kishte qenë akoma i ri dhe sahatin ia kishin dhënë në kujdes t'et, Palit. Por i ati, që e donte fort të birin, zanatin ia kishte dhënë si jo më mirë. Sahatin e qytetit ia la kështu nën kujdes Stasit. Kjo ngjalli pëshpërime dhe zilitarët gjetën shkak të flasin nëpër pazar. Po të qëllonte që sahati i madh të shkante përpara ose prapa pak minuta, — a ka sahat që s'i bën «nazet e veta», le të jetë edhe një sahat qyteti? — bota thoshin:

— Ja se si shkon puna kur e marrin në dorë çunakët! Stasi atëherë ishte tetëmbëdhjetë vjeç.

Pali zemërohej, merrte inat, i grindej të birit, ndonëse e dinte se nuk kishte faj; po ec e mbaj gojën e botës.

Stërgjyshi im kishte qenë një sahatçi i dëgjuar. Atë e merrnin gjer në Kavajë e në Durrës për të ndrequr sahatët e këtyre qyteteve, kur nuk shkonin mirë. Ai kishte vendosur sahatin e Prezës, kur ky fshat i madh i Tiranës deshi ta tregonte veten mbi të tjerë, atje përkundruall Krujës.

Pali vdiq posa martoi të birin. Gjyshja ime thoshte:

— Gëzimet e mëdha qëllon t'i vrasin njerëzit.

Unë bëja buzën në gaz. Ajo ngulte këmbë:

— Ti të bësh fëmijë shumë, që të kesh gëzime shumë. Po të kesh një djalë të vetëm, rrezik se të zë zemra kur ta gëzosh.

Ajo vetë kishte vetëm një djalë dhe unë as nuk doja t'u besoja fjalëve të saj dhe as i kuptoja me gjithë mend. Gëzimi i saj që i patregueshëm kur martoi djalin. Djali bëri pesë djem dhe ime gjyshe arriti t'i shihte tre prej tyre me nuse e me fëmijë.

— E, moj gjyshe, — i thosha unë, duke kujtuar Stasin, të shoqin.

— E, e, — thoshte ajo, — po ai ka qenë sahatçi.

Ç'desh të thoshte me këtë ime gjyshe, «ka qenë sahatçi»? «Zembrekët» e sahatëve, sipas saj, janë si «zembrekët» e njerëzve dhe një «zembrek» njeriu — një zemër — na qenka shpesh më delikatë. Ec e merr vesh time gjyshe. Por ajo kishte krijuar «teorinë» e saj, posa e pësoi aq rëndë në jetë.

Se s'kishte kaluar shumë vjet pas vdekjes së Palit, kur ja, një ditë sahati i qytetit lajthiti pak si shumë, nja dhjetë minuta, dhe kajmekani nuk ia dëgjoi as kambanën. Ky dha urdhër që Stasit t'i merrej sahati dhe t'i jepej një ustai tjetër. Ustai tjetër, për këtë, me sa dihej, kishte paguar tri mexhide të arta, që bënë pesëmbëdhjetë lira turke, dhe kishte futur mik edhe beun e madh.

U përpoq i varfëri Stasi, me ata miq që kishte, po ku i dilej beut të madh përpara?

— Shit shtëpinë, — i tha Stasia, po shtëpia e tyre nuk bënte as dhjetë lira dhe do të duhej që Stasi të

paguante dy herë më shumë bakshishe, se aq i kërkuan.

U qa Stasi me «harzuall»¹⁾ në Manastir, po valiu as që u përgjigj fare. U ngrit e vajti vetë në Manastir, po valiu kishte qenë për gjah, ku kishte thyer një këmbë a një dorë — që të kishte thyer më mirë kokën! — dhe Stasi ishte kthyer si vajti.

Ai vuri maraz të madh. Kishte pasur sedër të madhe, se, fundi i fundit, edhe pa kurdisur sahatin e qytetit, edhe pa u marrë me zembrekët e me kabanën e tij, Stasi mund të rronte siç pati rrojtur nder e për nder, i çmuar midis ustallarësh.

— Po sedra sedër! — psherëtinte me lot në sy ime gjyshe. — Burri burrë! — dhe tregonte zemrën, për të thënë se Stasi e kishte pasur «zemberekun» jo të fortë.

Burri nisi të mos hante dhe vuri duhanin, që s'e kishte pirë gjer atëherë, dhe ia preu oreksin fare. Raki nuk pinte dhe zuri të pinte. Nuk pinte përditë, ashtu siç bënin disa, po kishte ditë që e tepronte shumë, aq sa këmbët nuk e sillnin dot në shtëpi.

— Është poshtërsi e poshtërsive kjo që më bënë! S'dal dot në pazar, se tallet pazari me mua! — buçiste Stasi dhe grindej me muret e shtëpisë, kurse në dyqan, kur mërzitej shumë, nuk dilte, sahatët e botës nuk i ndreqte me kohë ose nuk i ndreqte fare; ndonjëherë, në vend që t'i ndreqte, i prishte.

— Të erdhí e keqja, çeli derën! — thoshte gjyshja. — «Jemi të rinj, more Stasi (i thosha). U bëmë me dy fëmijë dhe po bëhemi me një të tretë. Vëri, more burrë, gishtin kokës, se na mori rrokëllima!» «Dëgjo! (bërtiste ai). Sahati i madh binte në pazar dang, dang, dang, sikur bie një kabanë për vdekje». S'qe një punë: ajo kabanë e mori! Sedra të ngre, sedra të fut në dhe! Biri im, të kesh sedër, se pa sedër nuk i thua dot vetes burrë. Po me sedër dhe me gisht në kokë. Pa vështroje, pa vështroje tët gjysh.

1) Lutje.

Unë vështroja fotografinë mbi mur. Stasi i Stasisë kishte një vështrim të butë, pak të menduar e me shumë ëmbëlsi. Po kishte edhe diçka të thyer në atë vështrim prej njeriu me sedër shumë. Ku e kishte pasur ai tërë atë sedër, që e kishte vrarë? Gjithë kjo mbetej për mua e pakuptuar. Vetëm ndieja shumë dhembshuri. Dhe nganjëherë, kur dëgjoja të binte sahati i qytetit, dang, dang, më hipte të rrëmbeja gurët dhe të shkoja e t'ia bëja xhamat copë! Kurse gjyshja disa herë e dëgjonte me një drithërimë të patreguar.

Mani i vogël

Mani ishte i vogël vërtet. Emrin e kishte Mani i Manosmanit. Duhej të kishte pasur edhe një Man të Madh në fisin e tij. Ky mund të kishte qenë Man Osmani, gjyshi ose stërgjyshi i Manit të Vogël.

Për njerëz si Mani i Vogël thuhet se «mezi bëjnë hije përmbi dhë», kurse ai hijen e bënte vërtet të madhe. Të madhe, sepse Mani kishte një kokë sa për dy bashkë dhe, përmbi kokë, një qeleshe të bardhë dy pëllëmbë.

Qafën Mani e kishte të shkurtër; ta kishte pasur të gjatë, do t'ia këpuste barra e kokës. Po shpatullat i kishte të gjera, një kut¹⁾ këtej e një andej. S'të besohet se çfarë shpatullash të gjera që kishte. Dhe mbi njërën e mbi tjetrën shpatull, nga një turrë basmarash — këtej të bardha, andej me lule — këto për të rejat, si thoshte, ato për plakat. Për të rejat, gjithë trëndafila e mëllaga, që «të lulëzonin»; për plakat, të bardha, «që të mos nxijnë kurrë» dhe «të rinohen», thoshte Mani. Ai mbante edhe basmara të zeza, se dhe ato kërkoheshin, por ato i zhdukte midis të tjerave dhe, po të mos ia kërkoi, nuk i nxirrte.

— Të bukura basmatë! Të bukura për të ratë! Më të

1) Njësi matëse më e vogël se metri.

bukura për plakat e për të vatë¹⁾! — e lëçiste²⁾ Mani mallin e tij.

— Thotë të vërtetën, shejtani, — pohonte ime gjyshe e mbetur shumë e re pa burrë dhe që pleqëria sikur s'donte t'i trokiste në portë.

— Të bukura basmatë! — gjëmonte zëri i Manit rrugicë më rrugicë të lagjes sonë dhe gratë nxitonin kush ta fuste e para në shtëpi dhe të shihte se ç'kishte sjellë të re shitësi, se, për të blerë, para kishte pak.

Mani i vogël shkarkonte e ngarkonte basmarat — «plaçkurinat», siç u thoshin — derë më derë dhe mezi arrinte të shiste diçka. Po «beregaves», ia bënte ai, përherë buzagaz, sado pak që të shiste.

— Të bukura, të bukura basmatë! Si për të ratë, si për plakat, si për të vatë! — gjëmonte zëri i shitësit.

Nga i buronte gjithë ai zë? Dëgjohej që tri rrugica përtej tek gjëmonte. Dhe dëgjoheshin edhe këpucët e tij të mëdha me gozhdë, se nuk i lidhte, po i llokoçiteshin nëpër këmbë (ishin këmbët që llokoçiteshin në to. Si ato këpucë, dy vetë kishin në Elbasan, Mani dhe një hoxhë qorr, që bridhte pazarit dhe e mbanin për të shenjtë, po që ishte një i djallëzuar. Të dy xhuxhmaxhuxhë, ama asnjëri s'bënte hije përmbi dhë, as Mani me plaçkurinat, as hoxha me «shenjtërinë» e tij.

Mani thoshte:

— Unë e shes basmanë më lirë se Hoxhë Qorri shenjtërinë. Basmaja ime të vesh, shenjtëria e tij të lë lakuriq: ajo vesh vetëm Qorrin. Dhe jo vetëm që e vesh, po edhe i mbush barkun e i fan³⁾ xhepin. Unë barkun e kam zgrob⁴⁾ dhe xhepin të urtuar, — qeshte hidhur Mani i Vogël.

— Të bukura, të bukura basmatë! — dëgjohej që

1) Gratë e veja.

2) I bënte reklamë me zë.

3) Ngop.

4) Bosh.

tej zëri i Manit dhe i trokitnin këpucët kalldrëmeve që tej.

Ai ngjitej në çardak, hapte basmarat njëra pas tjetrës, me radhë e me kujdes. Çardaku shendonte me shtrojat më të bukura, njëra basma më e bukur se tjetra, — «se unë me një kusht rri tek agai, — lëvdohet shitësi, — që të më japë vetëm më të bukurat e basmave», dhe kjo qe e vërtetë.

Kur mbuloheshin me ato shtrojat, çardaquet tona bëheshin kopshte me lule. Dhe midis atyre luleve, — Mani, Mani «si një gjembaç», thoshte ime gjyshe. I kishte nganjëherë si hala hokat!) e saj ime gjyshe: të gjembonin. Po Mani s'e prishte zemrën kurrë. Dhe kur hapte plaçkurinat e tij, ai vetë i pari mrekullohej me bukurinë e tyre, le t'i hapte njëzet herë ditën, çardak më çardak.

— Apo s'janë të bukura! — shastiste Mani midis atij kopshti, kurse gjyshja ime ia priste:

— Kur futet ky shejtan në shtëpi, s'ka qese që nuk zgjidhet.

Shitësi vinte buzën në gaz. Sa qese kishte mundur të zgjidhte asaj dite Mani i Vogël. Ndonjë të rrallë, me sa dukej.

Sidoqoftë, Mani, që i njihte qeset e rrugicave tona, edhe basmarat i sillte sipas qeseve. Kishte raste kur nisej vetëm për qeset e të varfërve, — për «kokëhudhrat», siç i quante ai, thua se kishte lexuar vargjet e Çajupit. Kishte raste kur shitësi nisej vetëm për qeset e të pasurve, — për «kokëgjylet», tundte kokën e tij Mani, që e kishte sa një gjyle.

— Po të tëra të bukura! — reklamonte shitësi mallin, dhe kjo qe e vërtetë.

Ai sillej në mes të atij kopshti që na shtronte mbi çardak, me qelshen dy pëllëmbë, me kutin prej hekuri në dorë, me zërin që s'i pushonte asnjë çast,

1) Shakatë.

si një këmborë e kurdisur njëherë dhe që më nuk shkurdisej.

Nuk shkurdisej! Për fat të keq, Manin e zinte nga njëherë një kollë, që i shkallmonte kraharorin e gjerë; sytë thua se i kërcenin në ballin e tij me prag e ti thoshe se do të villte copa mushkërish. Atëherë gratë s'dinin ç'të bënin për të shkretin Man, — kush nxitonte e sillte gotën me shurup e kush çajin. Ai mezi qetësohej dhe, i ulur ose i shtrirë midis kopshtit të vet, fillonte përsëri t'i thurte lavdet mallit, mallit edhe agait.

Aganë ia quanin Haxhi Mulla. Haxhiu mbante një sarëk¹⁾ prej kashte e një shall mëndafshi ngjyrë ari, si andej nga Qabeja, ku kishte qenë që i ri për të siguruar xhenetin.²⁾ Kur e zinte kolla shitësin e Haxhi Mullës, ai ia shtrembëronte emrin agait e ia bënte Xhjulla. Gratë ia krisnin të qeshurit, të mësuara me kollitjet e Manit, kurse Mami vetë përpiqej të qeshte nëpër torturë dhe të mos harronte ndonjë bekim për Xhjullën, «shpirtmadhin e kësaj dynjaje».

Gjyshja ime atëherë zemërohej e ia plaste:

— Iu krimbtë shpirti në xhehne³⁾ të xhehnemit qenit!

Mani frikej, kolla i pritej, ai lutej:

— Mos, moj nënë!

Se Mani i Vogël kishte një karvan me kalamaj dhe duhej të shiste plaçkurinat e Xhjullës, që të mbante fëmijët me bukë. Dhe jo vetëm të shiste, por edhe të vidhte myshterinjtë për Haxhinë reshper.⁴⁾ Nëse agai i besonte, ta zëmë, 50 kut mall, Mani i Vogël duhej t'i kthente para sa për 55. Kështu tregonin. Po të mos hante në kut, po të mos i shiste në atë mënyrë plaçkat,

1) Çallmë.

2) Parajsën.

3) Skëterrë.

4) Tregtar stofrash.

për 5 kut tepër, Haxhiu ia mbante të 5 kutët nga shpërblimi që i jepte.

Thua të kishte zemër hajduti Mani i Vogël? Unë s'e kam besuar. Por nëna me gjyshen thoshin se ai hante në kut, si gjithë shitësit e plaçkurinave. Dhe kur Mani i Vogël niste e maste basmatë, gratë i qëndronin si gjeraqina përmbi krye.

Gjyshja e pyeste:

— Thuaj, më qafsh, sa ke (bënte ajo një gjest që tregonte vjedhjen) për aganë?

— Meazallah! — ngrinte duart me gjithë kut Mani i Vogël.

— Po për vete, a ke vënë mënjanë ndonjë bërxxhik? — e ngacmonte gjyshja.

Mani shtangte me duart e me kutin lart. Ai s'kishte vjedhur.

Nëna i bërtiste gjyshes:

— E teprove, ti, mome!

Gjyshja qeshte dhe nxitonte e i sillte kafënë shitësit, po nëna vazhdonte t'i bënte sytë katër kur ai maste basmanë. Kurse mua më prishej zemra, si më prishet edhe sot, që po i tregoj këto.

Mani maste dhe, si fajtor, me kokën të varur mbi basmara, mbaj mend që të ketë mërmëritur njëherë:

— Unë... unë, edhe sikur të... ha... në kut, në shtëpi të Filip efendiut nuk e bëj kurrën e kurrës! E kam mësues të çunit të madh! S'ia bëj haram mësimin çunit! Kurrën e kurrës!

Mani maste e priste pak basmanë me gërshërë dhe e shqyente, duke hapur pashin e krahëve e duke thënë urimin e rastit, — «e mbajçi me shëndet!» — niste pastaj e paloste përsëri mallin, e ngarkonte mbi supet e tij të gjera dhe mezi i zbriste shkallët e çardakut me ato këpucë si pranga, nën peshën e kopshtit që shkante ta shpaloste gjetiu.

Një viti, Mani i Vogël nuk u duk me muaj rrugicave tona. Kishte shitës të tjerë basmarash që endeshin nëpër Kala, po lagjes i mungonte Mani i saj i Vogël dhe shitësit e tjerë nuk i kishte qejf. Ata ishin hajdutë të prapë.

Veçse ja, një ditë, Mani u dëgjua që tej dhe të gjithë e pritëm me gëzim. Po përse nuk ia dëgjua zërin? I dëgjua këpucët me gozhdë. Kuti i tij trokiti kalldrëmeve dhe portave. Zërin e kishte të mekur fare.

— Duket i sëmurë, — tha nëna.

Mani i merreshin këmbët. Ai mezi ngjiti shkallë: tona dhe gjyshja nxitoi e i nxori një gotë ujë e një lugë mjaltë. Mani u qa, se kishte rënë shumë nga shëndeti. Në fytyrën petë dylli, sytë i shndritnin si prej ethesh. Ai mezi i shtroi basmarat përmbi çardak, se i merrej fryma. Po ç'basmara!

— Thoni që s'janë të bukura! — ia bënte Mani dhe qëndronte midis tyre tërë përgjërim. — Një gjylistan e shkuar gjylistanit.¹⁾ S'të kam sjellë basma të bukura si këto ndonjëherë, moj nusja e Filipit. As më të lira. Kri-zë: i ra pahaja²⁾ mallit.

Midis basmave, i ziu Man i Vogël ngjante më shumë me një dordolec. Mua më qahej dhe gjyshes nuk i jepej të bënte asnjë shaka. Mani e kishte kot që përpiqej të lëvdonte mallin: malli fliste vetë. Shitësit mezi i dilte një zë i çjerrë. Dhe kujt? Atij që kishte pasur një zë këmbore.

Gratë e zgjodhën shpejt e shpejt plaçkën që u duhej. Ato shkelnin zbathur mbi basmara, kurse Mani rrinte gërmuq midis mallit të tij, pasi kishte hequr edhe ai këpucët e i kishte lënë aty, në krye të shkallëve, si dy qen besnikë që kishin pushuar së lehuri. Ai mbante çorape leshi të zeza me njëqind arna ngjyrash të ndryshme. Çorapet s'kishin lule, po gjemba.

Gratë zgjodhën shpejt e shpejt për të mos e lodhur Manin dhe shitësi u vu të maste me kutin që i dridhej në duar. Po ja, e zuri kolla, ajo kolla që i shkallmonte kraharorin. Gjyshja nxitoi dhe e ndihmoi të shtrihej, nëna rendi për gotën me ujë, por kolla s'i pushonte. Ai rrotullohej në vend, sikur po e thernin, dhe kishte një

1) Trëndafilishtë.

2) Vlëra.

të keq të madh, të cilin shtrëngohej ta përmbante me duart grusht në kraharor. Kur vuri gotën në buzë që të pinte prapë, i gulçoi gjaku si grykë gjymi dhe i mjერი njeri u përmbys mbi basmara, ku blana e kuqe u bë pellg.

Më kot u munduan gratë ta ngrinin Manin. Ç'të rrëfej? Ai u përpëlit disa herë dhe pastaj ra përmbys e më s'u ngrit. Qeleshja e bardhë iu rrëkëllye nëpër pellg.

Mbaj mend klithmën e gjyshes:

— Po ky vdiq, moj e zezë!

Unë u fsheha në shtëpinë e zjarrit, ku nisa të qaja. Nuk vonoi të turbullohej e gjithë lagjja.

Ç'të rrëfej tjetër?

Haxhi Mulla kishte nxituar që nga pazari me mallkime për Manin e Vogël, që «i fëlliqi plaçkën» dhe «i prishi katandinë».

E Ëma e Vatrës

E zini me besë ju se njeriu mund të niset një orë udhë për një dorë lëmishte për dy dru, jo se s'ka ç'të ndezë në vatër, po për të hapë një zjarr me degë ulliri?

Lëvdojnë dushkun e lisiin për zjarr. Dhe kanë të drejtë. Të ngrohesh, s'i thonë shaka. Lisi me dushkun a me qarrin e bëjnë prushin sikur ta kesh mbushur vatrën me zaje të skuqura. Dhe një kërcop¹⁾ i plotë mund të mbajë plot një natë, po mban edhe dy, edhe tri net.

Lëvdojnë shkozën, që e bën prushin të vogël, por të fortë. Dhe ka një si këngëzë shkoza kur digjet, thua se një bujkth është futur midis flakëve e ia thotë me një fije zëri. S'ka asgjë melankolike në atë zë. Është një iso që përcjell flakët përtej oxhakut, — të bukura ato flakë, të lëvizshme, si perde të mëndafshta, kur fryn thëllimi nëpër plasat e dritareve, mbrëmanet, tinës, më të rënë të diellit, kur perdet e bardha marrin në të kuq dhe shkrepstin ndonjë kënd i xhamave të mbyllur.

Mua, kur digjet druri në vatër, lis qoftë ose shkozë, ose ç'të jetë, afshi nuk më hyn në trup po s'ia ndjeva bukurinë flakës. Ç'bukuri mund t'i gjesh drurit të shqopës ose atij të dëllinjës? Ky kërcet në zjarr si-

1) Trung.

kur të jesh duke pjekur bubuzhele! Dhe kërcejnë ciflat e ndezura nëpër shtëpi, që mund të t'i bëjnë shtrojat copë, sikur t'u ketë rënë karkaleci.

Mbi gjithë drurët them se është druri i ullirit. E them këtë jo se jam nga një vend ullishtash dhe se ai na ka ngrohur gjysh pas gjyshi, pa jemi rritur me afshin e tij në trup, na ka hyrë në palcë të kurrizit, na ka lidhur kockat, po pikërisht se na ka përcjellë netëve të gjata me flakët e tij të çuditshme, që të futin në ëndërrime. Kur digjet në vatër, ngrohtësia të hyn nëpër pore si një vaj dhe flaka të hyn në sy si një dritë që të ëmbëlson të parit. Të duket se ai zjarr të bën më të shëndoshë e më të mirë. Ia sheh flakën si nuk nxitohet kurrë, por ia merr veç me të shtruar, si një mendim i pjekur në kupën e syrit të shtëpisë, që është vatra. Ajo flakë nuk bubullon, ajo as që ndihet fare, po një këngë të fshehur ta kullon mu në zemër, thellë e më thellë dhe të ndriçon përbrenda të gjithin. Digjet si njëherë njëherë, e bardhë e si më të blertë, a më shumë si më të rimitë, e qetë si një rrjedhë drite. Ajo i përcjell drurët dhe, ndonëse i ronit¹⁾ për së gjati, përherë duket se më shumë i vesh me velin e saj të ndritshëm, që t'i stolisë. Druri nuk digjet, ai tretet. Ai nuk kuptohet se si shkërmoqet në një mori kongjijshtë veckël, si yjtë që mbushin qiellin, le të jetë gri ky qielli i vatrës dhe që ka zbritur te gjunjët e tu, dhe ti qëndron këmbëkryq pranë tij si pranë një qilimi magjik, që sa të ngroh, edhe të mahnit. Thua, or ka në botë zjarr më të bukur se ai zjarri i drurit të ullirit e më të ngrohtë e më të ëmbël se ai, më ëndërrimtar? Druri digjet si me një ëndërrim, — tani e gjeta ç'desha të them. Kush e njeh atë zjarr, le të thotë se mbase e teprova, kush nuk e njeh, le të më besojë e të gjejë rastin të ngrohet njëherë me dru ulliri.

Unë s'di a kam qenë kaq i mërdhirë sa të kem merituar emrin E Ëma e Vatrës. — E Ama e Votrës, siç i

1) I shkatërron, i copëton.

thonë tamam. Të paktën nuk më përmendet të kem qenë kaq i mërdhirë. Mbjaj mend se, kur binte dëborë e madhe në Korçë, unë, fëmijë, isha gati të rendja mbë udhë me punë e pa punë, vetëm që të çaja dëborën gjer më gju. Dhe kur akulli bëhej një pëllëmbë e dielli qëndronte në qiell si në një burg xhami opak, unë kërcëja i pari nëpër kolovajze. Acari ma bënte hundën si një piperkë të kuqe, që ta thërroje në misurin me fasule, aq përcëllonte. Erës së Krastës të Elbasanit, që im atë i thoshte se ka tharë edhe një tepelenas, i cili u lëvdua se paska qenë «vendar i erës», unë i qëndroja përballë me dëshirë, le të m'i fshikullonte veshët jo me hithra, po me thupra, kur frynte grykës së Shkumbinit, e lëshuar nga malet e Çermenikave dhe të Poliseve.

Kur ndizej zjarri, unë bëhesha njësh me vatrën, pjesë e saj. Vetëm që nuk digjesha bashkë me drurët. Ne kishim një shtëpi zjarri pa dritare, ku hynte pakëz dritë nga një baxhë sa një frëngji, ku llamba zakonisht rrinte e ndezur gjithë ditën në dimër. Kjo shtëpi zjarri, të cilën dielli nuk e shihte kurrë, ishte si një Pol i Veriut. Babai kështu i thoshte. Kurse gjyshja e quante Shpella e Shëndreut. Sot do t'i kishim thënë frigorifer. Unë kisha dëgjuar se nëpër shpella varej akulli qiri--qiri, — stalaktitet, që s'janë akull, siç e dini, por i formon lëngu i gëlqeres që rrjedh tavanëve të tyre. Neve, përpara se t'i vinim tavan shtëpisë së zjarrit, na qëndronin përmbi krye trarët dhe qeprat e zinj e nëpër ta era frynte si në një gorgë.¹⁾ Në atë shtëpi zjarri i kishte hyrë një herë e mirë mardha tim eti, që s'i dilte më kurrë. Dhe, meqë unë isha një pjesë e vatrës, më thoshin E Ēma e Vatrës, dhe pandehnin se isha fort i mërdhirë.

E Ēma e Vatrës, në besimin e moçëm popullor, ka qenë, me sa duket, «shpirti» i plakës së hershme të fisit, i mëmës së fisit, mëmë e një kohe shumë të vjetër, kur në familje nuk sundonte akoma burri, po gruaja, — koha e

1) Grykë shpelle.

quajtur e matriarkatit. Fjalët popullore mbartin shpesh shumë histori, ndonjëherë edhe parahistori të largët fort... Sidoqoftë, mua më thoshin E Ēma e Vatrës, emër ky që nuk më tingëllonte dhe keq në vesh; bile që më pëlqente, edhe pse prindërit e mi kujtonin se unë mërdhija së tepërmi, — «e kujt do t'i ngjasë ky korb (thoshte gjyshja), në mos t'et?» — pra, më lëshonin përherë vendin më të preferuar të vatrës, qoshen, ku mbli-dhej kutullaç edhe maçoku i shtëpisë. Unë përfitoja dhe nuk ngrihesha t'ia lëshoja qoshen askujt. As edhe mysafirrit që mund të vinte, le të qe dhe plak, — dhe më thoshin edhe «murransh», pikërisht për këtë, siç u thotë në atyre pleqve që futen mu në hi nga të mardhurit.

Për mot ne kishim dru të mira zjarri, dru prelli¹). Drutë shtihen gjatë verës, si zahireja. Im atë lakmonte dushkun, që kishte më duk me kërcopët e tij të mëdhenj dhe me prushin e pasur e të qëndrueshëm. Unë desha drutë hollakë, drutë e shkozës, po më shumë ata të ullirit. Dhe nuk do ta besoni se, kur më merрте malli për një zjarr me dru të tillë dhe në shtëpi s'na gjendeshin, unë mund të bridhja pa pikën e turpit nëpër fqinjë për të sjellë në krahët e mi të njomë një vanda me dru ulliri. Askush nuk më përcillte duarbosh. Ndonjëherë ngarkohesha si një shitës drush në pazar, nga ata të varfërit, që s'kishin kafshë dhe i mbanin në shpinë drutë që nxirrnin për të shitur. Në shtëpi më qortonin, se s'më kuptonin, por ishte e kotë. Kurse im atë bënte kujdes që të kishte domosdo turrën e tij me dushk në qilar; për ullinj e për shkozë ai nuk kujdesej.

Kur vinte pranvera e shkadhiteshin²) drurët, në Elbasan secili shkadhiste ullishtën e tij. Nuk ishin pak ato shtëpi që kështu digjnin dru ulliri dhe ata shitës që nxirrnin dru ulliri në pazar. Po ec të kuptojë im atë se kjo E Ēma e Vatrës që ai ka djalë, futet në hi si

1) Vend që e zë shumë dielli.

2) Krasiteshin.

murransh jo sepse ndien kaq ftohtë në Polin Tonë të Veriut, po sepse nuk ngopet me bukurinë e flakëve dhe përgjon këngën e tyre në të fshehtë, po të ketë dru ulliri në zjarr.

Në pranverë, kur shkadhiteshin drurët, më pëlqente të shkoja në ullishtë, të mblidhja degëza lëmishteje, t'i lidhja me tërkuzë, t'i ngarkoja në shpinë e t'i sillja në shtëpi. Nëna më bërtiste, gjyshja më përqeshte, babai hapte sytë e bënte çudi. Kur merrnin ato degëza, zjarri bëhej menjëherë, — hidh e digj pastaj unë, që t'i shoh si qirinj e si kandle, dhe zemërohu nëna dhe nëm gjyshja, se i mbaroja lëmishtet aq fët, dhe gjej rast unë për t'u kthyer prapë në ullishtë, orë e pa kohë, për të sjellë të tjera, dhe shamatohu prapë me të shtëpisë.

E kisha bërë nja katër-pesë herë këtë marifet gjatë një stine, besoj se të atij viti të parë që u kthyem prej Korçë, ku dru ulliri nuk kishte dhe kur babai, sipas Korçës, shtiu dru dushku për stinën e ftohtë. I për-malluar për ullishtën e për drurin e saj, i tërhequr dhe nga puna e shkadhitesve, që «qethnin» drurët ashtu si qethen dhitë, me «gërshërë të madhe» — me sëpatë — unë, një herë a dy, lashë edhe mësimin e orëve të fundit që të veja për lëmishte. Domosdo, kjo mbaroi me një qortim të mësuesit e me një qortim edhe më të rëndë të babait. E pata dëgjuar atëherë babanë t'i thotë nënës:

— Ky çun shpesh është tuaf.

— Tuaf! Ç'janë këto fjalë të dhaskalit tonë, moj bijë? — ishte zemëruar ime gjyshe, duke e dëgjuar edhe ajo tim atë. — Ky shpirt mërdhi. I ati s'e kupton se i biri i kujt është ky djalë, — më pushtoi gjyshja në krahë, duke më thënë: — Shpirt, moj E Ëma e Vatrës sonë!

Mbaj mend se gjyshja, aty për aty, vuri napën¹⁾ e

1) Shami koke.

saj të bardhë mbi krye dhe zbriti shkallët, pasi i tha së bijës:

— Dola unë. Kam një punë gjer te Leka i Koloshit. Nëna u çudit.

— E, e, — ia bëri gjyshja dhe zbriti shkallët e mori udhët e lagjes.

Leka i Koloshit ishte një kushëri i largët i sime gjysheje, i varfër tek më s'bëhej, me një ullishtë që zor se i kishte 15 rrënjë pasuria e tij e tërë, përveç kolibes dhe... pesë a gjashtë kalamajve. Ai nga drurët që shiste, kur shkadhiste, i merrte pak korona.

«Shih kur gjyshja të na kthehet me një gomar me dru ulliri», thashë unë me vete, që e dija se ajo drutë e ullirit i mbante për më të mirat, ndonëse babai ishte lidhur pas dushkut.

Po gjyshja u kthye pa gomar e pa dru.

Veçse në fund të javës, në oborrin tonë, që në mëngjes, hyri Leka i ngarkuar me një barrë dru ulliri të zgjedhur e të prerë për qejf. Kështu bëri edhe pasdreke, kështu bëri edhe pasditeve të tjera, dhe më kujtohet gjyshja kur i numëroi së fundi në dorë dymbëdhjetë korona dhe Leka që më uroi e më bekoj:

— Paç jetën të gjatë e gëzofsh gjithë ç'të dashtë zemra! Të hëngërsha dasmën, moj E Ëma e Vatrës. Atë vit që të martohesh ti, unë do ta pres një ulli rroll¹⁾, që s'bën më kokrra, dhe do të ta sjell peshqesh në vend të dashit, që të ngrohesh me nusen tërë dimrin.

S'ju besohet, hë?

E rëndësishmja që se gjyshja më kishte kuptuar me mënyrën e saj, më kishte mbrojtur që s'jam tuaf, parvarësisht se mendonte që, edhe për të mardhur, unë isha i biri i tim eti...

1) Tepër plak.

S' e kam fjalën për çdo ceremoni

Kam përshtypjen se buallicat janë zhdukur. Nuk m'i zë më syri nëpër Shqipëri. Ndoshta sepse u zhdukën moçalet? Po liqenet u shtuan. Në Pogradec, buallicat e Starovës — edhe në Starovë s'm'i ka zënë më syri — «banjën» e bënin në liqen e jo vetëm në blatën¹⁾ pranë. Në Elbasan mbaj mend se futeshin te një rremë e madhe, që i thoshin Rrema e Pashës. Dukej sikur Rrema rrëkëllente buallica.

Ju kam treguar se, në lagjen tonë, buallica kishte vetëm një shtëpi. Mund të qenë pesë a gjashtë, të mëdha shumë ato kafshë, me brirë të ngërthyer. Kur kalonin rrugicave tona, duhej të futeshe në ndonjë portë ose të këmbeje drejtim, se zinin vendin. Pastaj, të ndillin frikën. Ishin të larta, si ca bina në lëvizje. Ishin elefantët tanë. Kishin sy të mëdhenj, të menduar, që shihnin ca si përpjetë. Çapiteshin rëndë, ngadalë, po edhe të qeta. Vendi nuk tundej. Nuk bëhej asnjë zhurmë e jashtëzakonshme kur kalonin. Edhe të vegjlit e tyre, kotorët, nuk qenë të lëvizshëm e lodëtarë si gjithë të vegjlit. Ata shkonin pas nënave, me një mendim të përhershëm në sy, sikur të kishin vënë hall përpara kohe.

1) Kënetë, gjol.

Ç'ishte ky hall? Mos mendonin se soji i tyre po shkonte drejt zhdukjes?

S'kam dëgjuar që mishi i buallicave të ahahet. «Mish bualli» do të thotë mish që nuk zien. Po qumështi i buallicës që i kërkuar: me të bëhej një kos që ta pritje me thikë. E kam shijuar dhe më ka pëlqyer shumë.

Buallicat ishin kafshë të urta, aq të urta, sa, merrni me mend, ato të lagjes sonë i kulloste një bari imcak e shkurtalac. Ishte i qetë, pa fjalë, ecte i menduar me kokën përpjetë dhe me një shkop të gjatë në dorë. Nga kotorët ndryshonte, se në turi nuk mbante gjemba hekuri. Kotorëve u lidhnin një si çark me gjemba, që të mos futnin dot kokën në gji të nënave dhe t'u pinin qumështin. Të zestë të vegjël!

Sado të urta qenë buallicat, prapë ato ndillnin frikë dhe jo vetëm me pamjen e tyre, por edhe se tregonin që nganjëherë merrnin ters, tërboheshin.

Njëherë Elbasani u vu në zi të madh. Flamurët u varën në gjysmë shtize në qeveri, në shkollën tonë e gjetiu. Çfarë fatkeqësie i kishte ngjarë shtetit tonë? Im atë buçiti në shtëpi dhe ndoti gojën. Na kishte vdekur djali i madh i beut të madh, diku në Evropë. Djali i beut kishte vite shumë nëpër shkollat e Evropës; në Elbasan s'ia kishin parë surratin kurrë. Nëpër Evropë atij nuk i thoshin as bej as pashë, tregonin, po markiz. Pra, na ishte evropianizuar zotëria gjer në titull, se emrin, që ia thoshin Alajdin, e kishte ruajtur. Alajdini kishte një llambë magjike — në përrallat e «Një mijë e një netëve» — dhe me të do të zbulonte të fshehtat e thellësive tokësore. Alajdini a kush tjetër në ato përralla fluturonte me një qilim magjik. Ky Alajdini ynë nga Elbasani çfarë kishte zbuluar në të thellat e Evropës dhe në qiejt e saj? Në Elbasan tregonin se kishte zbuluar kafenetë. Ky na ishte marifeti i tij i madh. Luftën e Madhe Alajdini e kishte kaluar në Vjenë. Në kryeqytetin e Austro-Hungarisë kishte zi buke. Nga Elbasani, Alajdinit i shkonin tërë llojet e ushqimeve, — arka

me peksimet¹⁾ të bardhë, dengje me pastërma, teneqe me vaj e me gjalpë, me djathë e me ullinj, kuti me ballakume²⁾ e kadaif e bakllava e çfarë jo, — fëstëk, lajthi, arra, fiq. Thoshin se markezit i kishin dërguar edhe tri buallica, që të hante kosin e tij të preferuar. Kjo, sigurisht, qe një shaka. Të tjerat qenë siç i tregova.

Një ditë prej ditësh Alajdini na vdiq, në Vjenë a në Romë. Vdiq nga një sëmundje, së cilës nuk i gjendej shërimi as atje. E balsamosën dhe e nisën për në vatan, që ta varrosnin në një xhami, ku kishte edhe stërgjyshin, edhe gjyshin me të tjerë, në mes të Elbasanit. Ai kishte sosur në Durrës, kur në Elbasan i vunë flamurët në zi. Na mblodhën edhe ne fëmijët e shkollave, na dhanë kurora dhe na nisën në rresht, me hoxhallarët e njerëzinë pas, që të dilnim tek Ura e Zaranikës për të pritur xhenazën³⁾.

Xhenazeja sosi me dy kamionë dhe një veturë. Mbi njërin kamion ishte Alajdini, i mbuluar në tabut me flamurin kuqezi, mbi tjetrin një tog xhandarësh të armatosur e me shirifin e zi të kapelës nën mjekër. Në veturë, beu i madh. Këto mora vesh, se për të parë s'pashë gjë të madhe.

Kortezhi i përmortshëm u nis për te Namazgjaja, — sheshi i lutjeve publike në mes të qytetit. Namazgjatë ishin të rrethuara me selvi. Kjo jona i kishte selvitë pesëqindvjeçare. Në to bënin çerdhen ushtri me laraska. Kur sheshi u mbush me njerëz dhe një hoxhë nisi të bërtiste lutjen e tij në një vend të lartë, majë disa shkallëve prej guri, njerëzia nisën të bënin atë si gjimnastikë të të falurit, bjerë e ngrihu. Laraskat re-re nisën të vërtiteshin nëpër qiell me krakerima, si vajtonjëse të porositura.

Ceremonia qe e gjatë, e kapitshme. Fëmijët hutonin pas laraskave. Më në fund, procesioni u nis për

1) Bukë e thatë.

2) Lloj biskotash të mira.

3) Të vdekurin.

te vendi i varrimit, xhenazeja përpara dhe ne pas, në rresht, me kurora. Por kur dolëm te sheshi i bashkisë, u bë një trazirë e madhe, një zallamahi e tmerrshme.

— Buallicat! — thirrën nga të katër anët.

— Buallicat! — u llahtarisën dhe morën shushavën¹⁾ njerëzia, duke u shtyrë, duke dërrmuar njëri-tjetrin.

Nuk di më se ç'u bë. Kujtoj vetëm një tufë buallicash që ishin lëshuar drejt nesh me një tërsëllimë të hatashëm. Shoh brirët e tyre, shoh kokërdhokët si grushte, pluhurin si re. Rashë përtokë, përmbys, si dhe shumë fëmijë, me ulërime, sikur ulërime jonë të dilte që nga thellësitë e tokës. Ne lamë kurorat dhe vrapin e mbajtëm në shtëpi. Ceremonia u mbyll si u mbyll, me një varrim te xhamia. Njerëzit kanë qeshur gjatë për atë që i ngjau së fundi beut-markiz. Qeveritarët thonë se i kërkuan falje beut.

1) U shpërndanë me vrull.

Hëna dhe Perihëna

Jeta e fëmijëve shkon shumë më shpejt përpara se jeta e të mëdhenjve. Njeriu vajti në Hënë vetëm këto vitet e fundit. Raku, shoku im me besë i fëmijërisë, për pak desh na shpuri në Hënë që sot e pesëdhjetë e sa vjet më parë. Që s'vajtëm, jo se na mungoi dëshira, po ja se si u ngatërrua kjo punë.

Kishim një mësues të fesë në shkollë, që na fliste shpesh për fundin e botës, — të dynjasë, siç thoshte ai. Fundit të dynjasë i thoshin «kataklizmo», — përmbysja e përgjithshme. Kur të vinte kataklizmoja për botën, na mësonte zoti Harallamb, të vdekurit do të ngriheshin nga varri! Zoti Harallamb e paraqiste botën tërë varre, varrezë anëmbanë, nga do të ngriheshin të vdekurit sa të kishin qenë. Ky s'kishte për të qenë aspak një gëzim i madh, si mund të mendohej — të jetosh edhe një herë, të bëhesh i gjallë! — po kishte për të qenë llahtara e llahtarës. Se njerëzit atë kohë do t'i gjykonin për tërë gabimet e fajet që kishin bërë në jetë. Se pse duhej bërë ky gjyq, unë nuk kuptoja asgjë. Bile kjo më neveriste. Merreni me mend ju vetë se përse duhej të më gjykonin mua më prapë për një xham që i kisha thyer shkollës, duke dashur të goditja me llastikë një rabeckë. Veshët më dhembnin edhe sot, kaq fort m'i ka tërhequr mësuesi.

Notën e sjelljes ma kishte thyer. Përse perëndia do të më gjykonte dhe do të më dënonte përsëri? — se perëndia do ta bënte 'vetë atë gjyq të përbotshëm. Tuaf i madh na paskësh qenë «i madhi zot». A thua se kishte për t'i dalë koha për tërë atë gjyq? Do të plakej, do ta linte mendja dhe gjyqin s'kishte për ta kryer kurrë. Kështu thoshte Raku. Mua ndoshta s'kishte për të më ardhur aspak radha që të gjykoheja, dhe për çfarë? — për një xham!

Po Raku ç'kishte bërë që ta gjykonin? Kohë e humbur, ai s'kishte bërë asgjë.

Perëndia po, perëndia kishte bërë gabime, gabime pa masë, mund të thoshe, tregonte nëna e Rakut. Cave ua kishte bërë barkun vërzom¹⁾, po dhe oreksin që u prishej për asgjë, sado të kishin të hanin e të fryheshin; cave ua kishte bërë barkun petë dhe oreksin ua kishte dhënë sa për të ngrënë botën, po dhe s'kishin të hanin asnjë lugë kos të holluar në hurrë, pra «hanin veten», si thoshte nëna e Rakut. S'janë gabime këto? Po kujt do t'i jepte perëndia hesap?

Mësuesi i fesë për këto nuk tregonte dhe, kur unë e pyeta një ditë, ai u zemërua kaq keq, sa thirri e u çorr një orë të tërë, duke më mallkuar:

— Të preftë perëndia ditën!

Zoti Harallamb nuk e ngrysi atë mars që erdhi. Raku thoshte:

— I preu perëndia ditët, — dhe bënte gjestin e gërshërës: — trak!

Priten ditët? Se mos janë letër, se mos janë pe prej leshi, se mos janë mish! Nëna ime, kur bëja ndonjë faj, më kanosej:

— Ta pres mishin me gërshërë!

Raku thoshte:

— Të kem fuqi, ia pres gjuhën me gërshërë zotit Harallamb! Pa shih sa të gjatë që ma ka, pa vështro

1) Rrjetë litari.

ç'pështyma që hedh... Vjen kësaj të hënë të vemi në Hënë, more Skëndo? — tha ai një ditë.

— Në Hënë? Ku në Hënë? Atje lart, në qiell? Po pse për të hënë?

Ç'kemi për të hënë? Histori, bukurshkrim, aritmetikë, gjmnastikë. Mua më pëlqejnë të tëra këto mësimë. Dhe Raku mezi e pret orën e aritmetikës. Në bukurshkrim po e dini. Të flasë për Skënderbeun, të lë pa mend: kaq koka turqish ka prerë fatosi, ai që mundi dhe dërrmoi dy sulltanë. Raku e ka mësuar ku bie India, i ka vizatuar dhe hartën. Sa për gjmnastikën, në turrakalorthi¹⁾ rendi ynë, — klasa jonë, si i themi sot, — rendi i pestë ia kalon edhe të gjashtit dhe Raku, siç ruan kalanë tonë dhe s'e merr njeri, ashtu merr edhe kalanë e të tjerëve.

— Jam bërë për dizdar, — thotë.

Se nga e ka mësuar këtë fjalë dizdar, që turqisht dashka të thotë komandant kalaje! Po Raku çfarë s'mëson! Ju mos pandehni se do të na nisë kot për në Hënë, ai që kërkon të niset bile dhe për të hënë. Ka një mendim në kokë, ka një plan.

I them:

— Raku, me ty unë vij edhe gjer në diell, se gjer në Hind e në Hënë po se po. Me Himën s'vete as gjer në Tiranë. Po në Hënë, more vëlla, s'ka vajtur njeri. Duhet të fluturosh. Aeroplani fluturon lart dhe pëllumbi, edhe krahëthata, po jo dhe kaq lart. Pëllumbi ngjitet më lartë se pesë plepa. Sa ngjitet krahëthata? Aeroplani, thotë babai aq ngjitet, sa kalon majën e Tomorit, të 2484 metrat. Sikur ta kalonte dhe Sharrin, do t'i duheshin edhe nja 400 metra më shumë. Sa mijë metra lart është Hëna, që s'vajti dot njeriu dhe as pëllumbi?

— Disa qindra mijë kilometra, — thotë Raku pa gjë të keq.

— Këtu e gjer në fund të dynjasë! Fiu! — mbeta

1) Kala dibrance.

unë, që s'mund t'i marr me mend aspak se sa larg janë edhe pak mijë kilometra, pa le disa qindra mijë.

Sa mijë kilometra tutje është Stambolli? Për ne, largësia nga më të largëtat ishte Stambolli. Pas Stambollit vinte Çinmaçini. Pas Çinmaçinit vinte Fundi i Dynjasë. Duhej pyetur mësuesi për Stambollin. Çinmaçin nuk kishte thoshte im atë. Sa për Fundin e Dynjasë... — unë ngrija kokën dhe vështroja me druajtje nga Hëna.

Hëna ishte duke u bërë e plotë. Ajo ishte sa një kokë e madhe zonje, me sy, me hundë, po pa veshë dhe e argjendtë. S'pyeste për lartësi Hëna, po vërtitej nga Lindja në Perëndim qiejve, sado të larta të qenë malet. Edhe Himalajat i kalonte, ca male atje në Hind, tregonte Raku.

Ne do të vemë gjer në Hënë! Mirë. I gatshëm jam. Po me se dhe si? Raku, që e ka marrë përsipër, e di vetë, por e mban të fshehtë. E drejta e tij. Të fshehtat duhen ruajtur dhe s'duhet t'i marrin vesh gjithë kalamajtë. Po përse do të nisemi për të hënë? Shoku me pëshpërit në vesh:

— Për të hënë, se i thonë Hënë asaj.

— Demek, kur të vijë muaji mars, do të nisemi për në Mars, — qesh unë.

— E përse jo, — hidhet ai pa të keq fare, me siguri të plotë, kurse unë, që ha shakanë, e gëlltit shakanë time.

Vajtkëshim edhe në Mars! Ç'jemi sot? 20 shkurt.

— Të presim fundin e marsit veç, — i them Raku si me të lutur, se atij i mbushet mendja dhe na nis me të hyrë marsi.

— Përse — më pyet.

— Të mbarohen njëherë karakaftet, — i lutem unë.

Raku ia plasi gazit. Unë e kam me tërë mend. Karakaftet e manushaqet janë kaq të mbara këtë shkurt, sa është mëkat i madh të ikësh e t'i lësh pa mbledhur. Dale t'u shkojë vakti njëherë luleve tona të dashura të ullishtës.

— Po në Qershor kur do të vemë? — e pyeti Hima

Rakun, dhe shoh që i shkeli syrin. — Për muaj qershori?

— Ç'qershor, more? E ç'ma shkel syrin? — i shfryn Raku.

— Si? S'e di ti? S'e ditka ky, — përdredh buzët Hima duke u kthyer nga unë, sikur unë ta di. — S'e ditka ky, more Skëndo, se ka një yll me emrin Qershor.

— Jo po Korrik! — ia ktheu Raku.

Yje kishte vetëm një Mars me emër muaji, pastaj genë me emër dite: Mërkuri, Enjti, Premti, Shtuni. Dhe këtyre s'u thoshin yjë, po planete, se vërtiteshin rreth Tokës, si dhe Hëna. Marsi është yll. Këto ne i dinim, nuk e di se si, se në shkollë s'i kishim mësuar akoma. Po Raku gërmonte, pyeste, mësonte dhe këshu pasuroheshja edhe unë. Kurse Himës, edhe sikur të kishte një yll me emërin Qershor, njeri s'kishte për t'i besuar. Në lojëra atë e kishim shok dhe ishte djalë jo i keq Hima, po, për fat të keq, në mësime jo.

Më rrihte mendja tek e fshehta e madhe. Me se do të nisemi për në Hënë? Si? Përse? Raku ma kishte prerë:

— Mos pyet!

Nuk pyes, po s'rri dot pa pyetur veten time. Dhe përfytyrimi s'më ndihmoka fare. Më lehtë mund të përfytyroj se si bëhem urith e shpoj tokën gjer në zemrën e saj të zjarrtë, sesa të bëhem, — çfarë të bëhem? Zog? Zog çeliku? Dhe të fluturoj në Hënë?

M'u qesh me këtë mendimin tim — «urith, unë?» — dhe qesha me zë.

Raku pandehu se po tallem me të dhe, i prekur në sedër, hapi sytë me një qortim të vërtetë.

— Ke mësuar të tallesh zotrote! — u egërsua ai. — Po kur flet zoti Harallamb për jetën e shën Kozmait e për jetën e Virgjëreshës Mari, sytë m'i hap e m'i bën katër! Dhe je gati të vesh e të biesh më junjë te libri i tij greqisht, kur e hap Harallambi e

na tregon fullatat¹⁾). Dhe s'na besoke zotrote që unë të shpie në Hënë e gjer në Perihënë? Se ka dhe një Perihënë përtej Hënës, e di ti?

Jo, s'e dija. As Hima, sigurisht, që ngriti kokën dhe hapi sytë nga qielli.

— Në Hënë, — tha Raku, — e ka fronin perëndia, në Perihënë rri Krishti me Muhametin bashkë. Ne dhe atje do të vemi. Do t'i bëjmë vizitë babait, pastaj edhe djemve.

Me sa dukej, Hima u gudulis, se do të shihnim edhe Muhametin. Ai harroi se e kishte zënë punën me shaka në fillim.

Ishte e martë. Erdhi e enjtja bashkë me orën e mësimit të fesë. Myslimanët u ndanë veç dhe shkuan me hoxhën, ne të krishterët u ndamë veç dhe shkuan me zotin Harallamb. Zoti Harallamb nuk ishte prift, po thjesht mësues. Ngaqë ishte mik i beut dhe s'dinte tjetër gjë veç fesë e kishin bërë mësues feje. Rrogën e merrte më të madhe se tërë mësuesit, tregonin.

— Ja punë, ja! T'u mësosh fëmijëve proçka dhe të marrësh rrogën më të madhe! — thoshte Raku.

— Bëhemi mësues feje? — hidhej Hima.

— Bëhu zotrote! Vër dhe një çallmë! — i hidhej Raku.

Unë qeshja me gjithë zemër. E përfytyroja Himën me çallmë dhe s'e mbajta dot gazin.

Se ç'po na llototiste një të enjte zotnia i fesë, nuk e di. Po më duket se për ikonën e Shënmërisë, që tregonin se kishte fluturuar që nga Shkodra e kishte vajtur gjer në Itali, kur turqit morën qytetin, dhe shqiptarët i luteshin akoma asaj përtej detit. Ajo s'kishte qenë aspak një ikonë katolike — «qoftë larg!» — zemërohej zoti Harallamb, — po një ikonë ortodokse!

Raku i preu fjalën mësuesit e i tha:

1) Ilustrimet.

— Tregojnë se përpara se të vinte në Itali, zotni, ikona vajti njëherë në Hënë.

— Po ç'do të donte në Hënë? — u çudit zotnia.

— Vajti të marrë dorën te zoti, që atje e ka fronin, zotni.

Në klasë se kush pëshpëriti, por u dëgjua:

— Fluturoi, fluturoi gomari! — dhe gjëmoi gazi i të gjithëve.

Zoti Harallamb kërceu në këmbë, i thatë e i gjatë si një shufër shtogu, sigurisht edhe fyl përbrenda, se zëri i dilte i hollë e si i krisur.

— Jashtë! Jashtë! Jashtë!

Kur Raku hapi derën të dilte jashtë, në klasën përballë, tek bënte fe hoxha, buçitën bubullima të vërteta, dëgjuam britma, grushte, shqelma dhe hoxhën si i çmendur:

— Hairsës! Dinsës! Kaur derri! — dhe bam me grushte e bam me shqelm.

Dera u hap atje përballë dhe doli fishek Hima, që mbante me të dy duart hundët e gjakosura, që ulërinte, kurse hoxha i futi edhe një shqelm.

— Ta tregoj unë Perihënë ty, domuz²⁾ e bir domuzi!

Ju e kuptoni se as në Hënë vajtëm dhe as në Perihënë.

1) Mosmirënjohës, i pabesë.

2) Derr.

Njëherë te ne erdhi një sheh

Ai i thoshte vetes sheh, po nuk vishej me xhube dhe çallmë nuk mbante në krye, as të gjelbër as të zezë. Mbante kofsharë si malësor, xhamadanin e kishte me sumbulla të mëdha ari, në brez kishte një revole dhe në kokë një takije me majë, së cilës i thoshte «plis». Po kishte mjekër, një barrë mjekër, të bardhë e që i mbulonte kraharorin e gjerë.

Mbaj mend se ishte nga Podujeva dhe se emrin e kishte Maliq. Kjo Podujeva, tregonte ai, binte në afërsitë e Nishit dhe unë, që tani e dija se Nishi gjendej në Serbi, bëja çudi se sa thellë shtriheshin shqiptarët në Ballkan, kurse shehu thoshte se shqiptarët kishin pasë qenë motit, në kohën e pellazgëve dhe të ilirëve, populli më i madh i Ballkanit.

Mbaj mend se ai fliste ca si «trashë» dhe se, në fillim, ne s'ia kuptonim ndonjë fjalë a ndonjë shprehje, po shumë shpejt nisëm ta kuptojmë shpënguar. Dhe mbaj mend se ai nuk thoshte «miku», po «niki», se nuk thoshte «kam qenë», po «kam kenë», se nuk thoshte «qofsh bekuar», po «kofsh bekua». A thoshin kështu nga ajo anë? Sot e di se kështu thonë nga Gjakova, me «-ua», dhe më kujtohet se shehu kishte jetuar shumë në Gjakovë, prej nga kishte ardhur.

Përse kishte ardhur ky burrë i moçëm në shtëpinë

tonë? Babai, mora vesh, s'e kishte mik, as të njohur. Na e solli një mik i shtëpisë sonë, kosovar i vendosur në Elbasan, një mësues muzike, me sa më kujtohet, që i binte bukur violinës. Ky mik ka qenë një goxha burrë, me kokën gjer atje, që, kur ngjiste shkallët e çardakut tonë, duhej të përkulej e të thoshte:

— Në shtëpi tënde, more miki Filip, do ulur koka patjetër, sado burrë kofsh!

— Mbaje lart, mbaje kokën lart, — ia priste hokatarja ime gjyshe.

— E mbaj, — thoshte ai, — po s'kam tjetër.

Morëm vesh se mysafiri nga Kosova na kishte ardhur ato ditë në Elbasan për dy qëllime: e para, që të falej mbi varrin e Kostandin Kristoforidhit; e dyta, që të çmallej me mësuesin e muzikës, të cilin e kishte bir miku të dashur dhe e desh e e nderonte siç i pat dashur e nderuar t'anë, të vrarë motit përkrah Bajram Currit, atë mot që Bajrami u mori osmanëve Shkupin. Si u fal në varrin e Kristoforidhit e si u përfal tri ditë me birin e mikut, sheh Maliqi — unë po i them si i thoshin — deshi të njihte edhe tim atë, që i kishin thënë se dinte gjëra mbi jetën e Kristoforidhit. Doli që plaku kosovar Kristoforidhin e kishte njohur motit, jo në Stamboll, po këtu, në Elbasan, ku e kishte sjellë njëherë puna në moshë të re.

— I këndoja librat, — na tregoi, — abetaren e gjithë të tjerat. Erdha këtu e i putha dorën. Me abetaren e tij kam mësuar të shkruaj shqip. Me të tjerët kam rënë në bela shumë herë, se i quanin «qitape të kaurit». Këto qitape të kaurit qenë shqip dhe, siç e ka thënë i madhi Vaso Pashë motit,

*Ju mos shikoni kisha e xhamia,
feja e shqiptarit asht shqiptaria.*

I tillë ishte sheh Maliqi.

Ai ishte shumë i kaluar në moshë dhe kishte marrë përsipër të piqej edhe një herë me disa miq e të dashur, përpara se të vinte dita e fundit që mosha po ia

afronte. Kjo mua më bëri shumë përshtypje. Po përshtypja mbi të gjitha që se ai mund të nisej që nga Podujeva e Gjakova për të ardhur në Elbasan, që të shohë varrin e Kristoforidhit. Në të vërtetë, Gjakova nuk ishte larg. Ja tek ishte në hartë, fill në cep të Shqipërisë, sapo të kaloje kufirin. Po një kufi është kufi dhe largësitë një kufi i rrit. Atje i thonë shtet tjetër. Pra, Gjakova më dukej edhe më e largët se ç'që në të vërtetë.

Po dhe kjo s'kishte qenë gjë. Dy a tri vjet më parë, gjakovari plak kishte marrë një udhëtim shumë më të gjatë: ai kishte vajtur gjer në Stamboll.

— Kam miq të vjetër atje, — tregonte. — Vajta të falem edhe me ta, se i shoh a s'i shoh më tjetër herë. Sa kam këmbë, nuk duhet t'ia përtoj. Kjo botë ka gëzime shumë. Për shembull, të shohësh një vend të bukur. Kur kam parë së pari Vlorën, kam thënë «tani le të vdes». Vajta dhe iu fala Ismail Qemalit në varr. Ju fala edhe Avni Rustemit. «Të lumët ju, — u thashë, — tek pushoni! Vend më të bukur s'do t'ju kishte gjetur Shqipëria!» Stambolli s'e ka shoqin për bukuri. Unë vajta ta shoh edhe një herë, se kam shokë që më kanë mbetur atje. Kjo botë ka gëzime shumë, po gëzim i madh shumë është të shohësh edhe një herë një shok të vjetër. Po medet! Shokët i gjeta të mjerë sa s'm'u besua. «Ku ka, more, si viset tona? — u thashë. — Të mira qofshin a mos qofshin, ato janë tonat. Me bjeshkët, me lumenjtë, me fushat, me detet e me gjithçka kanë. Kthehuni, more të mjerë!» Por ah! Kurbeti është një gjarpër, që të lidh këmbët e s'të lëshon. Vajta dhe u fala me të Tre, me Abdylin, Naimin e Samiun. Desha t'i pyes se ç'është kurbeti. Po nuk do të më përgjigjeshin, e dija. Mos pyet për çka di, për çka dihet. Edhe nën tokë njeriu e ndien se është i huaj. Kockat nuk e harrojnë vendin tek u ngjizën. Çdo njeri s'e tret cilido dhë. Po mallin për vendlemin¹⁾ nuk e tret asnjë dhë.

1) Kështu i thoshin rilindësit vendlindjes.

Shokët e mi i gjeta të mjerë, se dhe kush i kujtonte ata në vendlimin e tyre? Ja vdiqa unë dhe ndonjë nip e mbesë që kanë, pastaj bëhen si s'kanë qenë. Ata të Tre, po ata të Tre, edhe në mos paçin nip e mbesë këtu, nipër e mbesa kanë gjithë shqiptarët kudo që janë. Vetëm kockat kanë në Erenqoj¹⁾. Turp për ne që na kanë mbetur atje! Po ka njerëz që turpin e hanë me bukë, le të jenë cilët të jenë, unë do ta them! — buçiti ai.

Ne u nxorëm mysafirëve raki dhe burrat pinë dy-tri gota. Dhe si pinë, edhe nisën të këndojnë. Plaku mbante me vete një trastë që ia kishim varur në mur.

— A s'ma jepni atë trastë, ju lutem, — na tha dhe unë u ngrita e ia dhashë.

Ai e zgjidhi e nxori një lahutë.

Unë lahutë s'kisha parë ndonjëherë. Edhe babai m'u duk se s'kishte parë. Plaku tregoi se ajo e kishte harkun prej qimeje kali dhe telin po ashtu. Lart, te dorëza, kishte një kokë dhie, që ngjante me përkrenaren e Skënderbeut. Plaku e kurdisi lahutën dhe nisi t'i bjerë, me çfarë zëri! Këngë po e quaj, porse ai më shumë recitonte se këndonte, veç kur hove-hove e ngrinte zërin. Sytë iu mbushën që në fillim me lot, kur ia mori:

*Hej ju male, hej të Shqipërisë,
tha, hej ju lisat e gjatë, hej!
mori fushat e gjera me lule,
q'ju kam ndër mend dit' e natë, bre!*

*Ti, Shqipëri, tha, ti moj më jep nderë,
më jep emërin, hej, shqipëtar!
Zemrën ti, tha, moj seç ma gatove,
plot me dëshir', o moj, edhe me zjarr!...*

Dukej e pabesueshme. Unë tjetër herë këngë lahute nuk kisha dëgjuar dhe të më thoshin sot se këto

1) Lagje e Ysqydarit, matanë Bosforit, përballë Stambollit.

vargje mund të merreshin me lahutë, do të thosha jo, po të mos i kisha dëgjuar ashtu. Por i kam dëgjuar me lahutë dhe veç që s'jam i zoti t'u jap tingullin gjuhësor që u jepte lahutari plak nga Kosova. Vargjet ishin po ato, të gjera, të madhërishme, aq sa veshi im, i pamësuar me atë këngë e llojë recitimi, nuk do ta kishte hapur kurrë, dhe, ç'më ka mbetur në kujtesë është krejt e pariprodhueshme. Bile sot ajo lloj e kënduare e atyre vargjeve, ajo lloj e recituare, fundi i fundit, më tingëllon edhe vetë si e pabesueshme. Kujtesës sonë ka arsye disa herë të mos i besojmë. Po kur mendojmë se ashtu ka ngjarë, nuk ka rëndësi se si ka qenë, rëndësi ka se ka ngjarë.

Babai thoshte:

— S'është e mundur!

Lahutari thoshte:

— Ia kam kënduar përmbi varr, në Erenqoj. Të ngjalleshin të vdekurit, ai do të ishte ngjallur, do të ishin ngjallur të Tre. Por ai s'kishte vdekur, s'kishin vdekur Ata, që të mos më dëgjonin. Dhe unë prandaj vete dhe u falem Atyre, se Ata s'kanë vdekur. Shpirti i tyre është në librat e tyre, në flamurin që kanë ngritur, në një kobure që u shkreh në mes të Parisit, në krye të Kuvendit, në një vend që i themi Prizren. Ai ka shkruar:

*Kur më shihni se jam tretur,
mos pandehni se kam vdekur!
Jam i gjall' e jam në jetë,
jam në dritët të vërtetë:
unë jam në shpirtit tuaj!...*

Drita e vërtetë jemi ne, ne të tre që na bashkon ajo fjalë, dhe mijëra të tjerë që i bashkon po ajo. Gjithkush e ka në trastë një vjershë nga ato, një fjalë nga Ata, një amanet. Unë mbaj në këtë trastë edhe një lahutë. Naimi nuk shkroi këngë lahute, por

unë ia këndoj edhe me lahutë. Le të çuditen disa e të mos i pëlqejnë kështu. Ju dëgjuat e mos thoni asgjë. Doni tani një këngë të bërë për lahutë? Është një nga ato këngë, që, po t'i bjerë gurit, e thyen, si pati thënë Naimi për fyellin, dhe po t'i bjerë verës, e buçet. Po vera e saj, kur buçet, mund të buçasë bota gjithë. Pa më dëgjoni:

*...Kur ka shkua te vorri i djalit,
mirë po pshtetet për degë t'ahit:
pikon lodja mbi vorr të djalit.
Kanë lanë kangën zogjië e malit.
Kanë lanë kangën me vështua.
«Por a e din se kush ka ardhë,
që nuk çohesh për m'u falë,
more i miri i nanës-ooo?
Amanet, o more bir,
dil një herë ksi burgut t'errët,
fol me nanën qi t'ka rritë,
s'më ke lanë kurrë kaq me pritë!»
Ka lshua hana rreze n'pyllë,
kanë shkrepë hyjzit nëpër qiellë...*

Kjo është e para këngë lahute që kam dëgjuar. Plaku dinte me dhjetëra si kjo. Nuk e di nëse ia mblo-dhi kush. Ka rrezik që t'i ketë marrë me vete në varr dhe unë atëherë s'e dija as që mblidheshin këngët, kurse tim eti dhe shokut të tij nuk ua fal dot që nuk ia mblodhën podujevasit.

Pas shumë vjetësh — më se njëzet vjet — i kam dëgjuar disa nga ato këngë në Veleçik, te një stan. I dëgjova pastaj në një varkë, në gjirin e Vlorës, në Rrogozhe. Veleçiku i dëgjonte edhe heshte, Karaburuni i përcillte me përplasje dallgësh përmbi shkëmb. I kam mblodhur disa prej tyre, por medet që s'kam ditur t'i mbledh qëmoti, nga ai plaku lahutar prej Kosove, që ishte falur në disa varre të Shqipërisë! Ai e thoshte edhe Naimin me lahutë. Gjithçka më ka mbetur në kujtesë si një legjendë.

Kur rendte hëna nëpër re

Kristoforidhi pati fëmijë shumë: pesë djem dhe katër vajza. Po dhe fatkeqësitë i ka pasur të mëdha me fëmijët. Shumicën i pa t'i vdisnin sa ishte gjallë, që nga vajza e tij e madhe, Anastasia, që mbante emrin e gjyshit të saj, Anastasit. Ajo vdiq mësuese në Berat. Pas saj, Kostandinit i vdiqën disa fëmijë me radhë, gjer te më i vogli. Djali i Pleqërisë, siç i thoshte ai dhe që unë emrin s'ia kujtoj. Emri i tij është harruar.

E keqja më e madhe që se këto fatkeqësi Kristoforidhit i erdhën në Elbasan, ku ai u vendos së fundi dhe ku i kaloi ato dhjetë-njëmbëdhjetë vitet e mbarimit të jetës së tij, në rrugën e pleqërisë. Shkonte një mot, shkonin dy dhe në shtëpi të shkrimtarit ngjante edhe një zi më shumë. Tregojnë se ai jetonte me frikën se mos po i vdes edhe gruaja ato kohët e fundit: ajo ishte shpesh e sëmurë dhe qëllonte të bëhej keq. Gruaja vdiq gjashtë muaj pas tij dhe pati gëzimin t'i shërbente gjer në fund, kurse Kostandini, ai duhet të ketë vdekur me tmerrin se prapë një si kufomë po lë pas vetes.

Kristoforidhi i priste si burrë, sidoqoftë, vdekjet e përsëritura dhe njeri nuk e pa të dëshpëruar asnjëherë. Një buzëqeshje e hidhur, dy-tri fjalë të mallëngjyera, të menduara, dy-tri të tjera të ëmbla për kuj-

timin e të ndjerit, ndonjë shëtitje vetëm nëpër ullishtat ose buzë Shkumbinit, ndonjë lojë tavlle me fjalë pak e me shaka të lehta, — me këto e mbante ai zinë disa ditë.

— Vdekja, — thoshte, — është binjakja e jetës. — Ke parë një rrufanë¹⁾ me dy qershi zotrote? Njëra skuq, tjetra nxihet e këputet prej shoqes.

Njeriu jetën duhej ta merrte natyrshëm, ky ishte mendimi i Kostandin Kristoforidhit.

Ai, sigurisht, e kuptonte se shumë vdekje ishin aksidente, se shumë të tjera i rrëmbenin njerëzit për asgjë. Sa ishin sëmundjet që shkenca nuk i merrte vesh dhe s'ua dinte dot mjekimin? Kostandini nuk i zemërohej shkencës, ai nuk u zemërohej mjekëve, po thoshte:

— Njeriu është akoma shumë larg që të bëhet njeri vërtet. Posa që ka marrë këtë rrugë, do të arrijë, po unë e ti nuk do të jemi.

Ndonjë shok i shakave ia kthente:

— Është shumë e gjatë kjo udhë, more vëlla?

Kostandini hidhte zaret, ato rrotulloheshin e binin, ai mendohej se si duhej të lozte, vinte gotën në buzë e mendonte, i lëvizte pullat e tavllës më nge, e zgjaste pra kohën e përgjigjes e në fund pyeste:

— Mos u mërzi, more vëlla?

Shoku i lojës dhe shikuesit përreth qeshnin. Kostandini atëherë jepte përgjigjen e pritur:

— Sa këtu e në Stamboll nuk është rruga, po jo dhe sa këtu e gjer në Hënë.

Hëna nxitonte në një qiell me re, sikur ta ndiqnin pas dhe ajo kishte marrë vrapin. Shoku i lojës ngrinte kokën e shihte.

— Hëna, me atë vrap që ka marrë, ec e zëre, — ia bënte shoku.

— Mos e shih sonte, — i thoshte Kostandini. — Nesër nuk do të shpëtojë kaq. Po dhe s'është puna gjer në Hënë. Pastaj dhe ne s'jemi kaq të nxituar, — hidhëronte

1) Vile, bistak.

së fundi burri buzën dhe i kërciste pullat pak më me forcë mbi tavëll.

Njerëzit ulnin kokën me trishtim, Kostandini e qetësonte prapë lojën e tij.

Një ditë ai lozte tavëll me Loshin e Bardhë, për të cilin do t'ju flas më tej. Ai kishte qejf të rrinte me Loshin. Loshi ishte i pastër, sikur të mos e prekte dot njolla. Kostandini i thoshte:

— Ti, more Losh, zemrën e ke edhe më të bardhë se faqen e se petkun: e ke dëborë: Nuk thashë se e ke të ftohtë: e ke zjarr. Po bota e kanë zemrën të kuqe, duke e pasur të ftohtë, kurse ti, ti e ke dëborë të bardhë, por e ke zjarr.

— Ka që e kanë edhe të zezë, katran, — vërejti dikush që vështronte të loznin tavëll të dy miqtë.

— Atyre u thonë zemërblozë, — tha Kostandini, zemërpisë, zemërserë.

— Ka që ua nxin edhe jeta, duke u rënë më qafë, — vërejti një tjetër.

— Atyre u thonë zemërcopëtuar, — tha Kostandini, zemërvrarë, zemërdërrmuar.

— Po ti, si e ke ti? — e ngacmoi Loshi.

— Unë? — Vuri dorën te zemra e vet Kostandini dhe i mori dorën Loshit e ia vuri atje. — E dëgjon?

— S'dëgjoj gjë të madhe, — tha Loshi. — Një si sahat, tik-tak, tik-tak.

— Nuk e dëgjon, more Losh? Zemra ime zien!

Këtë varg të Naim Frashërit ata të dy e njihnin.

— E posa zien, e bardhë s'është, more Losh, — tha Kostandini duke hedhur zaret. — Them se duhet të jetë një lëmsh i kuq prej llave.

Loshi e kishte mësuar se ç'është llava. Ai tha:

— E pra, ti s'dukesh fare si një vullkan, more Kostandin.

Kristoforidhi i kërciti atëherë fort pullat përmbi tavëll.

— Mos do t'i kërcasë edhe më fort? — e pyeti. — Apo mos do që t'i thyej? — I kërciti ai edhe më fort.

Loshi zgjati gotën dhe e trokiti me të. Ata e vunë në buzë. Kostandini përsëriti:

— Sa për ty, ti zemrën e ke edhe më të bardhë se petkun, more Losh. Ti je zemërbardhë.

Atë ditë, ata loznin tavëll në një kafe, që më pas ka mbajtur emrin e Shkumbinit dhe që ishte rrëzë Portës së Kalasë. Në kafe zhurma e zakonshme u bë papritur një heshtje e thellë. Kostandini së pari nuk e kuptoi, aq e kishte tërhequr loja. Por atij i ra shpejt në sy se Loshi po i hidhte keq zaret, që ranë dy herë me radhë përtokë. Ai u zgjat e i mori, duke vështruar me bisht të syrit njerëzit që kishin heshtur përreth.

— Ra guri e u mund burri, — tha dhe zëri i drodh, kur vështroi edhe duart e Loshit se si dridheshin.

Kuptoi, u mbështet pak në karrige, mori frymë me tërë kraharorin dhe ngadalë-ngadalë u çua. U çua, po kryet nuk e çoi dot. Mori gotën e nisi ta derdhte mbi dysheme, duke mërmëritur:

— Pastë ndjesë, se, sa që gjallë, i ka sjellë gëzime atit të vet:

Ai kishte pasur të sëmurë në shtëpi Djalën e Pleqërisë, po, me sa duket, s'kishte kujtuar se fëmija ishte dhe kaq keq. I mori krahun Loshit dhe doli.

Dajë Murati, një tjetër furrtar

Im atë ishte njeri pa neps¹⁾. Po ndonjëherë ai i thoshte nënës:

- Bëna një vorbe me fasule, moj grua.
- Në shtëpi apo në furrë? — e pyeste ajo.
- Ku të duash, po dua një vorbe me fasule.

Dajë Hasani i qante këto vorbe. Edhe nëna ua dinte. Kjo lloj gjelle dukej se nuk kishte asnjë sekret, po nganjëherë nëna s'ia qëllonte. Dajë Hasani nuk lajthiste kurrë.

Merr vorben, shtie fasulet, ujin, kripën, vajin — kur i bën pa mish — gjalpin kur i bën me mish (mishi duhet i dhjamuar dhe mish dashi), i vë kapakun, e ngjit kapakun me brumë anash dhe e vë vorben anës zjarrit. Asgjë më shumë. Blini një vorbe dhe provojeni. Hasani i vinte vorbet në një kënd të furrës dhe ato zienin dalngadalë, sa më larg flakës. Çdo gjë brenda zienëte e bëhej që ç'të haje! Fasulja dilte e plotë, si e paprekur, edhe mishi gjithashtu. Por në gojë shkrinin. Sidoqoftë, nënës sime këto vorba nganjëherë nuk i bëheshin gjë. Ajo ua vinte fajin atëherë fasuleve, mishit, vajit, gjalpit, vorbes vetë. Po përse furrxhiut nuk

1) Dëshirë e madhe për të ngrënë diçka, lakmi e tepruar.

i dështonte puna kurrë? Ku qe e fshehta e tij? Te dora e tij: ai nuk i lajthiste masat kurrë.

Një ditë që babait iu tek për një vorbe me fasule, dajë Hasani se pse e kishte mbyllur furrën papritur. Të kthehesha në shtëpi, s'më erdhi mirë. Më erdhi keq për babanë. Unë s'kisha mik vetëm dajë Hasanin, kisha mik edhe dajë Muratin, furrxhiun e Portës së Kallasë.

Ky furrxhi ishte një mjeshtër i rrallë. Ai nuk piqte vetëm bukët e lagjes, tavat e lakrorët, po bënte dhe shiste dhjetë dymbëdhjetë lloj bukësh. Për qahitë e për simitet ju keni dëgjuar, që i hanë në Elbasan me bugaçet (bugaçet e dajë Muratit qenë me nam). Ju kam folur për pitet që shkonin aq shumë me vaj, po edhe me kërnacka e lëng jahnie; me hallvë, — tërhanhallvasi, — edhe më shumë. Dajë Murati bënte çyrekë me brumë të ëmbël, të lyer përsipër me vezë, që i përdornim për dollëm në ditë festash. Bënte karvele të mëdha katërkëndëshe, bukë gruri të zeza, me koren dy gisht. Ai bënte bukë misri si erashka¹⁾; ato haheshin «si arrë», kjo qe shprehja... Po fundi i fundit, ju s'keni për t'u bërë bukëpjekës ndoshta dhe unë shumë gjëra i kam harruar.

Sa për vorbet me fasule, dajë Murati ishte usta mbi ustallarë, dhe mua më kishte zënë shpesh syri vorbe në furrën e tij, atje brenda, kur ai hapte qylhanin²⁾, të plota, të nxira, po me çfarë fasulesh brenda! Më kishte qëlluar ta gjeja dajë Muratin duke ngrënë drekë, këmbëkryq mbi postiqen e tij të zezë, përmbi tezgë, t'i them, duke më shkuar lëng nëpër gojë, «të bëftë mirë», të më thotë «bujrum, Skëndo», dhe unë të lëngëzohem fare. Fasulet mbanin erë që s'tregohet. Të pickonte hundët piperka e kuqe që dajë Murati kishte shkërmoqur mbi to. Ato i mbulonte vaji dhe, nën vaj, ishin si rruaza të bukura, si qelibarë të kuq. Të qenë më të mira këto fasule nga ato të dajë Hasa-

1) Freskore.

2) Dera e furrës.

nit e të nënës sime? Ato duhet të kishin shijen e tyre të papërsëritshme.

Furrën tonë e gjeta mbyllur pra dhe nxitova për te Porta e Kalasë, — harxhet në një shportë të vogël, vorben nën sqetull. Te sheshi dëgjoj tri të shtëna. Trembem dhe ndaloj. S'janë të shtëna pushke, po si revoleje dhe janë pranë. Bëj të kthehem, po më vete syri në dritaret e postë-telegrafës, ku shoh një flamur. Po, nesër kemi festë. Ditë Flamuri! Më shkriu gjaku.

«Më bënë veshët, sigurisht, — thashë me vete. — S'duhet të kenë qenë të shtëna revoleje. Duhet të provojnë që ditën fishekzjarret që do të shtien natën, se mos nuk u kanë dërguar fishekzjarre të mira», se një moti ua kishin dërguar të largëta e s'kishin ndezur.

Ky qe arsyetimi im. Nxitova këmbët duke hapur sytë se mos shoh në Portën e Kalasë njerëzit që provonin fishekzjarret. Një kalimtar i tha një tjetri:

— Kur pi ai, për qeveri nuk i bën tërt syri.

— Prit kur ta futin nesër në burg, — tha tjetri.

— Jo, more, jo, kështu e ka bërë edhe vjet.

— Vjet zëvendësoi fishekzjarret, — qeshi me të madhe tjetri.

Dikush qe pirë dhe shtinte pra në pazar. Qesha dhe unë me vete për këtë lloj gëzimi, të cilit ia kisha ndier lezetin edhe vetë, kur isha, siç ju kam treguar, në dasmë në Xhyrë. A, të kisha të shkoja dhe një herë në dasmë, makar edhe në Elbasan! Po në Elbasan qe e ndaluar të shtije, kurse në Xhyrë nuk pyeste njeri. Po ja që edhe në Elbasan kishte njerëz që nuk pyesnin. Ç'i pirë mund të ishte ky trim që e shkreppte në mes të pazarit? Nesër kishim festë.

Dajë Muratin e gjeta këmbëkryq përmbi tezgë, me tepsinë përpara, që priste bugaçe, mbushte qahi e simite, merrte e jepte para me duart e tij gjithë gjalpë të shkrirë dhe uronte:

— Gjak e dhjamë! Flamuri përpara dhe ne pas!

Pranë vetes ai kishte katër-pesë sahanë të vegjël me ullinj e me djathë, me hudhra, nja dy qofte,

ca japrakë dhe një pagure të përgjysmuar në mes. Unë u afrova me druajtje, ai u zgjat e më mori vorben nga sjetulla dhe shportën prej dore, duke më përfaquar.

— Do të hash ca fasule sot ti, — më tha, — që s'i ke ngrënë tjetër herë. Si për festën që kemi nesër, të Flamurit! — ngriti gishtin lart. — Dhe po nuk ia lëvdove ca atij Hasanit që më ke pranë, s'e ke mirë me mua! — qeshi ai. — Për drekë apo për darkë i do?

— Për drekë, — i thashë me drojë unë.

— Mirë, — tha ai dhe u ngrit menjëherë, vajti te qylhani, hodhi në vorbe ç'kishte shporta, seç hodhi edhe një tjetër gjë, po sigurisht erëza, se më tha që kisha harruar të sjell dafinë, hapi qylhanin dhe e futi me lopatë vorben në këndin e majtë. Zjarri që skuqte në mes të furrës, ia skuqi nga larg barkun vorbes.

Sahati ishte shtatë, tha dajë Murati, sahati më një vorben të kthehesha ta merrja. Unë s'dita si ta falënderoj, por ai më vuri shportën në dorë e më puti në ballë, duke thënë: «U kthefsh shëndoshë!» Po duke thënë këto fjalë, se si këmbëu mendim, më rroku dorën, më tha «prit» dhe u ul mbi postiqen e tij. Njerëzia pritnin që ai të niste e të shiste prapë simite dhe qahi me bugaçe, po dajë Murati më pyeti:

— A s'më thua, je a s'je trim, more çuni i Filip efendiut?

«Në jam trim? Edhe në mos jam, nuk e them. Edhe në mos jam, do të bëhem!» U turpërova dhe s'u përgjigja.

Njerëzia mezi pritnin që ustai të shiste, po ustai i kishte harruar myshterinjtë. Ai më tha:

— Epo, në je trim, na zbraze njëherë, — futi dorën dajë Murati nën postiqe dhe nxori që andej një revole, një karadaklie me mulli dy okë të rëndë.

— Ou! — bënë myshterinjtë çudi.

Karadaklie me gjithë mend, me mulli e me të tëra, me tytën dy bërzhikë! Sa plumba do të kishte brenda?

— Hajt, për shumë vjet! E gëzofshim Shqipërinë

dhe Ismail Qemali pastë dritë! Dhe ti u bëfsh një burrë trim, i kalemit e i gishtit, se Shqipërisë kalemi i duhet shumë, po gishti nuk i duhet pak! — Ma vuri ai revolen në dorë dhe ma çoi dorën përpjetë. — Shtrëngoje fort. Je bir shqiptari ti dhe kot s'të thonë Skëndo. Po hë, more, de! Sa bukur, sa bukur, trim i dajës! Tamam si bir shqiptari. Tërhiqe këmbëzën, hop! Hë, më të lumtë gishti!

Unë tërhoqa këmbëzën, revolja krisi me një kërcitje të mrekullueshme, thua si top. Myshterinjtë më uruan tërë gaz:

— Të lumtë gishti! Të lumtë dora!

— Edhe një herë — briti dajë Murati.

— Edhe një herë! — britën myshterinjtë dhe unë i mëshova gishtit edhe një herë dhe kush e kush të më uronte prapë; kur, pa e pyetur dajë Muratin fare, unë e ndeza dhe e shkrehja revolen prapë.

— Prapë! — briti dajë Murati.

Unë s'e shkrehja një herë, po dy herë me radhë.

— Prapë! — thirrën myshterinjtë dhe unë e shkrehja tri herë.

Desha ta shkreh edhe një herë, po arma bëri shkrap. Revolja kishte qenë me shtatë dhe unë i kisha djegur fishekët të shtatë. Çfarë mrekullie! Të shtiesh dhe ku? Jo në Xhyrë, midis maleve, po në mes të pazarit, në Elbasan, te Porta e Kalasë, me tërë atë millet përreth, që s'e kanë mendjen te simitet e te bugaçja, po se si kërcet një revole në dorën e një fëmije.

Dajë Murati më puthi në ballë dhe nisi të mbushte armën prapë, duke nxjerrë prej saj kalamidhet, që unë i mblihdhja e që ishin akoma të nxehta. Ato kalamidhe, po t'i kërkoj, mund t'i gjej akoma në ndonjë sirtar të shtëpisë, se nëna m'i pati ruajtur dhe unë i kam parë gjer vonë në një kuti.

Dajë Murati futi revolen nën postiqe dhe nisi të shiste prapë simite e qahi të mbushura me bugaçe e me gjalpë. Dy xhandarë, që kishin nxituar, sepse dëgjuan pushkë, nuk bënë shamatë, po u larguan duke

kafshuar secili nga një simite që u lyroste mustaqet e mëdha.

— Vorben më ora një, — më tha furrxhiu dhe unë u largova me kalamidhet akoma të nxehta në grusht.

A bëhej fjalë për vorbe e për fasule? Kemi ngrënë në fasule si për festë, me mish dashi. Përsipër nëna u shkërmoqi një piperkë të kuqe, që digjte ca si shumë, po që ishte kaq e shijshme edhe ajo.

Një mësim nga im atë

Kur vajtëm në të gjashtën plotore¹⁾, mësimet e gjeometrisë dhe të algjebërës mua m'u dukën të ngatërruara e të rënda. Në aritmetikë s'kisha qenë i dobët asnjëherë, po këto mësimet, me «brinjë» dhe me «këndë», me a-b-z-3c, nuk donin të më hynin në kokë. Përpiqesha shumë të futesha në të fshehtat e formulave dhe të teoremave, porse pa dobi. Trekëndëshit e katërkëndëshit unë kisha qejf t'i vizatoja në radhua. Po ky kujdes edhe qejf prapë ishte pa dobi. Ato figura të thjeshta kishin disa të fshehta të ngatërruara. Unë nuk hyja në to fare, po mbetsha jashtë tyre, ose kur hyja, më bëheshin si rrjeta merimange. Më vinte inat me veten, sa ta haja me dhëmbë. Më vinte turp nga shokët dhe kiamet nga mësuesi, zoti Musa.

Si i bëhej kësaj pune kështu? Dëshpërohesha dhe dëshpërohesha keq. Im atë s'kishte marrë vesh akoma asgjë, po kjo s'kishte për të vonuar shumë. Zoti Musa, që e kishte shok, që i dhimbsesha dhe që përpiquej të më fuste në të fshehtat e formulave dhe të teoremave, e zbraste i shkreti kokën, po nuk arrinte dot të mbushte timen. Raku, që më ndihmonte me gjithë shpirt.

1) Shkollë gjashtëvjeçare.

nuk ishte pa durim, nganjëherë ai e humbte durimin dhe më lëshohej e më shante:

— Truderr!

Truderr e çfarë truderrri se!

Unë 'dëshpërohesha edhe më shumë. Formulat e algjebërës më bëheshin si gjilpëra në sy; figurat e gjeometrisë si leqe, që më mbërthenin duart.

Unë e di se sa kam punuar për ato lëndë.

— E ke marrë me frikë, mor i shkretë, po shkundu!
— më bërtiste Raku.

Unë nuk kisha më besim te vetvetja.

Një ditë i thashë vetvetes:

«Më mirë t'ia tregoj këtë hall babait vetë, se t'ia tregojë zoti Musa», dhe në mbrëmje, në vend që ta pyesja për ndonjë fjali ndajshtimore e për ndonjë plotës nuk di më me çfarë emri të ngatërruar, e pyeta për një teoremë.

— Pa dale, — më mori ai radhoin nga dora, — mos nuk e ke shkruar mirë.

Unë s'e kisha shkruar, por e kisha bukurshkruar dhe tim eti iu bë qejfi nga tërë ai kujdes. Po prapë, rru-dhi vetullat dhe nduku mustaqen, nduku mustaqen e picërroi sytë, dhe nuk depërtoi dot në teoremën time. E pashë që u shqetësua; i erdhi rëndë që e zura ngushtë apo nuk i erdhi mirë që unë s'i kisha hyrë dot akoma 'gjeometrisë? Sigurisht që 'nuk i erdhi mirë aspak.

— S'duhet të jetë ndonjë gjë e vështirë, — vërejti ai më në fund, po duke mos më ndihmuar dot ta zgjidhja teoremën. — Unë këto lloj teoremash i kam ditur mirë fare. S'ka gjë për të mos u kuptuar në to. Po pa dale, pa dale... Sigurisht... do më kujtohen...

Ai lëvizte syzet përmbi hundë, po syzet nuk e ndihmonin fare: ato s'kishin fuqi depërtuese. Ishte çështja për një hipotenuzë dhe ai e përsëriste këtë fjalë, hipotenuzë, në të tillë mënyrë, sa nisi t'ia hante rrokjet e t'i mbetej nëpër dhëmbë një -uzë. Mua më qeshej dhe qesha me të vërtetë. Babait nuk i erdhi mirë që qesha, ai u vrenjt, më vështroi qortueshëm, mbajti do-

rën që të mos më heqë veshin dhe, në vend që të përpiqej më tej për të depërtuar në atë të fshehtëz-gjeometrie, m'u kthye e ma pat:

— Mos nuk shkon mirë me gjeometrinë zotrote?

— Me gjeometrinë dhe me algjebren, — u përgjigja unë, tanimë i shkarkuar nga një si ankth që më mundonte, por edhe me vajin që m'u bë tokël¹⁾ në grykë.

Babai shtangu e pastaj ma pat:

— P-po si? P-po si-i?

Unë rrudha krahët, ula sytë dhe më pikoi një lot.

— P-po si s'ma ke thënë? Tani e gjete ditën? Tani po vjen mesi i tremujorit! Do të kisha biseduar me Musanë. Do të të kisha ndihmuar dhe vetë. Unë këto gjëra... I kam ditur, — nisi ai të pengohet nëpër fjalët.

Mbi mur të dhomës, aty nga e majta jonë, e futur në një kornizë të bukur, të lyer me varak, nën fotografinë e babait e të nënës, që ishte pa kornizë, ishte varur diploma e tim eti. Ai e ruante si një gjë të shenjtë. Po kjo gjë e shenjtë, që ishte e madhe sa një tabak karte, na kishte të shënuara, me një bukurshkrim të rrallë, edhe notat që im atë kishte marrë në klasën e fundit të gjimnazit, në maturë. Dhe nëna ime, që dinte greqishten, më kishte treguar se ç'ishin ato nota, se të kujt mësimi qenë notat e mira dhe të kujt notat jo kaq të mira në mësim. Erdhi ky çast që ajo gjë e shenjtë tim eti po i lozte një drakulak²⁾. Se mua, padashur, pa e bërë aspak me qëllim, më vajtën sytë të diploma mbi mur, ndonëse bëra sikur nuk shihja atë, po fotografinë.

Tim eti i hipi gjaku në fytyrë dhe e pashë që lidhi shpejt duart pas shpine, se përndryshe do më kishte goditur. Më bërtiti:

— Mos më jep mua shembujt e këqij zotrote, shembujt që unë të paskësh dhënë zotërisë sate! Të

1) Kotkë, nyje.

2) Rreng.

kesh turp e të turpërohesh! Jo, ore!... E vërtetë, në algjebër dhe në gjeometri s'kam qenë nga të parët, por ama, këtë teoremë dhe disa si kjo do ta kisha pasur për turp të mos i dija, ta dish mirë zotrote, që më vëngëron andej nga diploma ime! Dhe sa për formulat që në kokën tënde s'u futkan dot, pa m'i thuaj, se zotëria ime ato i di!

Cfarë paraspate! themi ne andej nga Elbasani. Cfarë dacke! Më mirë të më kishte goditur me dru.

U provua që ai nuk lavdërohej, por i dinte vërtet formulat që mua s'më futeshin në kokë. Iu përmendën e m'i ngjeshi dhe mua kaq mirë dhe kaq fort në tru, sa zoti Musa nisi të bënte çudi se si u bëra unë kaq shpejt një pehlivan i algjebërës. Kurse gjeometrinë, edhe atë, im atë e përmendi dhe ajo kishte qenë më e lehtë se algjebra. Sa për zotin Musa, ai s'e mori vesh kurrë se si ngjanë këto, po duhet ta këtë marrë me mend. Ju po e mësoni së pari.

Ada Albani

Ka më shumë mundësi që ju të mos e keni dëgjuar këtë emër, porse unë do t'ju them që në fillim se c'është. Është emri i së fejuarës së Luigj Gurakuqit në Napoli. Një vajzë së cilës iu lidh kaq fort zemra për të dhe për veprimin patriotik të tij, sa emrin e familjes e këmbëu e e bëri Albani. Unë këtë tregim e kam për Luigjin, por i dhashë emrin e Adës, se e meriton të kujtohet.

Ma ka sjellë rasti, në rininë time të parë, të kem nëpër duar një numër letrash të Gurakuqit. Ato kishin mbetur te ne më 1917, kur Luigji i kaloi disa ditë në Elbasan dhe jetoi në shtëpinë e një njeriut tonë. Atij iu dësh të largohej me ngut nga qyteti dhe u la një-rëzve nën kujdes një baule. Baulen mund ta shihni në shtëpinë e tij muze në Shkodër. Ajo mbante për-sipër shkronjat L.G. prej tunxhi. Brenda baulja kishte pasur pak ndërresa të Luigjit, një numër çarçafësh — ai e kishte merak të flinte në çarçafët e botës — dhe libra e dorëshkrime, midis të cilave jo pak letra që i kishin dërguar. Kur Luigjin e vranë në Bari, baulia e tij ishte akoma në shtëpinë ku banoi, dhe atje mbeti. Ai s'kishte mundur ta merrte me kohë, nuk di përse. Kur dëgjuan për vrasjen e zotit Luigj, gratë tona e

qanë përmbi arkën e tij të çelur, përmbi teshat dhe librat e shkresat e tij.

Një ditë — atë kohë duhej të isha rreth gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe Gurakuqi po bënte gjashtë vjet që ishte vrarë — unë e zbulova atë thesar në sobalkën ku ruhej në shtëpi, dhe rrëmovja në të. Nga librat mbaj mend «Gjeografinë» e grekut të lashtë, Strabonit, «Historinë e Romës», që mbante emrin e Momsenit, historian shumë i njohur gjerman, siç kam mësuar më vonë, — «Jetën e Pirros» të Plutarkut, «Andromakën» e Rasinis, që unë e njihja, disa vëllime poetike, që nga Homeri te Danteja, që nga Ariostoja te Karduci, nuk di sa tragjedi të Shekspirit, po «Jul Qezarin» që lexoja nga Noli, dhe të tjerë autorë e vepra që s'më përmen-den. Midis tyre, veprat e plota të Metastasis, në një botim të bukur të shekullit XVIII, që mund t'i shihni në Bibliotekën e Elbasanit. I mbaj mend këta autorë, se kam mësuar të lexoj nëpër librat e Luigjit dhe të mësoj kështu italishten me ndihmën e frëngjishtes. Kishte midis librave të tij edhe vepra të mjekësisë dhe vepra shkollore, që i kishin vlejtur për të dhënë mësim në Shkollën Normale, dhe kishte dorëshkrime të atyre mësimëve, që për fat të keq, nuk ma nxitën interesin. Kureshtën time e tërhoqën, përkundrazi, letrat e tij.

I kam përpara sysh ato letra, të cilat në shumicën humbën nga trazirat e viteve, siç humbën edhe dorëshkrimet e tjera, po një pjesë, sado e vogël, arriti në Arkivin e Shtetit. Për to mund të flisja gjatë përmes kujtimeve të mia, po tri palë më kanë lënë përshtypje mbi të tjerat.

Njëra palë, — ato ishin nja 30, — vinin nga Kosova. Letra të shkruara siç shkruajnë njerëzit që s'apo kanë mësuar alfabetin dhe heqin mundim për tri-katër rreshta, me kalem qoftë ose me bojë. Kur ishte kalem boje-kopjativ — kuptohej se si ai që e kishte shkruar letrën, e kishte njomur kalemin me pështymë dhe i kishte mëshuar kac fort, sa letra më ndonjë vend ishte shpuar. Po çfarë letrash! Ja, për shembull, një prej

tyre, siç e kam të ngulitur në mendje, thua se fjalë për fjalë:

«Hasan beut i kam lënë amanet djalin dhe ai ta ka lënë amanet zotërisë sate, me njëqind djem të anëve të Kosovës. Na i bëj shqiptarë edhe më të fortë se veten. Se po s'i bëmë djemtë tanë më të mirë nga vetja, çfarë fituam?»

Këto, kuptohet, në një kosovarçe, që s'e kam lehtë t'ia riprodhoj tingëllimin. Dhe me një drejtshkrim, që më kot ta riprodhoj. Niste letra me fjalët «mëmë-dhetar i ndershëm e i ndritshëm zoti direktor Luigji» dhe mbaronte me fjalët: «Të merr në grykë një bujk i Kaçanikut, stërnip i stërnipëve të Musa Qesexhisë së kësaj Grykë dhe që dhe mua më quajnë Musa, Musa Kalaja.»

Im atë s'dinte gjë për një Musa Qesexhi. Më pas kam mësuar se ai s'kishte qenë gjithkush, po një kaçak i lashtësisë, për të cilin tregonin këngët dhe që kishte luftuar me Marko Kralin e me sulltanin vetë. Ai s'e kishte lëshuar Grykën e Kaçanikut gjer ditën që u vra prej kralit.

Sa për Hasan beun, ju e kuptuat se ai ka qenë Hasan Prishtina, që kishte dërguar në Normalen e Elbasanit, kur kjo u çel, njëqind të rinj kosovarë. E sa për fjalët e fundit të letrës, edhe në to ju kuptuat se flet Naim Frashëri.

Një pjesë tjetër e letrave që nuk i harroj — ato nuk bëheshin më shumë se 4 — firmoseshin nga njëfarë Baltoje me llagapin Stambolla, emër e llagap që më vranë veshin. Shkruesi lutej nuk di se për çfarë borxhi dhe i niste letrat me «i dashuri me shpirt, shkodrani im vëlla», dhe i mbaronte me «yti përjetë». Pyeta tim kushëri dhe ai u trondit fort.

— Është katili që e vrau Luigjin në Bari! Pa m'i jep, m'i jep t'i shoh! — më rrëmbeu ai letrat nga duart. Ai lexo dhe qaj, unë shih atë e mos mbaj lotët. «Vëllai përjetë!» që do t'i merrte Luigjit jetën për hesap të Ahmet bej Zogut!

Ju e dini se këtë armik e vranë partizanët në Pe-

qin, ku fshihëj dhe e ruanin fashistët, më 1944. E vranë miqtë përjetë të Luigjit, nxënësit e nxënësve të tij.

Pjesa e tretë dhe po kaq e paharrueshme e atyre letrave — rreth 20 letra italisht — kishin një bukurshkrim shumë tërheqës. Nisa t'i lexoja, sepse më tërhoqi edhe firma e tyre: Ada Albani. Ato mbylleshin të gjitha me këto fjalë: «*jotja e jetës e përtej jetës*». Dhe midis letrave ishte edhe një fotografi vajze të bukur disi, po me nur shumë, e buzëqeshur, po me syrin melankolik; flokët i mbante top përjetë, si motit; qafën ia vishte një dantelë, që ia mbulonte të gjithën dhe formonte një zambak të bardhë.

Letrat e Adës ishin të gjata. Unë vetëm mund t'i përmbledh disa prej tyre nga kujtimet e pashlyeshme që kam, se ishin dhe të parat letra të një vajze që lexoja. Po përmbledhjet e mia, ju siguroj, janë të sakta. Psh:

«Më shkruan se më do përherë. E di se s'mund të jetë ndryshe. Po ç'është tërë kjo largësi që na ka ndarë? E di që s'na ndan dot asnjë largësi dhe që ti kurrë s'ke munguar këtu, kurse unë jam për herë atje. Kur do të vish? Kur do të vish të më marrësh? Nxito, në goftë e mundur.»

Tjetër herë ajo shkruante:

«Më thua se kam durim. Ndarja për ne gratë është më e rëndë, dihet. Durimi i tyre është i fortë, pra. Po sado dhe më i fortë goftë se i burrave, edhe ai ka një cak. Ti je në ato male, ku ka krisur pushka. Të lumtë krahu! Unë jam krenare për ty dhe nuk mendoj të rreziku, besomë. Përpiqem të të shoh si je dhe kështu si je sot do të të kujtoj përherë, se kështu ka për të të kujtuar përherë Atdheu yt, dhe unë e adhuroj këtë kujtim. Unë, që u bëra nusja jote e zemrës, them se do ta kem emrin tim nën ndonjë kënd të ndonjë shkrimi për ty dhe kështu, edhe përtej jetës, kam për të qenë pranë teje. Stërgjyshi im i largët, që thonë se ka qenë nga ato vise të thepisura, do të jetë në emrin

tim. Lufto! Po mos harro të vish e të më marrësh. Të pres!»

Dhe tjetër herë:

«Unë jam Albani tanimë prej kaq vjetësh, po kam genë e tillë prej gjaku të hershëm fort. Dhe jam jotja. Mos duhet të t'i përmend këto? Ti, sido që ta sjellë puna, për një grua pranë do të kesh nevojë, makar të të lajë një faculetë. Një e atyshme mund të të dojë me tërë zjarrin e shpirtit, aspak nuk dyshoj. Po unë me tërë atë zjarr të dua dhe e kam provuar. Kur do të vish e të më marrësh? Kur do të më shkruash të nisem? Se unë nisem dhe vetë e të gjej, kudo qofsh. Në ato vise që u kam edhe emrin, unë jam me zemër e tëra. Po përse shkruan ti kaq rrallë? Shkruaj, të paktën më shkruaj?»

Dhe një letër e saj nga të fundit:

«Ti më ke përkthyer italisht disa vargje popullore. Skënderbeu nuk e paska dashur gruan as nga Pulja as nga Napoli. Unë [s'jam napoletane, po kam qëlluar. S'ka për të m'u ngushtuar zemra kurrë në suazën e maleve të thepisura, se do të mbaj në gisht unazën tënde. S'jam shprehje e limontisë¹). Kujto se kam lindur rrëzë një Vezuvi, se kam dalë nga ijat e tij, si më thoshe. Dhe eja, eja të më marrësh, ose më jep leje të vij. Mos bëj kaq hoka të trishtueshme me mua, të dua shumë. Këto janë hoka. Unë dashurinë ta njoh dhe ti hoka nuk arrin të bësh.»

Dhe nga letra e fundit:

«Më thua se je martuar njëherë, — me Shqipërinë. Ta uroj trashëgimin të madh e më të madh! Po prapë, kur të mundesh, më shkruaj, më kujto me një kartë-postale, në mos me një letër. Dërgo ndonjë fotografi. Unë s'po të shkruaj më, s'po të ngacmoj. Po ti më do dhe unë dërgesën tënde s'mund të mos e pres. Unë jam ajo që kam genë dhe s'mund të mbetem veçse ajo që jam: Ada Albani. E të puth përjetë.»

1) Mekje, plogështi.

Një javë pranë ministrash

Im atë, bashkë me një shok të vetin mësues, duhej të shkonte në kryeqytet, nuk e di për çfarë pune, atij gushti të vitit 1924. Në qershor kishte ngjarë revolucionin që dëboi Ahmet Zogun.

— Nuk marrim edhe djemtë? — thanë ata dhe na morën.

Vërsniku im ishte një shok i dashur dhe në Tiranë, edhe kur mbeteshim vetëm të dy, nuk mërziteshim.

Udhën e bëmë me automobil. Xhadeja prej Elbasani në Tiranë sapo ishte çelur.

Qe një udhëtim i paharrueshëm, nga i cili mbaj mend shumë gjëra. Për shembull, se prej Kavaje në Durrës punonte akoma dekovili austriak. Po lokomotivë më s'kishte dhe dy-tre vagonë i tërhiqnin kuajt. Mbi vagonë zbardhnin qeleshet e kavajasve dhe natpat e grave të tyre. Durrësit i kujtoj një sahat rrëgjaq, që s'i vinte as te gjuri sahatit tonë të Elbasanit ose atyre që pamë në Peqin e Kavajë dhe sahatit që do të shihnim në Tiranë. Po kishte Durrësi një kala me tërë ato mure, shumë më të mbajtur se ajo e Elbasanit dhe që u ngjitej kodrave. Kishte një portë të lartë, aty ku sot është qendra e qytetit dhe ku niset shëtitëtorja për në skelë. Edhe atëherë, kjo qe rruga kryesore e Durrësit megjithfarë tregtiazash laragane nga

të dyja anët. Më 1928, për madhështi — Shqipëria u ribë mbretëri! — bashkia e Durrësit, që ta dini, mori vendim të çelë shëtitoren dhe rrëzoi një pjesë të madhe të kalasë me gjithë portën. Poeti korçar Loni Logori, që ishte vendosur në Durrës, ku edhe vdiq, dhe që ishte inxhinier, u hidhërua shumë për atë krim dhe shkroi një strofë të kripur, një epigram, për kolegun e tij inxhinier, që mori përsipër shembjen e monumentit. Ja strofa, që meriton të përmendet:

*Me vendim të qeverisë
jepet urdhër perëndisë
të pushojë tërmetin.
Sa për të rrëzuar
e për të shkatërruar
kemi urdhëruar
inxhinier Skanjetin.¹⁾*

Bukur apo jo?

Përshtypje më pati lënë edhe ura e Shijakut mbi Erzen. Shijaku që një fshat i përhapur kodër më kodër, porse kishte një urë të montuar... prej hekuri.

Duhet të përfundoj se Tirana më pezmatoi. Pritja shumë. Kryeqyteti e kishte zor të hahej edhe me Elbasanin, kurse Korça e linte shumë pas. Sidoqoftë, Tirana kishte hijen e rëndë të kryevendit dhe këtë mund ta ndiente edhe një fëmijë. Ne të dy elbasanasit e ve gjël e ndjemë, dhe jo pak.

Ne banonim në han «Elbasani», aty nën sahatin e madh. Për të ngrënë, hanim në një restorant pak më lart, restorant i njëfarë Haxhiu, ku hanin nëpunësit e lartë. Rrugës, edhe atëherë, si sot, i thoshim 28 Nëntori. Ajo kishte diçka të veçantë: dyqanet përballë sahatit dhe hanit e kishin trotuarin të mbuluar dhe me harqe. Ja një gjë që s'e kishte Elbasani dhe as Korça. Këto harqe, si dhe hani, pas Luftës u bënë kopshte.

1) Inxhinieri që prishi kalanë.

Në restorantin e Haxhiut, — ai mbi tabelë quhej «gjellëtore», po për të thirrur e thërritnin akoma «akçihane», — në atë akçihane hahej mirë vërtet. Imambajalldia¹⁾ që me nam. Minestra²⁾ me lëng pule me fidhe e vezë e me limon që e rrallë; mishit të qengjit e të kecit i haheshin gjer kockat, dhe me sa shije! Kadaifi me kajmak ishte i parrëfyeshëm; Haxhiu ishte sheqer e mjaltë; shoqëria, e lartë.

Im atë dhe shoku i tij njiheshin prej kohësh me Luigj Gurakuqin, i cili drejtoi Normalen në Elbasan që në fillim, ku erdhi prapë më 17. Ai ishte ministër, po qejfi ia kishte të hante me dy mësues të thjeshtë. Ulej pra në tryezën tonë, i bëshëm në trup, me sytë të mëdhenj gjithë gjallëri e fisnikëri, zeshkan në qime e me çehre të bardhë. Ai vinte në restorant me dy turra gazetash në xhepa, — këtej gazetat e vendit, andej të huajat, — komentonte lajmet me miqtë arsimitarë, qante me ta hallet e qeverisë së re, gjente fjalë edhe për ne të vegjlit. Ne na donte shumë dhe ëmbëlsirat tona i paguante përherë ai, duke thënë, i mallëngjyer:

— Përfitoj nga rasti!

Gurakuqi s'kishte fëmijë, s'ishte martuar.

Mbaj mend se ishte hokatar dhe hokat i shkonin veçanërisht edhe pse i mbahej goja dhe fjalët sikur i kërcitnin nëpër buzët e fryra. Di se ka qenë orator i zoti, — lexojini fjalimet e tij, — veten e quante për shaka Demosten, meqë Demostenit, oratorit të madh të Greqisë së lashtë, na i qenke mbajtur goja.

E pra, Luigji hante në tryezën e miqve të vet elbasanas, të vjetër e të rinj. Ai nuk mbahej aspak se që ministër. Nuk kishte ndonjë ndryshim nga veshja me një shumicë nëpunësish. Kishte një qostek të hollë ari, nga njëri xhep në tjetrin të jelekut, siç kishin dhe kaq të tjerë. Bastun nuk mbante, siç imbanin kaq

1) Patlixhana të mbushur.

2) Lloj supe.

të tjerë për salltanet. Por kur futej në gjellëtore, të gjithë ngriheshin për ta nderuar dhe Haxhiu nxitonte t'i shërbente vetë dhe jo garsonët, djemtë e akçiut.

Një ditë, në drekë, në gjellëtore hyri një burrë i shkurtër e shumë zeshkan, me një xhybe të zezë, me kryq të artë mbi kraharor, po në kokë jo me kamillaf: ai mbante kapelë. Ishte Fan Noli, kryeministri! Njerëzia kërcyen në këmbë dhe Noli u duk edhe më i shkurtër nga ç'ishte. Ai kishte një mjekër të plotë, në vend të syve kishte dy xixa. Buzëqeshjen e kishte të ëmbël, mund të thosha melankolike, si më është tiposur në kujtesë. Zërin kumbues. Kur fliste, asnjëri nuk dëgjohej: mbanin vesh të gjithë. Unë, ato që tha, më shumë i mbaj mend nga ç'kam dëgjuar pastaj për të kur e kujtonim.

Kur hyri Noli në gjellëtore, im atë me shokun e tij nxituan t'i puthnin dorën, por ai s'i la dhe i përqafoi shqiptarçe, kurse Luigji e rrëmbeu shokun dhe gati e zhduku në krahët e tij, duke i lëvduar nuk e di çfarë gjellësh të dhjamura e duke u shkelur syrin mësuesve. Noli nuk përdorte mish, ai hante vetëm zarzavate, ishte «vegjetarian», si thonë. Ai qeshi e tha se do të gjendej edhe ndonjë gjellë për një njeri të përkorë, kurse Haxhiu i solli shpejt një pjatë me kos, një tjetër me turli sade, një të tretë me radhiqe dhe me një limon pranë.

Hirësia hapi sytë me kënaqësi dhe habi, dhe e pyeti gjellëtorin, duke zgjatur duart e duke marrë një shishe të vogël, që ishte mbi tryezë.

— Gatuan të tilla zotrote?

— Gatuj përditë për ty, zotëri, që kur të urdhërosh e të vish, të kënaqesh.

— Kurse unë s'jam dukur këtu kurrë! — ia bëri Noli me këqardhje dhe trazoi radhiqet e spërkatura sadopak me vaj.

— S'ka gjë. Unë e kam për detyrë t'i kem radhiqet përditë për ty. Ja si më urdhërove zotrote dhe nuk u turpërova.

— Dhe herët e tjera ti i ke hedhur, — tha Noli, duke përdorur edhe një grimë kripë.

— Ia kam hedhur barkut, — tregoi Haxhiu barkun e tij pllaçë. — Edhe unë jam kundër dhjemit, — tha ai dhe krisën të qeshurat nëpër akçihanen që dëgjonte në heshtje.

Pas fjalëve të para që u këmbyen për shëndetin, mësuan se Noli e kishte kërkuar gjithë mëngjesin Gurakuqin në telefon për një punë urgjente, dhe s'e kishte gjetur. Ministri tha se kishte qenë në zyrë, po me telefon të prishur, gjë që s'i ngjiste për herë të parë, — «se kemi ca telefonistë (tha), që s'janë as telefona-xhi, ca oficerë që tytën e mbajnë nga ne, ca nëpunës që më shumë kanë unaza nëpër gishta, se bërthamë në kokë» (i ra ai me gisht kokës së vet).

Nëpër sallë heshtën pirunjtë e lugë dhe kaloi një si fërgëllimë.

Haxhiu tha:

— Sekush mençurinë e vet, zotëri, — që donte të thoshte, sigurisht, se armiqtë dhe hajdutët nuk janë kaq budallenj, kurse Noli u zbeh dhe mezi u për-coll.

— Ti, Haxhi, — i tha ai akçiu, — i harron myshterinjtë? Nuk druhash për allishverishin?

— Jo, — ia ktheu Haxhiu. — Janë ata që s'më harrojnë dot mua. Ata duan të hanë mirë dhe kjo është e para e shumë punëve të tjera, në mos e të gjitha për një shumicë të madhe. Një akçi si unë bën përherë punë. Zotërinjtë kanë neps. Axhem pilafin tim nuk e gjen as në Axhemistan¹⁾, se në Stamboll jo se jo, dhe tavën time me kos të vish e ta hash këtu në Tiranë, te ky Haxhi, — vuri pëllëmbën mbi kraharor, — pranë tyrbes së Abdurrahman beut, jo në El-basan tek Abedini, le të jetë Abedini një usta i madh.

Noli qeshi hidhur dhe salla qeshi sadopak.

Nuk di t'ju them se ç'punë me rëndësi kishte krye-

1) Persi.

tari i qeverisë me ministrin e tij të financave. Ata biseduan një copë herë për një punë, Noli duke përcjellë nga pak kos, Gurakuqi duke mos e ngarë atë kohë një kokë qengji të ndarë më dysh. Noli na vështronte ne të vegjlit pranë me ngulm. Ai më pyeti në mes të asaj bisede:

— Kush të pëlqen më shumë, Elbasani apo Tirana, more trim?

— Korça, — iu përgjigja unë, tanimë i ambientuar midis dy të mëdhenjve të shtetit.

— Pa shih, pa shih! Di të çmojë saktë djali i mbarë, mor i dashur Luigj, — u kthye Noli nga shoku i tij.

— Të drejtë ka çuni, — pohoi Luigji. — Po Shkodrën nuk e njeh, si nuk e njeh as zotrote, — lojti ai syrin nga unë.

— E marr me mend nga fotografitë e Marubit, — ia ktheu Noli. — Një kështjellë, ku kanë muruar një grua të gjallë me emrin Rozafë, rrugica gjatoshë me mure kalarash nga të dy anët, fereuxe, perçe..., — dhe ai kapërceu prapë te çështja për të cilën kishte ardhur të takohej sa më parë me ministrin e tij, për t'u thënë pas pak mësuesve:

— Sa mirë bëni që i merrni djemtë me vete në udhëtimet tuaja! Një udhëtim, edhe i shkurtër, — u kthye ai nga ne të vegjlit, — është sa për një libër të gjatë. Një udhëtim i gjatë është sa për një bibliotekë. E dini ju kujt i thonë bibliotekë? I thonë një vendi ku ruajnë librat dhe ku vete ti e i këndon, me mijëra libra.

— Unë kam rrahur anët e dheut, gjer në Qabe, — deshi të qeshte Haxhiu akçi, që i solli prapë kos Nolit. — Sa libra kam në kokë, hirësia juaj?

— Ty ta ka zënë kokën Kurani qerim¹⁾ dhe s'të nxë asgjë më fare, — ia ktheu Noli. Të të them ta shkarkosh ca, do të thuash se kërkon të të bëjë kaur i pari i kaurëve.

1) Libri i shenjtë.

— Thuaje, thuaje, se ti s'je i pari kaurëve, — ia ktheu Haxhiu, — po i pari i Shqipërisë, i të krishterëve e i myslimanëve, — kurse Gurakuqi i tha Nolit:

— E sheh që s'ka në kokë vetëm Kuranin? Sa di kjo kokë! Udhëtimet i kanë vlejtur shumë, pa fjalë.

Noli përtypej e mërmëriste:

— Dituri është edhe të gatuash radhiqe si këto, që qenkan të famshme. Po ju, more djem, — u kthye ai nga ne, — akçinj do të bëheni, se s'po e themi dot akoma fjalën «gjellëtore» as ne, as zotërinjtë mësues?

— Ky zanat vetëm pa bukë s'të lë, — ndërhyri akciu.

— As pa gjellë, dhe në çdo qeveri, — kafshoi Gurakuqi gjuhën e qengjit dhe ç'qenë përreth qeshën.

Që të mos e zgjat, te rruga u duk një kalimtar i veshur spic, me një bastun me dorezë argjendi, me kokën pak si mënjanë. Një zotëri që hante pranë tryezës sonë, i bëri shenjë rojes së kryeministrit që rrinte te dera e restorantit, e diç i tha në vesh. Roja e dëgjoi me shumë qejf dhe nxitoi e doli jashtë në rrugë.

— Zotin Pandeli¹⁾ sikur po e përkëdhelim duke i dhënë edhe një polic, — ia bëri Gurakuqi nga Noli, pasi e pa edhe ai kalimtarin. — Tanimë zotëria e tij s'ka nevojë për roje. Zaten s'ka pasur nevojë kurrë, se nuk ndyen njeri dorën me një patriot të tillë.

— Fodullëku ia do, — u përtyp Noli, — po s'e ditkam.

— As unë s'e kam ditur, — tha Luigji.

— Dhe policin, me goxha çantë, — foli zotëria që hante pranë nesh.

— E di se ç'mban në çantë, — tundi kokën Noli.

Ai i tha këto fjalë, përjashta u dëgjua zhurmë, pastaj roja nuk vonoi të hynte me çantën e Pandeliut në duar. Gurakuqi i bëri shenjë të largohej. Noli e vëngëroi me qortim.

— Kemi shumë për të spastruar, hirësi e lartë,

1) Pandeli Evangjeli, politikan reaksionar.

— tha zotëria pranë nesh me inat gati të papërmbajtur.

— Kemi, — pohoi Noli me kokë dhe e la bukën e më nuk hëngri.

Ju e dini se ata të qeverisë revolucionare të vitit 1924 nuk vepruan për një spastrim të shpejtë të vendit nga kundërshtarët dhe kjo kushtoi shtrenjt shumë. Zogu nuk e zgjati as gjashtë muaj që të rrëmbente fuqinë me armët serbe dhe me rusët e bardhë. Pandelinjtë u bënë kryeministra prapë. Sa për çantën, kjo paska qenë njohur shumë për zotërinë spic: ai e përdorte vetëm për ndërresat që shpinte për t'i larë. Këtë kujdes e paske pasur dhe i qëndronte mbi krye vetë. Sqimat kanë huqe të çdo lloji.

I përmend këto siç kanë qenë. Atëherë pak gjë më mbeti në vesh, sigurisht, po më pas veshi më rrëmbente shumë e më shumë. Noli do të shkruante në mërgim, me keqardhje e dhembje të madhe shumë, që nuk përdori kamxhikun. Vjershat e tij i keni parasysh, «marshet» e tij të Barabait dhe të tjera, këngët e tij «mangall» dhe të Salepsulltanit. Mua, nga fëmijëria, më kujtohet se si atij dhe disa shokëve të tij njerëzit e mirë u përgjërroheshin.

Kufomat e gjalla

Një dramë e Leon Tolstoit mban titullin «Kufoma e gjallë». Kaq më mjafton që t'ju zgjoj interesin për vepërën, nëse do t'ju pëlqente ta lexonit.

Ju kam treguar se si në Elbasan loznin «Otellon» dhe «Robert Guiskardin». Shekspirin kishim nisur ta importonim që nga... Turqia. Unë isha ende i vogël që të kuptoja dhe të zemërohesha për këtë, se si ish-Turqia e sulltanëve po na eksportonte kulturë, le të kisha dëgjuar se Shqipëria kishte mbetur një «Turqi e vogël». Në mesjetën shqiptare largohej ndonjë autor yni, të cilin i çakërdisej koha. Koha ishte e tillë që edhe mund t'i çakërdiste njerëzit, sidomos ata të cilëve iu prish mendja se nuk mund të pritnin gjë prej saj. Ata kërkuan të mirat materiale dhe disa edhe i gëzuan. Të mirat morale u hodhën t'i kërkojnë në arratinë e shekujve, ku shpesh nuk ditën t'i gjenin, pra s'qulloën gjë me vlerë.

— Skënderbeu po, po Robert Guiskardi?! — pata dëgjuar njëherë të shprehej jo me qejf im atë, po nuk e pata kuptuar.

Drama «Robert Guiskardi» tregonte dashurinë tragjike të një normandi me një shqiptarkë, në shekullin... XI.

— Hane Shan,¹⁾ hane Bagdat, — thotë një fjalë e urtë.

Po në Elbasan loznin edhe «Mullah Tahirin» dhe kjo ishte një komedi groteske, një farsë, e cila suksesin e madh e kishte pikërisht sepse në qytetin ku punonte që nga Rilindja Shkolla Normale, tregohej në skenë se cili pati qenë arsimi anadollak, — «me shkue në hoxhë». Hoxhën — mullanë — duhet ta përfytyroni me mjekër ose pa mjekër, si të doni, po domosdo me çallmë. Kur efendiut qëllon t'i bjerë çallma, i del një kokë e qethur me makinë zero, në mos tullace prej vetiu. Dhe ta përfytyroni hoxhën me një shkop të gjatë thane në dorë, që kur godet me të nxënësit e tij — «talebete» — i bie çallma nga koka domosdo. Atëherë është dhe kulmi i gazit, si në sallë, ashtu edhe në skenë, se qeshin aq fort artistët, sa dhe shikuesit.

Suksesin komedia në fjalë e kishte përherë të madh e të përgjithshëm, si ndër të ditur, si ndër të paditur. Mbase dhe ndonjë hoxhë a mulla do të kishte qeshur me vetvete, po të kishte ardhur në shfaqje, po hoxhallarët dhe mullallarët nuk vinin në «qatër», e kishin «për gjynah».

Ndër të paditurit ose injorantët kryesorë të kohës, në qytetet si Elbasani, qëllonte të ishin prefekti me komandantin e xhandarmërisë. Ata, për disa gjëra, mund të haheshin midis tyre, si për shembull për egërsinë; po disa herë nuk haheshin dot për injorancën. Kjo s'ka qëlluar vetëm një herë në kërthizën tonë të Shqipërisë. Ndër zotërinjtë që e pëlqenin mbi të tjerë «Mullah Tahirin», ka qenë pikërisht një ndër prefektët e qytetit.

— E ka qarë fare! — e admironte prefekti komedinë, dhe kishte të drejtë.

Prefekti kishte mësuar te një hoxhë, te një mulla si Mullah Tahiri ynë, i cili thoshin se qe një personazh që vërtet kishte mësuar motit në Elbasan. Prefekti, pra, nuk dinte më shumë se ç'kishte mësuar te mullai i

1) Damasku.

tij ezber¹⁾, përmes Kuranit dhe shkopit. Shqip, zotëria nuk dinte të hidhte më shumë se firmën e tij — Merxhan — dhe autori i komedisë mbi këtë lloj xhahillëku e kishite lëshuar tërë mllefin e tij prej mësuesi të shkollave të para shqipe që ishte.

E pra, në Elbasan, tregojnë se, në vitin 1936, u luajt «Kufoma e gjallë» e Leon Tolstoit. Unë s'e kam parë, por e kam të dëgjuar. Tregonin se subjekti i dramës ngatërronte një konteshë me një burrë. Autori, shkrimtar i madh realist, nuk e kuptonte mirë përse nuk kishte lumturi bashkëshortore në atë jetë, si nuk kishte shumë e shumë gjëra të lakmuara nga zemrat e mira. Dhe duke mos e kuptuar, po duke protestuar, prapëseprapë tregonte edhe tragjedinë e jetës ku rronte, edhe dëshpërimin për të ardhmen. Njerëzit me zemër të mirë, duke u revoltuar kundër jetës, nuk zbulonin dot rrugëdaljen e dëshpërroheshin. Po revolta prapëseprapë shtoej, vala e saj rritej, gjer të bëhej një ditë tetori mal në Rusinë cariste dhe të pëlciste, sepse njerëzit me zemër të mirë e kishin zbuluar rrugëdaljen.

Pra, «Kufoma e gjallë» u ngjiti edhe në skenën e Elbasanit. Pjesën e luajtën, si zakonisht, disa nxënës të Shkollës Normale. Regjisor ishte autori i «Mullah Tahirit», që se pse kishte ndier nevojën e një vepre të Tolstoit. Po ndoshta sepse Tolstoi kishte nisur të njihej me ndonjë libër të vetin edhe shqip, — apo sepse, në kinema, rolet e veprave të tij i loznin artiste të njohura. Rolin e konteshës Liza te «Kufoma e gjallë» e lozte një nxënës shumë i ri, mustaqja pa dirsur, që nën fustane e bishtaleca dukej një konteshë e vërtetë si Elbasani nuk e përfytyronte dot ndryshe. Ai nuk lozte keq dhe e kuptonte aventurën e zonjës që trupëzonte, kështu që shikuesit dhe ndonjë shikuese prekeshin disa herë thellë nga monologët e Lizës, ndonëse u dukej qesharak i shoqi i saj, Fedja.

E merrni me mend se në rreshtin e parë të sallës

1) Përmendsh.

vendosej prefekti, i zhytur në kolltukun e tij, që ia kishte shinin sjellë nga zyra. Ai gruan dhe fëmijët nuk i sillte në teatër. Nga kjo anë, ky prefekt kishte mbetur, si nga shumë anë, te mullai i tij. Ai nuk e çonte familjen në «qatër». Po, si prefekt që na ishte, zotëria do të bënte figurë të keqe po të mos vepronte si njerëzit e ditur të qytetit, po të mos shkonte në teatër.

Prefekti e pa shfaqjen e «Kufomës së gjallë» me ëndje dhe pa ëndje. Kjo nuk u kuptua mirë. Po në fund doli e qartë se ai ishte i pakënaqur, meqë nxitoi e iku i ngrysur. Mësuesi-regjisor kuptoi se shfaqja nuk ishte pëlqyer nga i pari i hyqymetit. Prefekti i kishte tundur edhe gishtat me njëfarë mënyre, duke u larguar pa i dhënë dorën. Xhandari që kishte zotëria roje, erdhi e i tha mësuesit se prefekti e priste të nesërmen në zyrë «me sabah».

Në ankth, regjisorin nuk e bëri veten, po dhe trupa e tij e kishte vënë re se kryeqeveritari doli i ngrysur. Pra, u përpoqën aktorët dhe shokët e tyre të kuptonin përse zotëria kishte ikur i ngrysur nga salla e nuk i dhanë dot dum.

Një palë mendonin se zoti Merxhan nuk kishte marrë vesh asgjë, disa thoshin se ai kishte dëgjuar ters ndonjë gjë dhe qaheshin se shqiptimi i tyre s'kishte qenë përherë i qartë, gjë që ishte e vërtetë. Po premierat e kanë këtë rrezik, sado të bëjë trupa dhe regjia. Një palë tjetër mendonin se prefekti kishte pasur ndonjë mërzë dhe pjesa nuk e kishte ndihmuar për t'i hequr hallin, po përkundrazi. Prefekti donte «Mullah Tahirin». Pra Mullah Tahiri duhej luajtur përsëri dhe sa më parë, të paktën «për t'i hequr kasavetin» zotit Merxhan. Njëri tha se zoti Merxhan duhej të kishte nuhatur, në mos kuptuar, protestën shoqërore të pjesës, po të gjithë u hodhën e thanë se kjo ishte e pamundur dhe ai që e shprehu dhe që nuk e besonte as vetë, nuk nguli këmbë në mendimin e tij. Një i ka-

1) Hallin, shqetësimin.

tërt tha se duhej të kishte ndonjë dramë midis Merxhanit dhe Merxhanores, dhe tërë ky diskutim përfundoi në gaz.

Të nesërmen, me mëngjes, mësuesi-regjisor e la vrapin në prefekturë. Prefekti s'kishte ardhur. Atij nuk i dihej se kur dilte në zyrë, pra duhej pritur. Piu mësuesi duhan pas duhani, një orë të tërë, nëpër korridoret e prefekturës, nëpunësit nisën të mërzhiten nga ecejaket e tij, sikundër edhe ai u mërzhit me mënyrën se si ata i hapnin kokërdhokët ose e tundnin kokën kur tregonin se «e kishte ftuar prefekti» për çështjen e «Kufomës së gjallë», që u luajt natën e kaluar. Dhe mësuesi u bë më në fund nervoz; ai që nuk bëhej lehtë nervoz, zbriti katin poshtë dhe doli e u ul te shkallët, në derë të prefekturës, ku priti edhe ndonjë orë a më shumë.

Së fundi, nëpër një duman pluhuri dhe duke hedhur gurët e çakullit si gurë sabeje¹⁾, u duk tej vetura e prefektit. Ajo vinte me nxitim të vërtetë, thua se në prefekturë na qenë bërë të paduruar ose merak.

Zoti Merxhan doli rëndë-rëndë nga dera e makinës, që nxitoi e ia hapi xhandari i tij. Ai i bëri një përshëndetje të thatë mësuesit, si dikush që e ka harruar këtë njeri dhe që nuk di se e ka thirrur. Xhandari i bëri me sy që t'u vinte pas dhe ata ngjitën shkallët me hapat e ngathët të kryeqeveritarit, i cili ngjitej sikur ta tërhiqnin nga lart me çengel, mahmur nga një darkë e gjatë që kishte kaluar me miq pas shfaqjes së «Kufomës së gjallë».

Mësuesi priti edhe plot një orë te dera e zyrës së zotit prefekt, gjersa xhandari i bëri shenjë të hynte. Hyri me kapelën në dorë. Syzet e rënda dhe të trasha, me një hundë pak si tepër të madhe, që i zinte gjysmën e fytyrës hollake, e tregonin përherë si një shpend të çuditur, edhe të mos qe i tillë. Edhe prefektit ashtu iu bë, që i tha:

1) Prazhgë.

— Mos u çudit se të kam thirrur, pas asaj thjatroje që pamë mbrëmë, zoti Mehmet. Po urdhëro, urdhëro e ulu në atë kolltuk, — i tregoi ai vendin, — se të bëra të presësh ca. Po punët, më kupton, — hapi ai krahet dhe hapi pëllëmbët, për të treguar se kishte pasur një mal me punë atë sabah, dhe shtoi: — po vërtet, dua të të pyes zotërinë tënde për një gjë: plak njeri zotrote, ç'të lidh ty me thjatron e me çunërinë?

Këtë pyetje mësuesi sikur e priste. Ai iu përgjigj rumbullak:

— Arti, zoti Merxhan.

— Arti, — lidhi duart zoti Merxhan, sikur ta zinte me të dyja duart atë fjalë dhe artin vetë, ta shtrëngonte fort, për të mos i shpëtuar. — Unë nuk e marr vesh fare atë fjalë, që ta dish zotrote, zoti Mehmet. Po s'ka rëndësi dhe nuk dua të ma shpjegosh. Thjatroja është thjatro. Si njerëz të qytetëruar që jemi, edhe do të vemi e do ta shohim. Po që të lozim thjatro unë dhe zotrote, — tregoi ai veten e pastaj mësuesin me dorë, — këtë nuk e gjej, si të thuash, dhe kaq të pëlqyer.

— Zotëria juaj se mos lozni thjatro, — ia bëri regjisori, duke e treguar prefektin me gisht. — Ju jeni njeriu i qeverisë, që lozni rolet e qeverisë. Thjatro loz unë, — vuri ai pëllëmbën mbi kraharor. — Unë jam njeriu i artit.

Prefekti e vështroi shtrembër. Ai çeli e zgjati një kuti të argjendtë, regjisori u çua, u zgjat e mori një cigare. Prefekti tha:

— Ju të thjatrosh nuk jeni si tërë të tjerët. Do-mosdo, ky zanati i karagjozit ka pahanë!) e tij nëpër botë. Në Stamboll e çmonin. Italianët lënë mendtë pas tij. Edhe unë s'jam nga ata që nuk i vënë paha. Po ju qofshi që e bëni atë zanat!

Mësuesi u drodh nga zemërimi, i shpëtoi cigarja

1) Çmimin.

që sapo ndezi, dhe e shkeli me këmbë përdhe. Ai ia ktheu:

— Ky zanat është art!

— E di, — tha prefekti.

— E dini, po s'e merrni vesh, më thatë, — ia ktheu përsëri mësuesi.

Prefekti e kuptoi se i hasi sharra në gozhdë. Këta thjatroxhinjtë bëjnë thjatro edhe në zyrë të hyqymetit, gjersa bëjnë në mes të pazarit. Më mirë të hynte në çështjet.

— E kujt është ajo thjatroja që na lojtët mbrëmë, zoti Mehmet? — pyeti.

— E Leon Tolstoit, siç e kemi shpallur dhe zyrat tuaja të nderuara e dinë, që na dhanë lejen ta lozim, — deshi t'i dilte përpara së keqes që parandiente mësuesi.

— Po ç'është ai zot e ku rron? — pyeti prefekti.

— Ka qenë një zot që rronte në Rusi dhe që shkruante, si Naim beu ynë...

— Naim beu ynë s'ka bërë thjatro! — ia preu gati me të fortë prefekti.

— Ka shkruar Sami beu, — ia pat tanimë gjakftohtë mësuesi dhe mori cigaren tjetër që i zgjati prefekti.

— Si ia thonë emrin atij rusit? — pyeti ai, i zënë keq.

— Leon Tolstoi, — përsëriti mësuesi. — Ka vdekur tridhjetë vjet të shkuar, në kohë të carëve, — e theksoi ai këtë fjalë.

— Me carët ishte apo kundër? — nxitoi dhe u interesua prefekti.

— Jetën s'ia di, — u përgjigj mësuesi, — po kam dëgjuar se ishte kont.

— Kont?! — hapi sytë dhe lëvizi nga vendi e u ngrit prefekti.

— Kështu kam dëgjuar, — tha mësuesi, i cili më kot po përpiquej të zbulonte se përse e kishte thirrur Merxhani në zyrë.

— Dhe i bënte konteshat theatrina! — tha prefekti

gati me zë të lartë e pastaj kroi dy-tri herë gurmazin, duke mbajtur zemërimin.

— Ai shkruante edhe mbi konteshat, zotëri, po teatrina s'kam dëgjuar që t'i bënte. Po zotrote ke të drejtë nga një anë, se kontesha që janë bërë teatrina ose teatrina që janë bërë kontesha ka pasur edhe ka nëpër botë. Kjo është e saktë.

— Po mbrëmë, a nuk e pamë një konteshë theatrinë? — e forcoi prapë zërin prefekti që mezi përmbahej.

— Jo, — tha mësuesi. — Mbrëmë ne pamë çunin e Kamber Sekserit të lozë rolin e një konteshe, zoti Merxhan.

— Pse, çuni i Kamber efendiut ishte ai? — bëri çudi prefekti.

— Si urdhëron.

— Qenka për të biseduar me Kamber efendiun. Goxha avokati të nderuar nga mileti dhe nga qeveria t'i dalë djali si çupë në thjatro! Më vjen keq.

— T'et s'i vjen keq, — ia ktheu mësuesi. — Kam biseduar vetë me zotin Kamber dhe s'është kundër, bile i pëlqen.

— Më vjen keq, — e mbajti veten prefekti. — Po kjo është punë e avokat efendiut. Unë nga zotëria juaj, — e ngriti ai edhe më shumë zërin, — dua vetëm këtë punë, që t'i biem shkurt: nuk dua konteshë në thjatro! — bëri ai një gjest të prerë me pëllëmbë.

— S'po ju kuptoj, — u çudit shumë mësuesi.

— S'ka asgjë për të më kuptuar këtu, zoti Mehmet. Unë s'dua konteshë në thjatro! — bëri ai të njëjtin gjest. — Këtë urdhëroj!

— Po ne mezi e luajtëm atë pjesë dhe kemi bërë shpenzime dhe kemi lejen tuaj të qeverisë, — tha mësuesi. — Pastaj, tërë botës i ka pëlqyer mbrëmë. Ç'vërejtje keni zotëria juaj, që ta di?

— Kam vetëm një vërejtje, — u ul në vend rëndë prefekti: — që nuk dua konteshë në thjatro. Dhe mos e bëni për fjalë se ai thjatraxhiu rus na paska qenë kont.

Mësuesi në çdo gjë kishte menduar, po te këto, jo.

Ai thithte e tymoste cigaren dhe nuk dinte ç'të bënte, ç'të thoshte më. Urdhri qe i prerë me sëpatë. Kur i shkrepri në mendje dhe pyeti, gati duke kërcyer nga kolltuku:

— Po sikur ta bëjmë konteshë markizë, zoti prefekt?

— Bëjeni ç'të doni, po konteshë s'e dua, — qe përgjigjja.

— Bukuri! — i qeshi fytyra mësuesit. — Qoftë e bërë!

Po prefektit iu vrenjt balli dhe këmbu mendje:

— Shiko, — i tha, — nuk e dua as markizë!

— Mirë, mirë, e bëjmë dukeshë, zoti prefekt, po s'e deshët as markizë.

— As dukeshë të mos ma bësh! — ia preu prefekti me gjestin e tij të dorës.

— S'po i vëmë asnjë ofiq të këtillë zonjës Lizë: po i themi shkurt zonja Lizë, — qeshi mësuesi. — Jeni i kënaqur?

— Ju jeni një burrë i mençur, Mehmet efendi, — qeshi dhe prefekti. — Sikur të mos merreshit me thjatro, unë do të kisha një paha edhe më të madhe për zotërinë tuaj, si patriot të vjetër që të kemi..

— Po ky është art, zoti Merxhan, — ia bëri duke mbajtur veten mësuesi.

— Unë andej s'marr vesh e mos më ngatërro andej.

— *Evet, efendëm¹⁾*, — nderoi regjisori, — as konteshë, as markizë, as dukeshë nuk do t'i themi, po vetëm zonja Lizë do t'i themi, — dhe mori leje e doli.

— Dhe as për kont të mos bësh fjalë, — shtoi prefekti kur ai po dilte.

Në Klubin e intelektualëve, pjesëmarrësve të trupës dhe ndonjë shoku të tij, që e kishin pritur mbi tri orë mësuesin, kafeja u ishte dukur pelin dhe tavlla nuk u kishte pasur lezet fare. Kur Mehmeti u dha në portë, garsoni rendi dhe e pyeti:

1) Po, zotëri.

— E?

— Nuk e do as konteshë, as markizë, as dukeshë, —
iu përgjigj mësuesi.

Garsoni përsëriti këto fjalë të çuditshme me mend
dhe i dëgjoji prapë kur Mehmeti ua thoshte shokëve dhe
ai i solli kafënë. Të gjithë bënë çudi. Garsoni i tha në
vesh mësuesit pasi kuptoi gjithçka:

— A, more zoti Mehmet, po quaje zonjë, more. Kon-
teshë është mbretëresha që do të kemi, s'e di zotrote?
S'e ke marë vesh ti se Naltmadhnia u fejua me një
konteshë Maxharie?

Ky Garson kishte qenë përherë ibliz.¹⁾ Ai tha:

— «Kufomat e gjalla» do kenë njësoj sukses, zoti
Mehmet.

«Kufomat e gjalla!» Mësuesit i pëlqeu ky këmbim
i papritur titulli. Pjesa u lojt aty e tutje edhe me këtë
këmbim.

1) Djall.

Baba Tomori

Jeta e inspektorit për tim atë, të cilit shëndeti po i merrte teposhtë, nuk qe e lehtë. Duhej të shëtiste shumë, edhe fshatrave, ku ishin disa shkolla. Ja, shkollë kishte në Mollagjesh dhe ai kishte ndihmuar që të ngrihej. Kishte dhe në Zavalinë të Shpatit. Mollagjeshi do katër orë me kalë, Zavalina shtatë. Po Zavalina është fshati i Isuf Qoses. Si do të mos shkonte në Zavalinë, le të qe makar larg gjer në Gjirokastër? «Trimi i thatë», siç thoshte kënga, kishte luftuar motit kundër Turqisë me trimëri të rallë. Turqit s'kishin guxuar t'i vërsulen Shpatit gjersa u çlirua Shqipëria.

Tregonin se Isuf Qosja kishte luftuar edhe për shkollën shqipe. Qeveria nuk çeli shkollë në Zavalinë, kur Shqipëria u bë. Zavalina u ngrit burrë për derë, ngriti zërin e i tha qeverisë:

— Ti paç turp!

Qeveria çeli shkollën në ato kropa.

Zavalina është tutje, në Shpat, për së gjati ca përrenjve, ku arat e bukës nuk bëheshin më të mëdha se dy dynymë (flas për motit). Im atë duhej të merrte udhën e malit majë mushkës. Ishte një mundim i madh për të, por ai kthehej me zemrën mal. Bijtë e vegjël të fshatarëve mësonin mirë, mësuesi ishte me ndërgjegje të lartë. Ai kishte bërë edhe dy harta vetë, njërin të

Evropës e tjetrën të Azisë, se vetëm të Shqipërisë kishte pasur, edhe atë të vjetër shumë. Babai do t'i çonte një të re.

Po nga ato udhëtime babai kthehej i sëmurë. Kur u kthye nga inspektimi i parë gjer në cep të Shqipërisë, ai zuri njëzet ditë shtratin. S'ishte mirë me veshklat. Nëna i thoshte të kërkonte ta këmbente punën, se ajo punë nuk ishte për të. Babai thoshte se do ta këmbente, po prapë s'bënte gjë. I pëlqente të bridhte, donte të shihte vendin, të njihnte njerëzit, të lidhte miqësi të reja.

Kur erdhën pushimet e vitit për të cilin flas, ai duhej të shkonte për inspektim në Gramsh. Gramshi ishte nënprefekturë, po nuk kishte as pesë shtëpi. Njëra ishte godinë qeveritare, — seli e nënprefekturës, e xhandarmërisë dhe çfarë tjetër. Ishin pastaj dy dyqane dhe nja dy kotece që u thoshin shtëpi. Shkollë kishte, por jo në qendër: shkolla ishte lart, në fshat, në ca rrëpira. Shkolla ishte një haur. Ajo kishte vetëm tri mure, i katërti, ai i prasmi, i ishte rrëzuar. Mësuesi thoshte hidhur:

— Andej na ruan bregu nga erërat.

Ju e kuptoni se këto i kam parë me sy vetë, se im atë, po të kisha pushime, do të më merrte pas.

— Ne kemi vend të bukur, — më thoshte. — Të varfër, po të bukur. Duhet ta njohësh, që ta çmosh. Duhet ta çmosh, që të përpiqesh për të. Duhet të përpiqesh për të, që të kesh gëzime.

Nëna nuk i bënte zë kur e dëgjonte, po prapë i lutej të ruante veten. Pastaj ç'do të bënte ai për pushime në inspektim? Po shkollat kishin halle shumë dhe për mësuesit e mirë s'mund të kishte pushime. Pastaj, shkollën s'e mban vetëm mësuesi. Po s'luftove në kohë pushimesh me qeveritarët, shkollë s'ka pas pushimesh. Dhe kishte mësues fshati që edhe për pushime nuk i ndaheshin shkollës, po luftonin me qeveritarët për të meremetuar godinat e për t'i pajisur, vinin në lëvizje fshatin, nxënësit vetë.

Atij mbarimi qershori të vitit 1929, ne të dy vajtëm në Gramsh. Dymbëdhjetë orë udhë. Po e bëmë

udhën me një ndalesë në Shushicë, ku kaluam një natë te një mik që nga gjyshi.

Shushica është një fshat i fundeve të Shpatit, në të djathtë të lumit të Devollit. Devolli e ka gërmuar shumë shtratin e tij të gjerë në ato anë. Në dimër e në kohë shirash ai skuq e tërbohet. Shushica e merr emrin nga një përrua i madh, — si dhe krahina e Devollit nga lumi që buron atje. Përroi rrëzohet nga faqet e larta të Shpatit. Ai shkon me kaq nxitim, sikur të mos i pritët të takohet me t'anë, — siç i thonë, — lumit të madh. Ujë s'ka as sa të mbulojë thundrën e mushkës, po, kur bie shi, përroi vërshon me buçima e bubullima, me popla.

Ne nuk fjetëm në një shtëpi, po në një kasolle. Kishim pasur një mik të varfër shumë. Zilet e dhive tringëllinin në gjysmën e kasolles matanë dhe era e plehut të zinte në grykë. Një kalama që s'kishte gjumë, qau gjithë natën. Dhe unë nuk mbylla sy, por dëgjova tak-takun e djepit të përcjellë nga zilet e dhive dhe nga psherëtimat e nënës së shkretë, që tundte të voglin më kot. Babai gdhui me sytë pufka dhe mbaj mend se shtrëngonte njërenë ijë. Pimë nga një sopllake qumësht dhe miku na priu gjer në Gramsh, ku edhe ai kishte punë.

Kasollja e tij ishte në një faqe përmbi lumin e Shushicës. Që atje dukej vetëm mali i Zavalinës, trekëndësh me majën poshtë, se kështu e tregonte gryka e lumit. Kur kaluam atë grykë dhe dolëm në rrugën kryesore, mbi Devoll, përpara na u shpall Tomori, vigan sa s'e them dot, me Çukën e bardhë e të kaltëryer, në qiellin pa një re. Përse s'më kishte rënë në sy gjithë ai mal dje, kur erdhëm këtej? Trekëndësh edhe ai, po çfarë trekëndëshi e me majën lart! Më kishte hutuar udha, me përrenjtë që mezi i kapërcenim, me ulërimën e Devollit. I zoti i kalit dinte vetëm të nëmte¹⁾ njerëzit, kafshët, drurët, gurët, veten. Diell, asnjë rreze. To-

1) Mallkonte.

mori duhej të kishte qenë gjëkund, i mbështjellë nga retë, dhe mua s'më kishte vajtur mendja te mali. Po ja, si një përmendore, që ta kishin punuar gurskalitës me dalta që nga retë, Tomori, mbi gjithë malet.

— Baça Tomori! — tha im atë, i mrekulluar.

Miku që na përcillte, qëndroi dhe vuri dorën përmbi vetulla, që të kundronte malin, sikur ta shihte për të parën herë.

— Mirë e the, — ia bëri. — Atë kemi baba.

Kalari¹⁾, që dinte veç të nëmte dhe të grindej, ia dha së qeshurës.

— S'jeni tuafër vetëm ju dhaskenjtë, — i tha ai tim eti. — Ky qenka tuaf e mbi tuafët. Prandaj ka mbetur më këtë ditë, — i tregoi ai lekat mikut tonë.

Miku, Selmani, shtrëngoi shkopin dhe shtrëngoi nofullat, që të mos e qëllonte. Pështyu njëherë përtokë e ia bëri:

— Po të mos kishin qenë këto male, more zot, ç'do të ishe zotrote?

— Unë s'jam asgjë, — tha kalari dhe pështyu edhe ai. — Ti e quan veten se je? — E vështroi me njëfarë zemërimi. Im atë psherëtiu:

— Sa keq që fole!

Kalari s'u përgjigj, po bëri një gjest me dorë për të thënë «ndoshta».

— Dreqi ta marrë! — dhe fytyra i mori një të zgërdhirë të frikshme.

Selmani heshti.

Unë vështrova tim atë. Ai nxitonte, me kokën të përkulur mbi kraharor dhe i përkëdhelte kalit jelen e hirtë.

Mua s'm'u ndenj më mbi kalë, po zbrita dhe eca përpara, vetëm — merr gurë dhe flaki sa më larg në lumë. Gurët binin në valët e shkumëzuara dhe as që dallohej mirë se ku binin. Unë vështroja Tomorin të madh e mbi të madh. Përreth tij, andej tutje, nga i tho-

1) I zoti i kalit, qiraxhiu.

në Tomoricë, duhej të kishte gremina të mëdha. Kur qe formuar Tomori, andej llavat s'ishin mbajtur dot. Këtej, në drejtim të Elbasanit, ato kishin rrjedhur si më nge, duke formuar tërë një hundë vendi, me çuka, dhe zbritnin shkallë-shkallë drejt veriut, për së gjati Devollit, që do t'u priste pastaj udhën në të dalë të fushës së Cërrikut. Trupin e kishte shtrirë Sulovës këtej. Andej thellë, mali kishte shpinën, të drejtë. Ashtu dukej.

Cili poet e kishte quajtur Tomorin baba? S'më kujtohej. E përse baba? S'e merrja dot me mend. Po emri më pëlqente, kur shihja malin me gjithë atë madhështi. Ai qëndronte me kokën në qiellin e kaltër, i bardhë e i kaltëryer. Dëbora i ndriste në njërën anë dhe të lëbyrte sytë. Malet e tjera s'dukeshin gjë përballë tij, përveç njërit, që ishte si një takije e murrme — në dimër ajo duhej të ishte e bardhë — atje në fund të Vërrçës. Atij i thoshin Komjan, tregoi Selmani, kur e pyeta.

Babai tha:

— Tomor dhe Komjan janë nga emrat tanë të lashtë shumë. Si Drin e Bujanë, si Sharr e si Dajt.


Babai i tha këto dhe heshti. Dy të tjerët nuk folën dhe as unë. Tomori dukej sikur pohonte nga tërë lartësia e tij. Unë pritja që babai të fliste prapë, se e kuptova se përse i tha ato fjalë. Ai domosdo duhej të fliste, tani që kuptova se përse Tomorit i thoshin baba. Kalari s'm'u bë se e kishte kuptuar.

Po kalari, duke përcjellë një mendim që e kishte pasur në krye, zuri e foli:

— Të kishe edhe pesë okë më shumë ti, zoti mësuës, me gjithë djalin, kali im nuk të mbante. Edhe kjo dynja kështu është, që ta dish ti, more zot nga Shushica, që na bëre nder mbrëmë e që të qofshim falë, që vjen me ne sot e që të paçim.

Shushicari e pa vëngër. Unë bëra çudi me këtë gojë tani hoj e mjaltë. Mbajta dorën e s'e hodha një gur në lumë. Im atë ia bëri:

— E di që s'të marr vesh, more Limi?



Limi, kalari ynë, qëndroi dhe zuri kalin prej kapistre. Ai tha:

— Ky zot më thotë se pa atë mal ne s'bënim dot. Unë s'bëj dot pa këtë kalë. Më kuptove? — e ngriti zërin ai dhe u vrenjt e u kthye në gjendjen e tij të zakonshme. — Pa këtë kalë, — përsëriti fort, — jo pa këtë mal! — tregoi ai Tomorin.

Zërin e Limit e shurdhonte lumi që ulërinte. Tomori, me kokën përperjetë, s'mbante vesh fare nga ne. Kështu thashë unë me vete dhe e flaka poplën aq larg, sa më dhembti krahu.

— Ti qahesh për fukarrallëkun shumë, — ia bëri Selmani me një zë të vrarë. — Mbaje, mbaje kokën lart! — ngriti ai shkopin dhe tregoi nga Tomori.

Tomori s'lojti vendit.

Unë vështrova tim atë: ai kafshonte mustaqen dhe nxinte, me kokën të varur mbi kraharor. Vështrova kalarin: ai zverëtinte¹⁾, me një ngërdheshje të frikshme.

Atëherë kali nisi të gërhinte, po pak si shumë, me një kollë të brendshme, që ia vinte në lëvizje muskujt e gjatë të qafës, ia tkurrite, ia zgjaste.

— Se ç'ka ky kalë, — tha babai dhe i tërhoqi lenen, që kafsha të ndalte.

— Mbahu, Çil²⁾, bëhu trim! — i fërkoj kalit i zoti ballin, qafën.

Bëmë edhe ca rrugë pa folur. Gërhima e kalit shpeshohej, bëhej e mundimshme. Kur kaluam përmes një përroi dhe do të merrnim pastaj një të përperjetë, Çili u ndal e më nuk ecte. Babai e goditi me të dy këmbët që i vareshin pas barkut. I zoti e tërhoqi për kapistre, po kafsha nuk u çapit.

— Sikur të zbres dhe unë ca dhe të shpihem, — tha im atë dhe zëriti.

— S'e bëre keq, — tha Limi dhe e vështroi kafshën krejt të ndryshuar në fytyrë.

Në fytyrë ai kishte një dhembje të madhe, që e

1) Ishte errësuar.

2) Kalë bojë hiri.

bënte tjetër njeri, po prapë ngërdheshej dhe unë ngërdheshjen s'ia duroja, kurse dhembjen ia ndjeva.

Selmani e shihte edhe ai me dhembje kafshën e po ashtu dhe të zotin. Ai tha:

— Ky kalë nuk të shpie dot gjer në Gramsh, more zoti Filip. E pashë që mbrëmë, po ç'e do se vetë s'kam kalë. Kam një krushk ca më përtej dhe na bën hall ai.

Babai vështronte kalarin që nuk fliste, po tundte kokën e pohonte si i dërrmuar me atë ngërdheshjen e tij të padurueshme. Ai e tërhoqi kafshën me forcë prej kapistre dhe Çili më në fund u nis, pasi shfryu fort flegrat e thella.

Vendi kishte qenë midis dy brigjesh të larta, që s'të linin të shihje rreth e qark. Kur dolëm përmbi kodrën matanë, Tomori na u shpall sërish, madhështor. Dhe sa pranë!

Askush nuk fliste. Mbase të gjithë vështronin malin ose dëgjonin trokëllimat e potkonjve nëpër gurët e e udhës, ose mbanin vesh ulërimën e lumit të kuq, që nuk pushonte atje matanë, poshtë nesh, nga e djathta.

Pas një copë here, Limi qëndroi si një i ndërliqur¹⁾ dhe i bërtiti malit:

— Po fol, more baba! Fol, bre, se nga ti pritet një fjalë!

Selmani e vështroi me frikë dhe hapi sytë nga im atë, duke bërë një shenjë me dorë te koka. Po kjo kështu? Prapë Selmanit nuk iu ndenj pa folur.

— Ti qenke tuaf i madh e jo unë, more mik i mirë, i tha Limit dhe u përpoq të qeshte.

Limi uli kokën. Ai nxori kutinë e drodhi një cigare duke ecur, e drodhi e ia vuri shokut në buzë.

— Ndize, — i tha e nisi të dridhte një tjetër për vete. — Tuafe është kjo botë.

Selmani shkrep, e ndezi, tymosi shumë e ia bëri: — Pike duhan të fortë. Më pëlqen. Gërxhall e dua edhe unë.

1) I çmendur.

Ai s'tha ndonjë gjë të re: përsëriti çka i kishte thënë edhe gjatë natës, kur ata këmbyen kutitë dhe i kishin pasur të dy me gërxhall.

— Po dhe atë fjalë, — vazhdoi Selmani, — atë e the mirë: kjo botë është tuafe. Doemos, do bëhemi edhe ne ca tuafë. Po ne..., — deshi ai të shtonte dhe ndonjë fjalë, po vështroi se si ishte prishur edhe më shumë 'Limi në fytyrë' dhe nuk shtoi më dot një fjalë.

Shtoi im atë:

— Po ne, ne jemi që do t'i mbajmë të tëra e do t'i provojmë të tëra e do t'i vëmë edhe për së mbari. Dhe durimi duhet, duhet i madh. Ke fëmijë? — e pyeti kalarin.

— Unë jam më i duruar se ai baba, — ndezi cigaren. — S'jam si kjo kafshë! — e goditi ai Çilin me tërë grushtin në vithe dhe e bëri të nxitonte: — Po jam tuaf? Jam! Kur është tërë një botë! Po ti, |more mësues, mësomë si të mos jem tuaf, të kam byrazer! Unë përgjigjen nuk e pres nga ai baba! — thua se gërthiti njeriu.

Selmani i zuri krahun.

— Ai baba kërkon të jesh si shkëmb, o mik i mirë, — i tundi pak krahun. — Kaq kuptoj unë, — pshe-rëtiu.

Limi vështronte tim atë, që kishte kaluar ca përpara dhe s'e kthente kokën, por ecte sikur shkante drejt Tomorit. Tomorit i ndrinte dëborë. Devolli rridhte i kuq, i kuq. Unë flaka mbi të dhe ca grushte me gurë.

Një udhëtim fantastik

Kur mendoj për udhëtimet që kam bërë, më duhet të them se ky qe fantastik.

Im atë një ditë në sofër tha:

— Do të nisem gjer në cepin më jugor të Shqipërisë. Më kanë ngarkuar të inspektoj shkollat në Berat, Vlorë e Gjakastër e në krahinat e tyre përpara vitit shkollor që vjen. Them të marr edhe djalin me vete. Ti ç'thua, moj grua?

Nëna vështroi nga unë. Sapo kisha mbushur të trembëdhjetëvjetët. Thua se isha për udhëtime të gjata unë? Nëna rrudhi krahët, e druajtur. Babai më pyeti:

— Po ti, ç'thua, more Skëndo?

Pyetje është kjo?

U nisëm.

Nëpër ato vise të largëta të çonte makina, po gjer në Lushnjë ne i ramë me kalë, nga Dumreja, nëpër Belsh, nëpër Pekisht e tutje. Lugina të buta, vende me liqene shumë, po që ujin e përdornin pak; s'kishin kanalizime, si kanë sot me qindra kilometra. Vera kishte qenë shumë e thatë gjer në fund të korrikut dhe i kishte zhuritur ato vise. Gushtit, kur kaluam ne andej, shiu më shumë i kishte flladitur se njomur. Të lashtat e kishin pësuar: misrat zor t'i ngjallte më

reja¹⁾. Ishte një mot me një gjysmë zie. Fshatari që na shoqëronte, një mik i shtëpisë, tregonte edhe për mote më të prapa e thoshte si i ngushëlluar:

— Ka edhe më keq.

Ishte një njeri me këngë e me shakanë po në buzë. Me të s'e ndiem as vapën as udhën. Tetë-nëntë orë rrugë. Kur hasnim në ndonjë nga të dyzet liqenet e Dumresë, fshatari thoshte:

— Ja çifligu i bretkosave. I ziu njeri që s'e bën dot për vete! Për këtë mund t'ia kesh zili bretkosës, — shkulej ai në gaz e ia merrte një kënge tjetër të gëzuar.

Në Lushnjë e kaluam natën bashkë në një hotel. Dumreasi piu dhe nuk i mbaronin këngët. I zoti i hotelit nuk deshë ta qaste dhe e shau «morraxhi». Im atë u zu me hotelxhiun dhe mezi e mbajtën mikun të flejë aty, duke paguar për të më shtrenjt. Tërë natën na hëngrën të gjallë çimkat. Të nesërmen, kur u larguam, babai e shau hotelxhiun e i tha «çimkaxhi», por ai qeshi. Kishte të drejtë. Në Berat çimkat na pinë nga një okë gjak, në Vlorë edhe një tjetër okë. Në Vlorë kishte edhe kunupe,-kunup i thonë mushkonjës. Sa okë gjak kishim ne, që s'na mbaronte? Saranda, që kishte një hotel si një guvë, paskësh qenë edhe ajo mbretëria e kunupit. Po mjaft me këto.

Kur vinte mbrëmja dhe ndizeshin dritat në Mangalem e në Gorricë, këtej e andej Osumit, ne nuk na zinte gjumi jo nga çimkat, po nga shastisja. Qëndronim gjer vonë, babai dhe unë, gjer pas mesit të natës, nën ato rrapet e mëdha mbi lumë, shihnim dritat si shuheshin palë-palë. Mos po vinte mëngjesi dhe po shuheshin yjet? Jo. Diku çelej ndonjë dritë dhe diku tri a katër, tek ishin shuar dhjetë. Ne ktheheshim në hotel dhe prapë nuk na zinte gjumi, gjersa kapitëshim së kundruari në dritare. Hynim në shtrat, çimkë e kunup nisnin kërdinë mbi trupat tanë, po ne më nuk

1) Shiu.

zgjoheshim. Nuk na zgjonte as dielli më të dalë, si s'na kishin zgjuar dot zogjtë që mbushnin shelgjishtat e rrapishtat në lumin pranë, as tellallët, as hamenjtë, që se pse ishin aq të shumtë në Berat. Një zotëri plak — atij i thoshin Jorgji, po veten e quante Gjergj — na çoi të vizitonim kalanë. Ai tregonte historira të lashta për perandorë të Romës e Bizantit, për despotër e princër, me emra të çuditshëm, për luftëra pa fund edhe për luftën gjëmëmadhe, ku ishte vrrarë i kunati i Skënderbeut, burri i Mamicës me emrin Muzakë Topia, bashkë me pesë mijë ushtarë, nën muret e asaj kalaje. Kjo ka ngjarë, siç e dini, më 1455.

Unë shastisja pranë mureve vigane, më mbante era gjak, dëgjoja kujet, shtrëngohesha pas tim eti fort. Plaku tregonte përtej lumit, lart në mal, vendin ku Skënderbeu kishte bërë dasmën me Donikën, të bijën e kukur e aq fisnike të të famshmit Gjergj Aranit. Kishin qenë tre mijë dasmorë, ishin pirë treqind bute me verë, ishin pjekur tri kope në hell, ishin kërcyer të nëntëqind vallet e Shqipërisë.

— Të vemi atje, baba, — u hodha unë.

Po andej udha nuk na çonte. Duhej të ktheheshim prapë, të dilnim përsëri në Lushnjë.

— Aman! Atje do të flemë?

Atje fjetëm, te çimkaxhiu, që na qeshi në surrat.

Në Vlorë sosëm një pasdreke me furtunë. Malet zgjatnin në det Karaburunin si një krah kreshniku, që deshi të zinte Sazanin, deshi ta kapte, të bëhej zot mbi të, se ishte i tij dhe ia kishin rrëmbyer. E kishin rrëmbyer ata, — «qenërit!» — siç u thoshte një mësues i atyshëm me emrin Jani. Mësuesi fliste për një Selam nga Salaria, që ishte hedhur më 20 përmbi tela, që topin e kishte zënë nga gryka! Dhe italianët i kishin hedhur në det. Kur kalonte rrugës ndonjë lab festebardhë me majë, që ishte ca i madh në kocka, Jani hidhej e i thoshte:

— Ja Selami!

— S'jam Selami, s'jam Selami, a i vrrarë! — qeshte labi.

— Në mos qofsh, do jesh! — i zinte krahun më-suesi.

Labi më s'qeshte, por e shihte drejt, i trokiste me pëllëmbë mbi shpatull dhe ndiqte udhën. Si s'do të ishte? Domosdo që do të ishte, kur ta donte puna. Dhe puna dihet se e desh.

Ismail Qemali s'kishte më shumë se një rrasë të madhe guri përmbi varr, atje lart në Kaninë. As Avni Rustemi këtu poshtë, në të dalë të rrugës për Skelë. Bota kishin monumente të lirisë, ne kishim nga një rrasë mbi ndonjë varr. Një rrasë kishte Kostandin Kristoforidhi në Elbasan. Skënderbeu s'kishte asgjë. Kush do t'ia ngrinte monumentin? Po ne s'kishim liri.

Sazani atje përtej ç'ishte, që mbyllte gjirin e Vlorës? — Një kryqëzor prej guri, me topat e ngrehur nga ne! — gjëmonte mësuesi.

Kryqëzorë u thoshin anijeve të luftës. Karaburuni shtrinte krahun, po s'e arrinte dot akoma Sazanin.

Tepelena kishte një kalá të rrënuar, të shkretuar, një si rrugicë me nja dhjetë dyqane, një xhami. Dhe rrugë e gjatë, gjer në Tepelenë, mal pas mali, greminë pas gremine.

— Gremina të tilla ka në hënë, more baba? — pyesja unë.

Im atë qeshte me krahasimet e mia hënore. Në hënë kishte vetëm shkretëtira, po te ne kishte Selamër.

Kaluam dhe nga Salaria. Salaria ishte shkrep i gjallë dhe me kullotat si shkrep. Era që frynte drejt maleve, dukej sikur sillte ushtimën e Vjosës që nga thellësitë e mëdha.

Makina vërtitej si një brumbull maleve të zhveshura dhe rrugës nuk i dukej fundi. Shoferi tregonte për një aksident, ku i kishte mbetur një shok, diku në një humnerë, pranë së cilës kaluam. Vetullat i mbli-dheshin shuk në ballë, cigarja i fikej në buzë, pasi digjej e tëra. Ai vërtiste timonin me dy pëllëmbë tërë të çara. Ne u binim maleve qark e përqark. Mos po dilnim atje ku ishim nisur? Jo, ja tek dolëm në Te-

pelenë. Atje kishte një kafe. Pimë nga një kafe. Piva edhe unë.

Babai tha:

— Na erdhi shpirti në vend.

Shoferi qeshi.

Kur Gjirokastra na u fanit¹⁾, nuk e kuptuam se ishte qytet. Dhe kur makina mori të përpjetën për qytet, asaj iu mor fryma tri herë në as dy kilometra. Prapë, trimëresha makinë u ngjit gjer te Sheshi i Çerçizit, kërcit motori dhe avullo.

«Ka siklet, e gjora!» thoshte shoferi.

— Çfarë kalaje! — bëra çudi unë me bedenat e saj te retë.

— Është burg, — tha shoferi e i dha edhe një herë marshit nga vetja. — Hajt, ta pafsha hairin! — dhe kamioni u hodh përpjetë në vend, po prapë e mori udhën, sado me zor e i gulçuar. — Mbahu, moj xhane! — i dha zemër shoferi makinës së tij.

Ajo turfullonte si një hamëshore²⁾ që i kanë vënë frerin dhe freri po i bluan dhëmbët.

Shoferi tha:

— E kam sedërlie të madhe.

— Sedërlie?! — qeshi babai e qesha edhe unë.

— Do hamë sonte bashkë, — këmbëu bisedë shoferi.

— Doemos, të kemi mysafir, — i tha babai. — Ti na solle kaq mirë.

Shoferi qeshi me të madhe.

— E sheh atë kullë atje në majë fare, pranë atyre selvive? — tregoi ai me dorë diku shumë lart mbi qytet. — Pas asaj kulle e kam unë shtëpinë. Pra, ju kam unë mysafirë. Erdhëm tek unë.

— Pse, ngjitet sedërlija gjer atje? — deshi im atë të lozte, po mua më sëmboi për të, se ai ishte shëndetlig e duhej të merrte më këmbë një të përpjetë si ato të përpjetat e Salarisë.

1) U duk.

2) Pelë race.

— Ne shqiptot jemi sedërliinj, — tha shoferi.

Çfarë sedërliinjsh, se!

Kur jemi ngjitur asaj pasdreke majë lagjes së Dunavatit, thashë se kaq e pat babai. Po babai kishte qenë prapë i fortë. Vuajti, u la në djersë, iu morën këmbët, por u ngjit. U ngjit dhe e mbajti veten si burrat atë natë, s'i luajti qepalla. Këngët e vjetra lelebasanase që këndoi në çardakun e lartë të mikut, mblodhën gjithë lagjen aty.

Bënin çudi gjirokastritët e thoshin:

— More, ç'këndoka ky dhaskal gegë i imët!

Këndon, posi!

Ç'ti kujtoj Dunavatit? Madhështinë përkundruall. Andej na qenke një mal Çajup, emrin e të cilit e mbante një vjershëtor që u kishte kënduar bariut e dhenve:

*Bariu, shokë, bariu,
kur gjëmon e fryn veriu,
është përjashta fatiu,
e rreh breshëri dhe shiu!...*

Libohova qenkësh dikur nga e djathta, vendi ku kishte lindur Avni Rustemi dhe ku im atë kishte bërë dy vjet mësues në kohën e Turqisë. Ajo na paska rrape të mëdha e gurra, si diku përkëtej Tepelenës, jo larg një lumi me emrin Drino. Po sa Drinër paska Shqipëria? Me këtë na u békëshin tre: një i Bardhë, një i Zi dhe ky këtu. Ç'bojë kishte ky këtu? Shoferi e quajti të Argjendte... Po s'do të venim në fshat të Avniut. Ama do të venim në Mashkullorë.

Edhe në Mashkullorë kishte gurra. Ku mbijnë rrape, ka edhe gurra. Atje na ishte Rrapi i Çerçizit, ku, thoshte këngë, «turqit i skuqi e i bëri me bojë» trimil Këngë, jo fjalë! Po ku na kishte ngjarë kjo luftë e famshme?

— Ja, — na treguan një vend të çfarëdoshëm, atje përposh fshatit, në ca luginëza.

«Bëhen trimërrira në një vend të çfarëdoshëm?» pyeta veten unë, shumë i habitur. Ndoshta dhe vendi s'ishte i çfarëdoshëm dhe ashtu më dukej mua, pasi kisha parë Salarinë.

Era që frynte atë ditë dhe që s'pushonte, bënte të kërcasin fort krahët pa numër të Rrapit dhe e përhapte ujin e gurave si bishtra kuajsh. Ajo m'u përgjigj:

«Nuk është vend si çdo vend, more Skëndol!»

Jo, nuk ishte.

Delvina në gropë, midis gjelbërimit të përhirtë të ullishtave, kishte vetë një gjelbërim më të thellë.

— Për ca muaj ka për t'u bërë si një top ari, — tha shoferi, — kaq ka limonë dhe portokalle.

Babai, që në Gjirokastër kishte fjetur mirë, në shtëpi të atij shoferit tjetër, e pyeti shoferin e tani-shëm:

— Ç'ka Saranda, kunupe apo çimka?

Shoferi nga Shqipëria e Mesme e kishte atë të parën udhë për Sarandë. Ai u përgjigj:

— Ç'fat të kemi. Njeriut, more zot, po s'ia piu gjakun kunupi, do t'ia pijë çimka; po s'ia piu çimka, do t'ia pijë kunupi, — dhe ai tregoi një xhandar që ishte kapardisur mbi një kalë me shalë që po ngjitej rëndë-rëndë asaj së përpjete që ne filluam ta zbritnim.

Shoferi i dha kaq fort makinës, sa e ngriti pluhurin duman e gurët nisën të fishkëllejnë nga të dy anët e rrotave. Kali e vërviti xhandarin në ca xina,¹⁾ kurse ne nuk qëndruam fare, po fluturuam. Pas ca, fishkëllyen mbi ne pesë plumba, po shoferi qeshte dhe kamioni fluturonte përmes dumanit e gurëve që ngrinte.

Në Sarandë, po e dini, na pritën kunupet, po dhe çimkat. S'u mor vesh cilat qenë më shumë dhe cilat më të pashpirt.

1) Lloj murrizash.

— Këtu kam pak punë, — tha babai. — Erdhëm më fort për Butrintin.

Merrte njeriu tërë atë udhë, 60 kilometra të asaj kohe, nëpër Qafë të Muzinës e nëpër Kardhiq, qoftë edhe për Butrintin?

Ne gjetëm një kalë, dhe morëm udhën për Butrint, në fillim anës së detit, pastaj përtej një qafëze, anës së një liqeni të madh, që e tregonin me ujë të kripur; atë e lidhte me detin një kanal në Butrint. Nga kjo anë, Korfuzi ishte si një mur.

Më pas kam mësuar t'i çmoj më mirë bukuritë e gjireve detare, të ngushticave, të atyre si liqeneve që sajojnë: ëndrrat e mia janë pasuruar dhe s'e durojnë shkretëtirën blu të deteve të hapta pa masë.

Im atë tregonte për Butrintin. Ai përsëriste mbi kalë çka unë dija mbi Enean, mbi Pirro Neptolemin, mbi skllaven e këtij, Andromakën e Trojës, të shoqen e Hektorit që vrau Akili, i ati i atij Pirroje. Shoqëruesi, që tërhiqte kalin, një çam i varfër shumë, i grisur keq e me këmbët zbathur, mbante vesh këto histori dhe nuk thoshte asgjë. Ai ndalte herë pas here, dridhte një duhan, shkrepnte masatin dhe e ndizte, tërhiqte kalin dhe ne merrnim udhën përsëri.

— Ka peshk në këtë liqen? — e pyeti im atë.

— Ka, — u përgjigj shoqëruesi.

— Zini ndonjë çikë?

— Zë agai, për italianët, — u përgjigj ai.

— Si? Nuk zini fare?

— Po dhe zëmë, në të fshehtë, — pohoi ai.

Më tej u bë kjo bisedë:

— Ç'ka në Butrint? — pyeti im atë.

— Pyll e kënetë, — qe përgjigjja.

— Çfarë pylli?

— Dafinë shumë.

— Sa bukur! Po tjetër?

— Dushqe, ilqe, xina.

— Po tjetër?

— Edhe ferra, po deshe zotrote.

Babai ia dha gazit.

— Po tjetër?

— Gurë. Gurë si shkëmbinj, po të gdhendur.

— Mure a ka?

— Ka, po i ka përpirë pylli dhe kënetë.

— Thua j dafina, — ndërhyra unë.

— E, more djalë, dafina, — s'ma prishi qejfin çami dhe ktheu kokën e më buzëqeshi.

— Po statuja, a ka? — e pyeti im atë.

Çami s'e mori vesh këtë fjalë, «statuja». Ai u mendua pak e pastaj u përgjigj:

— Ka, more, ka: gjarpërinj dynjaja.

Im atë ia dha një gazi edhe më të madh. Unë ndjeva frikë shumë. Çami ktheu kokën dhe e vësh-troi babanë duke përdredhur buzët, ku i gjembonin mustaqet e mjekra e parruar prej ditësh.

Në Butrint gjetëm vetëm pyll e vetëm kënetë. Pastaj, gurë të gdhendur, që babai i quante pellazgjikë. Gjetëm edhe një copë mur, po kënetë s'na la të ndjekim më tutje, se e kishte përpirë. Ku s'kishte kënetë, kishte gjarpërinj. Ata rrëshqitnin me tufa, të rrëmbyer. Çami tundte një purtekë dhe e përplaste sa përpara prapa, majtas e djathtas, duke fishkëllitur e duke bërë «fru-u! fru-u!»

Pellazgjia ishte në duar të gjarpërisë!

Ku ta kishte këtu varrin Pirro Neptolemi? Ku Andromaka? Ku djali i saj i mitur? Ku të qe porti nga ishte nisur Enea dhe kishte dalë në Itali, pranë Romës?

— Ikim! — tha me dëshpërimi im atë.

— Ikim, — tha çami dhe ikëm, të pezmatuar keq.

Kur dolëm tek ajo qafëza nga pamë detin përsëri, deti ishte ndezur e bërë gjak nga dielli që po binte si lëmsh zjarri.

— Bukuri e madhe! — mbeti çami në vend, shkrepiti masatin e ndezi cigaren që i ishte shuar.

— Si? Si the? — e pyeti im atë, sikur të mos e kishte dëgjuar.

— Them bukuri e madhe, — tregoi çami detin, qie-llin e diellin, të rrethuar nga unaza e maleve.

Unë një çast shastisa, pastaj u kapita mbi samar e m'u pulitën sytë. Si nëpër tym dëgjoja një bisedë për bukurinë e madhe, për gurët e gdhendur, për gjar-përinjtë, për dafinat, për peshkun, për italianët, për nja aga që iu përmend edhe emri, po që s'më përmendet, për duhan, për opinga... e për të tjera.

«Fitorja e Samothrakës»

(Vazhdim i një udhëtimiti fantastik)

Samothraka është një ishull i brigjeve të Greqisë, në veri të Egjeut. Aty, një mbret i Maqedonisë së lashtë mundi një tjetër mbret të po atij vendi. Këto të gjitha janë tanimë shumë larg e të harruara fare. Por unë desha të përmend këtu se fitimtari i parë ngriti në Samothrakë një monument të famshëm, me një statujë që simbolizoi fitoren dhe mbajti emrin «Fitorja e Samothrakës». Statujën e zbuluan para një shekulli në atë ishull, po s'kishte kokë e i kishin mbetur fletët, bashkë me frymën madhështore të hovit e të fluturimit. Është një nga veprat më të njohura të skulpturës antike dhe, në mos nuk e keni parë, gjeni një fotografi që ta shihni domosdo, se ia vlen.

Kur lamë Sarandën atij gushti 1928 për t'u kthyer në shtëpi, i ramë Bregdetit, herë me kalë dhe herë me makinë, se ajo rrugë ushtrake, që kishin çelur italianët gjatë Luftës së Madhe, më shumë s'punonte, se punonte me makinë. Im atë s'kishte kaluar andej kurrë, po disa miq i kishte, një në Nivicë, një në Borsh dhe dy në Himarë. Kishim pra edhe ku të flinim, se do ta donte puna. Babai ishte lodhur e këputur, po:

— Do shohim bukuri të rralla, more bir, — më tha dhe sytë i morën flakë. — Ti kurrë s'ke për t'i ha-

rruar dhe mua do të më mbetet peng përjetë po s'i pashë ato vise. Vështirë se jeta më sjell këtej tjetër herë.

— S'dihet, — thashë unë, jo se nuk më entuziazonte ajo ide, po sepse ia kisha frikën shëndetit të babait.

Berati po, Vlora po, Gjirokastra më shumë, nuk ngjanin me viset që kisha njohur. Kjo Shqipëri e vogël — kjo Shqipërizë — që nga Veriu në Jug e që nga deti në thellësi të maleve, kjo trevë ka kaq pasuri të mëdha pamjesh, klimash, bimësie, siç ka dhe këngë dhe valle dhe veshje. Ju e dini dhe unë do t'ju tregoj edhe për vise plot. Po Himara, bregdeti i saj, ishte diçka tjetër nga ç'kisha parë gjer atë ditë, gjer në cepin më jugor të vendit. Unë s'isha më shumë se trembëdhjetë vjeç, por im atë i kishte arritur të dyzetepesat. Çudia ishte e madhe se si këmbenin panoramat, këndet e vështrimit se si nuancoheshin ngjyrat. Mos ishte më i kaltër deti në Himarë se në Vlorë, më i kaltër në Vlorë se në Durrës? Im atë entuziazmohej e thoshte:

— S'kemi parë të këtillë kaltërsi akoma! Ç'thua ti, more bir?

Edhe mua ashtu më dukej.

Mos është mali më i ashpër mbi Bregdet, atje ku vendit i thonë Laban e ku i thonë dhe Çikë?

Im atë thoshte:

— Çfarë ashpërsie! Pa shih! S'ishte i tillë as Kardhiqi. S'të duket?

Edhe mua ashtu më dukej.

Po Labani, thoshte ai, duhej të ishte fjala Alban. A s'i thoshin Labërisë dhe Arbëri? Për Çikën thoshte duke qeshur me të madhe:

— Kjo s'është e bukur, kjo është e egërsuar, egërsia vetë. Prandaj ka pjellë Karaburunin. Karaburun turqisht do të thotë Mal i Zi. Italianët i thonë Lingueta, Gjuhëzë. Por ai është si një lloj dragoni, — dhe qeshte prapë. — Janë të tmerrshme këto male, po njerëzit i kanë marrë me të mirë. Ja kësaj maje të tmerrshme i kanë

thënë Çikë. Në shpinë të saj thonë se janë disa gremia të tjera, po emrin ua thonë Trëndafil.

Së lartmi fare, që nga Çika e gjer në det, rrogomisej¹⁾ një përrua i gjatë, sikur të rrogomisej nga retë. Një ujëvarë fantazmagorike, e bardhë e që të rrëmbente sytë. Asnjë pikë ujë s'kishte: vetëm gurë e shkëmbinj rrokulliste. Poshtë, gryka e përroit bëhej sa një grykë lumi dhe në det hapëj delta e bardhë gjer thellë. Vendësit atij përroi i thonë Përroi i Thatë. Atë anijet duhet ta shikojnë nga larg në det, se italianët lundrues ia kanë vënë emrin «*Strada bianca*», Rruga e Bardhë.

Fshatit pranë i thoshin Palasë. Babai thoshte se nuk di cili perandor i Romës, ndoshta Jul Cezari, kishte zbritur atje me anijet e tij për t'u ndeshur në luftë me një tjetër perandor të Romës, a diçka e tillë. Palasë mos donte të thoshte pallat? Tek zbresin perandorët, ngrihen edhe pallate. Po ne pamë ndërtesa të varfërish, kopshtije të vogla pesë hapash, fiq, ullinj, portokalle. Pallat s'na zuri syri gjëkund, veç disa kambanareve, që andej i bënë më të larta se nga ne. Në Himarë kishte tri a katër mbi shkëmbin e fshatit, që ishte si «çerdhe petriti». Dhërmiu kishte më pak a më shumë. Lartësitë e tyre haheshin me selvitë, kurse selvi nuk kishte tri a katër, po qindra, po mijëra. Kaq zi mbajnë këtej me tërë këto selvi? Kaq shumë varre kanë? Selvia është simbol i bukurisë. Kënga thotë:

*Hajde moj, ma ke shtatin,
hajde moj, si selvie!*

— Bukuri, hë! — ia merrte im atë këngës dhe unë zbuloja bukurinë në çdo selvi të ngulur si heshtë midis shkëmbinjve.

Çikën e pamë mirë kur iu ngjitëm Llogorasë, nëpër ato leqe kilometrike, që s'di sa qenë, po më thonë se gjashtë. Çika rrëkëllente ujëvarën e saj të bardhë

1) Rrëkëllehej duke u gremisur.

shkëmbore si pa gjë të keq. Tutje pamë dhe një herë Porto Palermon, si një anije, që të kishte hedhur hekurin në gjirin e maleve. Atje ne kishim parë një kala të braktisur, që thoshin se e kishte ndërtuar Ali pashë Tepelena. Një djalë që ruante andej ca dhen, sipas fjalëve të pleqve, tregoi se, për të qëndruar kalaja, aty kishin murosur tri nuse: një himarjote (vendase), një janinote (ku ta dish se përse), një suljote (se me suliotët Ali pasha sapo ishte vrarë asokohe). Edhe në kalanë tonë të Elbasanit tregonin se kishin murosur një nuse së lashti, por jo tri!

Që këtej, që nga Llogoraja, kalaja e Ali pashës mezi shquan, po siujdhesa mbi të cilën është ngritur, është vërtet si një anije që ka hedhur hekurin midis maleve. Perandorët e romakëve më kalojnë nëpër mend, të paemëruar, sepse emrin vetëm njërit ia di, Jul Cezarit, por egërsinë ua kam dëgjuar edhe unë, vocërraku. Atë katarakt gurësh e shkëmbinjsh kundër tyre e pati shembur Çika.

Sytë m'i rrëmbente Çika, pastaj Porto Palermoja, pastaj disa ishuj në detin e hapët, që lundronin, thua një kope delfinësh.

Për ngritjen e Llogorasë nuk pata ato përshtypje që njerëzia kanë zakonisht. Zura të kuptoja mirë se çfarë ngjitjeje po bënim, si për te retë, vetëm kur shoferi, që kishte qenë një djalë i heshtur shumë, u qa se motori po gulçonte tepër, po prapë lëvdoi makinën që i bënte ballë si herë të tjera një të përpjete që s'kishte të dytë. Dhe kur dolëm në majë të së përpjetës, shoferi e ndali makinën dhe më tha:

— E, more Skëndo, je i zoti? Fluturo!

E, e të ketë fletë njeriu! Të kisha fletë! Çfarë fluturimi që kisha për të bërë, një herë, dy herë më lart se mali, të shihja përposh detin, selvitë, Çikën, e të zbritja në follenë time, atje përmbi ujëvarën, të më mbyllej qepalla duke kundruar përçark.

Ne u nisëm dhe, tek kalonim qafën, midis ca pishave të larta shumë, na u duk gjiri i Vlorës tutje, larg, si lumë drite. Im atë i thirri shoferit:

— Ndal!

Shoferi ndali kaq shpejt e kaq fort, sa na tronditi shumë.

— Ç'pate? — u tremb ai.

— Hiç asgjë, — mermëriti babai. — Po shikoni, shikoni, more djem, atë pishë!

Ishte një pishë mbi çdo pishë. Pishat i ndejnë degët gjithë përreth, si çdo dru. Ai dru s'kishte asnjë degë nga ana që ne vinim, po vetëm andej, vetëm drejt gjirit të Vlorës i kishte nderur degët e saj, katër a pesë, si krahë, si fletë. Çfarë fletësh!

— Fryn tramundanë e marrë deri këtu, — shpjegoi shoferi. — Furtuna ia ka dhënë atë formë. Të tërë çuditen sa e shohin.

Im atë tha:

— «Fitorja e Samothrakës»! — dhe bëri shenjë që makina të nisej.

Ai pastaj na shpjegoi ato dy fjalë. Por unë vetëm kur e kam parë në muze, në Luvër, e kam kuptuar krahasimin.

Pisha është edhe sot. Mund ta shihni. Krahët s'i ka kaq të mbushura si atëherë, po pikërisht se i ka ca të zhveshur, ngjet edhe më shumë me «Fitoren e Samothrakës». Ju bëjeni ndonjë ditë krahasimin. Midis tyre, ndryshimi është se statuja gjendet në një muze, kurse pisha përmbi mal e përmbi dete.

Më kujtohet mësuesi vlonjat që thoshte se nuk kishim Monument të Lirisë. Ajo pishë që Monument i Lirisë. Apo s'qe Çika vetë!

«Kësulëkuqja» e ritreguar

Në ato dy-tri vitet e para që vajta në Lice, frëngjishten e mësova mjaft mirë, sa për t'u bërë një lexues i zellshëm. Natën, disa herë e gdhija në ato fjetoret e gjata, të ftohta e të larta të konviktit tonë, megjithëse në tavan ndriçonin disa llambushka elektrike, me të cilat mezi shihnim njëri-tjetrin nëpër gjysmëterr. E gdhija me «Kontin e Monte Kristos» e me «Lizën në botën e çudirave». Po kisha ndonjë shok që ishte dembel i madh në të lexuar edhe pse jo pa interes për çka tregohej në to. Një dembeli të tillë unë isha i detyruar — apo më mirë e kisha në qejf — t'i tregoja mëngjes për mëngjes çfarë kisha lexuar në mbrëmje dhe atë mësuesi i frëngjishtes na e mbante midis «gllabëruesve» të letërsisë.

Përfundimet qenë dy dhe të përkundërta: e para, frëngjishten e mësova mirë, edhe pse s'ma kishte ënda gramatikën e sintaksën; e dyta, u sëmura keq nga sytë.

Të kisha dëgjuar mjekun duhej të kisha mbajtur syze prej katër dioptrish e gjysmë për larg. Në Korçë kishte edhe një dyqan optik. I zoti i dyqanit kishte një vegël, ku ti ngulje të dy sytë dhe ai lëvizte dy vida: kur kthjellohej mirë vështrimi në xhamat e veglës, që i ngjante një mikroskopi me dy degë, sytë e tu i kishin dioptritë të matura saktësisht. Mua dyqanxhiu më

dha syze me tri dioptri dhe s'ka dyshim që vegla e tij punoi saktë.

Po t'ju flas për leximet e mia të para, duhet t'ju tregoj për ca librushka që i përkitnin një serie të gjatë përrallash e tregimesh për fëmijë, seri që mbante emrin «Libri rozë» dhe kishte arritur numrin 222. Broshurat qenë të gjitha me kapakë bojë trëndafili dhe të ilustruara dendur e mirë.

Kam «konsumuar», siç mund të merret me mend, një numër të madh përrallash e tregimesh për moshat e reja. Çelja Sezamën me thesaret e mrekullueshme të Ali Babait, gjuaja me hark me Robin Hudin, goditja me shtizë me Aivanonë, mbaja për dore Lizën në «Botën e çudirave». Nisa të lexoja atëherë dhe nga udhëtimet e Marko Polos, të Kristofor Kolombit e të Magelanit me shokë.

Kur fola për Lizën, thashë një të vërtetë, se kur kthehesha në shtëpi gjatë pushimeve tremujore ose vjetore, atje kisha një Lizë të vërtetë, të cilën e shëtitja më nge nëpër atë botë çudirash. Ishte motra ime e dytë, katër vjeçe për pesë, pikërisht në atë moshë, kur fëmija jo vetëm kërkon t'i tregosh përralla shumë, po t'i ritregosh përherë atë përrallë që i pëlqen mbi të tjerat; bile të të korrigojë, kur të bësh gabim ose të harrosh ndonjë gjë në të treguar, bile të ta tregojë edhe vetë dhe të shtojë nga e vetja.

Ju pritni një shembull dhe unë kam marrë për sipër t'ju ritregoj në të tillë mënyrë përrallën e famshme të Kësulëkuqes së Perosë. Ky ritregim trajtohej pak a shumë në këtë mënyrë:

Unë: — Na ishte një Kësu-ulëku-uqe. Asaj i thoshin Kësu-u-lë-ku-uqe, se...

Motra: — ...se në ko-okë na mba-ante një kësu-ulë të ku-u-uqe!

Unë — Një kësu-ulë si kërpu-udhë të ku-uqe: kërpu-udhë me pi-ika të ba-ardha...

— Si mitani i nënës, more Skëndo. E ke parë mitanin e ri që bëri nëna sivjet, sa i bukur është?...

Dhe Kësu-ulëkuqja i kishte fa-afet e ku-uqe. Dhe kur bënte di-imër, i sku-uqte maja e hu-undës.

— Si një lulëkuqe.

— Hahaha! Hahaha! Edhe unë e kam hundën si piperkë të kuqe, more Skëndo, dhe jo vetëm në dimër, po dhe në verë, thotë babai.

— S'ka lulëkuqezë më të bukur, — dhe i puth Li-zës majën e hundës.

— Edhe ti të kuqe i ke faqet, si molla, more Skëndo, — më puth ajo faqet e bën sikur m'i kafshon. — Nëna thotë se unë i kam si luleshtrydhe! Si luleshtrydhe i kanë faqet plakat, more Skëndo, tërë vrëma! Apo jo? — vrenjtet vogëlushja.

— Ti s'i ke si luleshtrydhe, si plakat, dhe as si molla, që deshe të m'i kafshosh të miat, por i ke si trëndafille! — ia puth unë faqet e u marr erë, mbush mushkëritë me zhurmë me atë erë dhe ia bëj: — Trëndafille gallate! — kurse çupkëza, së cilës ka nisur t'i ngasë prapë mendja pas përrallës, nis e tregon për Kësulëkuqen prapë:

— Dhe Kësu-ulëku-qja na kishte një gjy-yshe, një gjy-yshe që e donte shu-umë. Po gjy-yshja na ishte e sëmu-u-urë!

E kishte zënë malarja, të shkretën, dhe doktori i kishte dhënë sulfato!

— Sulfato! — shëmton fytyrën e saj të bukur e vogla, që e di se ç'janë ato kokrra të verdha ilaçi, të hidhura helm.

— Pinte gjyshja sulfa-ato, dri-idhej nga ethet, po pla-akë, e gjo-ora! Sëmundja i zgja-aste...

— Ashtu si gjyshes sonë, more Skëndo, kur u sëmur sivjet e mezi u shërua. Po ne gjyshen s'e kemi plakë. Apo është gjy-yshe dhe e mundon sëmundja si tërë gjyshet?

Unë i shpjgoj se sëmundja u bie njerëzve në çdo moshë. Fëmijët, kur s'hanë, sëmuren lehtë, për shembull, kur nuk e pinë qumështin. Motra, që pikërisht qumështin e ka baras me sulfaton, prish fytyrën dhe hidhet te përralla:

— Dhe gjy-yshja e kishte shtëpinë në fsha-at. Në një fshat përtej një py-ylli të ma-a-adh, të zi-i-i...

— ...ku ka kërpudha shumë, e luleshtrydhe sa të duash dhe lulëkuqe si trëndafila gallatë. Po ka dhe egër-iira, si në çdo pyll!

Dhe vijon motërza:

— Dhe ai ujku i ma-adh i ma-alit andej vërti-itet! Unë e kam parë ujkun në atë librin tënd të kuq për Kësulëkuqen. Bobo! Ç'sy-y që ka-a! Bobo-o! Ç'go-ojë e ç'dhë-ëmbë!

— Andaj, edhe kur nëna e niste Kësulëku-uqen të shihte gjy-yshen, ajo e porosiste të mos i bje-erë pyllit, po rrugës së ma-adhe, drejt...

— ...nga kalojnë të gj-ithë, 'la-arg pyllit. Atje ujku ka frikë të dalë, se e vret xha Gjoka me çifte bam-bam!

Se përse xha Gjoka i Tushemishtit kishte hyrë në mendjen e së voglës si një gjahtar, nuk më përmen-det. Mbase kjo ishte një shpikja ime.

Motërza pyet:

— Po ai ujku, si kishte bërë ashtuu, more Skëndo?

— Û-ujku i kishte vajtur gjyshe në shtëpi-i, — nis e nxitoj tregimin tani unë, se, sado qejf të kem ta ritregojmë bashkë përrallën, ky qejf nuk zgjat veç nga fillimi. — Dhe kishte bërë një të kërcyer ujku, dhe... një të kullufitur! Një të veshur si gjyshe! Me syzet mbi hundë! — i heq unë syzet e ia vendos së voglës mbi hundë dhe ajo harron atë çast tmerrin: është bërë gjyshe me gjyzlykë, e ç'bukuri! — kurse tregimi vazhdon në të tillë mënyrë gjer në fund, ndërsa ky fund i përrallës nuk është ai që ju njihni të gjithë, po një tjetër, që e kemi shpikur ne të dy:

Ai ujku i madh i malit që aq i madh, sa e kishte kullufitur gjyshen pa e përtypur, po, kur rënkonte atje brenda plaka, në «barkun e lubisë», dukej sikur rënkonte ujku i shtrirë si gjyshe, si i sëmurë në shtrat, me gjyzlykë përmbi hundë, ja kështu. Po, kur të matet ujku t'i hidhej edhe Kësulëkuqes që ta hante, një gjahtar vigan, me një shtizë më të gjatë se një mi-

nare, atij ia thoshin emrin Kaman, si një trim i madh i «Historisë së Skënderbeut» të Naimit.

— ...Kamani e mbërthen ujkun me shtizë në grykë, e ngordh, i çan barkun me shpatë, gjyshja del e gjallë, — përfundoja përrallën unë dhe Liza trokiste me gaz pëllëmbët e saj topolake, me lot te sytë, kurse Kësulëkuqja nxirrte nga shporta lakrorin e ngrohtë, që i kishte sjellë gjyshes dhe që nëna e kishte tëhollur për të, si dhe një pjatë me gliko portokalli, apo dytri ballakume, — se këtë glikonë e portokallit dhe ballakumet motërza na i hante fort dhe përralla duhej të mbaronte me njëren prej tyre, në mos me të dyja bashkë.

Në shtëpinë tonë, kuptohet, «Libri rozë» me përrallën e Kësulëkuqes ishte kurdoherë i hapur dhe shëtiste odë më odë. Që të mos grisej, unë e kisha lidhur librin me një karton dy herë më të trashë se ç'qe ai vetë.

Jaja jonë

Jaja¹⁾ Rinë, për të cilën ju kam bërë fjalë dhe tjetër herë, ishte një njeri që mund ta quaj «të çuditshëm». Të them se ishte «një shpirt i keq», më vjen zor. Së pari, ajo na donte dhe ne kishim dhembshuri për të, pavarësisht huqeve të saj të tepruara. Së dyti, ajo e kishte pësuar ligsht shumë në jetë, bashkë me familjen e saj dhe, nëse kishte huqe, mund të thuash të padurueshme, për ta mëshiruar duhej ta mëshiroje, për ta urryer e përbuzur, jo.

E mbetur e ve tetëmbëdhjetë vjeçe, ajo s'kishte dashur të martohej më, por ishte kthyer në shtëpinë e të vëllait, ku u plak e ku arriti të nëntëdhjetat. Se pse s'ishte martuar e bukura Rinë e mbetur aq fort e re pa burrë, këtë s'e dinte askush. Por unë përherë kam imagjinuar se ai mot që ajo kaloi me të shoqin ia vlente sa për një jetë, sado e gjatë, sado e mundimshme që të vinte ajo jetë, dhe Rina kishte pëlqyer të mos e cenonte kujtimin. Se ç'pati qenë burri i saj, nuk e di mirë, po, me sa kam dëgjuar, një njeri i thjeshtë i lagjes, më bëhet se një samarxhi. Kam kërkuar të shoh fotografinë e tij, sigurisht, në të fshehtë. Po fotografi

1) Teta

prej tij nuk dukej të kishte mbetur. Kështu që kujtimi që i ruante Rina të shoqit gjer në pleqërinë e saj aq të shkuar e për të cilin unë po flas, për fantazinë time ishte një nxitje e përhershme dhe diçka e bukur, sado e dhimbshme. Le të kishte jaja edhe një herë më shumë huqe nga ç'kishte, unë mund t'ia falja të gjitha e të më mundte përherë respekti që ndieja për atë qenie, të cilën moshë e kishte bërë si një gorricë të zier e të ftohtë.

Ajo ishte kthyer tetëmbëdhjetë vjeçe, pra, tek i vëllai, dhe ky qe një fatkeq tjetër, se një djalë të vëtëm që pati, i vdiq akoma pa u bërë burrë dhe grua nuk i dha dot një fëmijë të dytë. U pleqëruan shumë vëllai me të motrën, me plasjen në zemër, se shtëpia do të mbetej pa zot, se nuk do të linin askënd pas vetes, — dhe të gjithë e kuptojmë se ç'është një plasje e gjatë: është si një vdekje me tortura disa herë dhjetëvjeçare.

Ata banonin në një shtëpi të madhe sa një kala, ndoshta shtëpia më e madhe e lagjes sonë, e ndërtuar e tëra me gurë të skalitur me bodrume të thella e të larta, me një kamerie sa tre lëmenj bashkë — një tarracë, siç e themi sot — guri dhe ajo, me pllloçka, dhe akoma një kat tjetër përsipër, i lartë ai dhe gur i gjallë. Po jeta, që shtëpinë s'e kishte rrënuar dot, fisin, ku ta dish përse, e rrënoi. Jaja thoshte që «i kishin pasë marrë më sysh» dhe ec t'i mbushje mendjen se e kishte kot, se ajo zemërohej. Bile ajo e dinte dhe kush i kishte marrë më sysh dhe në zemër të saj pshonte¹⁾ gjithë jetën kundër shtëpisë së «syrit» armik, por atë shtëpi nuk e gjente që nuk e gjente gjë dhe nuk e ka gjetur as sot, po nga tre meshkujt që u ndanë motit, ishin bërë trembëdhjetë në kohë të fëmijërisë sime prej asaj sofre, kurse sot, si të themi, janë 33 «oxhakë», të të tëra mjeshtërive, të të gjitha specialiteteve, të lumtur dhe që s'dinë se «kanë thyer»

1) Mallkonte me vete.

një pshim, që do të kishte dashur t'i shtinte të gjallë në dhe.

Jaja Rinë kishte pasur edhe një vëlla të dytë, po motin që ajo u martua, Kosta mori kurbetin. Elbasanasit pas kurbeteve nuk kanë qenë të dhënë thuajse fare, po, me sa duket, kur ndonjë Koste i ngulej kurbeti në tru, ai dilte veç shokëve.

Kosta ynë u nis edhe u zhduk. Dërgoi pak letra nga Amerika, dërgoi dhe një gusht para, sa për të merremtuar shtëpinë e tyre të madhe, që ustanë e donte po brenda, pastaj heshti nuk di sa vjet. Shtëpia nisi ta qante për së gjalli, edhe trarët, edhe plloçat, kur ai e përmendi me një letër nga një mbretëri që pak-kush ia kishte dëgjuar emrin në Elbasan, që na e quanin Brazil, ku kishte pyje që mund ta mbulonin Evropën tonë dy herë, dhe lumenj të gjerë sa deti ynë dhe të gjatë sa nuk u gjendeshin burimet. Këto kishte mësuar jaja për atë mbretëri, që na qenkësh sa një botë më vete, një Amerikë më e madhe se Amerika që dinte plaka. Po Kosta nuk u përmend më shumë se me tri-katër letra dhe nuk e di a dërgoi ndonjë pare nga ajo Amerika tjetër që e thoshin Brazil. Ai prapë heshti, heshti plot tetë vjet këtë radhë, dhe prapë shtëpia e qau për së gjalli, edhe trarët, edhe plloçat. Po ja që, pas tetë vjetësh të tjerë, ai u përmend, këtë radhë me një letër të vetme, nga një si Amerikë e tretë, që emrin ia thoshin Argjentinë. Kosta shkruante për atë vend se kishte fusha pa fund, me kuaj hamëshorë, që nuk numëroheshin, dhe me lopë e me qe sa për të ushqyer me gjalpë e me mish tërë botën, se ai atje do të bënte pasuri të madhe, që s'e kishte bërë dot gjer atë ditë, dhe të tjera, dhe të tjera, një letër të gjatë me të tilla, — dhe pastaj vëllai heshti e s'u bë më i gjallë.

Të tre pleqtë, këtu në Elbasan, edhe kur po arrinin të tetëdhjetat e të nëntëdhjetat, pritnin akoma Kostën e tyre që t'u kthehej nga ajo Amerikë e tretë, t'u kthehej e t'u mbushte konaqet e gurta dhe kamerien përplot. Po zjarri në oxhakun e tyre të madh sa vinte e bëhej më i kursyer. Pleqëria, që ua kalbte tru-

pin si dardhën që nuk bie nga dega, u ruante një bërthamë në zemër, jo të zezë, po vërtet si dritë.

Kam përse ta kujtoj, pra, jajën tonë më shumë me dhembshuri, me dhembshuri të madhe, e të më vijë keq, se ndonjëherë i jam zemëruar e më është fokur prej saj. Por i ri kam qenë.

Jaja kishte qejf të vinte me ne për verim. I pëlqente shëtitja, donte të njihte vise të tjera, njerëz të tjerë, dhe ku ta dish? Ato kujtime të saj të largëta të rinisë merrnin ngjyrimë të reja kur ajo udhëtonte dhe gjendej përpara atij liqeni aq të madh e aq të bukur. Njëherë pata dyshuar se ajo burrin e kishte pasur nga Pogradeci, po kjo nuk qe e vërtetë. Njëherë tjetër pata thënë se mos ai kishte qenë qiraxhi dhe i pati folur për udhëtimet e për viset, po dhe kjo s'kishte qenë e vërtetë.

Babai nuk ia prishte kur jaja kërkonte të vinte e të kalonte verën me ne, kurse nëna mbyllte gojën, edhe pse nuk i pëlqente kjo plakë havale. Gjyshja ime, që e kishte gjuhën të mprehtë, i ngulte ndonjë thumb dhëndrit, — «këta dhaskalët janë njerëz me damarë», — po babai nuk ia prishte qejfin jajës kurrë. Ai e quante «motër të madhe», sepse nga motrat që kishte pasur e që i kishin vdekur, kjo jaja, kushërira e tij, nuk mbante vetëm emrin e më të madhes, por edhe i ngjiste shumë, me sa thoshte ai, në të parë — kur qe e re — ndërsa Rina e tij edhe ajo kishte mbetur e ve jo më shumë se njëzet e një vjeçe dhe ishte kthyer pa fëmijë në shtëpi të babait, ku kishte vdekur shpejt.

Ajo s'dyshonte në «lumturinë e botës tjetër», ku nuk nxitoi aspak të shkonte, jo se i dhimbsej vetja dhe i pëlqente «kjo botë», po se Kosta i saj do të kthehej domosdo një ditë me një tufë kalamanë dhe nipër e mbesa dhe për këtë plaka nuk dyshonte asnjë grimë dhe që ia shtonte jetën mynxyrë. Dhe vetëm kur të vinte Kosta jeta kishte për të këmbyer, mbi tokë do të bëhej lumturia, ose, më drejt, do të dukej përsëri, edhe një herë, se një mot lumturie që kishte njohur Rina me të shoqin dikur, ajo lumturi jo vetëm që

nuk harrohej e s'mohohej, po kujtimi i saj mohonte çdo mundësi tjetër lumtërie në jetë, veç asaj të kthimit të Kostës në gjirin e shtëpisë.

Ky portret i gjatë i jajës Rinë ia vlen më shumë se ç'do t'ju tregoj tani, po, meqë jam nisur t'ju tregoj diçka, le ta mbaroj këtë hyrje të gjatë me një tregim të shkurtër.

E pra, një vit që jajën e kishim mysafire në Pogradec, babai na shpuri si ngaherë në Tushemisht një të diel, që ta kalonim me Gjokën, vëllamin e tij, për të cilin kishte dashuri të madhe. Mori me qira babai varkën më të mirë që ngiste Mili, një varkëtar i njohur, mik me besë dhe gati vërsnik i tij, shok i rinisë, tushemishtar i vendosur qëkuri në qytet. Ne kaluam një ditë të gëzuar në fshat. Mili vajti dhe tërhoqi grepat që kishte hedhur në liqen jo larg Krastës, dhe nxori tri-katër kokrra të mëdha korani, sa për të mbushur një kosh. Qe një ditë plot diell dhe me një fllad të lehtë. Po pasdreke, kur do të ktheheshim në qytet, veriu sikur e forcoi duhmën, liqeni u trazua, im atë që vuante nga stomaku, e druajti troshitjen dhe vendosi të kthehemi në këmbë. Po Mili ia mbushi mendjen që ne të vegjlit të na çonte me varkë në Pogradec, se rrezik s'kishte, era s'qe e kundërt, që të na hidhte në thellësi; do të koloviteshim e do të bënim qejf të madh. Me vete ai kishte marrë edhe dy nipër të tij, gati të moshës sime.

Nëna s'deshi, jaja Rinë tha «ba-ba-ba!» dhe i foli tim eti gjersa i tha «mos u marrose, more Filip?», por u bë e Milit dhe e babait. Varka u nis anës e anës së liqenit, nëna me babanë e me jajën i ranë xhades, ne e pamë shoqi-shoqin dhe i bëmë zë gjer aty pranë bregut të Starovës, pastaj nuk u pamë më dhe secili ndoqi udhën e tij — ne nëpër ujë, ata nëpër tokë — të bindur ne se do të arrijmë më përpara se ata në shtëpi, ku do të na gjenin. Po Mili nuk e pati të lehtë vozitjen, ra edhe një vesë shi që na bëri qull, kështu që, kur ne arritëm në shtëpi, nga fqinjët morëm vesh se babai me të tjerët kishin arritur me kohë, ishin

bërë merak e kishin vajtur në pazar të shihnin se mos Mili na kishte shkarkuar atje dhe na kishte marrë në shtëpi të vet. Dhe ngjau e pangjara.

Ne kërko ata në pazar, ata kërko ne në shtëpi; ata bjeri anës së liqenit për të na kërkuar, se mbase nuk ishim kthyer akoma, ne bjer xhadesë se mos po i gjejmë andej, — një si varangjel¹⁾ i vërtetë, me alarme, me lote, me britma, me mallkime nga njëra palë, — ata, — po jo dhe me shumë kokëçarje nga pala tjetër, ne. Jaja Rinë në këtë mes ishte e bindur se Mili, që i ishte dukur përherë një njeri nursëz — ai, në të vërtetë, ishte përherë i qeshur — Filipin se pse e kishte zili dhe smirë dhe mëri! Ne ai na kishte mbytur në gjol, të tre fëmijët e Filipit, dhe vetë, me të dy nipat tushemishtarë, ia kishte mbajtur në Shën Naum, kishte kaluar kufirin, pra, ishte hedhur matanë, në Jugosllavi. Mili fëmijë s'kishte dhe kishte rrëmbyer kështu të dy fëmijët e së motrës! Kushërira s'dinte se si ta marroste në këtë mënyrë të kushëririn, Filipin, i cili kishte, — thoshte jaja, — vetëm miq të paqenë, gjer edhe katila.

Nëna ime desh kishte lojtur nga mëndtë; im atë desh kishte ngritur dorën mbi plakën. Na ishte bërë një i tillë alarm, sa nisi të trazohej tërë lagjja e buzës së liqenit dhe sekush të shpikte nga koka e tij se Milin e kishte parë a s'e kishte parë, thellë ose anës, se dhe era kishte nisur të frynte në të kundërtën, duke ngritur shqotën. Rrëzë shkëmbinjve të Trapezicës, përtej Shën Naumit, zbardhonin kreshtat e dallgëve, dallgë të zakonshme, po që jajës i dukeshin male, nënës sime lubi, kurse babanë tim e bënin të mos ruante dot gjakftohtësinë dhe logjikën.

Ne i kërkuam sa i kërkuam prindët dhe, me shqotën që nisi, u futëm te një fqinjë, ku na poqën secilit nga një kallëp të madh misri. Aty u bë edhe takimi i famshëm, — me lot, me gaz, me të thirrura, me

1) Lojë që i thonë cic-mac.

—shpirte, me xhane, me amane, — domosdo edhe me gliko prapë dhe me kafe, për të sjellë zemrën në vend dhe, së fundi edhe me Milin, që piu edhe raki dhe që qeshte me gaz të madh. Kurse jaja e vështronte me një palë sy të shqyer, se ishte apo nuk ishte e mundur që Mili të mos qe ai përbindëshi që ne na kishte mbytur dhe që ishte hedhur matanë kufirit, po të pinte aty raki, pranë saj, dhe ajo të pinte kafe, kurse ne, të uritur, të kafshonim misra e të na nxiheshin buzët. Nëna qante dhe qeshte, kurse babai përpiqej të mbante një pamje të denjë, që s'i shkonte fare pas tërë asaj ka-trahure¹⁾ e çmendurie.

Kur u qetuum e u kthjem në shtëpi, nëna nisi të na tiganiste vezë. Jajës i dridhej akoma tërë trupi nga llahtara, prej së cilës nuk shqitej dot. Veç kur nisi të na molloiste se, kur varka po kalonte rrymën e Volorekës, atje ku lumi derdhet mbi liqen dhe ku kaluam në mëngjes, një gjarpër si nja një pash na kishte kapërcyer përpara, na kishte prerë rrugën, i zi pisë, dhe kishte marrë rrjedhën përpjete. Ja shenja e fatkeqësisë, — gjarpri! Po të preu gjarpri rrugën, është një me një, do të të ngjasë e pangjara. Gjarpri një, macja e zezë dy. Im atë shqiptoi fort një fjalë, që s'e përmbajti dot:

— Budallallëqe!

Mua m'u bë qejfi dhe nisa të tallem ca si rëndë me jajën, edhe pse nëna më bënte shenjë të hesht. Plaka m'u kthye e më qortoi si njeri të pacipë dhe nisi të parathoshte nuk di se çfarë të zezash të tjera që mund të na pritnin nga ajo shenjë e zezë që kishte parë, kur im atë ia pat:

— Ti, Rinë e dashur, s'ke parë as gjarpër, asgjë. Atë që pe ti, e pashë dhe unë: qe vetëm një kallamishtë!

— Kallmishtë?! Gjarpër! — gërthiti plaka.

— Gjarpër, gjarpër, — pohova dhe unë, megjithë-

1) Trazirë.

që s'kisha parë asgjë, po që më vinte inat, se me dukej se im atë kishte rënë në pozitë e jajës, sikur të thoshte se «kishte kallamishtë, pra, nuk do të na ngjiste asgjë, se, po të ishte gjarpër, na priste e zezë».

Jo gjarpër, jo kallmishtë, — unë s'hëngra vetëm vezën time të tiganisur, por edhe atë të jajës, së cilës iu for¹⁾ në fyt buka dhe fjeti atë natë pa ngrënë.

Kjo histori e gjarprit dhe e kallamishtes zgjati ndonjë javë, duke e ngacmuar jajën, gjersa ajo s'guxoi më ta zinte me gojë dhe ne, më në fund, e lamë rehat.

1) I ngeci.

Eremiti i Krastës

Sigurisht, xha Gjoka nuk ishte eremit¹⁾, dhe eremitë unë s'mbaj mend në moshën time, edhe pse i kapërceva të shtatëdhjetat. Ajo kohë që kishte eremitë duhej të ishte shumë më e largët, ndonëse nuk ka përse të çuditesh që edhe në kohën time të kishte tepruar ndonjë. Flas për ngjarje të një gjysmë ose dhe tre çerekë shekulli më parë, kur shumë gjëra në Shqipëri kanë qenë si në mesjetë.

Kam vajtur shpesh në Tushemisht pas vitit 1927. Kur u rrita ca, më tekej e i kërkoja leje tim eti të kaloja ndonjë të diel ose dhe ndonjë ditë të javës të xha Gjoka në fshat dhe nisesha me tushemishtarët që ktheheshin mbrëmave nga Pogradeci në shtëpi, ose nisesha dhe vetëm, anës së liqenit, kur që kohë e mirë dhe ma kishte ënda të llapashitja këmbët në ujin e ngrohtë e nëpër shkumat bardhoshe të bregut. Këto kanë qenë ndër çastet më ëndërrimtare të fëmijërisë sime, kur gjendesha vetëm me Malin e Thatë, që shtrinte kurrizin e tij gjer përmbi re, si një luan i përgjumur, me Krastën e Tushemishtit asaj rrëze mali, që skuqte si një prush në të shuar, me faqet e Rëmenjit e të Zërvas-

1) Murg që banon në shpella, vetëm.

kës nga e djathta, të veshura nga gjelbërimi i thellë i pyjeve të gështenjave. Buajt, atë pasdreke, bënin banjën e tyre të fundit të ditës në liqen. Gjemitë e peshkatarëve, si buallica të mëdha edhe ato, ktheheshin nga anët e Krastës, ku vendi që i thellë dhe ku korani i kishte kullotat më të mira e rritej së tepërmi. Lopatat e tyre lllapashitnin ujin edhe më me pak zhurmë se këmbët e mia dhe unë ia merrja një kënge me tërë zërin, sa varkëtarë e llopçarë e shpeshëri — edhe zgalemët vetë — mbanin vesh këtë këngëtar të çakërdisur, i cili ia thoshte me një zë që s'i ishte trashur akoma dhe kishin, sigurisht, gëzim, se ai gëzonte.

Kështu u nisa një pasdreke gushti, pa kaluar ende mirë vapëhera. Frynte veri dhe që ngritur një krivec¹⁾, që i zhubraviste për mrekulli ujërat. Zgalemët, që pakëz erë duan e fillojnë të gjallërohen, troshitnin të kaltërtin e liqenit e të qiellit, si balona të bardha, me të cilat lot era. Stipkat, ca si rosa të vogla e të zeza, që u ngjajnë bajzave dhe që në qytet, në kohë vere, nuk i afrohen bregut, andej ishin me tufa. Unë ua kisha këmbyer emrin e u thosha «shqipka», se emrin «stipkë» e gjeja si të padenjë për atë liqen aq të bukur e të madh sa një det, midis atyre maleve dy mijë metra të larta. Mbi atë liqen, për mua, duhej të notonin shqiponjëza. Ato s'numëroheshin. E besoni se ai emër «shqipkë» u mbeti dhe mua më duket se u mbeti prej meje?

Te gryka e lumit, Voloreka, që del nga disa burime të mëdha rrëzë Krastës së Zagorçanit, asohere mbyste dhe bënte kënetë një pjesë të mirë të fushës, duke formuar atë që quhej Blata e Starovës. Në vend të Blatës, sot ka një park të rrallë, me ujëra, drurë, lule, dhe Volorekës emrin ia vunë shumë të bukur, i thonë Drilon. Te gryka gurgulluese dhe me ujë të ftohtë të lumit, unë hodha atë ditë dy grepa, po nuk zura asnjë peshk. I mërzhitur, i mblodha më në fund

1) Erë e veriut që nis e trazon liqenin.

penjët dhe e lashë vrapin te xha Gjoka, një çerek ore aty përtej, në mes të Tushemishtit. Po xha Gjokën nuk e gjeta në shtëpi. Më thanë se ai ruante një bostan në një si zhurishte që kishte rrëzë Krastës, në Zaranivë, pranë Blatës. Atje e kalonte burri natën, me një kanik¹⁾ të lartë me shtrat, që kishte ndërtuar në mes të arës.

Ja fat! Të kalosh natën mbi kanik me xha Gjokën!

S'qe një punë që të më mbanin në fshat, në shtëpi të tij; pra më dhanë nja dy shkorsa, që të mos mërdhija natën, — unë të mërdhija! — më dhanë dhe një trastë me dy sahanë plot peshq të fërguar e piperka të pjekura, se Tushi, djali i Gjokës, po vonohej nga mulliri, kurse i ati priste darkën e do të kishte dhe një mik të uritur. Unë hodha trastën në sup dhe shkorsat mbi të, dhe u nisa nëpër ca mezhda që më treguan, — «do t'ia mbash mezhdës së madhe drejt midis dy arash, mbjellë njëra me qepë e tjetra me piperka, pastaj një mezhdë nga e djathta, që të nxjerr rrëzë Blatës; aty rruga të çon në çip të Krastës dhe, me të kapërcyer atë çip, përmatanë është ara me bostan që sheh nga Zagorçani, me kanikun në mes».

S'kishte se si ta ngatërroja rrugën. U nisa ca i fyer, siç e kuptuat, — të mërdhija unë! Peshku i fërguar dhe kulaçi i ngrohtë që mbante torba, më gudu-lisnin hundën e qiellzën gjatë udhës, po s'i çika me dorë.

Kishte kaq shumë nositë²⁾, që uleshin e ngriheshin si aeroplanë të bardhë nga të katër anët e Blatës, sa unë e humba dy herë udhën nëpër atë mezhdë, gjersa rashë në bostan të xha Gjokës.

Bostani qe rritur dhe vendi dukej sikur të qe mbjellë jo me shalqinj, po me ca zaje të paarritshme në madhësi e në ngjyra, që t'i kishte rrokullisur mali gjatë atyre shirave të fundit me vërshime. Vapa kishte bërë edhe ajo punën e saj — në mos dhe njeriu — dhe

1) Kasolle arash.

2) Pelikanë.

kës nga e
pyjeve të
njën e ty
katarëve

më të çara mes për mes e që u
thi lloj insektesh, ku zbr-

mbuluar me dega dustika, të gjerë sa për tre vetë dhe
ku mund të rrije edhe ulur e të mos të çikte koka në
mbulesë. Po xha Gjoka nuk ishte brenda dhe as që
dukej gjekundi, as në arë, as anës së kënetës, as në
ndonjë gërnx të Zaranivës. U ngjita mbi kanik e nisa
të thërres:

— O xha Gjokë, ore! Kabull mysafir-ir, ore-e
xha-a Gjokë!

Zëri më vinte me uturimë që nga Krasta, po për-
gjigjja e xha Gjokës jo. Dhe përsërit unë dhe përsërit
Krasta, dhe çirru unë dhe ajo me tërë mushkëritë e
me tërë shkëmbin.

— O xha Gjokë, ore-e! — dhe xha Gjoka vuv.

Në të parën nuk u bëra merak. E dija se veshët
nuk e kishin lënë, megjithëse tim eti, pesëdhjetë vjeç
jo, kishin filluar t'i rëndoheshin. Po ku ta dish se ç'bën-
te Gjoka? Mbase kishte hedhur grepat në Baltë dhe, kur
gjuante peshk, ai e kishte zakon të mos pipërinte dhe
bëhej me inat po t'i fliste njeri. Mbase, në atë buzë-
mbrëmje, kur hëna doli në vetull të malit dhe drita e saj
pikëloi Blatën këtu dhe liqenin përtej, xha Gjoka ngrinte
me kujdes ndonjë çark kundi a ndonjë grackë për ndo-
një lepur a për ndonjë çakall, në mos për ndonjë iriq,
mishin e të cilit e lakmonte shumë «e ka si të kecit
(thoshte), të majmë dhe që lufton edhe ielet¹⁾ — po që
kishte edhe marifetet e tij për ta zënë xha Gjoka. Ai
çelte gropa të thella aty ku kishte vënë re se e kishte
zakon të vërtitej iriqi, i mbulonte me barishte dhe ashtu
i zinte.

— Ke parë zotrote, — më thoshte njëherë, — tri gë-
shtenja bashkë se si u ngatërrohen gjembat në njëckë

1) Reumatizmin.

degë? Ashtu i kam zënë unë njëherë tre iriqë bashkë në një gropë të vetme, goxha gropë, që ishin ngatërruar kaq shumë midis tyre, për të kaluar njëri mbi tjetrin, për t'u ngjitur lart e për të shpëtuar, sa ishin koklisur mirë e mirë dhe mezi i shkollisa që t'u bëja punën.

Sigurisht që xha Gjoka tallej me mua, po dhe unë s'i besoja. Tre iriqë, si tri gështenja! Bukur, hë!

Kështu me xha Gjokën tim. Por unë më kot thërres prapë atje majë kanikut, se Gjoka s'përgjigjet. Thashë me vete se më njuh nga zëri dhe kërkon të më lozë ndonjë lodër, po ç'është kjo lodër që ta bësh tjetrin të çirret nga fyti e nga mushkëritë? U bëra merak. Thashë «do të iki», edhe pse më vinte keq që më vajti mundimi huq. Se, me mendjen time arsyetova që xha Gjoka nuk ishte aty, por unë nga një udhë, ai nga një tjetër, nuk ishim takuar dhe ai, ku ta dish përse, atë mbrëmje e kishte pasur mendjen te shtëpia dhe e kishte braktisur bostanin. Zbrita prej kanikut, hodha torbën me shkorsat mbi sup — të mërdhij unë! — dhe s'i rashë më nga mezhdat, se po errej e mund të rrëzohesha në ndonjë gropë, u ngjita Krastës e mora një rrugë më të gjatë e të lartuar anës kodrës, ku edhe fshatin e kisha përpara me llambat e kandilet e ndezura. Po ec e thërrit akoma ndonjëherë emrin e xha Gjokës, se mos është aty gjëkund e s'më ka dëgjuar, ose që ai të marrë vesh se lojën e teproi dhe unë po iki, apo se është në të kthyer dhe ai kthehet mezhdave, kurse unë largohem malit.

Ishte një mbrëmje e bukur shumë, me një çerek hënë dhe me yj që nisën të ndizen palë-palë mbi liqen e përmbi male, me cicërimat e bujqërthëve, me ndonjë kujë kukumjaçke, po dhe me ndonjë shpend të vonuar, që se pse vërtitej ose kthehej kaq vonë në kënetë. Kanë edhe nositët hallet e tyre. Nga poshtë, era që ishte ngritur, bënte të fëshfërinte kallmishten e kënetës, si një iso për zërat e pëshpërimat e natës. Unë ndieja një si drithërimë nga tërë këto bukuri të syrit e të veshit, ndieja freskun, që sikur ngrihej nga

kishte nga ato «zaje» të çara mes për mes e që u skuqte brendësia ku lëviznin lloj-lloj insektesh, ku zbrishte e ngulte sqepin edhe ndonjë zog.

Kanikun e xha Gjokës e gjeta të lartë sa dy burra në këmbë, me shkallë të sakta, me një shtrat prej trine atje përsipër, të shtruar me katër gisht fier të thatë, të mbuluar me dega dushku, të gjerë sa për tre vetë dhe ku mund të rrije edhe ulur e të mos të çikte koka në mbulesë. Po xha Gjoka nuk ishte brenda dhe as që dukej gjëkund, as në arë, as anës së kënetës, as në ndonjë gërxh të Zaranivës. U ngjita mbi kanik e nisa të thërres:

— O xha Gjokë, ore! Kabull mysafir-ir, ore-xha-a Gjokë!

Zëri më vinte me uturimë që nga Krasta, po përgjigjja e xha Gjokës jo. Dhe përsërit unë dhe përsërit Krasta, dhe çirru unë dhe ajo me tërë mushkëritë e me tërë shkëmbin.

— O xha Gjokë, ore-e! — dhe xha Gjoka vuv.

Në të parën nuk u bëra merak. E dija se veshët nuk e kishin lënë, megjithëse tim eti, pesëdhjetë vjeç jo, kishin filluar t'i rëndoheshin. Po ku ta dish se ç'bente Gjoka? Mbase kishte hedhur grepat në Baltë dhe, kur gjuante peshk, ai e kishte zakon të mos pipëtinte dhe bëhej me inat po t'i fliste njeri. Mbase, në atë buzëmbremje, kur hëna doli në vetull të malit dhe drita e saj pikëloi Blatën këtu dhe liqenin përtej, xha Gjoka ngrinte me kujdes ndonjë çark kundi a ndonjë grackë për ndonjë lepur a për ndonjë çakall, në mos për ndonjë iriq, mishin e të cilit e lakmonte shumë «e ka si të kecit (thoshte), të majmë dhe që lufton edhe ielet!» — po që kishte edhe marifetet e tij për ta zënë xha Gjoka. Ai çelte gropa të thella aty ku kishte vënë re se e kishte zakon të vërtitej iriqi, i mbulonte me barishte dhe ashtu i zinte.

— Ke parë zotrote, — më thoshte njëherë, — tri gështenja bashkë se si u ngatërrohen gjembat në njëckë

1) Reumatizmin.

degë? Ashtu i kam zënë unë njëherë tre iriqë bashkë në një gropë të vetme, goxha gropë, që ishin ngatërruar kaq shumë midis tyre, për të kaluar njëri mbi tjetrin, për t'u ngjitur lart e për të shpëtuar, sa ishin koklisur mirë e mirë dhe mezi i shkollisa që t'u bëja punën.

Sigurisht që xha Gjoka tallej me mua, po dhe unë s'i besoja. Tre iriqë, si tri gështenja! Bukur, hè!

Kështu me xha Gjokën tim. Por unë më kot thërres prapë atje majë kanikut, se Gjoka s'përgjigjet. Thashë me vete se më njeh nga zëri dhe kërkon të më lozë ndonjë lodër, po ç'është kjo lodër që ta bësh tjetrin të çirret nga fyti e nga mushkëritë? U bëra merak. Thashë «do të iki», edhe pse më vinte keq që më vajti mundimi huq. Se, me mendjen time arsyetova që xha Gjoka nuk ishte aty, por unë nga një udhë, ai nga një tjetër, nuk ishim takuar dhe ai, ku ta dish përse, atë mbrëmje e kishte pasur mendjen te shtëpia dhe e kishte braktisur bostanin. Zbrita prej kanikut, hodha torbën me shkorsat mbi sup — të mërdhij unë! — dhe s'i rashë më nga mezhdat, se po errej e mund të rrëzohesha në ndonjë gropë, u ngjita Krastës e mora një rrugë më të gjatë e të lartuar anës kodrës, ku edhe fshatin e kisha përpara me llambat e kandilet e ndezura. Po ec e thërrit akoma ndonjëherë emrin e xha Gjokës, se mos është aty gjekundi e s'më ka dëgjuar, ose që ai të marrë vesh se lojën e teproi dhe unë po iki, apo se është në të kthyer dhe ai kthehet mezhdave, kurse unë largohem malit.

Ishte një mbrëmje e bukur shumë, me një çerek hëne dhe me yj që nisën të ndizen palë-palë mbi liqen e përmbi male, me cicërimat e bujqërthëve, me ndonjë kujë kukumjaçke, po dhe me ndonjë shpend të vonuar, që se pse vërtitej ose kthehej kaq vonë në kënetë. Kanë edhe nositet hallet e tyre. Nga poshtë, era që ishte ngritur, bënte të fëshfërinte kallmishten e kënetës, si një iso për zërat e pëshpërimat e natës. Unë ndieja një si drithërimë nga tërë këto bukuri të syrit e të veshit, ndieja freskun, që sikur ngrihej nga

ujërat e më thoshte se «pa mbulesë anës së Blatës nuk kalohet nata, more bir», dhe nxitoja çapin asaj trage¹⁾ që sapo nisa të marr nëpër gurët e kuq, që fitonin ngjyrimet të mahnitshme, po dhe që m'i vritnin këmbët me sandale, kurse ndonjë dëllinjë më fshikte shalët me pantallonat e shkurtra. Ia nisa një kënge si nga Elbasani, që mund të më dëgjonte atje përtej Tushemishti i tërë, ia nisa me tërë zërin.

Unë ia nisa këngës, xha Gjoka më fanitet, gjithë ai kërcëp, në një të kthyer të Zaranivës:

— Po ti këtu, more?

Më trembi, jo fjalë. Po dhe unë, ama, e mbajta veten mirë.

— Ja, siç po të fanitem në këto gërxhe, more xhaxha. Kurse bostanin tënd,... të rroftë bostani, se më të kishin rënë iriqët e po ta bënin fushë. Tre i zura dhe i kam këtu në torbë. Dhe... mbajnë një erë...

Ai futi hundën në torbë, më pushtoi e më shpoi me mjekrën si dëllinjë, e ma pat:

— Po nuk e di ti, more gegërush²⁾, se unë jam bërë eremit?

Unë këtë fjalë, eremit, e dëgjoja për herë të parë. E mora si një nga ato shakatë e xha Gjokës — siç qe vërtet — e ia ktheva:

— Kur nuk e di plaka jote në fshat, nga ta di unë në qytet? Mua më hëngri qejfi të kaloja një natë mbi kanik nën hënë, pranë Blatës, dhe të shoh nositët nesër në qiell, kur të ngrihen në të aguar, pra u nisa. Po kaniku ishte bosh dhe ty, me sa duket, të kanë lënë veshët.

Në qesh e ai më pushtoi e më shpoi e më tërhiq me vete gjer në një zgaure në shkëmb të Krastës, ku më thotë të ul kokën e të futem brenda tij. Dhe futemi në njëfarë shpelle jo dhe shumë të thellë, po mjaft të gjerë sa dhe për dy të tjerë si ne.

— E sheh se jam bërë eremit? — më thotë ai për të

1) Rrugë.

2) Gegë i vogël.

treguar se nuk gënjen. — E sheh ti si e kam shtruar këtë vend më mirë se kanikun? Ka ftohtë në kanik, ore. Ftomën e Blatës dhe të Volorekës mos e di asgjë zotrote: të hyn në kockë edhe tani në mes të gushtit dhe s'të del as gushtin tjetër.

— Po bostani të la shëndetin, — i them unë, që vërtet kisha parë ndonjë dëm, ose kështu më qe dukur.

— Kam kaq bostan sivjet, sa s'ma ble njeri. As vete e çel ti një dyqan në Elbasanin tënd dhe ta jap unë bostanin badiava, një kacidhe okën? Do të bësh fitim të madh... Po jo, more, jo, mos ia ki frikën bostanit, se e ruan ky këtu, — ia bëri Gjoka dhe doli e u ngjit mbi një gur, ku nisi të thërriste e të bënte të gjëmojë Krastën e Blatën bashkë:

— A zuzar i zuzarit! Dale, dale, pa të biesh në ndonjë nga ato grackat e mia, pa të të lënë pa këmbë, more çakall i çakallit! Të paska vajtur mendja për bostanin e fukarait! Dale, dale, qen, ta rrëfen Gjoka i Kolit trimërinë ty, hajdut bostanesh! — dhe qesh ai jashtë e qesh unë në guvë, nga s'kisha dalë, se ndjeva ngrohtë, tani që ftoma e Blatës dhe e Volorekës kishte nisur të kafshonte vërtet, le t'i thoshin mes gushti.

Që të mos e zgjat, xha Gjoka ndezi një zjarr të mirë përjashta, pak më përtej se dera e shpellës, që të na ndriçonte ne përbrenda; nxori ç'kishte në torbë, sahanë dhe kulaç, shtroi mbi shkorsë hudhra e qepë të njoma, që i kishte qeruar e pastaj pastruar në ujë të Volorekës, zbrazti domate si mollë të kuqe — «molla të arta, ore, kështu u thonë nga Shkodra!» thoshte ai duke m'i treguar sa të mëdha e të bukura ishin domatet — nxori nga xhepi dhe një shishe gjysmëokane me raki dhe «bram, të kam gjetur e mirë se më urdhërove në shpellë të eremitit të kësaj Kraste, more gegërush! Dhe pi ai dhe detyro dhe mua ta vë në buzë, dhe ha ne me të dy bulçitë piperka e qepë e hudhra e mollë të arta, dhe atë koranin.

Bëhet xha Gjoka në qejf e nis e më tregon për jetën e eremitëve dhe unë marr vesh më në fund se

ç'kanë qenë këta. Dhe që të më provojë Gjoka se vërtet aty na paskësh qenë shumë herë motit, që as pleqtë s'e mbanin mend, një shpellë eremitësh, burri ngrihet, del jashtë dhe më sjell njëra pas tjetrës dy mokra të vogla me nga një vrimë secila në mes.

— Ja dhe mokrat, me të cilat bluanin kutrulinë e rapsallit,¹⁾ — më tregon.

Hëna përjashta kishte nisur të bënte lodra të mëdha përmbi liqen tutje e përmbi Blatën pranë, me përrunj dritash. Kallamishta mbante një iso të vërtetë me erën që frynte. Bujqërthit qenë rralluar, po kukumjaçkat shpeshuar. Ja dhe bufi po ia thotë, kurse xha Gjoka, që ka pirë aq sa të bëhet çakërcejf, po më duket si një eremit i vërtetë. Ja kur të ngrihet e të bluajë kutruli e rapsall me ata gurë, le t'i ketë dërguar plaka tërë atë kulaç e le të mos ketë të ngopur me këtë gegërushin pranë. E pyes unë:

— Po mysafirë, a qasin eremitët, o xhaxha?

— Ma merr mendja se po, — më thotë ai dhe, meqë është bërë çakërcejf dhe i shket goja, shton: — Besoj se edhe mysafir ka.

Unë turpërohem, se nuk jam më shumë se 14-15 vjeç, po dhe një shaka të tillë nga goja e xha Gjokës sonë tani e dëgjoj për të parën herë.

— ...se, — vazhdon ai, — mos i pandeh as budallenj eremitët ti. Çfarë nuk u sillnin atyre bota në këto shpella, se qenë të leshtë bota e i merrnin për të shenjtë dembelat, ca derra të tillë, që duhet të kenë qenë hamës e pimës të mëdhenj e të ndyrë, siç janë tërë dembelat, që ta dish ti. Se a ka dembelë më të mëdhenj [se 'bejlerët, more bir, se dhespoti (të 'më ndiejë perëndia që i besoj, por unë them të vërtetën dhe perëndia e di)? S'ka! E pra, kush i ushqen ata me mish e me peshk, me gjalpë e me djathë, me kutruli e rapsall. bejlerët e dembelët? Ja, kjo kockë, që ruan bostanin, se d'jemtë e një ruffjani vijnë e ia vjedhin e

1) Lloj gurësh.

unë s'u heq dot kopaçen si e kanë hak, se beu nesër vjen e ma bën bostanin fushë, pa bërtas e thërres atje majë kanikut ose këtu mbi gurin e kësaj shpelle, se kam ngrëhur çarçet dhe i kam ngrëhur vërtet. Po shyqyr që s'vjet na u bë bostani që të kënaqim dhe Elbasanin se rruga e makinës u çel e mund të shpjerë edhe bostan tatëpjetë dhe se s'ka si ky bostan Zaranive. Pa çaje!

Ai më kishte vënë përpara një shalqi sa për ta pushtuar unë me të dy krahët, dhe i feksi në dorë një thikë e madhe, që ma zgjati dhe unë ia ngula bostanit dhe e çava nga lart poshtë. Bostani krisi dhe u hap si një hazine e kuqe flakë, kurse xha Gjoka ma vuri gjysmën përpara dhe gjysmën e vuri përpara vetes, duke ngulur në të të pesë gishtërinjtë; nxori një gjysmë zemre shalqiri, që mund të peshonte një okë, dhe nisi të hante me tërë dhëmbët e tij të gjatë. Unë u fryva pa ngrënë akoma as çerekun e zemrës që më ra në pjesë, dhe xha Gjoka pastroi vendin duke vërtitur jashtë ç'kishte tepruar, me të dyja duart, tatëpjetë Krastës.

Rakinë thua se e kishte pirë, peshkun e kusurin e kishim ngrënë, nga bostani ishim velur, fjalët i kishim harxhuar, hëna po bënte të njëmijë lodrat përmbi liqen e përmbi Blatë, kallamishta po ia thoshte isos për shtatë palë qejfe, bufi me kukumjaçkën nuk flinin, as bretkosat.

— Ne s'jemi as buf as kukumjaçkë, — i them unë xha Gjokës. — As ia marrim me gjumë, se nesër pa aguar do të zgjohem, që të shoh nositët kur të ngrihen?

Por ai fjalët nuk i ka mbaruar, sepse unë kam një dyshim që ato mokra s'janë ndoshta të eremitëve, po shumë më të moçme, të njerëzve të parë, ndërsa xha Gjoka më tregon se aty në shpellë dhe rrotull ai ka gjetur ca ovulla¹⁾ të vjetra shumë, që dhe seç këndojnë, por ai s'i këndon dot, edhe pse greqishten e ka më-

1) Para të vjetra.

suar dikur dhe duhet të jenë greqishte sipas tij, po të dëmtuara fort. Pra jemi këtu nën një vend me gjeturina antike. Për këto para të vjetra kush mund të na thotë një fjalë të saktë në Pogradec? Për babanë dyshoj, për doktorin gjithashtu. Xha Gjoka shfaq mendimin se mund të na thotë një fjalë një vjershëtor me emër atje në qytet, se ai merret me shumë gjëra, edhe me antikatat. Unë i premtoj se do ta pyes vjershëtorin, do t'ia rrëfej ovullat.

Në këto fjalë dhe me gjumin që më është larguar nga qepallat, shoh xha Gjokën që çohet e më thotë t'i vete pas. Zbresim nga Krasta, kalojmë mes për mes bostanit, Gjoka ngjitet majë kanikut e bërtet e thërrret si di ai nëpër natë, aq sa s'dëgjohet më buf e kukumjaçkë për një çerek ore, — dhe as bretkosë, besa! Zbret prapë dhe dalim buzë kënetës, ku xha Gjoka ka hedhur grepat. Njëri ka zënë një ngjalë të trashë dhe të gjatë sa një bisht gomari; tjetri një koran sa një kokë kërriçi edhe ai, kurse tjetri, ç'besoni ju se ka zënë? Dyzet, pesëdhjetë bretkosa! Kishte shtrirë xha Gjoka anës kënetës një sixhim me 40-50 grepa të kuar me miza dhe zhabat kishin rënë në to e kërcenin si djaj të vegjël nëpër dritën e pakët të hënës. Eremiti i Krastës u këpuste me thikë këmbët e prasme dhe i fuste në torbë, kurse zhabat e sakatuara i flakte në kënetë. Kjo ishte për të bërë çudinë e madhe. S'më dukej vetja as anës Blatës së Starovës, po ku ta dish në ç'botë, që zor se merrej me mend.

— Edhe këto na duhen, — tha xha Gjoka dhe shtoi: — Një shok «eremit» atje përtej, që ua ngjesh këmbëve këto pjesë zhabash, vërtit mbi to dollakët dhe i bëjnë mirë për ielin. Vetë ka merak t'i zërë. Këtë nder ia bëj unë.

Ju i merrni me mend ëndrrat e mia të asaj nate në atë shpellën e vogël të Zaranivës, midis Tushemishtit e Zagorçanit, ku ia thoshte bufi e kukumjaçka. Nositët që janë ngritur e kanë fluturuar nëpër qiellin e ëndrrave të mia, dukeshin si kope resh dëbore, që thua se do të binte e trëndafiltë përmbi

Mal të Thatë e përmbi Blatë. Në Krastë endeshin ngjala të mëdha, si ato kafshët parahistorike që u mbaron emri me zorë, -dionozorë, -iktiozorë,... -ngjalozorë me fletë, dhe që s'janë të frikshëm aspak, po që bëjnë rreth e qark meje lojëra prej nuselalesh.

Në agim më zgjoi një erë e mirë gjalpi e theka-ritçeje. Përjashta shpellës, mbi një gur, xha Gjoka kishte shtruar shkorsën e tij dhe mbi të, dy sahanë të mbushur kapul me këmbë pulash të kuqërruara. Dhe kulaçin të përcëlluar në prush, shishen pranë, nga e cila kishte tepruar dy gisht raki, dhe domosdo një bostan, i cili kthente nga qielli zemrën e tij flakë të kuqe, kurse mbi Blatë nositët vërtiteshin si aeroplanë që u trëndafilonin pendët nën dritën e diellit gati në të guar.

— Ha! — më urdhëronte xha Gjoka. — Bota janë hajdutë bostanesh, unë jam hajdut pulash. Si të duken këto këmbë pulash?

Unë e di se nuk ha këmbë pulash po ha këmbë zhabash, se njëherë im atë ka treguar në shtëpi që xha Gjoka i hante shumë zhabat, mishin e të cilave e vinte midis mishit të koranit e të iriqit, përmbi mishin e pulës, dhe se këtë marifet e kishte mësuar në «Kohë të frëngut», dmth gjatë Luftës Botërore që shkoi, kur francezët e mbajtën të pushtuar shumë muaj Pogradecin.

Unë haja me qejf të madh, pa merak fare, kurse xha Gjoka këhente ndonjëherë shishen, më uronte dasmën e vazhdonte të më thoshte se ai ishte... një «hajdut pulash».

Skënderbeu në liqen të Ohrit

Ju e merrni me mend se nata me xha Gjokën, atje në shpellën e tij të Krastës së Tushemishtit, nuk na kaloi vetëm me të ngrënë e me të pirë e me gjumë. Nuk di përse xha Gjoka u ndez atë natë për Skënderbeun. Unë s'e kisha dëgjuar të fliste ndonjëherë për të. Për Skënderbeun kisha dëgjuar nga babai, kur lexonte «Historinë» e shkruar nga Naimi dhe kisha lexuar tanimë «Historinë» që shkroi Noli. Po nga legjenda e tij nuk dija gjë. Mbaj mend që babai i usta Markos, atje në Podgozhan të Mokrës, ai plak që dukej sikur të kishte dalë nga shpella e stërlashtë e moteve, si një xhungë reje, dhe të kishte zbritur midis nesh e të fjalosej si njeri, të kishte thënë, kur im atë e pyeti për moshën:

— Jam i motit të Skënderbeut unë.

Im atë kishte qeshur, por unë e kisha marrë me gjithë mend, sepse dhe Skënderbeu a nuk qe i bardhë si dëborë? Ata të qëmotshmit kështu duhej të ishin të gjithë. Sikur të ngrihej në këmbë ai plaku i Podgozhanit dhe t'i vinin një shpatë në dorë, do të ishte Skënderbeu vetë, i lartë gjer atje e me hundën si të zhgabonjës.

Xha Gjoka nuk ngjiste në asnjë me Skënderbeun. Ai kishte hyrë në udhën e pleqërisë pa mjekër e pa mustaqe. Vetëm ballin e kishte të rrudhur shumë, si një

Mal me Vija¹⁾, për të cilin tregonte ime gjyshe se qe zënë keq me Tomorin përkundrejt dhe ky e kishte bërë më atë ditë duke e gjuajtur me rrufetë e tij. Xha Gjokën e kishin gjuajtur shumë rrufe të jetës. Po prapë, ballin çallatë e mbante lart xha Gjoka, nuk e përkulte kurrë, si ai Mali me Vija.

Që të mos e zgjat, atje në shpellë xha Gjokës seç i hipi të tregonte për Skënderbeun. Kjo ngjau pasi ne hoqëm grepat nga Blata dhe nga bregu i saj sollëm me vete tërë atë peshk e ngjalë, por edhe një torbë me këmbë zhabash. Gjoka i hodhi dru zjarrit te gryka e shpellës, e ndezi mirë e na bëri dritë, drodhi pastaj edhe një cigare dhe gërxfhalli i tij m'i bëri sytë pufka së kollituri. Nuk di atëherë se ç'bisedë këmbëu xha Gjoka kur tha:

— E di, more gegërush, se cili na i ka sjellë zhabat në këtë Blatën tonë, që i paçim uratën?

Unë hapa sytë e skuqur dhe bëra çudi me këtë pyetje, se zhabat ku rrojnë, veç në kënetë? Nisi xha Gjoka nga përrallat. Do të hap veshët, le të mos jetë natë dimri, po natë gushti. I thashë:

— Keq s'ju ka bërë kush jua solli!

Ai tha:

— Jo, xhanëm, jo. Falemnderit. Pastaj kush tha se këndojnë keq zhabat? Të zë gjumi me atë këngë për shtatë palë qejfe. Ëndrra të liga nuk sheh. Ke për ta provuar. Po, që ta dish ti, kjo është një histori për të vënë veshin, se plekset me Skënderbeun.

Skënderbeu, që thua ti, more gegërush, ka luftuar shumë në ato anë përtej liqenit. Luftërat ai i bënte në tokat përtej Dibrës e Manastirit, që i kishte marrë turku. Kur sulltani i qasej Ohrisë, trimi bënte çmos që ta thyente aty e të mos futej i prapi Shkumbinit tatëpjetë. E di ti se nga ajo kohë ka mbetur në Ohri një lagje me emrin Skënderbej? Në rininë time ishte akoma, sot nuk e di. I ka shqepur aq shumë turqit Skënderbeut me

1) Mali i Shpiragut.

nam në fushën e Strugës e të Ohrisë — është një fushë ajo sa tri herë kjo e Starovës — sa është bërë vendi gropë, kaq e kanë rrëmihur këmbët e kuajve dhe e kanë handakosur për të kallur të vrarët çallmëmëdhenj. Aq gropë u bë vendi, sa që u kthye në një blatë të madhe. Këtu është blatë burimesh, ndryshon këtu nga etje. Atje është ujë i ndenjur, qelbet.

Njëherë që Skënderbeu kishte fituar luftën, siç e fitonte përherë, ai u kishte thënë kumandarëve të tij përreth:

— Ore djema, vështroni sa vise të bukura dhe të buta ka atje në anën përmatanë këtij liqeni. Ç'janë ato gjelbërime?

— Janë gështenjat, o kryezoti ynë, — i thonë kumandarët e tij, — gështenjat e dëgjuaara të Katjelit e të Rëmenjit. Si nuk paske dëgjuar zotrote për to? Po na gudit.

— Turpi për të gjallët, — kishte thënë Skënderbeu e kishte shtuar se do t'i pëlqente shumë të kalonte dy-tri ditë e të pushonte këtej, të njihte këto vise që s'na i paskësh njohur akoma, ai që Shqipërinë e njihte me pëllëmbë, të flinte njëherë nën ato hije, se gjumë më të lehtë njeriu s'bëka se nën gështenjë, thoshte ai, dhe kjo luftë e kishte lodhur ca dhe hak kishte.

Tregojnë se Skënderbeu, kur s'e kishte marrë akoma rob sulltani, sado djalë princi që na qe, shkonte me barinj të dhe i kishte qëlluar të flinte pyjeve me ta, edhe në pyjet me gështenja të Matit, dhe mbante mend sa gjumë të lehtë që bënte.

— Njeriu, — thoshte ai, — duhet të ketë të lehta shumë gjëra: gjumin që bën, ujin që pi, hajen që ha, rrobat që mban.

Dhe Skënderbeu kishte vetëm një gjë të rëndë, shpatën, se shpata duhet të godasë e të vrasë. Fjalën e kishte si gur qoshi, që zë vend e që s'lot. Ti, more gegërush, që s'ma ke syrin për shpatë, mbaje mend nga xha Gjoka dhe nga Skënderbeu, se edhe ai e thoshte këtë, që fjala duhet gur qosheje, le të flas unë shumë. Dhe sa për gjumin, në të shkon mendja për një gjumë

nën gështenjat e do ta provosh, atje në lëmenj unë e kam një krushk dhe vemë e i hamë edhe një mish si Skënderbeu motit.

— Skënderbeu kam për të qenë unë, apo ke për të qenë ti? — ia ktheva xha Gjokës.

— Unë? — u çudit ai. — Po dhe mundet. Po ta zëmë se jam Bendo Shapërdani.

Xha Gjoka, me sa kuptova pastaj, t' trazonte kohërat, Bendo Shapërdanin e pandehte të kohës së Skënderbeut, le të kishte qenë ai shumë më i këtejshëm, kështu që unë nuk e ngacmova andej, por e ktheva në historinë që kishte nisur:

— Dhe fjeti në Rëmenj e në Katjel i biri i Gjon Kastriotit, more xhaxha? — e pyeta.

— Atë që thoshte, Skënderbeu e bënte. Ai u nis re van me kalin e tij të shpejtë dhe me një trumë shokësh, dhe erdhi në këto anë. Po udha-udhë e lodhja-lodhje. U thotë shokëve kur sosin pranë Gurit të Kuq dhe gjejnë aty mbi liqen një koriqe gështenjash:

— Unë, — u thotë, — kërkoj falje, more djem e vëllezër, se do t'ia marr këtu një oft me gjumë. Ka kohë gjer t'i vemi Bendo Shapërdanit në Katjel. Le të shkojnë dy prej jush e t'i thonë të na presë.

Që ta dish ti, Bendoja kishte kulla si në Katjel, përtej kalasë së Pogradecit, lumit thellë, si në Alarup, rrëzë Malit të Thatë, këtu përsipër nesh.

Dhe si tha Skënderbeu edhe e bëri: u mbështet pas një gështenje sa tri lisa bashkë, puliti qepallën mbi qepallë dhe ndjeu gjumin t'i vijë. Trimat, që ta dish ti, gjumin e kanë në dorë: e thërresin kur u duhet dhe ai urdhëron e vjen.

Ishte një të rënë të ditës. Dielli qe fshehur nga Lenia, kallamishta fëshfërinte në liqen. Është koha kur zhabës së ngopur nga gjahu i ditës i jepet të gërgasë, Nis zhaba e gërget. Trimit se ç'i mërzit veshin kjo që bën gër-gër. Bëri t'i flasë gjumit prapë, gjumi është trembur, s'e urdhëron dot. Se ja që dhe gjumi i trimit mund të trembet ndonjëherë e pastaj të bëhet zevzek, si ai kali që e nget zagali. Gjumi bën të vijë — zhaba gër-gër —

gjumi ik. Se s'qe dhe vetëm një zhabë apo qenë dy, po treqind, tërë një kallmishtë me zhaba.

— More, — i foli trimi rojes që kishte pranë. — Ç'është tërë kjo potere? Mos janë turqit që po vijnë prapë, apo iu trazuan shpirtrat atyre që s'u ka çelur akoma gropën dushmani?

Roja qesh me të madhe me shakatë e të zot, qeshin dhe të tjerët sa tundet guri dhe hesht çdo gjë anembanë, në liqen e në mal, e mban vesh, se flet ai, ore! Trimi vë prapë qepallën mbi qepallë, po zhabat prapë të tyren, — gër-gër. Ha-ha se bëri gjumë. Dhe si s'bëri dot gjumë, u zemërua trimi e i mallkoi.

— U shofshi!

Po shuhet fara e zhabës? Të qëndronin në liqen, — i zinte mallkimi, nuk i linte. Njëra palë e zhabave vajti e mbushi Blatën e Ohrisë, tjetra palë këtë Blatën tonë të Starovës. Ato të Ohrisë janë të kuqe, se u zhyen me gjak turku; këto të këtushmet janë jeshile, si myshku i burimeve tona. Dhe në liqen mos shko të kërkosh zhabë: nuk rron dot më zhaba në liqen.

Ja kështu, more gegërush... Sa për mahananë e përrallës, ti je djalë dhaskali dhe s'ke nevojë të ta tregoj unë, se e merr vesh vetë. E sa për Skënderbeun, unë s'di aq shumë sa yt atë për të, po sikur të kalonim një natë mbi tryezën e tij në Pishkash të Qukësit e të hanim atje një mish, do të të mblidhja ca miq të moçëm që kam asaj ane Shkumbini e ç'nuk do të tregonin ata për Skënderbeun me nam, se e kanë pasur të shtëpisë, që nuk di se si.

E ke dëgjuar ti atë historinë e asaj nuses që mbushte ujë në krua dhe që Skënderbeu, që të mos bëhej ajo me turp, urdhëroi ushtrinë të mos kalonte andej, se nuset e reja bëhen me turp kur u kalon burri i huaj pranë? Ajo e mbushi bucelën plot dhe vajti i preu udhën trimit të madh e i thá:

— Mos deshe gjë zotrote të pish një ujë, se je lodhur e të mori etja nga lufta që ke bërë? Urdhëro, se kjo bucelë të ftohtë e merr, po më të ftohtë e jep ujin e malit. Im atë, që ta dish zotrote, të është

vrarë përkrah. Jam e bijë e filanit. Vëllai më lufton pranë tët vjehrri, Aranitit. Burrin ma ke roje pas: jam e shoqja e filanit. Dhe të mos kishim një plakë që do shërbim në shtëpi, ti do të më kishe qasur të vij pas burrit e pas teje, edhe për luftë, edhe për shërbim. Po pi, pi, nga kjo bucelë dhe sonte të na urdhërosh për darkë.

Skënderbeu piu gjysmë bucelë nga ai ujë, që unë s'pi dot gjysmë sapllake. E di ku bie ai burim ti? Në një skërkë midis Pishkashit e Rajcës në mal. Dhe është në të një udhë që i bie shkëmbit mes për mes. Që të kalonte andej ushtria, Skënderbeu e goditi shkëmbin me shpatë. E sheh edhe sot vendin e thua: e goditur shpatë! I thonë Shkalla e Skënderbeut. Bendo Shapërdani nuk i pati besuar motit. Kur vajti dhe e pa, u mahnit:

«Aha! Më la në hije Skënderbeu! — tha Bendoja ynë. — Nuk hiqem kësaj bote me kohë! Ka lindur një trim i madh shumë këtë radhë. Unë luftoja me një pasha, ai lufton me dy sulltanë». Dhe mbylli sytë Bendoja.

— Po pastaj, si e priti Skënderbeun Bendoja në Katjel, more xhaxha? — nuk m'u durua dhe e pyeta Gjokën. — S'do të ketë qenë Bendoja ky, po ndonjë tjetër.

— Ç'rëndësi ka se kush ka qenë? — ma pat xha Gjoka si pa të keq. — Po si thua ti, a ia marrim me gjumë, se dhe zjarri u shua, edhe hëna u çua lart shumë, edhe zhabat po këndojnë për shtatë palë qejfe, s'po them se po gërgërasin! Nesër do të të zgjoj me kohë, mos ki merak, që të shohësh, se si zgjohen nositët. Hajt, pafsh ëndrra të bukura, me nositë e me nuse, dhe kujtimi i Skënderbeut na ndihetë përherë.

Natë shkurti me dëborë edhe akull

Emri i Leninit ka ardhur herët në Shqipëri, kohë përpara Revolucionit të Tetorit, po të mendojmë te një veti e njohur e karakterit të shqiptarit, që ai është shumë politik, përherë i interesuar dhe i informuar mbi çka ngjet nëpër botë. Tregojnë se Sami Frashëri ka botuar, shumë vjet përpara se të vdiste, një artikull ku flet mbi socializmin si për një shpresë të njerëzimit. Dhe dihet se Mihal Gramenoja, në gazetën që nxirrte në Korçë, Leninin e quajti xhaxha Lenin, duke e paraqitur si një profet. Nuk ishte gjë e vogël për kohën.

Unë s'them dot se kur kam dëgjuar së pari për emrin Lenin, po emri «bolshevik», që në fëmijërinë time, tregonte në Shqipëri njeriun e përgjyruar për popullin, të thjeshtë shumë e zemërbardhë edhe më shumë.

— Ç'ke me filanin ti, — të thoshte tjetri, kur fliste për një shpirt njeriu: — ai është bolshevik njeri.

Këta bolshevikët kishin ngritur një shtet sa një e gjashta e botës. Ishte një shtet drejtësie për popullin, i pari shtet i tillë në botë, por edhe një shtet i madh shumë, që po forcohej përditë, pra, që u ngjallte shpresa të mëdha popujve të tjerë.

Për këto, sigurisht, flitej e bisedohej edhe në Shqipërinë e varfër e të skllavëruar nga brenda dhe nga

jashtë, porse unë kam qenë i vogël dhe nuk më ka mbetur gjë në vesh, që të kem kujtime, përveç kujtimit të asaj fjale bolshevik.

Ishim një ditë nja tre-katër shokë, që diçka po hanim të ëmbël te një zanatçi dibran, që shiste qumësht e kos, po bënte edhe muhalebi, hallvë, tərhan e hallvë të bardhë, e ndonjë tjetër gjë me sheqer, në bulevardin e «Shën Gjergjit» në Korçë. Ai kishte një dyqan të vogël, bri një kafeneje të madhe me xhama shumë e me pasqyra plot, ku kishte edhe tri bilardo dhe që mbante emrin «Splendit», e shkëlqyeshme. Dyqani i dibranit që i vogël e vetëm me tri tryeza ngjit e ngjit, por i pastër e që s'rrinte bosh kurrë. «Splenditi» ziente si një koshere, aty kërciste tavlla e trokiteshin kupat, goditnin njëra-tjetrën me sëlлим bilat mbi bilardot e mëdha, nëpër një tym, si ajo mjegulla e madhe që mbulon shpesh fushën e Korçës në kohë dimri.

Ne u kënaqëm me muhalebitë e dibranit dhe tani po haheshim se kush do të paguante, kur hyri një burrë, që dukej i plakur shumë para kohe. I thyer së tepërmi në shpatulla, i vrrarë në fytyrë e i vrenjtur, i parruar atë ditë, i veshur jo keq, por i pakujdesur për paraqitjen e tij, kur hoqi kapelen, ai u duk se ishte i pakrehur, e, kur zbërtheu pallton e madhe e e shkundi nga dëbora, shalli i shkau përtokë e iu ndot. Unë nxitova e ia ngrita, ia fshiva nga coprat e akullit, me të cilat ishte mbushur dyqani asaj dite shkurti. Përjashta bënte një dimër i sertë.

— Të falem nderit e më paç uratën, — më tha zotëria. — Po të më ndiesh, more bir, se, pa të njohur ende, do ta nis me një qortim. Ose ti, ose një nga këta djem të mbarë, shokët e tu, posa thatë një fjalë: jo «më qeras», jo «të qeras». Shqiptari as qeras as gostit. Këto janë fjalë të huaja, që i kemi bërë tonat pa ndonjë nevojë dhe shqipen e kemi përzier me greqishte e me sllavishte e me turqishte ca më shumë, tani me italishte edhe më keq. Po bëjmë një çorbë derri, si thotë fjala. Unë, për pjesën time, as e përtyp dot as

e gëlltit këtë çorbë. Më mbetet ja këtu, në lëfyt. Ne pleqtë kemi luftuar për një shqipe të pastër dhe e pastruam me sa mundëm. Kristoforidhi, Naimi punuan si ata. Juve të rinjve ju bie ta ruani të pastër e ta pastroni edhe më tej, ma do shpirti mua dhe e do puna. Se armiqtë e Shqipërisë janë po ata dhe, po të them një të vërtetë, që tha një shqiptar i mirë aty motit, Shqipëria, siç e kemi sot, nuk është ajo e vërteta, po ka mbetur një si Turqi e dytë. Vetëm festen kanë ndërruar e kanë vënë kapelën. Mos fola keq? Kur të flas keq, më thoni «ndal» e më drejtoni udhën, se ju jeni djemtë e mi në vite, kurse unë mund t'ju kisha mësues në dituri. Po si i thonë shqip «qeras» ose «gostis», more djem? Ta gjejmë e ta themi. Nuk e kemi, ta krijojmë atëzë fjalë që na duhet prorë, se ne jemi vatra e bujarisë, pa do të gëzohemi me të prituri e me të përcjellë miq, dashamirë. Unë për veten time nuk them «hajt të të qeras» po «eja të të gëzoj». Më duket bukur. Po mund të ketë edhe më bukur. Kjo gjuha shqipe, më ka thënë një i ditur që e njeh me rrënjë, është det. Kur i thashë «eja të të gëzoj me një qumështor» — qumështor, më dëgjon, more Bajram, jo «muhalebi!» (tundi ai dorën nga i zoti i dyqanit) — më tha i dituri: «Bukur, bukur shumë. Më pëlqen. Po do të gëzoj unë ty, se e kam unë», dhe më gëzoi... Po, more Bajram, se mbajta djalin në këmbë, m'u sill nga një kafe këtyre trimave nga unë, se këta qumështorin e hëngrën, kurse mua më sill një qumështor e një kafe dhe këto të jenë të miat të gjitha. Gëzoj unë, nuk qeras! Dëgjove?

Ne qeshëm me gjithë zemër pas tërë këtyre fjalëve të thëna urtë e butë, po me një palë sy të vrarë dhe si të munduar së tepërmi. Zotëria u ul në karri-gen që unë kisha lënë bosh, vetë mora një karrige në tryezën ngjitur, miku e gjeti me vend të shpjegonte.

— Kafe kemi «Splenditin» pranë, po besa që nuk ndrit, po skëterron. Unë kafënë e pi në ca tregëtiza të këtiilla me mjeshtër si ky, që, kur paguan, nuk të duket se pagove, po se të kanë gëzuar, se të kanë «gos-

titur» de! Dhe Bajrami vetëm për mua dhe për ndonjë shok timin bën kafe, se ky nuk është i kësaj mjeshërie, por i qumështrave dhe i të ëmblave.

Bajrami nuk i vonoi kafetë me shkumë dhe secili nga ne futi dorën në xhep që të paguante të parat e të dytat, porse qe e pamundur: nuk i merrte të hollat Bajrami, me një urdhër që i dha me sy zotëria. Ky tha:

— Unë të kem të tillë gëzim përditë, more djem, që të rri në një mësallë me katër petrita shkollarë, jo! Nuk varfërohem kurrë, sado të prish, po pasurohem, më këndon bujkthi në magje, si tregon përralla, e më shtohet mielli, edhe në mos paça të bluaj.

Dhe, për t'u paraqitur, ai tha një emër, që unë e dëgjova për herë të parë dhe që më kujtohet. Po ç'është nevoja ta kujtoj? Ju tanimë e njihni njeriun. Për t'u paraqitur në mënyrë edhe më të plotë, ai shtoi së fundi:

— Jam bolshevik si xha Mihali. Dhe ca fjalë, si «bolshevik», shqip s'janë, po shqipja i bën të sajat me dëshirë.

Xha Mihali — e kuptoni, Mihal Gramenoja — kishte vdekur tre vjet më parë, një ditë si ajo: ishte shkurt, që një pjesë të madhe të Korçës e bëri gërmadhë. Atë ditë e mbaja mend mirë dhe mbaja mend xha Mihalin në qivurin e hapur, me flamurin përsipër, po me kokën të zbuluar, që i binte dëbora dhe i ngjiste në vetulla e në mustaqe, dhe ai, jo sikur të kishte vdekur, po sikur të kishte porositur që ta shëtinin nëpër qytetin e tij të rrënuar, të shihte Korçën se në ç'ditë të zezë po e linte, pa le të binte dëbora, se s'kishte se ç'ti bënte më atij. Gërmadha shumë shihje nëpër Korçë edhe pas tre vjetësh.

Zotëria kishte qenë mik i xha Mihalit dhe nuk i shkohej në shtëpi pa kaluar njëherë atë mbrëmje nga dibrani, mik edhe ky i Gramenos, që të këmbenin dy fjalë e të sillnin në mend dy-tri kujtime. I sëmbonte plaga dhe ndiente lehtësim që na gjeti aty, edhe pse e nisi me një të qortuar. U gëzua, u gëzua shumë. Kur

drodhi cigare, drodhi me kaq lehtësi, sa qe për t'u çuditur se sa shpejt i bëri gjashtë, për ne, për Bajramin e për vete. I kishte rënë në sy se ne e kishim nderur më parë dhe nga kjo anë nuk na qortoi.

— Edhe pa tym nuk bëhet, — tha e qeshi, duke dejtuar cigaren e tij nga «Splenditi» më poshtë.

Duke tymosur, ai lidhi mendimet:

— ...Se Mihali ishte bolshevik, — tha dhe ngriti gishtin lart. — Keni dëgjuar për Leninin ju, more djem? S'keni dëgjuar. Bajram Curri i thoshte hazreti Lenin. Bajram Currin po e dini, si dini dhe xha Mihalin. Bajram Currin e vranë, xha Mihali vdiq. Po unë, që e kam pasur mik Mihal Gramenon, më shumë se mik, shok, më shumë se shok, vëlla, më shumë se vëlla, mjeshtëri, e kam njohur atë si një div. E pra, ai div nuk ishte plak kur mbylli sytë, nuk i kishte mbushur të gjashtëdhjetat. Nuk u vra prej plumbi, po vijtë vite që njeriun e farmakosin. Shkurt, edhe atë e vranë, them unë me timen.

Ju nuk keni dëgjuar për Leninin. Ai ishte i pari i bolshevikëve. Kemi mbajtur zi për të në këtë Shqipëri tonë, që mezi e bëmë të përgjysmuar e që na e lanë të përlumur. Na bëri Avniu të mbanim zi për bolshevikun e parë. Lenini, tha ai, në parlament, zbuloi se kush deshi ta copëtonte e ta robëronte edhe një herë këtë copë Shqipëri. Leninit i dhimbsej për tërë të vuajturit e botës, tha ai, si të mos i dhimbsej edhe për ne? Pesëqind vjet robëri, ore! Dhe në krye të punës, Esadërit, si përherë.

Ka qarë Mihali, si po qaj unë në këtë çast për Mihalin e të më ndjeni. Pleqëria këtë ka, ta bën qepallën të flashkët. Po ju, syrin xixë ta mbani, shkrep-tima t'ju lëshojë vështrimi!

Pra, Mihali qau atë ditë që u mor vesh ajo gjë-më që i gjeti bolshevikët. Ai më tha:

— Do të të rrëfej, vëllai im, se ç'kam dëgjuar unë njëherë për Leninin. E kam nga Bajram Curri vetë këtë. Dëgjon, more dibran, nga Bajram Curri, — u kthye ai nga i zoti i dyqanit dhe nisi t'i drejtohej së pari atij,

duke u rikthyer pastaj pak e nga pak nga ne e duke dredhur e ndezur cigare pas cigareje. — Ka qenë një burrë, — më tha Mihali, — që vinte ca i shkurtër, si ne të dy, po jo i gjerë e i plotë si unë motit, po ca i thatë e pa dhjamë si ti sot. Me sytë prush e me një të qeshur në këndin e tyre, që e shihje ti dhe të bëhej balsam ajo e qeshur, po e shihja unë (afendikoi, — ta zëmë se jam) dhe më bëhej plumb. Ku e kishte tërë atë forcë në atë trup? Tundi një Rusi 200 milionëshe. Mundi një botë 1000 milionëshe. Urdhëro e bëji llogaritë, se dhe ai pushkë kishte, por ata topa. Dhe frontet këtu e në Kostandinopojë. Kjo që kemi jetuar ne në këto vite, ose kemi dëgjuar, nuk është më histori, që ta tregosh. Se si do ta tregojnë ata që do të vijnë, nuk e di, po duhet të jenë të fortë në dituri. Se hipi opinga në fron! Car e careviç, princër e dukër e më the të thashë, Rasputinër me mjekrën gjer në dhë, tërë bejlurçina e Moskovit, tërë afendikonjtë e zuzarëria, mbaroi nën mitraloz, u korr. Cili shpëtoi nga ajo farë dhe paratë nuk i la kumar në Montekarlo, në Karlsbad e në sa bade e Karlo¹⁾ që janë, u bënë karrocierë, lëre-lëre, u bënë kamerierë, u bënë lustraxhinj nëpër botën e gjerë, u bënë lerë. Ka në Elbasan një bej, që ia kanë gjetur emrin që m'iu lumtë: beu me nallane. I paftë njerëzimi keq e më keq bejlerët, që s'do t'i shpëtojnë mitralozit të opingës, bashkë me tanët! Jo me nallane, po bythëjashtë, me nder nesh! Vjen një ditë, kur mblidhen hesapet dhe kur lahen borxhet me kamatë të rëndë. Karamanjolla²⁾, për një ditë të tillë lindi. Po ta kisha fjalën te bolsheviku i bolshevikëve, xhaxha Lenini, që i bëri të parët e Rosisë trokë, kur nuk u hoqi kokën.

Mendje e madhe. Shumë mendonte, pak fliste. Kishte dhe shokë të fortë, se pa shokë të fortë mos kër-

1) Sot Karlovivari (Çekosllavaki), vend ujërash termale e qejfesh.

2) Gijotina, ku të dënuarit me vdekje i pritet koka.

ko të jesh i fortë. Po është i fortë kush di të zgjedhë shokët. Dhe bëhet më i fortë kush, midis atyre që ka zgjedhur, gjen edhe arrën fyçkë.

Punonte shumë, hante kur mundte. Në pallatin e madh të qeverisë kishte dy dhoma: një për punë, një për gjumë. Dhe këtu një krevat prej hekuri, si ai që ke ti në shtëpi, që s'u martove, mor i mjerë. Ai beqar nuk qe, po nusen e kishte si veten. Punonte shumë dhe ajo, sa s'kishte kohë për kusi e për fshesë. Se kur bënte gjumë ai njeri, njeri s'e dinte. Po a bënte vallë gjumë? Bënte, domosdo. Po mendja njësoj i punonte, ajo si bënte gjumë. Si kjo ora ime, veç që kjo do ngrehur dhe e tija jo.

Një natë, ai ishte i këputur për gjumë, i këputur keq. Kishin një mbledhje të gjatë qeverie. Çështje shumë, punëra mal, ca që s'u jepnin dot udhë. Armiqtë i kishin shtrënguar pisk. Duhej bërë një goditje ku të përpinte dheu armata të tëra. Po si? Po kur? U thotë Lenini shokëve që, pasi kishin dhënë secili mendimin, e merrnin fjalën prapë dhe prapë:

— Ore shokë e vëllezër, turpi për të gjallët, po s'më mbajnë këmbët, bre, dhe qepallat i kam plumb. Të flas edhe unë një fjalë përpara se të flasin edhe ca shokë që s'i kemi dëgjuar, po që s'do të ma marrin për keq, se s'mundem më të mbahem. Të them si mendoj unë për çështjen, të mbështet pastaj kokëzën në këtë kolltuk tek jam, të mblidhem në këtë gëzof, se, e mira e mori, po kam dhe ftohtë, dhe ju vijoni të rrihni mendimet sa të bëj unë një sy gjumë. Në mos u zgjofsha, të më zgjoni kur t'i jepni fund e të keni vendosur. Ja mendimi im, shokë, për çështjen: kështu e ashtu e ashtuzë. Tri më duket se janë masat që ne duhet të marrim, pra...

I ra shkurt xhaxhai, ngriti gëzofin, futi kokën në të e mblodhi mirë këmbët në atë të ftohtë Rusie, kur lufta i kishte ngushtuar shumë edhe për qymyr. Mbylli sytë dhe fjeti që atë grimë. Do të kishte ndonjë javë që s'gjente kohë të flinte, veç me të vjedhur.

Ti e merr me mend dumanin e mbledhjeve. Pi-

në çibukë andej nga ato vise të ftohta dhe avullon çaji nëpër samovarë. Mendimet duhen rrahur fort, se janë rreziqet gjer mbi kokë. Ti thua se ngrite këtë mur, kur të shembet ai muri matanë. O burra të ngresh atë, të shembet një tjetër më këtë anë. Sekush duhet të ketë katër palë duar dhe s'ka, si ka dhe vetëm një kokë.

I rrahën fort mendimet bolshevikët një nate të gjatë dimri dhe Lenini aty, që flinte dhe që mendimin e tij e kishte shprehur. Agoi, u ngrit pastaj dielli. Njëri tha:

— Shokë e vëllezër, ja dhe dielli një hosten përmbi Nevë. Kishim një muaj pa e parë të bekuarin. Të them një fjalë më shumë unë më plaku? Ç'pata për të thënë, unë e thashë që në krye dhe i kam përsëritur. Ju dëgjova të gjithëve dhe iu ktheva të tërave me mend edhe një herë, i mata, i kukata. Dhe shoh xhaxhanë tonë që fle aty, futur kokën në gëzof, e çuditëm si nuk e bëmë me tërë këtë tym jo më të gërhasë, po dhe të teshtijë një herë, pa le të kollitet. Unë, me mendjen time, pas tërë këtyre arsytetimeve që shtruaam dhe që pa bukë nuk them se janë, se shumë mësuam prej shoqi-shoqit dhe më mirë e njohim tani gjendjen, paçka se rrugën nga do t'ia mbajmë asnjëri nga ne s'e bëri dot të qartë në fund, siç na duhet ta shohim, unë i kam dhënë fund me mendjen time: them se xhaxhai ynë aty na e bëri të qartë me ato që tha dhe them se ajo është rruga. Dhe siç më keni vënë mua ta drejtoj këtë mbledhje dhe mora fjalën, dua t'ju ftoj tani që të vendosim e të votojmë se kush është me Leninin. Kush të jetë me të, le të ngrejë dorën, në qofshi me mendjen time, që t'i japim fund me kaq dhe paq.

Votuan, e zgjuan Leninin e i thanë:

— Zgjohu, se votuam. Jemi me ty, plot 18 vetë; dy janë kundër dhe një s'merr anë.

1) mata mirë.

Ai, me atë buzën e tij me gaz si përherë, u paska thënë:

— Meqë vendosëm, do të veprojmë që sot.

Sa për ata që ishin kundër, me ta bolshevizëm s'kishte për të pasur në Rusi, them unë Mihali. Ç'thua ti? — më pyeti vëllai.

Unë i thashë:

— Po kush do të zgjedhë 21 shokë, mund t'i dalin dhe dy-tri fyçka, ore Mihal Grameno.

Ju, djem, që më dëgjuat, a jeni me mua?

Ne ishim me të.

Kështu mbaj mend se kam dëgjuar unë së pari për Leninin. Ka qenë tek ai dibrani dhe nga një shok i xha Mihalit. Dibrani na solli edhe nga një kafe nga ana e tij dhe mbaj mend se atë zotërinë e kam shoqëruar gjer te dera e shtëpisë atë natë dhe se thoshte:

— Ky shkurt i qenit, ky shkurt!

Konspirata e parë

Në vitin e tretë të liceut — atëherë isha 14 vjeç — në klasë na u shtua një bashkënxënës shumë më i hedhur se ç'kishim qëlluar ne të tjerët. Emrin ia thoshin Hazbi. Ishte nga Vlora. Atij sytë i shkrepnin për çdo gjë të bukur e të shëmtuar, për çdo gjë të mirë e të keqe. Kur fliste për Skënderbeun e për Ismail Qemalin, merrte flakë. Kur përmendej Esat pashë Toptani, bubullonte. Vitin e parë të liceut e kishte bërë në Gjiro-kastër. Edhe atje kishte pasur një shkollë të mesme franceze si kjo e Korçës, por që u mbyll. Kishte bërë pastaj një vit në Shkodër Hazbiu dhe së fundi e dërguan në Korçë.

Ai ishte një fotograf i apasionuar dhe ne, me ardhjen e tij, zumë të dilnim shpesh në fotografi. Ishte i pajisur me të gjitha mjetet, të cilat i mbante në shtëpinë e një miku të familjes në qytet, se vetë jetonte në internat. Fotografonte vetë dhe stamponte vetë. Përdorte një letër stampimi si të kuqe dhe fotografitë e Hazbiut, nga kjo anë, kishin një bukuri më vete. Ishte një peizazhist i lindur. Të thoshe se kishte dalë, aq i ri, nga atelieri i Foto Sotirit të famshëm të Korçës, që tani, për fat të keq, është harruar, po që bënte mrekulli me aparatën e vet. Foto Sotiri ishte shok i piktorit të njohur Vangjush Miho, i cili në lice na jepte mësimin e vizatimit.

Hazbiu mund të linte çdo mësim pas dore, po në orën e vizatimit nuk mungonte kurrë. Ne, në të kundërtën, vizatimit «ia varnim». Sikur nota e vizatimit të ndikonte në mënyrë të tillë, që të mund të vendoste në kalimin e klasës, disa nga ne liceun s'kishim për ta mbaruar ndoshta kurrë. Por as nota e kishte atë ndikim, as Mihoja e kishte atë zemër. Me Hazbiun isha zemëruar dy-tri herë për «mosrespektimin» tim ndaj artit të pikturës. Po a s'e kisha boll unë muzikën? Jo. Pikërisht sepse isha muzikant duhej të isha edhe një vizatues i mirë.

Hazbiu kishte dhe një tjetër pasion, gjahun. Bënte si bënte dhe zhdukej dy-tri ditë nga shkolla, në cilëndo stinë, edhe në dimër. Dhe prej tij qëllonte të hanim ndonjë thellë derri të pjekur për merak. Kam shijuar prej tij edhe thëllëzën e parë. Njëherë edhe një sorkadhe dhe ky mbeti për jetën time një si eveniment¹⁾, se tjetër herë s'kam ngrënë mish nga të sorkadhes. Hazbiu fliste për kafshët e për shpezët e gjahut më shumë se për çdo gjë tjetër. Ai i njihte gjahtarët e zotë të Korçës e të Vlorës dhe më përshkruante cilësitë e qenve të tyre. Njihte pushkët e gjahut dhe lëndonte, mbi të gjitha, ato të markave belge dhe franceze. Pushkë të vetën nuk kishte, po kishte i ati dhe kishin disa dajo e xhaxhallarë të tij.

E kuptoni se ky Hazbiu mua, dhe jo vetëm mua, dhe jo vetëm klasës sime, na dukej një njeri i jashtëzakonshëm. Duhet pranuar se ishte i tillë. Apo nuk merrte dhe nota të shkëlqyera, ndonëse nuk punonte shumë! Frëngjishten e kishte lënë një vit, kur u largua nga Gjirokastra për Shkodër, po na arriti shpejt dhe doli në ballë të klasës. Kishte një kujtesë të habitshme si për poezinë, ashtu edhe për prozën. Copat e leximit, me një sy që u jepte, i mbante përmendsh dhe mësuesit shtangnin pas mënyrës së tij të recitimit. Të thoshe një artist në skenë. Mësuesit, edhe pse Hazbiu që i pa-

1) Ngjarje me rëndësi.

përmbajtur dhe i thoshin «rrëmujaxhi», e admironin, e përkëdhelnin, nuk e qortonin për asgjë, le të zhdukej për gjah ku t'i tekej dhe le të dinin të gjithë se qe për gjah, kur kujdestari i tij dërgonte lajmin se e kishte të sëmurë në shtëpi. Kur i thosha se si bën që nuk e qor-tojnë, më thoshte:

— I josh me një thi a me një thëllëzë.

I pëlqente të përdorte fjalë shkodrane.

Nuk qe aspak e vërtetë që ai t'i gostiste me gjah mësuesit. Hazbiu nuk i përkulej askujt dhe nuk lypte prej askujt përfitime. Por ai dinte të bënte miq, t'u afrohej sidomos të moshuarve, pikërisht si një i madh.

Një të diel, nuk di me çfarë rasti, «Gazeta e Korçës» që asaj dite botonte një faqe vetëm me fotografi, faqen e katërt — fotografi nga e gjithë bota: yje të kinemasë që ishin në zenit, burra shteti që bënë bujë, gangsterë të dëgjuar, bankierë të falimentuar, riviera të stërnjohura dhe të tjera — asaj dite, gazeta në fjalë na i kishte mbushur plot dy faqe vetëm me fotografi të «mbretit august». Fotografia e tij, që quhej «e fundit», pushtonte gjysmën e faqes. Në të tjerat mund ta shihje Zogun bukurosh edhe nxënës shkollë me qylaf e me kravatë në Stamboll, edhe kolonel të ushtrisë austro-hungare, edhe president republike me shapakën si pallua, edhe majë kalit, edhe midis qeverisë së tij, edhe tek paradonte ushtrinë, të ngarkuar me aq nishane, sa, sado të ishte bojalli, të dyshoje se qenë prej teneqeje, se, po të peshonin vërtet, edhe Petër Sturgji nuk do t'i mban-te dot.

Asaj të diele për të cilën ju fola, unë dhe Hazbiu e lexuam gazetën bashkë në kopshtin e «Themistokli Gërmenjit». Statuia na kishte kthyer krahët, po neve na pëlqente të qëndronim tek ai vend. Hazbiu nuk talllej aspak kur thoshte:

— Qofshim përherë nën hijen e tij!

Hapëm gazetën dhe, në faqen e fundit, na doli një fytyrë pa nishane shumë në gjoks, po përherë me atë mustaqen spic. Hazbiu pështyu dhe ia pat:

— Pushti!

Ulur në diell, në një bankë pranë nesh, dy pleq, që kishin hapur dhe ata gazetën, na vështruan të trembur dhe s'e bënë të gjatë, por u çuan e ikën. Asohere edhe muret kishin veshë dhe guximi i shokut tim mund të quhej i marrë. Unë, për vete, mbeta pak si keq. Ishte e para herë që dëgjoja një shok timin të fliste në këtë mënyrë kundër mbretit, ndonëse kundër mbretit veshi më kishte zënë fjalë jo të pëlqyera edhe nga të tjerë. Hazbiu, si për inat të pleqve dhe timin, që e vështrova si me gjyç, u lëshua me tërë mllëfin:

— Jo vetëm pusht, po rrezil, po katil, po mender teje dhe mender atyre, — tregoi ai pleqtë me një gjest të inatosur...

S'e dija që «rrezil» e «katil» ishin rima të një vjershe të Nolit, e cila tanimë ishte bërë e famshme, po që mua s'më kishte rënë në dorë.

Shoku nisi të më fliste hapur kundër mbretit. Ai kishte dëgjuar për jetën e pallatit, të princesshave, të lalë Krosit, dhe i mëshonte Hazbiu kundër jetës së asaj hordhie, jetës personale më shumë se jetës politike, që ai duhej ta dinte akoma pak. Po përfundimi i tij që i saktësisë më të madhe:

— Me një sulltankë të tillë, more vëlla Skëndo, ç'mund ta presin Shqipërinë tonë? Tërë të zezat?

Mbaj mend se kemi biseduar dhe herë të tjera për Zogun. Hazbiu kishte formuar horizontin e tij politik, kurse unë kisha mbetur ende fëmijë, ndonëse kisha nisur t'i nuhatja disa gjëra dhe të kuptoja diçka. Kuptoja, për shembull, se mbreti po na shiste kokë e këmbë tek Italia, po se ç'ishte fashizmi, jo; kuptoja se ne ishim vendi që thuhej më i prapambeturi në Evropë dhe kjo më vriste në zemër aq sa dhe shitja tek Italia; kisha dëgjuar t'i thonë Shqipërisë «Turqi e dytë» e t'u vënë fajin bejlerëve; mbretin e urreja përbrenda, se na kishte vrarë Avni Rustemin, Bajram Currin e Luigj Gurakuqin, po s'mendoja akoma se dhe unë mund të isha hakmarrës i tyre. Kurse Hazbiu, — Hazbiu ziente dhe nuk përmbahej nga gjithë këto. Ai kishte shpërthime të tilla, kur ne nisëm t'i bisedonim këto vetë i dytë, sa

mua më vinte çudi se si bisedonte ai me kaq siguri e guxim, sa nuk kisha dëgjuar të bisedonte askush.

Shkuan disa javë. Hazbiu solli një ditë në shkollë një libër të madh. Në bankën e fundit të klasës, ku ne rrinim, s'bëmë tjetër veçse shfletuam atë libër. Mësuesi i historisë na tregonte për galët e për Versenzhetoriksin¹⁾, gjëra për të cilat unë kisha vërtet interes, po libri që solli Hazbiu nuk na la të dëgjonim asgjë dhe mësuesi, i tërhequr nga mësimi i tij, nuk e vuri re fare që ne as që e dëgjonim. Hazbiu kishte sjellë një katalog të madh të «Manifakturës së Armëve» (siç i thoshin) të Sent-Etjenit në Francë, një katalog i ilustruar si jo më mirë, me tërë armët «e vogla», — pra, ku mungonin topat e tanket, aeroplanët e luftanijet, po nuk mungonte asnjë armë vetjake zjarri dhe asnjë armë e bardhë. Përshkruheshin tërë këto armë në detal, tregoheshin efektet e tyre, domosdo kishin edhe çmimet e tyre me franga. Pushkë luftime, pushkë gjahu, revole, pistoleta, bajoneta, pinjolle, thika, biçakë dhe ç'nuk. Pastaj çfarë nuk reklamonte ai katalog? Vinin me radhë tërë pajisjet e shtëpisë, që nga tenxheret, te vaskat e banjës. Të thoshe se kompania tregtare e Sent-Etjenit interesohej njësoj si për vdekjen, si për jetën, që të nxirrte sa më shumë fitim nga të dyja. Veglat e peshkimit aty zinin dhjetë faqe.

Katalogu kishte pesëqind faqe. Na prishi mendjen me një fjalë, na mbeti në duar me ditë e me ditë. Jetë bënin këta djaj frëngjër! Ky ishte një katalog si për mbretin tonë, jo si për ne. Po ja që Hazbiut i kishte rënë në duar. Dhe bënim nga bënim e ktheheshim tek armët dhe mjetet e panumërta të gjahut. Shoku linte mendtë pas një çifteje «*a répétition*»²⁾, pas një tekeje që

1) Udhëheqës gal i shek. I para erës sonë, që luftoi me trimëri kundër romakëve.

2) Me përsëritje, gjysmë automatike.

ishte «l'élégance meme»¹⁾, pas një floberi²⁾, që ishte një «joujou»³⁾, po që thëllëzën e vriste nga 70 metra larg. «Turçikat» e lëkurës për qentë qenë të mahnitshme, thikat e gjahut të disa llojeve, që asnjëherë fantazia e gjahtarit tonë nuk do t'i kishte marrë me mend, çantat e shpinës... — po ç'ta zgjat?

Nja tri-katër faqe të katalogut u kushtoheshin vetëm mjeteve të shtypshkrimit. Gjer te mjetet e shtypshkrimit! Ja «manifakturë» e çuditshme armësh! Vula të çdo lloji e të çdo kalibri, — të rrumbullakëta, katrore, trekëndëshe, prej metali, prej gome, për kryeakte si për nënshkrime, për zbururime gjithashtu (zogj, bimësi, armë, — domosdo!). Edhe shkronja, që, po t'i radhitje në disa kapakë teneqeje, mund të formoje tekste të shkurtra. Shkronjat ishin prej gome. Shitej për to bojë e veçantë. Me një rul i shtrohej boja tekstit të radhitur, me një rul tjetër i kalohej përsipër kartës që vihej mbi tekst, dhe ja tek të tregonte ilustrimi se ç'dilte, — një mrekulli teksti i shtypur! Mbi të, manifaktura e famshme lëvdonte veten se një pasuri të tillë çëçitësh nuk ia afronte publikut asnjë tjetër manifakturë në botë, kurse nën të zgjatej, elegantsime⁴⁾, një firmë. Dhe si shembull merrej floberi, «fjalë e fundit», «më i lehti i gjithë floberëve» dhe «më i liri», me të cilin «Edhe një doçkë zonjëze» thëllëzën e vriste gjer më 70 metra. Dhe një lingua kishte kërcyer në ajër për ta kapur gjahun fluturim.

Qe pikërisht ky flober që ia kishte prishur mendjen shokut tim Hazbi. Kurse ajo reklamë, e shtypur me ato mjete të thjeshta shtypshkrimi, ia prishi mendjen dhe më fort. Nuk më kujtohet se sa kush-tonte floberi, por ato mjete të shtypshkrimit nuk bënin më shumë se njëqind franga franceze, pra diçka

1) Eleganca vetë.

2) Lloj tekeje e vogël.

3) Lodër.

4) Me shije.

më shumë se një napolon ar, rreth pesë dollarë të Shqipërisë.

Ishim ulur e po shihnim katalogun në atë qoshkun e Kopshtit të «Themistokliut», ku banda sapo kishte dhënë koncertin e së dielës. Hazbiu futi dorën në xhep dhe nxori një shuk me kartëmonedha. Ai i rreshtoi e i palosi dollarët duke i njehur. Nuk mbaj mend sa dolën. Po sa më shumë i afrohej dollarit të fundit, aq më tepër prishej shoku në fytyrë e thoshte:

— Mezi më dalin për floberin!

Shë fundi, ai tha me keqardhje të madhe:

— Nuk mbetet veçse ky dollar për shtypshkronjën!
— Dhe më tregoi dollarin, që të isha dëshmitar. — Mirëpo duhen pesë!... Po në drejç vaftë floberi! — u inatos ai.

Unë u habita shumë. Të këmbente floberin me shtypshkronjën Hazbiu? Ç'ishte ky qejf i ri që i kishte hipur në kokë?

— Ç'të lipset shtypshkronja, more? Ti për floberin ke ëndërruar. Ja dhe paret i paske bërë. Apo ke frikë se mos nuk ta vret thëllëzën e s'bën as për rabecka? — nisa ta ngas unë.

Ai qeshi hidhur e tha:

— Ti nga kjo jetë s'ke mësuar asgjë.

S'kam mësuar asgjë nga kjo jetë! S'kam mësuar se më një flober nuk vret vetëm rabecka, po mund të vrasë edhe «dora e çupkës thëllëzën nga 70 metra larg»!

— Po mirë! — ia pata. — Ja ku më ke! Dhe doçkë çupe në paça unë, ke dhe zotrote! — Dhe i tregova të dy duart, të cilat i kisha ndoshta më të mëdha se të tija.

— Shiko, — më përsëriti, — të kam ditur të mençur, por po më del... Si pandeh zotrote, se do ta durojë rinia beun zagat mbi zverk?

Kjo qe kaq e papritur, sa unë mezi e mora veten. Më në fund ia ktheva:

— Ta durojë? Jo, ta luftojë! Ja, me flober! — i rashë unë me tërë pëllëmbën katalogut dhe kapaku iu

gris. — Ti Zogun ma quan herë sulltan dhe herë rabeckë, që s'na bækërka «as për një meze».

Ai donte të qeshte, po më shumë kishte inat dhe më kot përpiquej të shtronte me pëllëmbë kapakun e grisur të katalogut.

— S'je, s'je budalla, — ma ktheu. — Po ti ke për ta mbajtur qumështin në buzë edhe për kushedi sa vjet. Na, na, fshi buzët! — nxori ai shaminë dhe ma vuri në dorë. — Unë këtë shtypshkronjë do të porosit! — i ra me grusht katalogut dhe kapaku i grisur fluturoi tutje.

Po kaloja nga çudia në çudi. Po dhe fillimi i shakasë që më pati hidhëruar, nuk më la të shastis.

— Çudi! Tani që unë Skëndo Vjershëtori kam shkarravitur vargjet e para, ja tek e gjeta Dhori Kotomani tim që të m'i shtypë. Ka borxh t'i shtypë dhe jo vetëm t'i shtypë, por edhe të dalë me tezgë midis pazarit: vjersha, vjersha nga Elbasani! Një kacidhe pesë! Shtypur nga Kotomani!)

Se si më befti ky ofiq Kotomani, as unë s'e di, kur nxora nga xhepi tërë një radhua me vjershat e mia të para. Mbaj mend se ajo e para vjershë rimonte-eta («e vërteta» të qe rima?). Ajo i këndonte, as më pak as më shumë, liqenit. Vjersha për pranverën vinte e dyta, kurse e treta, e treja qe se ç'qe! Ajo i këndonte një rabeckëje që kishte ngordhur në dritaren time, ku s'e kisha dëgjuar të çukiste për një drudhëz bukë!

Hazbiu më rrëmbeu radhoin, i hodhi një sy të shpejtë faqes së parë dhe nisi të improvizonte, sikur të lexonte vërtet nga vargjet e mia:

*Jo, more, më le pa mend,
mor tungjatjeta!*

*Na mbahesh një goxha shpend,
porsi rabecka!*

1) Dhori Koti kishte një shtypshkronjë në Korçë.

Më shtangu, jo shaka!

— Pse s'thuhet se të kam rival? — desha të loz unë, i mrekulluar.

— Nuk më lejon t'i gris këto vjersha? — e çori ai aty për aty radhoin tim dhe e bëri katër pjesësh, të cilat m'i rrsi në xhep. — Fshiji, fshiji buzët, — më vuri shaminë e tij në buzë.

— Ç'të zuri? — i rrëmbeva shaminë dhe gati sa s'e godita.

— Më zuri! Ç'të më zërë? Je i zoti të shkruash kundër Zogollit? — më ulëriu ai në vesh.

Këtë radhë unë e kuptova tërë seriozitetin e çështjes. Të shkruaja kundër Zogollit? Ja një gjë që s'e kisha menduar. Raku, shoku im në Elbasan, i vizatonte që moti me pupla, unë...

— Dhe kur të shkruash vjersha kundër Zogollit, more trim, unë do bëhem po aq trim e do t'i shtyp, more vesh? Do t'i shtyp unë dhe Minai do t'i përndajë. Nuk do t'i lëçitë pazarit, po do t'i përndajë, se Minai, mbahu ti për i mençur, po buzët s'i ka më me qumësht.

Minai ishte një shok klase, me të cilin Hazbiu kishte po kaq miqësi, sa me mua, po që unë s'e kisha akoma dhe kaq mik. Ai ishte korçar, i heshtur, i mbyllur, kurse mësimeve nuk ua thoshte. S'i hynte frëngjishtja në kokë.

Ajo bisedë me Hazbiun zgjati më shumë.

Ai kishte një ide të shkëlqyer. Unë s'e kuptoja gjer në fund apo s'e imagjinoja dot mirë! S'e kuptoja as rrezikun e kësaj pune, po që të shtyp në shtypshkronjën e Kotomanit një vjershë kundër Zogut, që ta kisha shkruar vetë, kjo më entuziazmoi. Fut dorën në xhep e nxjerr dy dollarë, që nuk di përse m'i kishte dërguar im atë ato ditë.

— Ti shtypshkronjën s'ke pse ta blesh vetë, — i them Hazbiut. — Ja ku të bëhem dhe unë ortak. Po dhe floberin duhet domosdo ta blesh, sapo e ke qejf të madh. Minanë po e paskemi tonin dhe bën hall edhe

ai nga ana e tij, kam besim. Po ti, që më mbahesh i mençur, harron se në klasë nuk kemi vetëm një Mina e një Skëndo e një Hazbi, — i përmend unë pastaj dhe dy-tri emra shokësh që i njoh për djem të mirë dhe trima. — Pesë veta, nga një dollar, ja shpenzimet i nxorëm lehtë-lehtë.

Hazbiu mend më përqafoi me lot në sy. Ai ma pat:

— E di ç'i thonë kësaj, more vëlla?

— I thonë konspiratë, — nuk ngurrova unë t'i përgjigjesha.

— Aty të kam! Konspiratë! Një konspiratë kundër Zogut! Do të shtypim fletushka dhe do ta bëjmë katilin rrezil, në daç sulltan e në daç rabeckë, madhërinë e tij! — ndizej Hazbiu e më shihte në buzë, bile nxori dhe shaminë e më fshiu buzët dhe qeshëm gjer në lot nga kjo shaka.

Unë e kisha kaluar atë minutë pragun e foshnjërisë!

Të nesërmen, konspirata u bë realitet. Të pasnesërmen, bashkë me floberin e famshëm, u porosit edhe shtypshkronja. Pas një muaji e pak, nuk vonuan që të vijnë. Dogana as që kuptoi gjë dhe as që bëri çudi.

Ne e vendosëm shtypshkronjën në qilarin e shtëpisë së Minait, ku, nën dritën e një kandili, jo vetëm që provuam se punonte punë e madhe, po shtypëm edhe fletushkën e parë, — që sot do t'i thoshim «trakt». Ajo ishte jo më shumë se pesë-gjashtë vija, po mbante kaq shumë epitete të kripura kundër Salepsulltanit, sa mund të shpikte imagjinata jonë e hakërritur për t'u shtuar epiteteve të Nolit në vjershat e tij, të cilat Hazbiu se nga i kishte gjetur e kopjuar dhe na i besoi. Ai vetë mori përsipër që një fletushkë ta fuste në oborrin e prefekturës. Minai do t'ia fuste vetë drejtorit të licent nën portën e shtëpisë, për të bërë «provën e parë».

Merret me mend se çfarë shqetësimi i tronditi au-

toritetet ato ditë, porse zhurmë nuk e bënë fare. Lajmet i merrnim vesh prej Minait, që t'anë e kishte nëpunës të vogël bashkie, dhe një kushëri polic. Morëm vesh se drejtori i liceut s'e kishte bërë për zë fare dhe kështu nuk dihej se ku mund të qe burimi i fletushkave. Po guximi ynë kishte qenë i madh, — gjer në prefekturë! Fletushka jonë kërcënonte se «do t'ia shkulinim pendët një e nga një Zogut, që veten ma cuan të parë dhe që është fundërrina e kësaj bote!» Ne «do ta pignim të gjallë», le të mos bënte «rabecka as për një meze»!

— T'i zënë, i varin, — kishte thënë polici kushëri i Minait, që ku ta dish se si e dinte përmbajtjen e fletushkës sonë. — Jo i varin, po në hell i shkojnë!

Në hell! Ne kaq deshëm dhe shtëpëm në krye të dhietë ditëve një fletushkë të dytë. Aty thoshim se. «edhe në pastë shqiptar pa pushkë, që ta rrëmbejë e t'i bëjë këрма Zogun me zogorinë.¹⁾ shqiptar pa sëpatë e pa hanxharë nuk ka, si nuk ka shqiptar pa gjak për të marrë për babanë e për vëllanë, për xhaxhanë e për ungiin, për mikun e për shokun, për vete e për gjithë Shqipërinë!» Dhe dy fletushka tonat i përndanë po atje. kurse në lice jo, që të mos na binin dot në gjurmë.

Qeverinë e zunë të dridhurat në Korçë, kjo qe fiala vetë e policit kushëri të Minait. Drejtori ynë vërtitej nëpër lice me një shqetësim të madh në çdo vështrim e në çdo gjest. Ai nuk nuhaste asgjë, po mund t'i digite që në lice nuk qe përndarë asnië fletushkë. Nuk di nga cili qytet, në Korçë sollën një batalion me ushtarë për të forcuar garnizonin. Ushtarët patrullojnë nëpër qytet po pa armë. Prapë njerëzia e kishte marrë vesh se ç'kishte ngjarë.

Nuk shkuan as dy-tri ditë dhe Minai erdhi në shkolle me një fytyrë të buhavitur. E ëma e kishte zbuluar

1) Kope ujqish.

shtypshkronjën tonë në qilar, sado në sepeten ku ne e kishim fshehur. I ati kishte bërë kusurin: shtypshkronjën e kishte zhdukur pa nam e nishan, djalin e kishte rrahur aq sa mezi mbahej në këmbë. Minai nuk zbuloi asnjë shok. Sa për konspiratën tonë, kjo mori fund me kaq, se dhe dy shokë na u frikësuan dhe na u larguan. Duheshin ditë më të mira, të cilat nuk kishin për t'u vonuar.

Për kujtim të Migjenit

...Ishim në mësimin e anglishtes. Ky ishte viti i tretë që unë e mësoja këtë gjuhë të huaj «kaq të lehtë e kaq të vështirë», siç e kanë quajtur. Të lehtë, se nuk ka gramatikë fare, të vështirë, se është plot me «përjashtime». Porse unë e kam gjetur me kohë sekretin e të mësuarit të gjuhëve: duhet të lexosh shumë. Gramatikën e mëson kështu prej vetiu dhe përjashtimet të nguliten në kokë vetëm përmes përsëritjes. Nuk do të dilni të humbur po të më dëgjoni mua.

Tani isha tetëmbëdhjetë vjeç. Lexoja çdo gjë që më binte në dorë nga ajo gjuhë, se dhe librat nuk gjendeshin lehtë, pra edhe mundësitë për të zgjedhur nuk i kisha. Sidoqoftë, arrita të lexoja Shekspirin në origjinal, le ta kishte ai fjalorin të pasur së tepërmi për mua, — 24 mijë fjalë! Lexova edhe voluminozin «David Kopërfild», që më argëtoi aq shumë, sa nuk më lodhi. Nisa të lexoja edhe «Sagën e Forsajtëve, po mezi i vajta gjer në çerek: ajo më lodhi shumë dhe më argëtoi pak. Më pas e kam lexuar më me qejf. Ju këta tituj dhe autorët i njihni. Me të tjerë s'po zgjatëm.

Pra ishim në mësimin e anglishtes dhe unë në këtë gjuhë e ndieja tanimë veten «të fortë». Mësuesi përpiqej shumë dhe që modest, e dinte se ç'i zinte kërraba. Po zellin e kishte të lavdërueshëm dhe ishte njeri me mend e me ndjenja. Se si i kishte qëlluar të gjendej në

rini në Bretanjen e Madhe, të bëjë atje një shkollë të mesme, as që e kujtoj. Po gjuhën e kishte harruar dhe shqiptimin e kishte të çalë. Këto ia «kontrolloja», se kishte lindur metoda e të mësuarit të gjuhëve me gramafona dhe unë përfitova, sigurova një numër pllakash dhe librin e parë të «linguafonit», siç i thoshin asaj metode.

Libri ynë i leximit atë vit kishte nisur të na bente të shijonim disa pjesë të zgjedhura të autorëve të njohur të anglishtes, që nga Shekspiri te Bernard Shou. Mësuam përmendsh edhe ndonjë stancë të Bajronit ose gjëra të shkurtra nga Shelli e Kitsi. Për shembull, «Vjershën e hënës» të të parit, sonetin në prag të vdekjes të të dytit, shkruar një natë përpara se të mbyllte sytë në Romë.

Atë mëngjes, mësuesi po na shpjegonte të famshmen «Ode të erës së Perëndimit» nga Shelli. Tercina danteske¹⁾ shungulluese, ku gjëmojnë detet dhe vërshëllejnë pjerrësitat e shkëmbinjtë, mund të të kujtojnë pjesë të romanit të njohur të Emilia Brontes, «Lartësitë nga ulërin era». Atë vjershë kisha filluar njëherë ta përktheja, por u tërhoqa shpejt. Po sot jam i detyruar të parafrazoj ndonjë varg, — e të më ndjeni.

*O erë e egër e Perëndimit, ti, frymë e vjeshtës,
ti, që me praninë e padukshme, fletët e vdekura
i vërtit, si një magjistrice, me kope e flakë,
të verdha e të zeza e të zbehta, të kuqe si ndër ethe.*

S'po vazhdoj! Në origjinal, kjo nis me një akord mazhor betovian:

O wild West Wind, thou breath of Autumn's being...

Betoveni dhe Shelli kanë qenë bijtë shpirtërorë të Revolucionit Francez, njëri më shungullues e më i bindur se tjetri. Shellin e quajtën që në rini Ariel, —

1) Lloj strofe me tri vargje.

kryesatan. Ai shkroi të parin himn mbi klasën punë-
tore gjithashtu. Kur Hajneja shkroi mbi minatorët e
Silezisë, himnin e tij e pati, them unë, para sysh.

Mësuesi e lexonte vjershën, vinte gjithë aftësitë,
gjithë frymën, në vargje shelliane, po prapë s'i mbushte
dot me ushtimën «e egër të së egrës erë të Perëndimit».
Ai ishte tërë siklet e mua më dhimbsej, po,
sigurisht, më dhimbsej edhe vjersha shumë. Prapë,
edhe ashtu siç e lexonte mësuesi, klasa i ndiente trombat
e simfonisë dhe të gjithë dëgjonin në heshtje të
plotë.

O wild West Wind...

...o thou... —

Kur, ngjau diçka e papritur, si një shembje a diçka
e çuditshme:

— Çohuni, djem! Në këmbë! Çohuni! — gjëmoi në
klasë britma e mësuesit, me një urdhërim që ne na
gozhdoi në vend.

— Çohuni, ju them! — thirri mësuesi dhe ne
mundëm të çohemi, të ngrirë.

— Pa ktheni vështrimin! — tregoi mësuesi me
dorë nga dritaret, prapë duke britur: — Ju lutem,
shihni! Pa shihni! — e uli ai zërin me të lutur e me
një drithërimë, që përshkoi tërë klasën e ngurosur,
e ne të gjithë mundëm të ktheheshim andej, si au-
tomatë.

— Shiheni! Pa shiheni! — i dridhej zëri mësuesit
në një mërmërimë. — Shiheni, se këtë s'keni për ta
parë ndoshta më kurrë një herë të dytë në jetën
tuaj!

Ne pamë malet e Oparit larg e gjithë malësitë që
valëzoheshin, e gjithë kodrinat për këtej, gjer për-
mbi fushën e gjerë të Korçës e përmbi pullazet e saj,
përmbi drurët, qiellin e gjithçka, që kishin marrë një
pamje fantazmagorie. Çfarë kishte sajuar natyra në
lëvizjet e saj! Mos Era e egër e Perëndimit kishte fryrë
mbi natyrën e tërë dhe kishte trazuar hapësirat, lar-

tësirat, tokat, pullazet, drurët, gjithçka, në të kuq gjak, në jeshil, në mavi, në një mënyrë magjike? Asgjë nuk jam i zoti të rikujtoj, e pa le të përshkruaj. Fjala fantazmogori është këtu në vendin e saj. Vetëm fotografia me ngjyra mund të fiksonte pamjen. Po dhe ajo! Pamja ndryshonte me një shpejtësi të pandalshme. Ajo donte filmin me ngjyra. Këto koha nuk i njihte dhe, po t'i njihte, ne nuk do t'i kishim pasur. Retina jonë ishte krejt e pazonja, — ajo ishte e zonja vetëm të ngurosej nga bukuria, një bukuri madhështore, por e frikshme në madhëstini e saj. Pastaj ndodhi një transformim kaq i shpejtë, sa natyra u bë e zakonshme, «njerëzore» tanimë, pa asgjë të çuditshme e përbindëshe, pasi na lëbyri sytë dhe mendjen. Një vegim i papërsëritshëm, një mirazh që kujtesa nuk e riprodhon dot më. Po ta kishte fiksuar aparati: do të kishte mbetur një tablo si s'kam parë tjetër herë në jetë më. E vërteta e madhe është se e bukura gjendet në jetën e gjallë. Kurse për fotografinë që ne e përcëmojmë, në njëfarë mënyre, kur themi se «arti nuk është fotografi», nuk kemi dhe kaq të drejtë. Ajo është një mjet i madh i fiksimit të së bukurës.

Ne u ulëm të shastisur krejt. Mësuesi i pari. Ai nisi përsëri mësimin, porse vargjet i pengoheshin në për buzë dhe s'ka dyshim që asnjëri më s'e dëgjonte. Kthenim kokën nga dritaret se mos po na fanitej prapë ajo bukuri, që u zhduk përpara syve tanë sapo u duk.

Mësuesi mbylli librin, vështroi jashtë dhe pastaj nga ne, mbylli sytë me të dy pëllëmbët, me bërrylat mbi katedër e me kokën të ulur. Ai heshti gjatë. Dhe salla heshti e tëra.

Mësuesi tha:

— Djem të dashur, popujt kanë pësuar fatkeqësira të rënda e përmbi të rënda në jetën e tyre, dhe pësojnë dhe do të pësojnë akoma. Tragjeditë s'kanë marrë fund për shumë popuj. E di që jua lëdoj zemrën, por e vërteta është kjo. Veçse janë ca fatkeqësira që, kur të shkon mendja në to, të dridhet veça-

nërisht shpirti. Unë s'levdohem dot se e njoh historinë e Shqipërisë kaq sa duhet. E kush mund të levdohet? Ne kemi një histori të madhe dhe pse jemi një popull i vogël; e të vegjlit kanë vuajtur shumë e më shumë. Kur të zbulohet historia jonë, atëherë do duket se sa e madhe është. Këtë unë e di. Po desha të flas për disa fatkeqësira të veçanta, — hoqi pëllëmbët ai nga sytë dhe pamë se i kishte gati të mbushur në lot.

Mësuesi buzëqeshi hidhur nga dritaret, e tha, duke mos e kthyer më vështrimin nga ne:

— Naim Frashëri nuk jetoi më shumë se 54 vjeç. 54 jetoi edhe i vëllai më i vogël, Samiu. Më i madhi, Abdyli, jetoi edhe një vit më pak. Ata i duheshin sa s'bëhej Shqipërisë në ato kohëra dhe ikën shumë përpara kohe. E merrni me mend se çfarë i ngjau këtij populli? Dëm i madh, trefish i madh e në as dhjetë vjet! Populli është një nënë e madhe, bijtë e mi. Ai lind bij të tjerë, që u zënë vendin atyre që vdiqën, që ndjekin punën e tyre dhe s'mënojnë. Porse unë s'mundem të harroj që Naim Frashëri, me të dy vëllezërit e tij, vdiqën të rinj akoma dhe pikërisht në ato ditë që i duheshin edhe më shumë vendit tonë. Naimi na la një vepër, një thesar që s'ka të çmuar. 15 vjet bëri që e krijoi, jo më shumë. Po të kishte krijuar edhe 30 vjet të tjera? Merreni me mend se sa kemi humbur! Po Samiu, me shkencën e tij? Samiu nuk pati kohë të bënte shkencë akoma në gjuhën shqipe, se sapo nisi. Duheshin shpenzime për të botuar libra. Kush do t'i hiqte shpenzimet? Kristoforidhi nuk e pa të botuar Fjalorin e tij. Lexuesit nuk ishin as dy-tre përqind e shqiptarëve.

Ne po mësojmë tani diçka nga Persi Shelli. Më pas do të mësojmë diçka nga Kitsi. Njëdizaj mësuam dy vjersha nga Bajroni. Këta ishin, që të tre, gjeni. Bajroni vdiq 36 vjeç. Shelli 29, Kitsi vetëm 26. A matet humbja e popullit që i humbi? Dhe humbjet e popujve janë humbjet e gjithë botës. Ata të tre bënë një art të madh në poezi.

Poezia, zakonisht, është arti që bëhet me rini. Ka dhe poetë që mbeten poetë në pleqëri. Po unë do ta marr ndryshe. Ta zëmë një minutë se Bajronit, Shellit e Kitsit do t'u ishte vakur pasioni i vargjeve. Po çfarë proze do të shkruanin ata, ata që ditën ta futnin gjuhën në ritmet e në rimat më të vështira? Populli, që i qau, për poezinë edhe mund të mos i qante, se sa lanë qe diçka e mrekullueshme. Po t'i qajë për prozën që nuk shkruan e për dramën që sapo nisën të lërojnë. «Prometeu i zgjidhur» i Shellit është një dramë që vetëm një Shekspir e shkruante. Ajo që shfaqti sot natyra dhe që u shua, mua më ngjan me atë që jeta s'i la Shellin me shokë të krijonin, — ktheu kokën mësuesi, hapi librin dhe nisi të lexonte më zë pak:

O erë e egër e Perëndimit...

I shkrova këto për kujtim të Migjenit tonë. Ai jetoi vetëm 27 vjet.

Derri në pallat

Liceu i Korçës ishte frëngjisht. Mësuesit francezë, që shërbenin aty duke nisur nga viti 1919, kur u themelua Liceu, patën qenë të çdo ngjyre politike, që nga njerëzit përparimtarë e gjer te ndonjë reaksionar. Historia e Revolucionit Francez të vitit 1789 dhe e revolucioneve që e pasuan më 30,40, gjer te Komuna e Parisit më 1871, nuk kishin se si të mos përmendeshin e të mos trajtoheshin në historinë e Francës që ne mësonim, sido që ta trajtonte këtë histori libri ose mësuesi. Nuk duhej shumë gjithashtu që ne të kuptonim se kjo Franca republikane, republikane ishte vërtet, po kishte edhe kolonitë e saj nëpër tërë botën, pra ishte po aq kolonizatore, sa edhe Anglia që ishte mbretëri. Secila kishte «perandorinë» e saj «përtej deteve», — republika si mbretëria. Rusoi vazhdonte të akuzonte po njësoj «kontratin social». Kjo shoqëri ku sundonte prifti dhe pësaniku, me një fjalë, nuk qe «më e mira shoqëri e mundshme», siç thoshte Kandidi, një personazh i tregimeve satirike të Volterit.

Një viti, kur ne bënim klasën e tretë të Liceut, — e gjashta, në të vërtetë, se zakoni ishte që klasat të numëroheshin së prap, atë vit na erdhi një mësues i ri i frëngjishtes, njëfarë Serzhani.

Zoti Serzhan qe pak si karagjoz në të parë, por i

rreptë, serioz e i zoti. I zoti, po një lloj «saltimbanku», siç e quajtëm më pas ne dhe i mbeti. Me këtë fjalë, saltimbank, francezët kuptojnë një lloj akrobati, zhongleri dhe ç'të duash përzier, edhe batakçi. Saltimbanku ynë ishte një pedagog i fortë, po, për fatin tonë të keq, shumë gjëra na i mësonte së prapthi. Me duart e tij ai çfarë nuk bënte. Ishte piktor, skulptor, marangoz, hekuraxhi, bënte kukulla si për Llazore, shporta si arinxhinjtë, poçe si poçexhinjtë, dhe çfarë të duash. Me gojën e tij ai të bardhën mund ta bënte të zezë dhe të zezën të bardhë me një gojëtarë që të mbërthente në vend, me ca lëvizje koke, sysh e duarsh, që ia kalonte aktorit më të zot. Duke ditur se Volteri pati qenë një ironik i pashoq, zoti Serzhan «provonte» se ai kishte qenë një «cinik i pashoq». Duke qenë e njohur se Rusoi pati braktisur fëmijën e tij, zoti Serzhan qante me lot për gjithë fëmijët e braktisur të botës, lëvdonte pjellën e tij dhe «familjen ideale» që ai kishte krijuar, kurse «një përbindësh Ruso» nuk kishte se ç'ti mësonte njerëzimit veçse si «të braktisë njerëzillëkun». Duke ditur se Viktor Hygoi ishte poeti i madh i Francës, zoti Serzhan orvatej të «proyonte» se ai kishte qenë «Frankejshajtaji¹⁾ i vargjeve. Për të treguar se si i famshmi dramaturg i shekullit XVII, Pjer Kornei, na qe ngritur dhe na kishte rënë në jetën e tij letrare, ekzistonte një thënie e tillë e famshme: «*Avec Atila, hola! Apres Agésilas, hélas!* — «*Me Atilën, hej! Pas Agjezilasit, medet!*» Zoti Serzhan këtë thënie e bënte: «Avek Hygo, — nignaud!» — «Të mbahesh me Hygonë, je rrotë!»

E kuptoni se në fillim ky lloj profesori tërë të papritura, po dhe me aftësira, na prishi mendjen dhe na u desh ca kohë që të psikologjisnim së fundi se me cilin kishim të bënim, ta psikologjisnin edhe kolegët e tij, mësuesit tanë: u desh e pakta një tremujor. Ndër nai-

1) Përbindësh robot i një romani fantastik të njohur të së shoqes së poetit të madh angles Shelli: u vu në ato vite në kinema dhe tmerroi botën e të vegjëlve.

vët kam qenë edhe unë, po duhet të them se dhe shoku im me besë i licëut, Hazbiu, për të cilin ju kam folur. Se ja, zoti Serzhan mori vesh nga disa përgjigje të Hazbiut në klasë se ai na qenkësh një gëlltitës i tërë një letërsie, se ai lexonte ç'i binte nëpër duar, pa ditur akoma të zgjedhë ose pa mundur, në atë det letërsie që reklamoni kapakët e librave dhe faqet e gazetave frënge. Hazbiu lexonte, për shembull, jo vetëm poetët e njohur të Francës, por edhe belgun Verhaeren, por edhe të tjerë belgë të shumtë. Kishte dëgjuar, për shembull, se konti Dë Gobino na paskësh folur mirë për Shqipërinë — gjë që s'e kishte gjetur dot se ku, — dhe kishte gëlltitur tërë tregimet e tij fantastike, kurse zoti Serzhan na qenkësh një adhurues i kontit në fjalë, sepse ky kishte pasë qenë një racist i tërbuar. Përfundimi që ky: në frëngjisht, Hazbiu merrte 18 pikë mbi 20 — të dy pikët e fundit zoti Serzhan i kishte për vete — kurse pas Hazbiut notat më të larta që u jepte nxënësve të klasës mësuesi nuk arrinin mbi 11-12. Unë e kisha të caktuar notën: merrja vetëm 11. Ky ishte një skandal dhe për Hazbiun, kur u përsërit kjo lojë tri-katër herë, që e rëndë, se kishte dhe bashkënxënës të tjerë jo më pak të zotë se ai. Zoti Serzhan nuk që një «i padrejtë ekcentrik», siç e quajti një shoku ynë, po një «saltimbank» i vërtetë, siç e quajti një tjetër dhe i mbeti.

Një ditë, mësuesi ynë aq i çuditshëm, sa dhe i pa-përmbajtshëm, në hartimin që na bënte në klasë çdo dy javë, na dha një temë kaq të çuditshme, sa dhe të poshtër, thënien e një «kritiku të madh», njëfarë Remi dë Gurmon, i cili kishte jetuar aty nga fundi i shekullit XIX. Hazbiu, kureshtar leximesh të çfarëdollojshme, se nga kishte mësuar mbi këtë zotëri se që një aristokrat ultrareaksionar, që na kishte pësuar edhe një fatkeqësi të rëndë në jetë, i kishte rënë «lupusi» i lëkurës dhe e kishte katandisur në të tillë ditë, sa i shëmtuari zotëri i lartë më nuk dilte nga shtëpia, po vetëm priste e përcillte pak miq të afërt që i adhuroni mendjen, i mëshironin fatin dhe i duronin surratin. Zoti

Serzhan na qe një nga admiruesit e atij çëçit kritiku, për të cilin na tha «se është një nga fytyrat më të ndritura të Francës», atë ditë që na dha temën e «e famshme», po pa na treguar domosdo se qe një «fytyrë» së cilës i kishte rënë «lupusi». Tema e zotit Dë Gurmon, që duhej të komentonim ne gjatë një ore, ishte kjo:

«Vini një derr në një pallat dhe do ta bëjë një haur».

E kuptueshme se derri e zhgërryen pallatin, si zhgërryen edhe tharkun e tij. Po zoti Dë Gurmon deshi të thoshte se populli në fuqi është jo një «fatkeqësi» vetëm, po pikërisht edhe një «ndyrësi». Zoti Dë Gurmon kishte qenë bashkëkohës i Komunës së Parisit dhe urrejtja e tij kafshërore për popullin Hazbiun nuk e çuditi. Unë atë urrejtje e kuptova dhe m'u vërtit gjaku. Hazbiut iu ngritën leshrat përpjetë. Na u bë se një derr na kishte depërtuar në klasën tonë, ku gjashtë vjet me radhë patëm qenë midis nesh për bukuri, me mësues që i kishim dashur. Dhe ky derr na zhgërreu «pallatin tonë».

Klasa hutoi. Nxënësit nuk dinin se ç'të shkruanin. Zoti Serzhan rrinte mbi ne si një kuçedër se mos pëshpëritnim me njëri-tjetrin. Disa, sigurisht, u inatosën, se e kuptuan thënien «e famshme», disa nuk kuptuan asgjë. Dy a tre e dorëzuan fletën e bardhë që në minutat e para. Njëri kërciti portën sa mend u thyen xhamat. Unë bëra të njëjtin gjest, kurse Hazbiu nuk lëvizi fare nga vendi. Po ky? Kjo më çuditi dhe më çuditi fort. Po Hazbiu i dha përgjigjen e duhur zotit Serzhan dhe zotit Dë Gurmon.

Mbaj mend se hartimi i tij tingëllonte pak a shumë kështu: që zoti Dë Gurmon, i thartuar nga shoqëria dhe nga fatkeqësia fizike, fliste si një qenie imorale dhe çnjerezore; se, meqë ai vetë kishte «lupusin» në turi, populli duhej ta kishte në shpirt; se ai kishte jetuar në shekullin XIX, kurse thënia e atij zotërie dy herë të

shëmtuar nuk ishte si për shekullin XX, po si për shekujt më të errët të Atilave dhe të hunëve; se nuk ishte krenari për tërësinë franceze që të numëronte ndër nxirësit e letrës edhe njëfarë kritikë me emrin e panjohur Remi de Gurmon. Dhe Hazbiu kishte cituar nga përshtatjet e fabulave të La Fontenit që ka bërë Çajupi ynë disa vargje nga ajo fabula, ku një bahçevan, të cilit iu bë havale një lepur, thirri zotërinë e tij që ta shpëtonte nga kjo e keqe: zotëria erdhi me kuaj e me zagarë, lepurin më së fundi e vrau, po se bahçen e bëri shesh dhe i ra në qafë së bijës së bahçevanit. Ja ç'është të futesh në shtëpi aristokrati, shkroi Hazbiu. Dhe e mbylli me këto fjalë: «Zoti Dë Gurmon na hyri në dhomëzën tonë të thjeshtë si një derr dhe kërkon të na zhgërryje. Po shqiptari thotë: derri do plumb!»

Kuptohet tërbimi i zotit Serzhan kur lexoi këtë hartim dhe ndonjë tejtër të ngjashëm me këtë. Ai nuk guxoi t'i vinte Hazbiut notë të pakalueshme, se ai frëngjishten e shkruante si mos më mirë, por i vuri notën 11, «për hartimin inkohorent» që kishte shkruar dhe për «cinizmin me të cilin kishte folur për fatkeqësinë fizike të njerëzve». Mua domosdo më vuri O, se s'kishë shkruar asnjë fjalë. Zotëria vuri dhe tri-katër nota 10, pastaj, tërë klasës, nota të pakalueshme dhe O për tërë ata që nuk e morën mundimin ta bëjnë detyrën.

Se si incidenti nuk u bë skandal, as unë nuk e di. Po të dy drejtorët e Liceut, francezi me shqiptarin, — ky për administratën, ai për mësimin, — i vunë çështjes kapakun dhe zotin Serzhan e këshilluan, sigurisht, që të jetë më i kujdesur me nxënësit, sepse ai nisi të tregojë tanimë i matur në klasë. Prapë Hazbiut nota e frëngjishtes i mbeti tërë atë vit 11-12, mori edhe dy-tri dhjeta dhe një ose dy herë të pakalueshme. Ky lloj tërbimi i saltimbankut nuk e tërbonte aspak Hazbiun, përkundrazi, nuk e bënte qejfin qeder.

Zakoni ishte në Lice, që, çdo tremujor, nxënësit i jepin një dëftesë me notat që kishte merituar dhe me një gjykim të përgjithshëm mbi përparimin dhe sjelljen e tij. Dëftesa i dorëzohej ose kujdestarit ose prindit të

nxënësit. Kështu që, kur i ati i Hazbiut, nëpunës i vogël në Vlorë, mori dëftesën e tij të tremujorit të dytë të vitit, dëftesë ku në gjuhën dhe në letërsinë frënge kishte rënë aq keq, me mesataren 10, iu prish gjaku. Iu prish gjaku edhe më shumë kur lexoi gjykimin që kishte dhënë për të birin drejtori francez, zoti Shëvalje:

«Nxënës i zoti, si ngaherë, por që ka dhënë shenja të një pretenciozi».

Të nesërmen, në telefon, si të shpjegohe, Hazbiu me t'anë? Ai një fjalë, i ati dhjetë. Ia kërciti telefonin në fytyrë, si dackë, dhe kushedi se ç'letër kishte për t'i dërguar. Po Hazbiu nuk e bëri të gjatë: ai nuk priti të merrte letër. Që të nesërmen në mëngjes i trokiti zotit Shëvalje në zyrë.

Zoti Shëvalje ishte një burrë ca i shkuar në moshë, me një buzëqeshje të lehtë, aq sa për të mos kaluar përtej seriozitetit të vendit të drejtorit. Ai të afronte aq sa mos të të largonte. Zotëria u çua në këmbë, siç e donte sjellja e tij e përkryer, dhe Hazbiu e pa që iu drodh njëra vetull dhe mustaqja e plotë, se e kuptoi qëllimin e vizitës së nxënësit. Hazbiu i tha afërsisht këto fjalë:

— Im atë, siç e dini, është një nëpunës i vogël, porse jo pa shkollë dhe që frëngjishten diçka e kupton. Zotëria juaj e merrni me mend shqetësimin e tij kur i ra në duar dëftesaime e tremujorit që kaloi. Unë nuk qeshë i zoti t'ia shpjegoja në telefon dhe nuk di a do të jem i zoti t'ia shpjegoj në letër. Më vjen keq shumë që vij t'ju shqetësoj. Po më vjen veçanërisht keq që të mos e di përse e kam merituar të rrëzohem në hundë e në buzë në konsideratën e zotërisë suaj, dhe më vjen keq t'ju them se unë nuk jam aspak i ndër-gjegjshëm që të kem bërë ndonjë gjest prej «pretenciozi» në shkollë ose jashtë shkollës. Më vjen shumë turp që të kem dhënë ndonjëherë një përshtypje të këtillë fatkeqe. Nuk kam qenë aspak i vetëdijshëm,

sigurisht. Prandaj edhe erdha që t'ju kërkoj ndjesë, si do t'i kërkoj ndjesë edhe babait tim, që paskam dhënë një përshtypje të këtillë. Zotëria juaj të më falni për këtë shqetësim.

Drejtori kishte një fytyrë që i vente e i vinte dhe Hazbiu e shihte se nuk i përgjigjej dot. Ai bëri me dorë një lëvizje, sikur të shuante mbi tabelën e zezë diçka që nuk e kishte shkruar mirë ose që ishte e tepërt. Hazbiu u mat të dilte me kaq, kurse drejtori tha me zë të dridhur:

— Duhet të bisedoj edhe një herë me zotën profesorin tuaj të frëngjishtes, zoti Hazbi. Babanë tuaj do ta gjej unë mënyrën se si ta qetësoj përmes një kolegut tim shqiptar vlonjat, që niset nesër për disa ditë me lejë për në qytetin tuaj.

Hazbiu mërmëriti:

— Zoti drejtor, ju falem nderit dhe më vjen keq shumë për shqetësimin që ju dhashë. Të më ndjeni, — uli kokën ai dhe doli.

Nuk e di çfarë bisede pati zoti Shëvalje me zotën Serzhan, as kolegu i tij me t'anë e Hazbiut në Vlorë, po letër shoku im nuk mori nga babai. Ai mori një telegram, ku shkruhej:

— Keqkuptimet ngjasin. Kujdes mësimet si gjithmonë. Babai dhe tërë të shtëpisë të puthin.

Zoti Serzhan ne nuk e patëm mësues më në tetorin që erdhi, kurse nota e frëngjishtes e Hazbiut u ngrit e u bë normale si pati qenë.

Po kjo histori mbaroi në të vërtetë më 8 prill 1939.

Atë ditë Hazbiu, i cili studionte filozofinë në Tuluz të Francës, u gjend në Paris, si dhe të deleguar të tjerë të shqiptarëve të atij mërgimi, për një miting të madh kundër agresionit fashist mbi Shqipërinë. Kishte qenë e nevojshme që të shkonte në legatën mynxyrë të Zogut për çështjen e një shënimi në pashaportën e tij. Kë gjen aty? Zotin Shëvalje! Ai ishte nisur që nga Perpinjani, qyteti në kufi të Francës me Spanjën, ku drejtonte një shkollë të mesme. Kishte bërë

800 e sa kilometra për të sjellë ngushëllimet e veta personalisht në përfaqësinë e qeverisë shqiptare për gjëmën që e gjeti atdheun tonë, që ai vërtet e kishte në zemër, siç e dinim në nxënësit e tij. Kur pa Hazbiun, e njohu menjëherë. Kërceu në këmbë dhe e rrëmbeu në krahë, qau me lot të nxehtë në supin e tij, duke thënë:

— Biri im i mjerë, Hazbi.

U ulën pastaj e ndezën një cigare bashkë dhe këmbyen disa fjalë urrejtoje për shkelësit e lirive të popujve. Hazbiu, duke folur për këta, me fytyrën e Zogut përballë në mur, nuk di se si e solli fjala që shtoi:

— Më shqip, zotëri, themi: «Të tërë derrat një turi kanë!»

Drejtorit i feksën sytë. Ai uli kokën e tha me një zë të vrarë:

— Ju kam bërë, zoti Hazbi, një padrejtësi dikur, padashur, po babai juaj më kuptoi dhe më vjen keq që ai keqkuptim më ngjau me një nga nxënësit që kam çmuar më shumë. Ju keni plotësisht të drejtë kur thoni atë fjalë aq të gjetur të gjuhës shqipe. Unë vetëm do të them këtë: se u plaka dhe nuk di a do të kem kaq jetë, sa të shoh të lirë Shqipërinë dhe jo vetëm të lirë, por edhe «zonjë», siç e ka dëshiruar një poet i madh, Naim Frashëri. Ëndrrat e poetëve janë realitet dhe unë kam kënaqësinë që, në pleqëri të shkuar, t'u besoj përherë Naimëve dhe Hygove.

Dhe u përqaftuan prapë e u ndanë për të mos u parë më. Nuk di të them se sa vjet jetoi akoma drejtori ynë i nderuar.

Mesjeta

Zoti Brëdel ishte një profesor i historisë mesjetare të Francës. E kemi njohur në një mënyrë të pazakonshme, në një duhantore, ku po zgjidhnim pipën e parë për Hazbiun.

Gjer atë kohë, ndonëse njëzet vjeç djalë, duhanin Hazbiu nuk e kishte vënë. Kur pa shokët e tij të universitetit se sa u shkante pipa në gojë, zuri t'i ketë zili dhe shpejt bleu një pipë dhe vuri duhanin. Desha ta imitoja dhe ai më bëri një dhuratë, por unë e lashë duhanin shpejt. Pipën e shokut e ruajta dhe e ruaj si kujtim të shtrenjtë. Me të kujtoj Hazbiun që jetën e pati të shkurtër: ai ra gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, në Brigadën V. Kujtoj shpesh kështu dhe atë ditë që blemë pipën e tij të parë dhe njohjen me profesorin Brëdel, të cilin e bëmë mik, por edhe më mik e bëri Hazbiu, i cili studioje filozofinë, ndërsa unë studioja për dentist. Ky zanat nuk më afronte sa duhej nga historia, pa le nga ajo mesjetare. Por ato që permenda i kujtoj me dëshirë.

Kisha hyrë në një duhantore bashkë me Hazbiun e me një shok tonin vendës, që i njihte pipat si mjesh-tër. Hazbiu donte një pipë të mirë, por edhe të lirë, gjëra që zor se bëhen bashkë. Për një pipë vërtet të mirë, një pipë angleze, për shembull, mund të har-

xhoje njëqind franga, një stërlinë; për një pipë të mirë franceze mjaftonin pesëdhjetë franga. Buxheti i tij ishte tërë-tërë 400 franga dhe s'i dilte as për gjysmën e muajit. Gjysmën tjetër të muajit e siguronte duke punuar si pjatolarës në një mensë popullore.

Tek jemi duke zgjedhur midis një kapice pipash të çdo lloji dhe të çmimeve modeste, hyn në dyqan një zotëri i shkurtër, me një kordele të kuqe në jakën e xhaketës. Është pra një arsimtar, me dekoratë akademike. Dhe blen një paketë me duhan dhe pipa i tymos në gojë. Ai hyri pikërisht në kohën kur shoku ynë vendës po i bënte agjitacion duhantorit e po i thoshte se këta miqtë e tij na qenë studentë të huaj, porse jo të kamur, se pipën Hazbiu sapo kishte nisur ta mësonte dhe mirë do të qe ta niste me një pipë për të qenë, por edhe sipas xhepit.

I zoti i dyqanit u bë kureshtar e na pyeti:

— Nga ju kemi zotërinë tuaj?

— Nga Shqipëria, — i thamë në.

Duhantori rrudhi krahët me keqardhje për të thënë se për Shqipërinë nuk dinte asgjë, kurse myshteriu që po dilte me pakon në dorë, u kthye menjëherë, hoqi pipën nga goja dhe iu drejtua të zotit të dyqanit me një qortim, duke i drejtuar majën e pipës në gjoks, si kobure.

— Më vjen keq, zoti Dypark, që nuk dini gjë për Shqipërinë dhe sigurisht nuk dini edhe se ku bie, duke e pasur megjithatë në Evropën tuaj dhe duke qenë Evropa kontinenti i parafundit i globit për madhësi! Ne francezët kemi luftuar në atdheun e këtyre zotërinjve, gjatë Luftës së Madhe, dhe ju ndoshta keni dëgjuar për fushatën e famshme të quajtur të Maqedonisë, që drejtoi gjenerali me emër Franshe d'Esperej.

— Për D'Esperejin kam dëgjuar dhe më bëhet se e graduan dhe mareshal përpara se të vdiste, kurse për fushatën e Maqedonisë të gjithë kemi dëgjuar, i nderuari profesor Brëdel, porse unë luftën e kam bërë me kalanë e Verdunit, — e ngriti pak zërin duhantori, duke

i ndritur sytë, duke mos e përmbajtur dot krenarinë se kishte marrë pjesë në qëndresën shumë të dëgjuar të asaj kalaje kundër gjermanëve. — Është turp ta them, — shtoi ai, — po ne francezët s'kemi qenë asnjëherë të fortë në gjeografi dhe këta zotërinj studentë nga Shqipëria, sikur t'u vinin re francezëve këtë cen, ka rrezik të bënin me turp gjysmën e bashkatdhetarëve tanë. Le të kenë pra ndjesë për mua, sidomos që u turpërova përpara një miku të çmuar si ju, dhe, sa për pipën, unë pipë më të mirë se kjo e markës Rob, franceze, që po i jap zotërisë, — i vuri ai në dorë Hazbiut një pipë të mrekullueshme, — s'kam, kurse zotëria ta pijë me shëndet e ta ketë dhuratë prej një duhantori injorant gjeografie, dhe ta dijë, siç është e vërtetë, që anglezët kanë namin për pipa, kurse pipat më të mira i bëjmë ne, edhe kur mbajnë markën e tyre.

Ne qeshëm me gjithë zemër, Hazbiu protestoi si mundi, duke dashur të paguante pipën, po duhantori jo vetëm që e detyroi ta merrte, po i vuri në dorë edhe një paketë duhan, duke thënë:

— Një klient, more mik, vlen sa një dyqan.

Sikur të bëja hesap paketat me duhan dhe pipat që ka blerë Hazbiu te zoti Dypark për disa vjet, them se do të kishte çelur një duhantore të paktën sa të tijën.

Sa për zotin Brëdel, kur u njohëm, ai deshi domosdo atë çast që unë dhe Hazbiu, bashkë me shokun tonë francez, të merrnim aperitivin¹⁾ me të në kafenenë e qoshes dhe kështu mësuam që ai e kishte bërë një pjesë të fushatës së quajtur të Maqedonisë në Shqipëri, në Devoll e në Pogradec. Dhe kur unë i tregova se mbaja mend çadëret e fundit të ushtarëve francezë që kishin qëndruar në Pogradec edhe shumë muaj pas mbarimit të luftës, na u desh të pinim edhe një aperitiv të dytë, që të zgjatej ajo bisedë e përziemërt, e cila profesorit i sillte lot në sy. Zoti Brëdel

1) Pije për të çelur oreksin.

kishte shumë simpati për Shqipërinë: ai nuk e harronte dot bujarinë shqiptare dhe fisnikërinë, kujtonte disa zakone tonat (krushqit, nusen me duvak mbi kalë, pushkët që shkrehen etj.); ai përmendi gjer kuleçët e Devollit dhe piperkat e Tushemishtit, dhe u ndamë, se na zuri dreka në kafe, po me premtimin që të shihemi tjetër herë më ngeshëm.

Për t'i bërë qejfin këtij miku të Shqipërisë, Hazbiu më shumë, unë më pak, ndoqëm ndonjë leksion të tij në universitet. Atij i bëhej qejfi mal dhe mbaj mend njëherë se dy orë të mësimit për kalorësin Bajar — një hero i njohur i Francës së kohës fill pas Skënderbeut tonë — i harxhoi më shumë për Skënderbeun, mbi të cilin na habiti se sa dinte. Studentët e tij hapnin sytë dhe nuk po kuptonin asgjë nga ky «lajthim» i profesorit, ndonëse historia e heroit të madh të një populli të vogël i tërhoqi, kurse zoti Brëdel nuk e zbuloi të vërtetën e atij këmbimi teme. U bëmë miq, pra, me zotërinë dhe nisëm ta ndjekim jo rrallë leksionin e tij, se zoti profesor ishte një erudit i talentuar, me një gojëtarë që të kujtonte historianët e lashtësisë dhe të humanizmit, njëfarë Tit Livi dhe Barleti, dhe që nga jeta e popujve përpiquej të nxirrte veçanërisht mësimë patriotizmi.

Kur vuri pipën në gojë dhe mësoi ta ndizte e ta pastronte, — një art më vete është ai i të pirit të pipës, — njëherë që kishte mbetur katër ditë pa rrojtur nga dy çibanë që i dolën në faqe, duke parë në pasqyrë veçanë e duke vënë re se kishte më shumë qime të kuqe sesa të zeza, Hazbiu tha se mjekra do t'i shkonte fort me pipën dhe la t'i rritet qimja, siç bënin plot studentë. E skaliti te berberi mjekrën dhe e bëri një «gjerdan», siç i thonë andej njëfarë mjekreje dy gisht të gjerë, që i bie rrotull fytyrës nga veshi në vesh. Dhe kishte jo vetëm shokë, por dhe shoqe studente, që i thoshin se ai «ishte mjekra më e bukur e tërë fakultetit»...

Një ditë, duke zbritur nga shtëpia ku banonim bashkë me Hazbiun, pranë lumit, te një shesh, gati tek

ura më e madhe e qytetit, takojmë zotin Brëdel. Ai mua më njohu, po hapi sytë e s'po e njihte Hazbiun, se po bëhej kohë që nuk ishin parë, që kur shoku im e pësoi nga çibanët dhe la mjekrën që iu formua mirë. Ai e përgëzoi për mjekrën, i zgjati qesen që të mbushte pipën dhe na mori për krahu duke na propozuar një shëtitje.

Kaluam urën e ramë nëpër një lagje të re, që kishte nisur të merrte formë nga ana veriore e lumit, Lagjja e re po rritej përreth një monumenti origjinal e si të huaj për ato vise, një si kishë e lartë bizantine me një kube të vetme dhe pa kambanare. I ndërtuar në bazalt të zi, monumenti dukej tepër i rëndë e i zyrtë. Ishte tetëkëndësh dhe me katër porta të gjera e të ulëta pa kanatë nga mund të hyje e të dilje lirisht, nga të katër pikat e horizontit. Mua atë monument ma kishte zënë syri disa herë që nga dritaret e dhomës ku banoja dhe, ndonëse ajo si tyrbe e murgët më çudiste në ato vise të alpeve, nuk isha interesuar të pyesja akoma se ç'qe dhe as të vete e ta shoh. Edhe Hazbiu nuk ishte interesuar fare

Profesori qëndroi përpara njërës nga portat e monumentit, në pragun e sipërm të së cilës lexohej me shkronja të zeza: **MONUMENT I TË RËNËVE NË LUFTËN 1914-1918.**

— Hyjmë? — na pyet ai dhe hymë. — S'keni qenë ndonjëherë këtu? — na pyeti prapë ai dhe Hazbiu tha: — Jo, — kurse profesori ia bëri: — Arkitekti ka pasur një ide të tillë, — dhe përdrodi buzët me njëfarë përcmimi.

Përbrenda u duk mirë tetëkëndëshi i lartë shumë, si ato xhamitë persjane, me kubënë atje në këll¹). nga buronte një dritë elektrike, që e ndriçonte vendin në mënyrë të mjaftueshme dhe, nga të tetë faqet, zgjatëshin lista të rënësh në frontet e ndryshme

1) Në majë.

të Luftës së Madhe, midis të cilave një listë, jo nga më të voglat, i përkiste Frontit të Maqedonisë. Kjo listë, e ndarë në tri degë, niste me emrin ALBANIE, nën të cilin ishin rreshtuar me germa të arta 50-60 emra, me një gjeneral në krye dhe me dy-tre nënkolonelë.

Zoti Brëdel hoqi kapelën dhe u vu në gatitu, për të nderuar «Të rënë të Francën në Ballkanin Jugor», ne mbajtëm heshtjen pranë tij e u hodhëm një sy të shpejtë emrave të të rënëve — një numër Polësh, Pjerësh, Klodësh, Rozhesh, Fransuash, etj., emra tipikë të vendit, me llagapët po kaq tipikë përbri.

Kur dolëm, zoti Brëdel na shpjegoi se ky monument u përkiste të rënëve të «departamentit» (prefekturës) dhe se çdo departament kishte një monument të tillë, por dhe çdo qendër komuneje kishte monumentin e saj të vogël, me emrat e të rënëve të saj, që ishin edhe në monumentin e përgjithshëm të krahinës. Ai na tha numrin e të vrarëve që kishte pasur ky departament prej më shumë se gjysmë milioni banorësh, — disa dhjetëra mijë të vrarë. Përmendi pastaj, i mallëngjyer, emrin e një shoku universiteti, që i ishte vrarë në Shqipëri, përkëtej Kapështicës, dhe foli për kujdesin që kishin treguar shqiptarët për t'ia gjetur trupin në disa rrëpira, ku ai ishte ndeshur befasisht me armikun.

Ne këto nuk na bënin ndonjë përshtypje dhe nuk e di nëse zoti Brëdel e vuri re. Mua diçka më ishte trazuar në tru, që donte të pëlciste dhe që më kot përpiqesha ta përmbaja, sepse druaja të mos e fyeja zotin Brëdel në ndjenjat e tij. Në një gjendje të tillë ishte dhe Hazbiu, i cili, më në fund, nuk duroi e tha:

— Lufta e Madhe i kushtoi botës dhe Francës shumë milionë nga bijtë më të mirë. Një kasaphanë, që nuk e nderon njerëzimin.

Zoti Brëdel ecte me kokën ulur. Ai tha me zë:

— Bashkohem me ju, që njeriu ka mbetur akoma ujk për njeriun. Turp!

Ai kishte nevojë të njihte luftën e klasave dhe Hazbiu kishte bërë gabim që shqiptoi fjalën «njerëzim», në vend që të shqiptonte fjalën e vërtetë, të cilën tanimë e njihte mirë. Ndërsa për «turp», — e kotë, mund t'i kishte thënë Hazbiu: për turp nuk mund të flitet kur është fjala për kapitalizëm.

Hazbiu i tha profesorit se luftërat i kushtojnë pa hesap pasurisë kombëtare, po faturat i paguan fshatari, i paguan punëtori, me vuajtje dhe me gjak. Zoti Brëdel i bëri komplimentin, duke thënë se i vinte mirë që shihte te ne «dy demokratë, sepse unë miratoja me kokë.

Hazbiu i tha:

— E vërteta është se edhe ne shqiptarët kemi vuajtur dhe e kemi paguar rëndë Fushatën tuaj «të famshme» të Maqedonisë, i respektuari profesor. Ne borxh s'jua kishim as juve as kundërshtarëve tuaj. Ne sa po krijuam shtetin tonë të lirë dhe shpëtuam nga kaq rreziqe të reja për atë shtet, gjer edhe nga copëtimi. Trashëguam nga osmanët një ekonomi të shkatërruar dhe na u shtuan shkatërrime që s'thuhën se sa na kushtuan, se na u bë vendi shesh lufte, pa na pyetur asnjëri. Nuk po zgjatem dhe të më falni që i përmenda këto tani që me zotërinë tuaj shkelëm në atë monument përkujtimesh me aq emra të vrarësh. Po pjesa më e madhe e tyre, fundi i fundit, janë viktimat, do të thosha unë.

Profesori u trondit shumë nga këto fjalë të fundit dhe ktheu kokën e e vështrroi monumentin me dhembshuri të madhe. Duke iu dridhur zëri, ai seç pëshpëriti. Ai na ndali pastaj te parmakët e urës për të vështruar ujërat e dallgëzuara e të turbullta të atij lumi, i cili i ngjiste një përroi vigan, që sapo kishte lënë lartësitë për të kaluar tërë potere midis mureve të thella, që i kishin vënë nga të dyja anët për të mbrojtur qytetin. Dhe tek ishim duke vështruar ujërat, Hazbiu vazhdoi bisedën e këputur:

— Fjalën s'e kisha tek ato të vërteta të njohura, zotëri, dhe më ndjeni se jua lëndova zemrën ndoshta. Po dihet se sa lënduese është shpesh e vërteta. Sidoqoftë, fjalën e kisha gjetiu.

— Po ju dëgjoj, — i shtrëngoi krahun profesori dhe dorën tjetër e zgjati nga treguesi i centimetruar, që shënonte lartësinë e ujërave në këndin tjetër të urës, poshtë: ujërat nuk e kishin arritur akoma pikën kritike.

— Desha t'ju ndërpresë e të them unë së pari, — foli profesori mendueshëm, — se bota po trazohet sërisht, në po atë mënyrë si njëzet e pak vjet më parë, dhe se, pas njëzet vjetësh të tjera, në mos shumë më shpejt, në këtë qendër do të kemi një monument të dytë për të rënë të një Luftë të Dytë të Madhe, ndoshta jo kaq anakronike sa ky që kemi, se edhe arkitektura ka evoluar këtë shekull, është thjeshtësuar. Listat me shkronja të arta kanë për të qenë ku ta dish sa më të gjata. Tërë morali që kam arritur të nxjerr unë, si specialist i historisë së mesjetës, zotërinj, dhe këtu më duket se takohem me mendimet që ju shprehët, zoti Hazbi, dhe që zoti Skëndo i ndan me ju, me sa kuptoj, tërë morali është se njeriu s'ka dalë akoma nga mesjeta dhe më vjen keq të them, që nuk e përfytyroj dot se kur ka për të dalë! — gati klithi ai. — Më falni që i shqiptoj këto fjalë fataliste përpara dy djemsh si ju, që vini nga një vend, ku, me sa di unë, nuk ka as hijen e një demokracie, me prapambetje të madhe akoma, ku, me sa dëgjoj, keni mbetur tek ju kam njohur dhe s'keni asnjë siguri për të ardhmen tuaj të lirë...

— ...Nëse mund ta quajmë liri atë që kemi, — e ndërpreva unë.

Ai buzëqeshi hidhur e vazhdoi:

— Ju ndoshta keni për ta arritur atë ditë, që ta shihni atë monument të dytë dëshmorësh për të cilin fola, dhe ta shihni me dhembje për një dhe më shumë shokë të dashur. Sa për mua, unë kam shpresë se nuk do të më lejojë mosha! — klithi ai prapë dhe ngri-

ti kokën e hodhi sytë nga monumenti përtej me një vështrim të dërrmuar.

Unë mendova se s'kishte më asgjë për të thënë. Ai thelbin e gjërave e njihte pak a shumë, ndonëse nuk dilte dot nga «qerthulli fatal» i botës ku jetonim. Sidoqoftë, ajo brengë e thellë që kishim përbrenda bëri të sajën dhe Hazbiu shpërtheu:

— Unë e kisha fjalën këtu, i dashuri zoti Brëdel, që për Francën nuk ranë vetëm francezët, por edhe të tjerë, dhe jo pak. Për shembull, andej nga anët tona ranë senegalezë shumë dhe indokinezë edhe më shumë. A thua se ka ndonjë monument në atë pjesë të madhe të Afrikës, që ju mbani si koloni bashkë me Gadishullin e Indokinës, ndonjë monument ku të jenë shkruar emrat e tyre me germa të arta?

Zoti Brëdel e vështroi me një shastisje të plotë dhe u mbajt fort pas krahut tim. Ai iu përgjigj:

— S'kam qenë kurrë në kolonitë. S'kam asnjë ide për këtë çështje!

— As unë s'kam ndonjë ide. — tha Hazbiu.

— Keni qenë në kolonitë? — rrudhi krahët profesori.

— Jo, jo, — vuri buzën hidhur në gaz Hazbiu. — Po ta zëmë se monumente të tilla ka dhe nëpër kolonitë, në çdo qendër prefekturë dhe komuneje. A është e vërtetë se senegalezët, vietnamezët, antilezët e sa janë ranë për atdheun e tyre, edhe pse ranë për Francën?

Profesori më rrëmbeu edhe mua krahun fort dhe nisi të ecte gati me të rendur giersa dolëm nga ura, pastaj, pas një vështrimi të tmerruar, uli kokën, u shkëput prej nesh dhe u lëshua përpara nxitimthi, përmes sheshit, përmes makinave uluritëse, aq sa gati e shtypi një tramvaj.

Hazbiu më tregonte se pas dy ditësh, në leksion, duke vështruar atë, që qëndronte në fund të sallës, profesori krijoi rastin për të përsëritur fort ato fjalë që na kishte thënë dy ditë më parë, që «ne jetonim akoma në mesjetë» dhe pyeti:

— Po vallë, a do të dalim? Dhe kur?

Një student ia bëri me zë pak:

— Duhet akoma ca kohë, po historia do të bëjë të sajën. Njerëzimi nuk është pa të ardhme.

Profesori vështroi sillën, se nuk e mori vesh se nga i erdhi ai zë. Ai heshti një çast, fërkoj fort ballin dhe sytë dhe doli prej klasës pa e mbaruar leksionin, duke kërkuar falje se qe i pamundur.

Një takim

Zoti Egrest nuk ishte i ashpër, ose i pagdhendur, siç e tregon edhe emri i tij. Ai, përkundrazi, ishte një njeri shumë i sjellë dhe delikat në ndjenjë e në të tjera. I hajthëm, pak i gjatë, po si i përkulur, me kokën pak si mënjanë, i thinjur para kohe, ai dukej përherë sikur sapo kishte hequr një sëmundje. Në zërin e tij, edhe fjalët më tingëlluese të gjuhës frëngjishte merrnin një lënim dhe bëheshin të butëza. Kur përpiquej t'i mëshonte zërit në ndonjë strofë të fortë të Viktor Hygoit, për shembull të «Fëmija grek», ai nuk ia arrinte dot me të vërtetë.

Zoti Egrest erdhi e na dha mësimin e gjuhës së tij në klasën e katërt të Liceut, ku fillonte gjerësisht mësimi i letërsisë me tragjedinë e Korneit «Sidi» dhe me komedinë e vetme, po shumë të njohur të Rasinit, «Paditësit». Stansat e famshme të Sidit tingëllonin gati si ato të së dashurës së heroit, Shimonës, në gojën e zotit Egrest, kurse «Paditësit» nuk therrnin, po merrnin një ngjyrim komik, si të një parodie pak a shumë të përmbajtur.

Mësuesi ynë i ri kishte dy pasione: gjermanishten e muzikën. Përsoste njohjen e gjermanishtes përmes metodës së të re, të quajtur «Linguafone», me një libër dhe disa pllaka gramafoni.

Zoti Egrest kishte tërë një diskotekë, gati vetëm me muzikë simfonike, posaçërisht franceze, gjermane e ruse, po ku nuk mungonin dhe veprat e kompozitorëve të mëdhenj të vendeve të tjera që nga Chopeni dhe Vjenavski, te Listi dhe Albenici, me dhjetëra të tjerë. Nëse nuk i kujtoj me qejf mësimet e letërsisë së Egrestit, që, le të qenë të mençura, nuk qenë tingëlluese, nuk mund të mos e kujtoj edhe me mirënjohje të veçantë, se, përmes diskotekës së tij, kam shtuar shumë njohjen e muzikës në rininë time të parë.

Zoti Egrest nuk bëri më shumë se një mot mësues në shkollën tonë. Vjeshtën tjetër më s'erdhi. Morëm vesh se ai tani ishte korrespondent i një gazete të madhe pariziane në Berlin. Ja përse zotëria e përsoste kaq me zell gjermanishten që dinte. Kur kam marrë vesh që ishte bërë gazetar, jam cuditur: unë gazetarët i përfytyroja njerëz shumë të shkathët, ndërsa mësuesi ynë nuk dukej i tillë, përkundrazi. Atë gazetën ku ai shkruante nuk pata rastin ta lexoia ndonjëherë dhe për mësuesin tonë të klasës së katërt më s'u mor vesh asgjë. Ai ata muaj që kaloi në Korçë thuafe nuk lidhi miqësi me kolegët e tij francezë dhe shqiptarë, të cilët pra edhe nuk e kujtonin.

Miqësi, përkundrazi, ai zuri me katër-pesë nxënës të klasës sonë, midis të cilëve Hazbiun. Kishte qejf të shëvistete me ne rrethinat e qytetit, të mësonte zakonet, t'i përkthenim këngët e vendit, që i dëgjonte me interes, të na ftonte dhe në shtëpinë ku banonte, duke na gostitur me biskota me verë — gjer edhe me shampanjë! — nga një gotë a dy, jo më shumë, dhe sidomos të na bëntë të shiionim muzikën simfonike, ta komentonte me pesë gjashtë fjalë me buzëqeshien e tij melankolike, me syrin depërtues, që sikur përpiçej të hetonte se si i kullon në shpirt muzika e një Bahu dhe Haideni, e një Shumani dhe Shuberti, e një Laloj dhe Raveli, një shqiptari që nuk ka pasur rastin ta dëgjojë atë muzikë...

Shkuan vite. Hazbiu dhe unë vajtëm të studionim në një universitet të Francës dhe Lufta e Dytë e Përbotshme na zuri atje. Kjo luftë, që nisi në shtator 1939.

për Francën, nja dhjetë muaj, gati nuk u ndie fare, veçse përmes alarmeve ajrore, që nuk pasoheshin nga ndonjë bombardim, përmes maskave antigaz, që njerëzit mbanin të varura në sup përditë. Po lajme të tmerrshme vinin nga sulmi hitlerian mbi Poloninë. Nga Shqipëria, e pushtuar në prill prej fashistëve italianë, më s'erdhi asnjë lajm. Gjersa Musolini urdhëroi sulmin mbi Greqinë dhe u bë gazi i botës me luftën e tij, po duke i sjellë Shqipërisë dëmet, që ne i merrnim me mend me shpirt të dërrmuar e me hakërrimën që nuk hakmerreshim dot. Në kufirin e tyre me Italinë, ku nuk shtihej asnjë pushkë, francezët kishin vënë të tilla pankarta tallëse: «Grekë ndal! Këtu është kufiri i Francës!» Për fat të keq, ata pastaj u bënë për të tallur vetë me disfatën që pësuan.

Një ditë, linjat Mazhino dhe Sigfrid¹⁾, në kufirin franko-gjerman u lëkundën dhe, brenda një muaji, nazistët përulanë Holandën, Belgjikën e gati dy të tretat e Francës. U nënshkrua ai armëpushimi i turpshëm i qershorit 1941, pjesa më e madhe e Francës mbeti e pushtuar nga gjermanët, në pjesën tjetër, të quajtur «Franca e Vishisë», u formua një qeveri kukull fashiste. Kjo e kishte qendrën në qytetin më të njohur të llixhave dhe të dëfrimeve të borgjezisë së madhe franceze, në Vishi, qytet që u bë qendra e tradhtisë së përbindshme, sepse që ajo borgjezi që e dorëzoi vendin duarlidhur, mund të thuhet, në duart e nazistëve teutonë²⁾, nga frika e lëvizjes së klasës punëtore, që ishte forcuar shumë në Francë, dhe për ta ndihmuar pastaj Hitlerin që të sulmonte Bashkimin Sovjetik, pasi Hitleri shtiu në dorë potencialin e madh industrial e ekonomik të Evropës, ku tani, në pjesën më të madhe, mbretëronte tradhtia e borgjezisë.

Gjatë këtyre muajve që gjermanët përgatitën fu-

1) Vija të fortifikuara fort, e para në kufirin francez dhe e dyta në kufirin gjerman.

2) Emër për feudalët gjermanë.

shatën e «Luftës rrufe» («bliz grieg») kundër Francës, propaganda, sidomos me radiostacionet, bëri një punë shumë të madhe për të përgatitur agresionin. Në radion e Stutgardit fliste një francez që kishte një gjuhë të mprehtë nëpërke, sa zor t'i gjendej për këtë shoku. Emri nuk i dihej, porse populli e quajti Tradhtari i Stutgardit. Qeveria e Parisit, këtij tradhtari, për nevojat e demagogjisë së saj, i bëri një proces në mungesë, proces që zgjati disa ditë dhe ku dëshmuar disa persona, të cilët e kishin indentifikuar prej zërit tradhtarit. Në mungesë ky u dënua me vdekje. Më tutje nuk di se si vajti kjo punë, pasi i vajti filli aq keq punës së Francës. Po mua dhe Hazbiut na erdhi shumë mirë, të them të drejtën, kur lexuam një ditë në gazetë se, midis atyre që kishin dëshmuar dhe kishin identifikuar tradhtarit e Stutgardit, kishte qenë edhe mësuesi ynë i dikurshëm, zoti Egrest. Gazetat jepnin pjesë të tëra nga dëshmia e tij dhe i thurnin lëvdata patriotizmit të «gazetarit të mirënjohur», që kishte kaluar «shumë vjet në Berlin». Ne ishim krenarë që ishte treguar trim zoti Egrest, se qe trimëri dhe jo shaka të dëshmoje atëherë në Francë, midis tradhtisë së përgjithshme të klasës dhe të qeverisë në fuqi, kundër tradhtarit të Stutgardit.

Franca e pësoi si mos më keq. Në Vishi u ngrit një regjim fashist. Terrori, sidoqoftë, ishte më i rëndë në pjesën e pushtuar nga nazistët. Shumë francezë kalonin «vijën e demarkacionit» midis të dy Francave dhe strehoheshin në Jug, sidomos ata që rrezikonin posaçërisht në Veri.

Ka qenë një ditë marsi me diell e vitit 1941. Në Shqipëri, Musolini kishte pësuar të pabesueshmen. Në Francën e Vishisë, qëndresa kishte filluar të organizohej. Studentët e huaj, të mbetur pa të ardhura, përpiqeshin të siguronin një krodhë bukë me mundime. Asaj dite të atij marsi, Hazbiu kalonte nëpër një shesh të qendrës së qytetit, me njëqind franga në xhep, që ia kishte dhënë hua një shokë algjerian, dhe shihte me lakmi derën e lokalit të madh përballë, ku mund të

pinte një kafe të mirë e pa sakarinë, ku mund të blinte nën dorë edhe pak duhan, sende që nëpër lokalet e zakonshme dhe në treg përgjithësisht, — përveç tregut të zi, — ishin zhdukur. Vendin e kafesë e kishte zënë një lloj sallate e egër, çikorja, e tharë dhe e bluar, kurse rolin e duhanit e luante sherebela apo tërfili. Në vend të patateve hanim «topinambur», një si patate e ëmbël, që thartohej pas tri ditësh që ta shkulje nga dheu.

I dhimbseshin Hazbiut frangat që kishte siguruar dhe i shtrëngonte në xhep. Nuk ishte i vendosur për kafen e vërtetë dhe as për duhanin e vërtetë që mund të shijonte atje përballë, kur, duke arritur në mes të sheshit, kë sheh? — zotin Egrest, që shullëhej, i ulur në një bankë. Nuk e gënjenin sytë aspak, sado që zoti Egrest ishte futur i tëri një një qyrk dhe në kokë mbante një kallpak¹). Ishte e njëjta fytyrë si jeshile, po ajo kokë thinjoshe e si mënjanë.

Sytë iu ndeshën të dy palëve në një largësi prej 20-25 metrash. Hazbiu e pa se zoti Egrest pati një dridhje tmerri dhe mbuloi menjëherë fytyrën me mëngë, që të mos e njihte nxënësi i tij i dikurshëm. Kurse Hazbiu iu këput sulmi që do të kishte marrë për ta shtrënguar në krahë mësuesin, siç i këputet zogut fleta në fluturim, se e lë zemra. Ai pati një dhembje të padurueshme në kraharor e në fyt.

Ndjeu Hazbiu një fyerje të tillë, që zor se e kishte ndier ndonjëherë më të rëndë në jetën e tij. Ajo frika e Egrestit prej pranisë së tij i tingëlloi si një mosbesim i tillë poshtërues, që e bëri atë çast të stepet e të ngrijë, gati të gërthasë. Tha të kthente kurrizin e të ikte, po pëlqeu më mirë t'i kalonte pranë zotit Egrest, dhe pranë fare, të shihte se si ai nuk e hiqte mëngën nga fytyra dhe të kapërcente duke llapashitur nën këpucët e tij dëborën gjysmë të shkrirë, që i spërkati Egrestit gëzofin.

Me atë inat e pështirosje u sul Hazbiu në kafene

1) Skufë e madhe lëkure.

dhe vajti u zhyt në kolltukun e këndit më të errët të lokalit. I erdhi kafeja që porositi, po iu ftoh e iu akullua, se nuk i bënte dora të merrte filxhanin e të pinte. Piu njërën pas tjetrës tri pipa plot.

Mund të kishte kaluar kështu mbi një gjysmë ore, kur nga kolltuku që ishte në shpinën e tij, dëgjoji zërin e njohur të Egrestit që i pëshpëriti:

— Ju jeni, zoti Hazbi? Ju jeni?

Ishte po ai zë i njohur, i lëmuar e delikat, po që dridhej.

Shoku im bëri sikur nuk kuptoi asgjë, i fyer në tërë qenien, në një trazirë të parrëfyeshme ndjenjash e mendimesh, habie të pështirë. Dhe nuk priti, por u çua me rrëmbim, vajti e pagoi garsonin te banaku, duke e porositur që t'i dërgonte një konjak prej tij zotërisë që kishte qëndruar atje pas kolltukut që ai la. Dhe doli.

— S'di a veprova mirë apo jo, — më tregonte Hazbiu. — Po fyerjen që më bëri, sado që ai ka të drejtë të ruhet e të druhet në këto çaste tradhtie, atë fyerje nuk ia durova! Asnjë arsye nuk mund t'i përgjigjej fyerjes që ndjeva. S'më kishte besuar! Po ishte penduar! Tepër vonë! I dhashë vetëm të kuptonte se prej meje nuk do t'i vinte asnjë e ligë. Dhe se dikujt duhet t'i besosh në këtë jetë. Një torbë kripë që zoti Egrest e ka ngrënë në Shqipëri, a ishte pak midis nesh? Si mund të shkiste ai dhe të më fryente, sado një çast, për t'u penduar pastaj? S'e di a bëra mirë, a bëra keq. Ç'do të kishe bërë ti?

Unë pohova se do të kisha bërë të njëjtën gjë, le t'i kuptoja të gjitha dhe le ta justifikoja edhe frikën e zotit Egrest. Sedra ngrinte krye e thoshte:

— Thuaj si të duash: s'më besoi me të parët!

II.

TREGIME TË TJERA

Karakaftja

Karakaftja është një lule për merak. Këtë jua kam treguar dhe tjetër herë. Zë dashuri me të në fëmijëri dhe s'të del as në pleqëri të shkuar. Atë mot që nuk dole të mbledhësh ullishtave, domethënë se ke munguar në Elbasan ose ke qenë i sëmurë. Po dikush tjetër e ka mbledhur në këmbën tënde dhe është kthyer në qytet me një tufë, ec e gostit në çdo rrugë miq e të panjohur me nga një lule dhe pi një kafe në klub me tufën erëkëndshme përpara.

Është e brishtë, e hollë dashuria për karakaften, një dashuri lulësh, e parfumuar. Është një si zambak, që mbin përmes gjerdheve e ferrave, rrëzë ullinjve e murishtave, gati fshehtazi. Është vështirë ta diktosh kërcellin e saj midis të tjerave dhe lulen e saj në bojë të kafes, që sapo del nga kupa e zambakut të gjelbër. Po është i brishtë ai parfum, nuk mban një orë, se pastaj sikur zhduket, po duke lënë sidoqoftë në kujtesë gjurmën e pranverës që sapo shkeli, kur nis të çërcërasë më me gaz mëllenja.

Kam pasur një zhgënjim të madh një viti për karakaften. Po më mirë të them se qe një zhgënjim me veten time. Se kur je njeri me pak dije për një send, mos ia vër fajin tjetërkujt veç vetes, e ca më pak një luleje. E pra, unë karakaften e kam ditur lule të Elba-

sanit, vetëm të Elbasanit me kodrinat përreth tij dhe fushës, midis Shkumbinit e Deyollit.

Një moti, në pavijonin 12 të Spitalit Nr. 1, u bashkuam dy adhurues të vjetër të karakaftes. Ai 53, unë 51 vjeç. Ai gjysh nga një vajzë e unë gjysh nga djali. Ishte mbarimi i shkurtit. Një kohë e rrallë e kishte mbushur jetën me diell, me zogj, me gjelbërim e me lule. Pishat e oborrit të spitalit, ndonëse s'kishin nisur akoma t'i përtërinin gjethet, dukeshin si të përtërirra nën atë dritë. Mblidheshin harabelat nëpër xhumat e pishave dhe bënin koncerte. Por aha! Neve s'na kishte shije gjithë ky gëzim. Po e kalonim kohën më të bukur në shtat, ai me veshkat sëmurë, unë me mëlçinë. Unë vërtetoja me mllef zemre, gati me dëshpërim, se kur nuk isha në Elbasan këso kohe, për lule, ullishtave, ku ta dish sa larg më kishte hedhur puna, ku ta dish se si më kishte mposhtur sëmundja.

Ne të dy të sëmurëve nuk na jepej të bisedonim për shqetësimin që na mundonte. E kalonim mërzinë në heshtje, në biseda gjithfarësh, larg botanikës sidomos. As rodërdendrone, as orkide, as edëllvajse dhe as lis martagone¹⁾ nuk vinin në gjuhën time. Shëtitës i vjetër i Alpeve, alpinist nga të paktit në Shqipëri, i vjerrur me litar jo vetëm për një lartësi, por edhe për një yllakulli (edëllvajs), unë shokut tim i kam shërbyer dy-tri herë për të njohur ndonjë thesar të florës. Po veshkat e mëlçia na kanë lidhur në shtat, në dhomën nr. 9 të pavijonit nr. 12, — mos trokitshi kurrë në atë adresë! — dhe na mbajnë larg prej botanikës.

Prapë, një ditë, e papritura ngjau. Një mëllenjë, s'di se si, u shkëput nga faqet e Dajtit, prej Linze ose dhe Tujani më përtej, u ngatërrua nëpër pyllin e ri të apartamenteve nën Kinostudio dhe, kureshtë pas kureshte, u shty gjer në oborrin e pavijonit nr. 12 dhe zuri të vërtitej nëpër pisha, futu në njërën e dil në tjetrën, si një sovajkë, që të endte me çerçërima pël-

1) Emra lulesh.

hurën e padukshme të kërshërisë, të këngës, por edhe të drojës ndoshta, — «si u ngatërrova, si humba kështu në këto vise të prapa, nëpër oborre dhe pisha harabelash?»

Mos 'na bënë veshët? Mëllenjë kjo? Vështruam shoqi-shoqin me një ndjenjë që nuk e fshihnim dot, sikur spitali të ishte hapur nga ullishta, ose sikur prej një mrekullie të ishte transportuar te Çezmja e Dakolit e te Rrapi i Mansit mbi Elbasan. Pranvera kishte fuqinë e një përralle, përmes një çerçërime mëllenje. Dhe si kaloi për ne ai çast mrekullimi, secili me një gjest të njëjtë ngutjeje u çua nga shtrati, veshi pallton e madhe, vuri kapelën, shtrëngoi shallin dhe doli në tarracë.

Marroçka mëllenjë kishte vënë në lëvizje gjithë shpeshërinë e vogël të oborrit. Bëhej një zhurmë që herë pas here gumëzhinte përpara nesh, kur zogjtë, me turma, si një fullim i shpejtë fërfëllimesh — fru-u, fru-u — lëshoheshin nga pisha në pishë. Laraskat e stërqokat, majë drurëve, zgjatnin sqepat e verdhë e zgurdullonin sytë. Disa strukeshin nëpër strehët e ndërtesës, ku kanë bërë foletë, nga një si frikë. Se s'janë kaq trimoshë këta zogj të mëdhenj e të zez. Më trim është shpesh një harabel e një xhixhim. Kurse një mëllenjë, që lë Dajtin e futet në Tiranë, ajo ku ta dish se çfarë qëllimesh të guxuara ka.

Ku ta dish vërtet? Me qëllim, pa qëllim, marroçka mëllenjë ishte larguar nga mali për mua dhe botanistin tim, që jo për bimë e për lule, por as për zogj s'kishim çelur fjalë ato ditë, që kishim rënë në hundë e në buzë në atë prag pranvere. Dhe ju i merrni me mend emotionet tona, shtangien tonë përpara asaj zhurmërie, që mbushte atë copëz natyrë të rrethuar nga pavijonet e një spitali.

Ndoshta dhjetë minuta, ndoshta një çerek ore, jo më shumë, zgjati kjo. Se mëllenja, e cila ia arriti qëllimit — me qëllim kishte ardhur për ne ajo gjer aty! — që na shkuli prej shtratit e prej dhomës, u zhduk shpejt, — iu zhduk zëri, se ne flatrën as që ia kishim

diktuar nëpër fletë e midis shpeshëve. Harabelat atë çast heshtën. Stërqokat mbetën me sqepin shtrirë dhe sytë të zgurdulluar. Një sorrë u ngrit e bëri lëmë përmbi pisha e pavijone, për të vëzhguar mirë se ç'po ngjet, për të kuptuar. Unë e shoku mblodhëm qafën nëpër shalle dhe hymë e zumë shtratin prapë.

Unë s'durova më, po, si thuhet, e çava heshtjen:

— Po na kaloi kjo kohë pa një karakafte, more shok! U pa se ia çatisi pleqëria. Kemi për t'i munguar tani disa herë lulet.

Shoku më pa me një dhembshuri të vërtetë. Ai më kot u përpoq të buzëqeshte. Heshti e pastaj tha:

— Ne, — tha, — gjer aty nga mesi i marsit jemi këtu, me sa kuptoj unë prej këtyre mjekëve, që fshehin çdo gjë, po që s'janë të zotë të fshehin asgjë. Pjesa e dytë e marsit, po u freskua dhe pak moti, si ka nisur këto dy-tri ditë, ka për të qenë me karakafte plot. Në mos pastë më Elbasani, të çoj unë në Lushnjë a në Berat dhe gjejmë lule sa të duash, që ta nxjerrësh mallin për sivjet e për vitin që vjen.

— Si?! Si?! — gati gërthita unë dhe shoku 'u tremb. — Si?

— Si çfarë? — bëri çudi shumë ai nga ky shpërthim.

— Ç'duan në Lushnië karakaftet e gjer në Berat? — ia pata unë po aq fort.

— Si ç'duan? — mërmërti ai, se iu mek zëri nga habia.

— Ç'duan? — pyeta unë tri herë më i habitur e me një theks pezmatimi, sikur të mos pyesja e të mos pezmatohesha, po të qortoja.

— Si ç'duan? — u hutua fare ai.

— Por a s'janë të Elbasanit karakaftet?

— Janë.

— Po atëherë ç'na thua, kur janë të Elbasanit? — gati sa s'kërceva nga shtrati unë.

— Them atë që është. — u dreitua shoku në shtrat. — Do të vemi t'i mbledhim në Lushnië ose në Berat. Mund t'i mbledhim në Himarë e Sarandë, po ka për të qenë tepër vonë, se janë vise më të ngrohta

andej. Mund t'i mbledhim edhe në Krujë e në Lag, që i kemi këtu më pranë, po duhen kërkuar, ndërsa andej nga Lushnja e Berati njoh disa kënde ku mbijnë shumë dhe mbajnë gjer vonë.

— Jo po!... Jo po, përse të mos hedhim edhe detin? — ia pata unë.

— E të dalim në Maltë! — m'u kthye fort ai. — Të kapërcejmë në Tunizi dhe Algjeri! Të hedhim jo Adriatikun, po Mesdheun. Shqipëria, more shok, s'ka një kënd, po një brez me karakafte rreth Bregdetit të saj, në viset kodrinore dhe, që në janar, mund t'i mbledhësh në viset e saj më të ngrohta e të Mesdheut, more botanist i lajthitur.

Kisha rënë si prej «kulmit qielluar», si thotë një poet. Më ishte bërë copë përtokë ai i lules së ullishtës sonë përfaqë Elbasanit. Ishte thërrmuar poezia e atij kërcelli luleje. S'i thashë vetes asgjë, s'i bëra vërejtje për këtë ndjenjë monopolizuese, gati përvetësuese, të një sendi të bukur, që, po të mos ishte karakaftja elbasanase, më mirë të mos ishte fare. Kurse shoku im, botanist i profesionit, sado i lidhur edhe ai ngushtë me atë ndjenjë e me atë poezi për një lule, e kishte atë ndjenjë e poezi të gjerë sa brezat vetë ku mbinte karakaftja, përkëtej e përandej Mesdheut. Ai ma tha edhe latinisht emrin e lules.

E pyes shokun me tërë pezmin:

— Të vërteta janë këto?

Ai shkulet në gaz.

— Si, more, po?

— Po! Do të vemë ta mbledhim lulen gjer në Berat, po të kesh kohë, vemë e kërkojmë edhe në Krujë. Do ta kërkujmë në kodrinat e Qytetit Stalin, po nuk besoj ta kenë lënë të gjallë gazet e naftës.

Gazet e naftës! Karakafte s'duhet të ketë pasur ai vend. Nuk i besova shokut për asgjë dhe ai e pa se kundërshtimi im s'i bëri ballë. Po të nesërmen, nga herbariumi i katedrës së botanikës së universitetit, ku shoku jep mësim, na erdhi tërë një koleksion karakafte të mbledhura nëpër Shqipëri, që nga Laçi në

Sarandë. Elbasani ishte vetëm një pikë në hartën e përhapjes së lules. Ishte e qartë dhe rashë në toka!). Thua se kisha për ta mbledhur atë lule në mars, megjithatë? Thua se do ta pritja me qejf ditën që ta mblidhja në Lushnjë e në Berat? Dÿshoja.

Në Berat kishte pasur karakafte të mrekullueshme. Në Qytetin Stalin nuk patëm kohë të kërkojmë...

Ikën disa vjet. Unë nuk mungova në prag të pranverës në ullishtën e Elbasanit. Po njëfarë pezmi më trazoi përherë me ndjenjën e vjetër të dashurisë për lulen. Diçka e cenonte poezinë e parë. Një viti më transferuan mësuës në tetëvjeçaren e Rubikut të Mirditës, ku bëra katër vjet midis minatorëve dhe punëtorëve të bakrit. U vendosa në një fjetore majë kodrinave, përmbi uzinën e vjetër të shkrirjes, përmbi minierë. M'u desh të mësohem t'i ngop mushkëritë me erën e sqfurit që përhapnin oxhakët e fonderisë, të më zërë gjumi me atë erë. Të rroj pastaj midis një natyre shkëmbore, të zhveshur e të përhirë. Ku thua se kishte kapërcyer njëherë zjarri i konvertit²⁾ të bakrit dhe e kishte djegur përngaherë bimësinë me të një mijë gradët e tij. Gati asnjë pishë më, asnjë dëllinjë, që ai vend i kishte pasur me shumicë, sado shkëmbor, 30-40 vjet më parë, kur nisi punën uzina. Asnjë dru ulliri ose ullastër, në një rreze prej një a dy kilometrash. Grahmat e sqfurit, në kohë lagështire, kthehen në acid sulfurik përmbi gjethe e drurë dhe e përcëllojnë bimësinë. Ajo pjesë kodrash e Rubikut ishte bërë një vend i zhuritur e i zharitur. S'ma kishte ënda t'i shëtitja në fillim kodrat, po prapë nisa të dilia nëpër to. se çdo vend ka jetën e tij interesante, edhe shkëmbi i shpëlarë ose i përcëlluar.

Kur asaj vjeshte dhe atij dimri të parë që kalova në Rubik bënte ditë me diell, në orën që isha i lirë, vetëm ose me ndonjë shok, endesha nëpër shkëmbinjtë,

1) Erdha në vete.

2) Kazan i madh gize dhe tullash, ku shkrin e pastrohet minerali.

soditja nga larg jetën e uzinës e të lumit nën të dhe më vinte keq që nuk isha botanist, se puna e parë që do të bëja, ishte të studioja mundësinë e pyllëzimit të atyre kodrave të shkretuara nga acidi, të paktën me ndonjë shkurre të fortë, që të mund t'i bënte ballë sqfurit. Lëmashqet¹⁾ e barishtet që mbinin aty, vendin s'e gjallëronin veçse pak fare. Po botanist nuk isha. Çuditësha, por më kot, me ndonjë pishë të rrëgjuar ose me ndonjë dëllinjë të spërdredhur, që kishte mundur t'i qëndronte sulmit të sqfurit, duke e mbajtur shpirtin me stërmundime të parrëfyeshme. S'e shpjegoja dot. Prapë kjo më ushqente mendimin se ai vend mund të pyllëzohej dhe e pata ngritur këtë çështje edhe në shkollë, që të bënim një aksion me nxënësit, po nuk siguroam dot një lloj pishë e dëllinje. Kjo do të bëhej ndonjë ditë, pa dyshim.

Erdhi pranvera te pragu. Ajo grykë Fani, e acartë në dimër, pranverën e ka të vonë. Po kur vjen. vjen me guxim. Çfarë pranvere e bukur që çatisi! Barishtet që mbinin nëpër atë kënd të zhuritur ku banoja, më duke-shin si diçka e jashtëzakonshme me bukurinë e tyre, me atë fije gjelbërim, me fletë e gjethe pak, me ndonjë lule të rrallë. Gazet e sqfurit e sulmonin të 24 orët pranverën dhe ajo vinte se vinte, me sakrifica, kuptohet, por e pandalshme.

Një ditë kisha dalë si përherë dhe isha ulur te një shkëmb. Lumi ishte egërsuar asaj jave. Maleve kishte rënë shi dhe shkrija e dëborërave kishte marrë me forcë përpara. Fani ishte përplot, i kuqërremtë, i tallazuar, i shkumëzuar, e gati sa nuk po depërtonte në pllajat e hedhurinave të gurit të keq e të mineralit, që janë krijuar nën minierë e nën uzinë. Uji kërcënonte kantieret. Insekte gjithfarësh lëvrinin nëpër barishte, zhapinj shullëshin nëpër gurë. Ishin zgjuar nga gjumi milingonat dhe kishin krijuar rrjetin e tyre rrugor. Nëpër të cilin, pa mbaruar mirë dimri, kishin nisur të furnizoheshin

1) Myshqet.

foletë me zahire për dimrin tjetër. Nisa të ndjek me sy ato rrugica, që më çuan rrëzë shkëmbit përballë, të cilin e përçarkonin, për të vijuar më tej. U çova dhe vajta të ndjek tragën. Çfarë goditjeje! Te rrëza e atij shkëmbi, nga ana tjetër, me kërcellin e lulen të hedhur në diell, — dy karakafte! Më bënë sytë?! Dy karakafte të plota, sikur të kishin dalë nga tuli i ullishtës dhe për mua vetëm, aty, midis shkëmbinjve dhe nën grahmat e squfurit! Si është e mundur? Është e mundur, po!

Nuk i këputa lulet. Kërkova nëpër shkëmbinj dhe s'gjeta të tjera. Këputa vetëm një, si një trofe, që t'ua tregoja shokëve të shkollës dhe të kantierëve. Dhe ai pezmi që dini, — që kjo lule nuk qenka vetëm e ullishtës sonë, — as që u zgjua fare tek unë. Atë e mbuloi tani admirimi për bimësinë e rrallë që i qëndronte squfurit që e sulmonte. E brishta karakafte! Ajo kishte qenë e një force të patregueshme.

Kur ia kam treguar këtë shokut tim botanist, ai u bind se kishte për ta gjetur lulen edhe më në veri, dhe vajti e e gjeti. Kjo ishte me interes për përhapjen gjeografike të gjinisë së karakafte. Po këto janë çështje të shkencës. Interesi për mua që se, kur një karakafte i qëndron acidit të squfurit, bimë të tjera më të mëdha do t'i qëndrojnë patjetër dhe vendi mbi uzinat ka për t'u pyllëzuar patjetër.

Mbaj mend megjithatë se i thashë shokut:

— Brishtësia dhe forca s'janë vetëm të përkundërta, por edhe të pajtueshme, — dhe mbaj mend që ai të më ketë thënë:

— Këtë e vërteton tërë jeta e natyrës dhe e njeriut.

Letër që nga fundi i dynjasë

Tasi do të nisej për kurbet. E kishte herën e dytë. Herën e parë nuk bëri prokopi. Amerika desh e hëngri të gjallë. Punoi nëpër minierat e qymyrgurit dy vjet me radhë, plasi njëherë një grizu¹⁾, prej së cilës gjetën vdekjen njëqind e ca vetë, ai bëri nja katër muaj nëpër spitale dhe doli teknefez²⁾. I dhanë një shpërblim për fatkeqësinë — 250 dollarë — i këshilluan klimë të mirë, të paktën për nja një mot, dhe, i pazoti si ishte tani për punë, me gjysmat e të hollave pagoi navllon³⁾ dhe gjysmat e tjera i solli në Sinicë. Klimë të mirë ka kjo rrëzë pishe. Tasit iu desh të punojë tani përsëri mbi tokë aq sa kishte punuar nën tokë. Sidoqoftë, klima e rregulloi, shëndeti i mori për mbarë. Veçse varfëria nuk iu nda. Varfëria si për të gjithë, edhe për atë, ata vjet nuk bënte prapa, po përpara. Me shëndetin që i erdhi, Tasi mund ta merrte dhe një herë udhën e kurbetit. Këtë radhë do ta kapërcente oqeanin në drejtim tjetër, do të merrte një rrugë shumë të largët — të Australisë. Në Australi, bashkëfshatarët e tij që kishin

1) Gaz helmues.

2) Asmatik.

3) Bileta e udhëtimit.

vajtur, tregonin se punonin pyjeve, druvarë, qymyrxhinj, dhe Tasi ia dinte edhe drurit edhe qymyrit. Vendosi pra të nisej dhe la rehen¹⁾ shtëpinë për të paguar navllon.

Ato ditë, përpara se të nisej, erdhën e përshëndoshën shumë nga ata që kishin djemtë e tyre në Australi. Natën e fundit pati për darkë të dy motrat e martuara dhe dajon. Darka vajti vonë, njerëzia u shpërndanë, Tasi mbeti me Agllainë te rrëzë e vatrës. Ajo më në fund i shtrëngoi llërën me të dy duart e u mbështet pas tij. Burri kujtoi se e zuri gjumi, i përkëdheli kokën gruas dhe ndenji zgjuar, se nuk i mbylleshin sytë.

Në vatër digjeshin kërcunjtë e fundit. Përjashta frynte një nga ato erërat e ngrohta të pranverës që shkrijnë dëborën maleve. Përroi gurgullonte gazmor. Matanë vatrës flinte çupka e tij, bashkë me të vëllanë e saj, ky i lindur tre vjet përpara se Tasi të merrte udhën e parë të kurbetit, ajo e lindur atë motin e parë që punonte nëpër galeritë e qymyrgurit të Amerikës. Të dy, të mbuluar me një velenxë, ku ishin përzier tërë leshrat e kërruteve dhe të kobeshave²⁾ që ai kishte, — shtatë krerë, të të shtatë ngjyrave, «si të ylberit», e kishte zakon të qeshte Agllaia që e pati endur velenxën.

Po sonte burri kishte një pikëllim të madh tek vështronte atë velenxë, ku binte drita e vatrës, që nuk arrinte ta ndriçonte. Ç'i kishte mbërthyer Tasi sytë mbi mbulojën, nën të cilën flinin ngrohtë fëmijët? Mos sepse të vegjlit kishin futur kokat brenda, ndaj s'i shihte e donte t'i shohë, që t'u nxirrte mallin mirë kësaj nate të fundit? Pas sa vjetësh kishte për t'i parë Tasi të dy fëmijët e tij? Këtë radhë ai s'kishte për t'u nisur për dy vjet. Për dy vjet s'dilte hesapi. Pa dhjetë vjet zor se kthehej. Djaln kishte për ta gjetur goxha burrë, vazhën grua për t'u martuar, në mos të martuar e me fëmijë.

Tasi vështronte velenxën dhe ndiente ftohtë. Agllaia,

1) Peng.

2) Emra dhish.

e mbështetur pas tij, nuk kishte zënë dot të ngrohtë akoma. Ajo nuk flinte, po, nëpër mugëtirë, edhe gruaja velenxën shikonte. Sytë e të dyve bashkoheshin mbi atë mbulojë dhe asnjëri, megjithatë, nuk mendonte më të ardhmen e tyre dhe të fëmijëve që kishin, po te velenxa.

Rruga është e gjatë gjer në Australi. Do të kalosh kaq dete. Janë vise të ngrohta përtej deteve tona, u kishin thënë Tasi e Agllaisë, po rrugë e gjatë, pastaj edhe shira shumë. Një gunë është e domosdoshme. Kur vajti burri së pari në kurbet, ai mori edhe gunën e tij me vete. E vjetër guna, po shpirt o gunë, — edhe ta shtrosh, edhe të mbulohesh majë vaporëve, kur nuk të del të paguash kabinën, po do të flesh në qiellin, dhe qielli, kur ka mëshirë, ka, po kur s'ka, tërbohet mbi të shkretin udhëtar. Guna e tij e vjetër Tasi i shërbeu jo vetëm udhës, por edhe në Amerikë, për shtrojë e për mbulojë. Atje e grisi Tasi gunën. Dhe që atëherë na kishte mbetur pa gunë. Me se të nisej, si të nisej pa gunë gjer në fund të dynjasë?

Vështronte Tasi velenxën, me të cilën ishin mbulluar fëmijët, dhe i dukej e bukur, e bukur fort velenxa e ngrohtë pa hesap, me leshin e kërruteve dhe të kobeshave të tij përzier. Mendja ia thoshte, po zemra prapë nuk ia desh: ajo mbulojë mund ta kishte bërë punën mirë, mund t'ia kishte zënë vendin gunës.

Agllaia vështronte velenxën, ndiente se i qenë akulluar këmbët e gati sa nuk dridhej. Si do të bënin fëmijët pa velenxë?

«Gjë që s'bëhet!» — i thoshte vetes Tasi.

«I gjori Tasi! — shtrëngohej Agllaia pas të shoqit, sikur të desh t'i jepte të ngrohtë për tërë atë udhëtim të gjatë. — Të gjorët fëmijë!»

Përjashta frynte ajo era që shkrinte dëborën në male. Thana e tyre ishte gati në të çelur te mezhda. Edhe kumbullës i kishin dirsur sumbullat e para nëpër degë. Përroi gurgullonte gazmor. Në fushë tregonin se ishin dukur dallëndyshtet.

«Po ngrohet moti», mendoi Tasi, që t'i thoshte ve-

tes se bënte edhe pa gunë, le të ishte i gjatë sa të desh udhëtimi. Pastaj, pjesa më e madhe e udhës ishte nëpër vise të nxehta.

Agllaisë iu bë sikur të kishte aguar dhe iu dëgjuan cicërima si të një dallëndysheje, po as aguar kishte, as cicërima dëgjoheshin. Ai udhëtim ishte i gjatë, gjer në fund të dynjasë, dhe një gunë duhet, në mos për të ftohtin e për shiun, për shtrujë e për mbulojë udhës. Por edhe atje ku Tasi do të soste, do të punonte pyjeve. Si bëhej pa gunë?

Fëmijët flinin e nuk ndiheshin. Tasi vështronte velenxën e pandehte se e shoqja flinte. E shoqja vështronte velenxën dhe pandehte se Tasi i kishte mbyllur sytë. Ai, i mbështetur pas gurit të vatrës, ajo e mbështetur pas tij. Dhe këndesi i parë këndoi. Përjashta po agonte. Për një orë, i kunati i madh do të vinte me dy mushka dhe Tasi do të nisej me të. Kunati do ta përcillte deri në Kapshticë. Tasi do ta bënte në këmbë udhën gjer në Follorinë. Nga Follorina mernte trenin, nga Selaniku vaporin dhe mirupafshim fundi i dynjasë — Australi.

— Është udhë e gjatë, — rënkoi Agallia.

— Australi i thonë, — ia bëri Tasi. — Po merak të mos kesh. Unë jam kthyer edhe me mushkëri të vulosura. Do të punoj e do t'ju mbaj mirë. Ti amanet fëmijët.

Gruaja mbyti ofshamën dhe hëngri lotët.

— Fëmijët do të rriten dhe ti do t'i mbash mirë, — tha ajo. — Po e kisha fjalën te rruga: është rrugë e gjatë shumë.

— Australi, — përsëriti i shoqi.

— Dimër akoma, — tha ajo.

Ai deshi të thoshte se po vinte behari, po heshti.

— Dimri ka qenë i thatë, — tha gruaja. — Do të ketë shira.

— Edhe andej? Ku ta dish, — i tha i shoqi.

— Andej janë pyje, — tha ajo.

Ai prapë heshti.

— Sikur të marrësh velenxën, more Tasi?

Ai nuk foli dot.

— Doemos që duhet ta marrësh, — livizi gruaja.

— Erdhi behari, moj Agllai, — tha i shoqi.

Jashtë u dëgjuan zilet e mushkave dhe kunati trokiti në portë.

Ata bënë një copë rrugë bashkë gjer përtej fshatit. Gruaja tërhoqte përpara mushkat, fëmijët koloviteshin e qeshnin mbi to. Tasi me të kunatin këmbenin cigare pas cigareje para tyre. Tasi thoshte:

— Erdhi behari.

I kunati vërente:

— Do kemi shira.

Tasi përqafoi gruan e puthi fëmijët. Agllaia hoqi torbën që kishte hedhur mbi njëren mushkë dhe fërkoj velenxën që kishte shtruar mbi samar. Ia solli torbën të shoqit, e hapi që të sigurohej a kishte vënë ç'duhej në të.

— Nja dy ndërresa dhe një kulaçë, ca djathë e një ftua me dy-tri mollë, — tha ajo, — e vari prapë torbën në samar dhe i mbajti mushkën të shoqit që të hipte.

Ai u lëshua e puthi dhe një herë fëmijët, i vuri dorën së shoqes mbi kokë dhe ia shtrëngoi pak, i kërcëu mushkës lart e u nis.

— Kujdes shëndetin, — e porositi ajo dhe burrat mbi mushka u zhdukën pas një kodre.

Fëmijët qanin me lebeti, ajo qante pa zë.

Tasi arriti në Australinë e largët. Ai u qahej përherë shokëve se nuk dëgjonte dot zë fëmije e zile mushke, pa kujtuar djalin e çupën që i la pa velenxë. Me të dalë Shëndreu, e dërgoi velenxën në shtëpi pas një fshatari që u kthye. Dërgoi ca dhurata të vogla dhe një dorë të holla. Pastaj më nuk dërgoi asgjë. Moti s'ishte mbushur, kur ata morën nga një kompani pyjore e Australisë 30 lira dhe një fletë të madhe ngushëllimi.

«Anastas Llambro Sinica ka qenë punëtor i mirë, — thoshte fleta, — po vullneti i perëndisë që i tillë. Perëndia qoftë me ju.»

Kuqina

Kuqina ishte lopa jonë. Vetëm atë kishim e asnjë kokë dele e asnjë dhi. Pasuri tjetër kishim nja katër rrënjë ullinj në një brinjë dhe nja dy-tri fiq te shtëpia. Bënim edhe ndonjë qase misër në një gropë, të cilën e quanim arë e i thoshim, nuk e di përse, Ara e Gomares. Një dynym.

Kuqina s'ishte ndoshta pasuria jonë më e madhe, po më e shtrenjta sigurisht. Ajo na njomte gojën me një lugë dhallë e na lezetonte qullin me një majë luge gjalpë. Djathin e saj e hanim dhe, për ne, djathi me ullinj të ishin gjellët kryesore.

Kuqina ishte një lopë e kuqe, siç e tregon emri. Ishte e madhe në krahasim me shoqet e fshatit dhe, për madhësinë e saj, kishte edhe emër në fshat: «Si Kuqina e Sinës së Kotes», thoshin. Sina ishte nëna ime, Kote më quanin babanë, që, kur isha unë akoma në djep, mori udhën e kurbetit /e u zhduk përtej deteve pa anë, ca thoshin në Amerikë, ca në Australi. E ku t'i dish hallet e kurbetçiu dhe kushedi se ç'fund pati i ziu Kote!

Kotja iku e na la me një lopë e me një viçë. Viçja ishte e kuqe dhe ia vumë emrin Kuqinë. Lopën e shiti nëna për bukë, viçen e ruajti. Ajo u rrit e u bë një nga shtyllat e shtëpisë.

Ishte një lopë e mirë dhe e urtë. Ne kalamanët na donte shumë, se e kullotnim brinjave, ne ia mblihdhim lendet e dushkut, që i shijonin fort, ne ia sillnim shportat me mollë e dadhë të rëna, që s'na i kursenin fqinjët, i mblihdhim edhe bërsi nëpër mullinjte e vajit të fshatit, e po ne e çonim në përrua të pinte ujë. E donim ne Kuqinën pra, jo vetëm sepse na njomte fytin me dhallë e na mbushte qypin me djathë, po se ishte një kafshë e urtë, që dhe ajo na donte shumë. Po të sëmurej ndonjëri prej nesh e Kuqina të mos e shihte ca ditë midis të tjerëve, në sytë e saj të mëdhenj ajo vinte hall. Të paktën ne kështu na dukej. Pastaj, si të mos e donim aq fort Kuqinën? Ajo na sillte nga vit gëzimin tonë të madh të vitit — një viç. Viçi bëhej shoku ynë me besë, ndonëse çdo pranverë, kur Kuqina pillte viçin e ri, nëna e shiste mëzatin a mëzoren dhe ne, me gëzimin e madh të të voglit që lindte, përzierim helmin e të madhit, që kushedi ç'fat kishte: në një tufë, në një zgjedhë, te një kasap a ku ta dinim ne.

Kuqina ishte një lopë e urtë, po që e kishte edhe një huq: nuk pajtohej dot me mushkat. Mbase e kishte pësuar ndonjëherë nga një mushkë a, ku ta dish, i kishte kuptuar ato xanxare, që ta ruajnë ditën e ta futin shqelmin. Dhe Kuqina, në vend që të hante ajo e para shqelmin, po të shihte mushkë pranë, i futej me brirë. I kishte plagosur Kuqina jonë nja dy mushka në fshat, prandaj dhe nëna një ditë mori një sharrë e ia preu brirët.

E, sa jemi mjeruar ne për ata brirë, që i kishte të mëdhenj e të bukur e aq trimërorë! U bë Kuqina një shytë e shëmtuar, me dy rrënjë brirësh të prerë si mos më keq, dhe nisën brirët përbrenda t'i zënë edhe krimba. Kështu që një nga kujdeset tona tani ishte që t'i qëronim Kuqinës krimbat e brirëve, se nuk duromin dot ta shihnim me ta.

Nëna e kishte plagë të madhe që ia preu brirët Kuqinës, po ç'ti bënte fshatit? Edhe fshatit i erdhi keq për brirët e Kuqinës sonë, — ata farë brirësh! — po fshatit i vinte edhe më keq për mushkat e tij, le

të ishin mushkat e fshatit tonë xanxaret e xanxareve, që patën bërë kaq pabesi me shqelmat e tyre, në bagëti dhe më shumë në njerëz.

Erdhi një ditë që dhe Kuçina u plak dhe ne s'e shitëm viçin e saj, po e ruajtëm e e bëmë lopë, që të na mbante me dhallë e me djathë, si na pati mbajtur e ëma. Kuçinën mund ta kishim shitur. Mishin e saj do të ishte gjetur ndonjë kasap që ta tregtonte. Mund ta kishim therur edhe për vete, të bënim pastërmanë e një dimri, t'i jepnim edhe botës. Po as e therëm, as e shitëm. E mbajtëm në katuan tonë, e kullotëm brinjave si dhe më parë, i mblodhëm si dhe më parë lende, mollë e dardhë të rëna, bërsi e ç'i duhej. Ajo qumësht më s'na jepte dot e as viçin s'e bënte më, po na falte dashurinë që na pati falur, ashtu në mënyrën e saj, si një lopë e urtë.

Tani Kuçina filloi e humbi edhe sytë. I zunë sytë perde dhe, sa më shumë shkonte, më pak shihte. Nisi të përplasej gjerdheve, të mos gjente dot rrugën e të mos gjente as portën e katoit. E lidhnim me një litar dhe e tërhiqnim, që të mos dëmtohej, dhe na vinte keq për të, sikur ta kishim gjyshen e shtëpisë.

Një mëngjesi e gjetëm që kishte dhënë frymën në katua. Ne të vegjlit qamë, nëna mbajti lotët, dy fqinjë na ndihmuan me një tezgë të madhe e e futëm lopën në një gropë, që e çeli nëna jo larg shtëpisë, atje te brinja, nën një shqopë. Ishte prill e shqopa kishte lulëzuar shpat më shpat. Fqinji ynë, xha Spiroja, na tha t'i rripnim lëkurën, se ishim keq për opinga e mund të zinim edhe një dorë lekë, po nëna dhe ne nuk dëgjuam. E mbuluam Kuçinën atje te shqopa me lule.

Nishani im i parë

— Sa vjeç je, more bir? — më pyeti xha Ligori.

— Nëntë thotë nëna, — iu përgjigja unë.

— Epo, që kur thotë nëna nëntë, nëntë je.

Xha Ligori më pyeti ashtu papritur për moshën që kisha dhe që ai duhej ta dinte. Kjo më bëri dhe nuk më bëri përshtypje. Xha Ligori ishte njeri me të papritura dhe veprimet e tij nuk më çuditnin as mua që isha i vogël. Për shembull, si e kishte marrë vesh xha Ligori ose, të paktën, si e mori vesh ai atë ditë, që unë do të kisha dashur të shkoja për gjah me të? Unë s'ia kisha thënë dhe askush s'e dinte dëshirën time. Po ja që, kur xha Ligori kaloi atje përtej shtëpisë sonë dhe pa se unë nxora kokën që nën një fik të madh, si prej një ushe¹⁾, ku të isha fshehur, ai sesi më vështroi e më foli:

— Shkoj për gjah, o çuni i adashit²⁾ (edhe babanë tim Ligor e quanin). Verdhashët janë sa dy turtuj një në këtë vakt fiqsh. Mos ruan verdhashin në atë ushe ti?

Unë, i çuditur dhe tërë qejf se më foli xha Ligori,

1) Vend ku fshihet gjahtari.

2) Njerëz që kanë të njëjtin emër.

zgjatja kokën nëpër fletë dhe më dukej se nuk shihja adashin e tim eti, po tufa me verdhashë, tek vërtiteshin nëpër qiell e vinin e binin kurora e breza të artë përreth takijes së xha Ligorit e përreth çiftes që kishte në krah.

Ai më pyeti:

— Ke parë çifte ndonjëherë, more bir?

Unë çifte kisha parë, po s'më dukej se e dija se ç'është tamam një çifte, që kur s'kisha prekur çifte me dorë e s'kisha parë çifte të godasë. Im atë për gjahtarët kishte një paragjykim të rëndë: i quante hajërsëzë, edhe adashin e tij, Ligorin. Di ja se me çiften venë për gjah — për verdhashë, për turtuj, për rosa. Ky fshati ynë, pranë detit, nga këta shpendë ka shumë.

Xha Ligori më vështroi me keqardhje, se nuk munda t'i përgjigjem, e më tha:

— Hajt të të tregoj xhaxhai ty ç'është një çifte, një çifte që ka vajtur më shpesh për gjah se stomna për ujë; çifte që thonë se ma kanë sjellë nga jashtë, po që e kam bërë vetë. Pa eja ta shohësh, more bir.

Unë zgjata kokën nëpër fletët e fikut, sikur të kërkoja ashtu të arrija e ta shihja çiften nga pranë. Xha Ligori hoqi armën prej suoit e e mbajti pezull në dorë: ai u çapit nga unë me hapin e vet të njohur, se calonte pak nga të dy anët e nuk dukej sikur ecte, po sikur lëkundej, si një direk i gjatë mbi një varkë të padukur, përmes kumit të rrugëve tona. Unë e zgjata edhe më shumë kokën. Xha Ligori u afrua kaq shpejt, sa nuk e pritja, dhe, frap më zuri veshin, sikur të kisha qenë një lepur i ngrirë në ferrë, që sheh grykën e çiftes e s'bën dot këmbë.

Frikë s'kisha, po ç'ishte kjo armë, të cilën xha Ligori thosh se e kishte bërë vetë? Sigurisht vetë e kishte bërë xha Ligori çiften, se çfarë s'dinte të bënte ai! Shtëpinë ku rrinte, e kishte bërë vetë. Elektrikun që kishte futur në shtëpi, e kishte bërë vetë. Traktorin e parë që erdhi në fshatin tonë (unë isha në sisë atëherë) tregonin se, kur u prish një ditë, e ndreqi xha Ligori. Ai kishte thënë: «Si puna e sahatit janë

këto maqina», kishte përveshur llërët dhe e kishte lënë traktoristin me gisht në gojë. Vetë e kishte bërë xha Ligori edhe sahatin që mbante varur te xhepi i xhaketës. Edhe xhaketën që vishte. Edhe çibukun, me të cilin pinte duhan e që tregonin se ishte prej një druri të panjohur, që vetëm me abanozin¹⁾ mund të krahasohej për i fortë e i bukur. Duhanin që pinte, doemos që e bënte vetë, si gjithë bota, po për gjithë botën nuk thoshin si për duhanin e tij, «duhan nga i xha Ligorit të Kozit». E çfarë s'bënte vetë xha Ligori? Ja, edhe çiften vetë e paska bërë! Doemos.

Xha Ligori më nxori që nga fiku, duke më tërhequr prej veshi, u ul në hije, më mori pranë, seç lojti nëpër çiften e tij dhe ajo më t'u zbërthye në sytë e mi si prej çudie — tyta veç, qyta veç, çarqet më tjetër anë — në kushedi sa copë. Xha Ligori m'i tregonte ato copë një e nga një, sikur të desh të vërtetonte se ishin pjesët e armës që kishte pasur në duar dhe që, si prej çudie, ishte zbërthyer në të tillë mënyrë të shpejtë. Dhe menjëherë, që të më linte fare pa mend, ai i mbërtheu pjesët me kaq shpejtësi e siguri, sa unë nuk e kuptova fare se si me ato pjesë u bë prapë një çifte e bukur, së cilës tani i vura re se xha Ligori i kishte gdhendur mbi kondak tërë zogjtë e gjahut që njihen në anët tona, që nga mëllenja e thëllëza, gjer te shaptorja e pata.

— E, more çuni i adashit, e pe? — më pyeti xha Ligori dhe ma vuri çiften në prehër.

Unë ndjeva armën mbi kofshët e mia dhe sikur më preku një gjë, që do të bënte tani ndonjë mrekulli mbi mua, do të më këmbente nga djalë të vogël shkolle, në gjahtar të madh. Lashë mendtë pas bukurisë së pushkës, së cilës i shkëlqente tyta dyshe dhe çarqet i qëndronin të ngrehur, gati të shkrepnin për të më përshëndetur mua.

1) Lloj druri i çmuar.

— Pushkë e bukur, — tha xha Ligori.

Unë s'thashë asgjë, po me majën e gishtave preka zogjtë, me kujdes të madh se mos fluturonin e iknin që nga qyta.

— Po thuaj një fjalë, more çuni i adashit. Ti s'thënke asnjë fjalë! Apo ke qejf të vish për gjah me mua? Tani verdhashët janë një sa për dy turtuj. Atje përfundi mezhdave të Koçit, tek ata fiqtë krecë¹⁾, e kam ngritur ushen. S'ma ke parë? Do vish? — më pëshpëriti ai dhe më shkeli syrin.

Nuk di a qeshë unë që u përgjigja «po», apo ishin zogjtë e qytës së çiftes. Xha Ligori më zuri krahun, vu-ri pushkën në dorën tjetër dhe u nisëm, unë këtej, çiftja andej, Ligori i Kozit në mes.

Unë e kisha mbushur me fiq këmishën e shtatit. Xha Ligorit sigurisht që i kishte rënë në sy, se fiqtë ma frynin këmishën përmbi bark. Hidhte ndonjë vështrim anash, po dorën s'ma lëshonte, dhe ecte. Unë shihja vetëm verdhashë e më dukej sikur kënga e tyre vinte që nga mezhdat e Koçit që nga krecët.

— Përse s'na jep një fik, more çun? — ma lëshoi dorën xha Ligori.

M'u duk se një tufë verdhashësh rrahën fletët e më zgjuan. Futa të dy duart në këmishë e ia zgjata xha Ligorit plot.

— Ti ditke t'i zgjedhësh fiqtë, — hapi ai sytë, i kënaqur, zuri një me majën e gishtave, e futi të tërin në gojë, u përtyp dy-tri herë dhe pashë fikthin e tij që u rrit dyfish kur u përcoll.

Xha Ligori zuri edhe një tjetër fik me majën e gishtave dhe, përpara se ta zhdukte edhe atë në gojë, më shkeli syrin.

— Ti ditke t'i zgjedhësh fiqtë më mirë se verdhashët, — më tha, — po kujdes, se ka roje këtej, ka bri-

1) Lloj fiku, që, kur piqet, i merr të krisura lëkura.

gadierë të prapë, — hodhi ai çiften në sup e zuri të m'i hiqte fiqtë nga duart një nga një, sikur të lozte gurmacesh, hiq këtu e fut në gojë.

— Janë nga fiqtë e shtëpisë sime, — mërmërita unë.

Ai bëri me kokë se i njihte dhe qeshi. Dhe tamam kur përcolli fikun e fundit që që më pyeti «Sa vjeç je, more bir?» dhe unë iu përgjigja «Nëntë thotë nëna» e ai tha «Që kur thotë nëna nëntë, nëntë je».

Në atë kohë po afroheshim te mezhdat e Koçit përmbi det. Një fërfëllimë fletësh u dëgjua, xha Ligori qëndroi në vend e më mbërtheu krahun, duke pëshpëritur:

— Verdhashët!

Unë hapa sytë, po nuk pashë asgjë. Nuk zgjati dhe kënga e verdhashit, «fu-fu», nisi të dëgjohej që nga një fik.

— Bukur këndon qerratai! — tha xha Ligori, duke mos lëvizur nga vendi e duke mos ma lëshuar krahun.

Dhe ashtu, siç e kishte zakon ai, më bëri të papriturën e madhe, kur më pyeti:

— Ke qejf të shtiesh, more çuni i adashit?

Në kam qejf të shtie? Sikur më mbeti zemra. Dësh të pyesja veten në kam apo s'kam qejf të shtie, kur xha Ligori hoqi çiften prej krahut dhe ma vuri në duar. Unë shtrëngova çiften ashtu si munda, ai ma rregulloi armën për të marrë nishan. Në qiell po fluturonte një re e hollë e e gjatë, si një pendë pate. Tytat e çiftes vinin në nishan pendën. Xha Ligori më thoshte:

— S'ka asnjë vështirësi. Majë fikut të mesit, ja atij fikut, që ka çukën më të lartë, kam lidhur verdhashin femër, fugën, të balsamosur. Ti do ecësh lehtë-lehtë, që të mos ndihesh, me çiften larë, e do marrësh nishan të balsamosurën. Po dëgjove se vërtiten verdhashë pranë saj, hiq këtë këmbëz, hiq edhe këtë tjetrën, ama shpejt, pa marrë frymë, dhe shih kur të këputen verdhashët e të bien në këmbët e tua. Kaq marifet ka: u bëre gjahtar! Kështu kam gjuajtur edhe unë për të parën herë,

dhe nëntë vjeç u bëra gjahtar. Duhanin e kam vënë që në sisë. Kur pinte duhan gjyshi, bënej duman kasollja. Ti duhan të mos pish, po për gjah të shkosh. Pa më trego si vihet në nishan. Hé, bravo!

Unë i tregova, po s'm'u duk se e drejtoja pushkën mirë, se dhe penda e patës ishte bërë në qieli si një fjollë e hapët fare, që sa mezi dallohej. Prapë xha Ligori thoshte se nuk qe nevoja t'i shihja verdhashët, po mjaft që do të dëgjoja se qenë mbi kokën time dhe të shtija me drejtim nga fuga e balsamosur. Ata, domosdo do t'i vritja. Ata vërtiteshin rreth femrës, që xha Ligori e kishte lidhur në çukën më të lartë të atij kreci.

— Ec, — më shtyu xha Ligori, — dhe dora t'u bëftë... — shqiptoi ai një fjalë, që unë s'po e shqiptoj, po që ishte e kundërta e një urimi, se gjahtarët, siç e kam mësuar më pas, e kanë për ters t'i urosh.

Nuk e di se si, po ja, tani, që po afrohesha te fiqtë, ashtu si papandehur dhe si kot, më hipi një frikë. Do të bënte çiftja bam edhe bam! Desha të mbyllja veshët. Jo vetëm që isha akoma i vogël e s'kisha shtënë me pushkë kurrë, po s'më kishte qëlluar të jem ndonjëherë pranë një njeriu që shtie. Si të shtija unë tani vetë? Kisha frikë. Më vinte turp nga vetja. Nisa të ecja pa kujdes e me zhurmë nëpër shkurret e pastaj nëpër fiqtë, edhe pse më sëmbonte keq gisht i madh i këmbës, ku më kishte hyrë një ferrë e tërë, si një lule që të ma kishte thithur gishtin në gojën e saj të bukur e të verdhë. Mos më kishte futur sqepin e tij në gisht ndonjë verdhash, i cili nuk donte që unë të shtija mbi shokët e tij, donte të më trembte ose të merrte hakun për shokët fatzez?

Kënga nisi të dëgjohej përsëri që nga vendi ku kishte qëndruar xha Ligori, unë ecja e bëja zhurmë përmes fiqve, kërkoja me sy degën e lartë, ku ishte femra e balsamosur, po s'e gjeja. Më dukej sikur, nëpër degët e fiqve, verdhashët lëviznin e fluturonin duke u tallur me mua, kurse unë kisha frikë të shtija, të dëgjoja çiften të më buçiste dy herë te veshi, bam edhe bam.

Vërtet verdhashët lëviznin e fluturonin përmbi kokën time si të shkujdesur fare e mospërfillës. Nisa t'i trembja, si trembin pulat, «ish! ish!», po me zë pak, që të mos më dëgjonte xha Ligori. Verdhashët s'e çanin kokën fare për mua, po lëviznin e fluturonin nëpër degët e fiqve. Verdhash ishte ai që bënte fu-fu përmbi kokën time, apo këndonte atje përtej xha Ligori dhe mua më bëhej sikur më këndonte verdhashi përmbi çaçkë?

Ja edhe dega e lartë e fikut më të lartë. Dhe në majë, femra e balsamosur, që xha Ligori e ka lidhur majë degës. Ja, në degë, pesëmbëdhjetë-njëzet fiq, që varin kokat e tyre të rënduara nga mjalti. Po verdhashë nuk shoh. «Shyqyr!» bëj me vete dhe lëviz krahun e godas me tytën e çiftes një degë të madhe. Atëherë, lart, rreth e rrotull fugës së balsamosur, u bë një zhurmë fletësh e një lëvizje e shpejtë gjethesh: m'u bë se u fanepsën krahë të artë, që u zhdukën dhe dëgjova xha Ligorin që bërtiti:

— Mos, more tutkun!

Kisha shpëtuar! S'qeshë i detyruar më të shtie. Verdhashët u trembën dhe çanë e ikën. Nga dega e lartë e fikut ranë pesë a gjashtë burmat¹⁾, unë lashë çiftet për tokë, mblodha burmat dhe xha Ligori, kur erdhi, duke më parë që kafshoja i kënaqur njëren prej tyre, ia shkrepri të qeshurit e tha, duke më tundur kokën me të dy duart:

— Mor i uruar, mor i uruar!

Pastaj ai vetë shkundi me tërë forcën nja dy degë të fikut e mblodhi e nisi të hante me shije të madhe burmat që ranë.

— Pate frikë, — ia bëri duke ngrënë e duke rrotulluar sytë, që i hapte fort.

Unë s'foli.

— Ç'është ajo frikë, more çuni i adashit? Ti duhet

1) Fiq të pjekur shumë në degë.

të bëhesh një nishanxhi i zoti. Unë gjahtar u bëra kur isha sa ti. Pyeta nënën atëherë sa vjeç jam e më tha nëna «nëntë». Pa eja me mua. Merre çiften, djalë.

I turpëruar, por edhe me drojë, unë ngrita çiften e i vajta xha Ligorit pas. Kur dolëm nga inqte te një rrip are, ai hoqi takijen nga koka dhe e vari në një degë. Pashë atëherë jo vetëm sytë e tij të veckël që më zhbironin, duke u përpjekur të më ledhatonin, por edhe kokën e tij, të cilën s'e kisha vënë re tjetër herë e që kishte formën e një fiku shëngjinas, pak si shumë të shtypur përsipër, një kokë tullace, që ndrinte nën diell e që ishte e djersitur.

— Pa eja këtu, — më mori xha Ligori prej krahu dhe qëndruam si nja njëzet metra përtej takijes. — Tani, — tha ai, — ti do vësh në nishan takijen time. Dhe të mos mbyllësh as sytë, as veshët, po të bëhesh trim e kapedan, kapedani i xhaxhait. Ja kështu të vësh në nishan, — u përkul ai dhe zgjati e drejtoi qafën horizontalisht, dhe mbështeti tytën e çiftes mbi zverkun e tij. — Kështu, more trim.

Ai kishte një qafë çuditërisht të gjatë, nga ato që ne u themi qafë rosaku, tërë rrudha. Qafa e tendosur nuk u çrrudh. Çiftja qëndronte shesh përmbi qafën e xha Ligorit dhe ishte drejtuar kaq mirë nga takija e varur te dega e fikut, sa unë, kur vura në nishan takijen, m'u duk se e kisha tamam në grykën e pushkës. Takija ishte e bardhë, po, midis fletëve të fikut, ajo më dukej si një zog i madh e i verdhë, i cili fërfëllonte nëpër fletët e pemës, duke ndukur ndonjë burmë me sqepin që s'i dukej.

— Fu-fu! Fu-fu! — nisi të bënte si verdhash xha Ligori. — Fu-Fu! Shtjer, more çuni i adashit tim të dashur!

Unë vura në nishan, mbylla njërin sy, tërhoqa në sekondë njërin dhe tjetrën këmbëz të çiftes, dega e fikut përballë u trondit, fletët lëvizën e u përplasën midis tyre, takija, si një zog, u duk të përpëlente krahët dhe e pashë që ra përtokë si një gjë që po jepte shpirt.

— Bravo! — bërtiti xha Ligori, hoqi tytën e çiftes nga zverku dhe rendi e ngriti takijen.

Unë nuk guxova të rend pas tij. Zemra më rrihte fort. Kisha qelluar! Të kërciturat e pushkës sikur s'i kisha dëgjuar fare, po kisha parë takijen të bjerë për-tokë, si një verdhash që jep shpirt duke përpëlitur fletët.

— Pa shih, — ma tregoi takijen, që erdhi e ma solli shpejt xha Ligori.

Ajo ishte shpuar nga kushedi sa saçma.

Ky ka qenë nishani im i parë.

Nëna dhe armët

Nëna kishte marrë torbën e kishte zbritur në qytet. Jo për të blerë ndonjë gjë, po se kishte ca mallëngjime. Mori edhe një pulë me vete e ca vezë. E bija mendoi se do t'i shiste për t'u sjellë ndonjë gjë fëmijëve. I tha njëherë se rrugën e kishin dëmtuar shirat dhe prapa kamionit do të troshitej keq. Pastaj, përse të merrte edhe pulën e vezët?

— Po ia shpie Marigosë, moj bijë, — tha plaka. — U bënë muaj që s'e kam parë. Po edhe për Marigonë s'nishesha këtë radhë. Dua të vete në kala. Kur çelën atë muze, unë s'vajta dot, se kishim Benkën të sëmurë. Tani duhet të vete. As ti nuk ke vajtur dot.

E bija uli kokën.

— Të shkoj unë këtë javë, ti shko javës tjetër. Fëmijët shyqyr tani i ke mirë, — tha plaka dhe u nis.

Kamioni nuk u ngjiti në qytet, po vazhdoi rrugën për më tutje. Nëna zbriti e mori të përpjetën më këmbë.

«Ndryshoi dhe Gjirokastra jonë, — u kënaq ajo me vete. — Pa shih ç'qenka bërë këtej këta tre vjet që unë s'kam zbritur nga fshati. Bukuri e madhe».

Ajo nuk vajti së pari te Marigoja, po mori të përpjetën e pazarit e pastaj të kalasë, me torbën në krah e me pulën në dorë.

Te porta e kalasë, roja e pyeti:

— Sa e mban atë pulë, moj nëne?

— Nuk e shes, — u turpërua plaka, që kishte harruar se kishte ardhur me gjithë pulë. — Ia kam sjell sime kushërire, Marigosë.

— Marigo s'kemi këtu në kala, moj nëne, — tha roja duke mbajtur gazin.

— Mos më turpëro, more bir, — i tha plaka. — Marigoja e ka shtëpinë majë Dunavatit. Unë këtu kam ardhur, se e keni bërë kalanë muze. Apo jam gabim?

— Muze e kemi bërë, — tha roja. — Dhe çfarë muzeu! Muze të armëve. Armë nga tërë kohërat, që nga ilirët e gjer te partizanët. Edhe të shokut Enver këtu i kemi.

— Dua t'i shoh ato armë, — tha plaka. — Në të Enverit të më shpiesh sefte, se ka qenë ai në fshatrat tona, pa ka ardhur e ka fjetur në shtëpi tek unë, e ma ka përcjellë plaku gjer përtej maleve. Vallë a do t'ia njoh armët?

— Ai ka mbajtur armë shumë, — tha roja.

— Im shoq një të Turqisë mbante. E kemi akoma në shtëpi atë dyfek. Djali mbante një revole të Italisë, një beretë, si ia thoshin. Ishte revolva e aksionit të parë që bënë andej nga krahina jonë djemtë, e kishte mbajtur një derro oficer fashist që përtej detit. Im bir e vrau.

— Po revolen, nuk e ruan në shtëpi? — pyeti roja me interes të madh.

— E ruani ju këtu, more bir, me armët e shokëve të tjerë.

Roja u skuq e u turbullua. Nëna e vuri re. Ajo i zuri krahun e i tha:

— Vjen e më tregon armët tani, se kam frikë mos ngatërrohem në tërë këtë kala?

— Do vijë një shoqe që kemi për këtë punë, — i tha roja. — Po këtë pulë, të më falësh, moj nënë, ma jep mua ta vë aty në një vend të sigurt. Në të dalë, e merr prapë. Mirë?

— Si të jetë urdhri, more bir, — i la plaka pulën në dorë. — Të lë edhe torbën?

— Lëre, — i tha roja. — Ja edhe Vera na erdhi. Kjo është Vera, që shoqëron vizitorët nëpër muze, — i tha ai dhe nëna e puthi vajzën në të dy faqet.

— Të më tregosh ato të Enverit njëherë, pastaj të djalit, — e shtrëngoi pas vetes plaka. — Pastaj e di ti ç'të më tregosh. Po ta fillojmë që andej.

— Nga të duash e fillojmë, moj nënë, — tha Vera. — Vemi drejt e në vend, shohim së pari ato që do ti, pastaj i marrim të tjerat me radhë.

— Kështu, t'u bëfsha, — i zuri plaka krahun vajzës e nuk ia lëshoi më.

— Po djalit, si ia thoshin emrin? — pyeti shoqëruesja.

— Pavlo, Pavlo Landoni.

— I vrarë në çlirimin e Tiranës.

— Ashtu, të keqen. Atje ia kemi dhe varrin. Po armët ia kemi këtu. Atje varri, këtu armët, — i shtrëngoi krahun fort e me dorën tjetër i përkëdheli vajzës faqen.

— Ka qenë trim, — tha roja.

— E kush qe partizan e s'qe trim, more bir? Ishe partizan ti?

Roja tregoi krahun e majtë, ku i varej mënga.

— Trimi i nënës! — u përgjërua plaka. — Të më ndjesh, oë s'më ra në sy.

— Shkojmë, — tha vajza dhe u fut nëpër korridoret e larta e të ftohta të kalasë, ku topat nxirrnin grykat e tyre, oë ndritnin nën neon.

— Tërë këta topa kanë zënë djemtë tanë! — çuditej plaka.

— Djemtë dhe vajzat. — tha Vera dhe qeshi.

— U, ç'u turpërova dhe me ty, moj bijë! Po vetëm fshati vnë i ka dy dëshmore, moj. Njëherë ia thoshin emrin Verë, si dhe ty, tjetrës Anë. Trime vajza, diem të vërtetë. Pesë gjermanë shtriu Ana, pa e dha xhanin. Ç'tona fërë këta, moj bijë!

— Këta janë si për mostër këtu, — shpjegoi shoqëruesja. — Partizanët nuk zunë kaq pak,

— E marr vesh, — tha plaka.

Ato ngjitën shkallë pas shkallësh e dolën në një sallë të madhe të mbushur nga të katër anët me armë, mbi mure e nëpër vitrina. Plaka qëndroi te dera dhe shikonte, i mbante fort krahun vajzës e sikur dridhej.

— Armët e Pavllos i kemi atje, — tregoi Vera me dorë diku nga e majta. — Të shokut Enver, ja ku janë, — tregoi ajo në mes të sallës, atje te muri përkundrejt, ku ishte një arkë prej xhami.

Plaka i lëshoi krahun. Ajo u drejtua nga arka dhe ecte e sikur lëkundej pak e s'i bënin këmbët mirë, hapte duart anash e shtrëngonte grushtet.

— Ja dhe armët e tij! — tha me zë. — Kjo pushkë ka qenë! Këtë e kujtoj unë. Edhe këto këpucë i mbaj mend, — i pa ajo me radhë objektet dhe, sa herë që fliste, kthente kokën nga vajza, sikur të desh të dëgjonte mendimin e saj, se me të vërtetë ashtu ishte, me atë pushkë e me ato këpucë kishte qenë shoku Enver në shtëpi të saj apo jo?

Vajza ishte shumë e emocionuar e përpiquej t'i buzëqeshte. Plaka tha:

— E mbaj mend mirë, kur Sotiri e mori këtë pushkë, që e kishte varur në mbrëmje te muri, doli me të në dorë, moj bijë, si e do zakoni, kaluan pragun, kaluan edhe portën jashtë e im shoq ia dha pushkën të zot e i tha: «T'u bëftë pushka top, more vëlla, e të na urdhërosh prapë, se njerëz jemi e mall kemi.» E di ç'i tha ai? «Mali me mal nuk piqet, se njeriu me njeriun piqet.» Dhe prapë u takuan, një herë këtu në Gjirokastër, një herë në Tiranë. Në Tiranë e kam takuar edhe unë, se kam qenë në kongres të gruas dhe unë, kur isha ca më e re, dhe ai erdhi në kongres. I thashë: «Jam nëna e Pavllo Landonit, more Enver.» «Ti Persefoni je? Po të njoh, moj, fare mirë. — m'u hodh në qafë ai. — Sotiri a mbahet si ti?» S'na kishte harruar! — tha plaka. — Kur u ktheva në fshat, i tregova burrit. Qau burri. Burrë Sotiri, po qan. I thashë: «Kam një mendie, more Sotir. Ti ç'thua?» «Të dëgioj.» — tha ai. «Atë beretën e Pavllos, që na e solli komisari i tij pas Çlirimit, dua t'ia shpiem Enverit, ta ketë kujtim

nga ne të dy dhe nga djali vetë. Ti ç'thua?» «Ç'të them unë, moj Persefoni? Ti e the. Po e marr revolen nesër e po e shpie në Komitet të Partisë në Gjirokastër. Më mirë se ata të Komitetit, kush e mbaron këtë porosi!» «Ashtu të bësh», — i thashë dhe ai të nesërmen mori armën e e shpuri. Dhe ju tani e keni revolen këtu. Se e ruajti Enveri dhe me porosi të tij e kanë vënë këtu, me të shokëve. Po ti, moj bijë, po qan! Hajde, trime e nënës, hajde! Pa shih mua, moj, qaj unë? Pa m'i mbaj ata lot, se të kam çupë, — e përqafoi ajo vajzën. — Kështu de, më rrofsh. Tani më trego armën e djalit.

Armën e tij e kishin vendosur në një arkë tjetër me xham, ku s'kishte vetëm një beretë, po diça. Nëna u turbullua një çast dhe zemra iu trazua në gji. Tha se do të rrëzohej. Do të mos e njihte, vallë, revolen e djalit? Sytë nuk i bënë t'i lexonte etiketat? Po dhe nuk donte t'ia tregonte armën shoqëruesja, së cilës i shtrëngonte krahun fort. Vajza e kuptoi dhe heshti. Nëna e mblodhi veten. Ajo i vështroi revolet me radhë. Te njëra i mbetën sytë, se në dorezë kishte një krisë, të cilën ajo e njohu. Ishte revolja e tij! tha:

— Pa ma merr këtë këtu, moj Verë.

Vajza nxori armën, nëna e mori, e vërtiti nëpër duar, e vuri te faqja, e vuri te buza, iu gëzua si një fëmijë, duke ngritur herë pas here sytë nga Vera, sikur të donte t'i thoshte: «Mos ma vër re, moj bijë, është e tij, e njoha midis shoqeve, nuk lajthita.» E shtriu revolen me të dyja duart, ia vuri vajzës në buzë, kjo e puthi, e puthi dhe një herë nëna vetë revolen, e futi në arkë. shtyu me kujdes xhamin e tha:

— Trimi i nënës!

Kaq tha, pastaj u kthye, mbuloi sallën anembanë me një vështrim e foli:

— Ama armë u kemi marrë qenërve! Ja dhe flamurët që u kemi zënë. Tani të m'i tregosh me radhë armët, dëgiove, moj bijë? Edhe ato të ilirianëve të m'i tregosh. Keni edhe shpatën e Skënderbeut ju këtu, kam dëgjuar. Edhe atë dua ta shoh. Pa më jep dorën, moj Verë e nënës.

Kumbullat e zerdelitë

Verës, babai e kishte zakon të bënte domosdo gjumin e drekës. Dhe jo vetëm babai, por e gjithë shtëpia: vëllai i madh, motrat, nëna. Të gjithë i bindeshin urdhrin të pashkruar të usta Gjergjit. Edhe gjyshja.

Shtëpia binte në një qetësi të plotë, ku mund të dëgjoje edhe mizën. Po te dhoma Milloshi i vogël, me të motrën edhe më të vogël, qëllonte të mos mbyllnin sy.

Në mos ishte një përrallë, që ua ngacmonte mendjen dhe që, njëri ose tjetra, e tregonte nën zë — ishte një merimangë. Një merimangë e madhe, me këmbët e saj si fije floku, që del nga ndonjë kënd i panjohur i sergjeneve¹⁾ të errëta, si nga një kënd përralle.

Nëna në këndin e saj nuk dëgjohet, as motrat këtu përbri. Gjyshja mbi nim gërhet ndopak, sa për të mos u zgjuar babai, i cili fle në kuzhinë, bashkë me djalin e madh. Merimanga në tavanin e bardhë ecën, ndalet, ecën, ndalet, kokëtatëpjetë, dhe s'ka frikë aspak se bie e thyen qafën.

Shtëpia e tyre kishte merimanga plot, «e vjetër shtatë palë qyqesh», siç thoshte babai. Pastronte nëna,

1) Vendi ku vihen enët e kuzhinës.

pastronin motrat, po me fshesë e me sukulla¹⁾ në duar, merimangat dilnin, njëra më e çuditshme se tjetra, të mëdha e si të vizatuara me laps; si ato vizatimet që bënte vëllai në shkollë, si pilivesa — veç pa krahë — shpesh edhe të trasha, me ca këmbë të shkurtra, si teze Dhespa përtej murit të avllisë.

Kur mungonte mbi tavanin merimanga, nxitonte atje, kokëtatëpjetë gjithashtu, ndonjë zhapi i shkathët, që nuk gjuante veç miza me gjuhëzën e tij si gjilpërë, po ndoshta edhe merimanga.

Milloshi nuk i duronte as merimangën, as zhapiun. Ata ishin për të një botë përherë në lëvizje, përherë në përgjim, në të cilën merimanga gjuante miza dhe zhapiu miza dhe merimanga.

I shoqi i teze Dhespës, Ristoja, si një zhapi i madh, nuk gjuante merimanga, po derra. Ai sillte shpesh nga një derr që kishte vrrarë fushës, tek dëmtonte misrat. Dhe babai i thoshte:

— Të lumtë dora e të lumtë krahu, o fqinjë, se mirë thonë që derri do plumb.

E mishi i thiut të egër me një gotë verë përpara, është mezja e mezeve.

Milloshi jo vetëm i ritregonte përrallat e gjyshes, por ai ritregonte edhe përrallat që krijonte vetë, për derra të egër, ndërsa për merimanga jo, as për zhapij.

As për kumbullën e për zerdelinë e teze Dhespës nuk kishte arritur Milloshi të krijonte ndonjë përrallë.

Kumbulla ishte një kumbull gjatore, që i piqte kokrrat përmbi murin e avllisë. Edhe zerdelia. Dhe të dyja të larta, sa dy herë muri.

Kumbulla i bënte së pari kokrrat jeshile e që shndritnin nën diell. pastaj kokrrat merrnin një bojë qielli të errët e më të errët, — si ajo vera e zezë që pinte babai, — përherë e më të shndritshme nën diell, gjersa, kur piqeshin e bëheshin si zaje, rëndonin degët që

1) Rroba, thesi me të cilin pastrohen dyshemetë.

vareshin e mend thyheshin. E veç kur kokrrat shkëputeshin prej degëve dhe goditnin tokën, — tok!

Zerdelite ishin edhe ato të gjelbra së pari — pemët të gjitha jeshile dhe të gjelbra qenkëshin sa pa pjekur — pastaj ato zverdheshin e bëheshin si mandarinat, që babai i sillte ndonjëherë në shtëpi, të bukura, si topa të artë, si doçkat e motrës së vogël, pa edhe të forta zerdelitë, sa nuk shkëputeshin prej degës kurrë, veç t'i lëkundte ndonjë erë e marrë.

Kur piqeshin kumbullat e bëheshin gati për të rënë, Milloshin me gjithë motërzën gjumi më s'i zinte për drekë. Përrallat edhe të vënë në gjumë, qoftë kur i tregon Milloshi e fle motra, qoftë kur i tregon motra e fle Milloshi. Po kumbullat të lënë pa gjumë. Ato veç kur bien, — tok! Dhe fëmijëve u bën zemra ting! Tok!

Sa kohë do që të bjerë kumbulla e dytë pas së parës dhe e treta pas së dytës? Nganjëherë ajo mund të presë gjersa të ngrihet babai e ti të kesh leje të lësh shtrojen e të nxjerrësh kokën te dritarja e të vështrosh se ç'që ajo kumbull që ra — ndonjë për të qenë, apo ndonjë dështake — dhe të kthehesh të shtrihesh, sa kohë që babai s'të ka bërë zë që t'i shpiesh kutinë e duhanit.

Ka raste kur bien dy kumbulla, njëra fill pas tjetrës, — tok-tok! Dhe ka raste kur bien edhe dy e dy të tjera bashkë, — tok-tok! Tok-tok!

Hoho dy! Hoho dhe dy!

Dhe zemra atje përbrenda nuk të godet, po të troket, si ai sahati me zile mbi oxhak, që zgjon babanë në të gdhirë, për të çelur dyqanin, — tik-tik! Tik-tik! Tik-tik! shpejt e fort.

Kumbullat bien e ti përgjon si bien e ta bën zemra ting! apo tik-tik! fort. Atëherë, nëpër oborr, ndihet një si fëshfërimë.

— Mitri! — pëshpërit motra e vogël.

Dhe tërë këto, si në përrallë¹⁾.

1) Ky tregim e merr temën nga jeta e Migjenit.

Midis zogjve

- Baba Riti, dua të shoh zogjtë.
— Çfarë zogjsh, more Genc?
— Zogjtë atje te rruga.
— Po ja, shihi. Ata atje janë harabela. I sheh si lozin? Ja dhe laraskat...
— Laraskat janë të zeza, baba. Unë dua zogjtë e bukur, atje te rruga te lodrat.
— Mirë, hajt të vemi.
As «te rruga, te lodrat» s'ka zogj të tjerë veç harabelave dhe laraskave. Mos do pulëbardhat vogëlushi?
— Ti do zogjtë e bardhë, more Genc. Ata s'janë këtu, po në det.
— Nuk dua të bardhët. Të verdhët dua. Unë e di ku janë. Vemi?
— Vemi.
Ata kaluan një copë rrugë. Rruga kishte qenë mbushur me harabela. Edhe plepat ishin plot, po të voglin nuk e interesuan aspak gjithë ata zogj lodërtarë.
Laraskat venin qiellit truma-truma, çakërdiseshin nëpër ajër tërë klithma. I vogli nuk deshi t'ia dinte as për laraskat.
Një pulëbardhë ishte shkëputur nga deti. Gjyshi qëndroi dhe e shihte se si fluturonte lart, midis plepave, si ndonjë aeroplan që do të zbriste përmbi xhade.

Por i nipi as që e ngrinte kokën përplotë. Ai thërriste me padurim:

— Baba Riti, hajde, se do të të shtypë makina.

Makinat venin e vinin. Ato nuk trembnin as harabelat, as laraskat, as pulëbardhën lart midis plepave, as plakun midis xhadesë me kokën përplotë. Makinat nuk trembnin askënd.

I vogli zuri të qeshte e të gëzohej dhe plaku nuk do ta kishte dëgjuar të nipin, sikur një makinë të mos i qëndronte me një ulërimë të madhe rrotash, borie dhe shoferi, mu në hundë.

— Më falni, — tha baba Riti i turpëruar dhe nuk i pëlqeu të dëgjonte çfarë tha shoferi.

Ç'kishte bërë djali?

Djali kishte qëndruar pranë një qoshku në të majtë të xhadesë, te kopshti i lodrave të fëmijëve. Në qoshk lëviznin zogj të shumtë, midis të cilëve, që atje përtej baba Riti shquante harabelat, pastaj disa zogj laramanë me shumë të verdhë nëpër pendë, që duhej të ishin gardalinat; të tjerë të verdhë fare, që duhej të ishin kanarinat.

Punë me vend kishin bërë me këtë qoshk plot zogj të vegjël këngëtarë, po s'kishin menduar edhe për një qoshk tjetër me zogj të mëdhenj, të cilët fëmijët duhet gjithashtu t'i njohin, — stërqoka, sorra, pulëbardha, për shembull. Mund të kishte edhe një qoshk të tretë me zogj gjahtarë, të cilët fëmijët duhet t'i njohin gjithashtu, sepse fantazia e tyre me të tillë zogj mund të fluturojë edhe më larg, gjeraqina, huta, shqiponja. Pse të mos kishin edhe ndonjë qoshk të katërt me lepuj e me lepurushë, me ndonjë tjetër kafshë të urtë, ta zëmë një iriq?

Kur mendoi te iriqi, plaku mbështolli buzët, sikur ta kishin pickuar gjembat. I bëri pyetjen vetes se a qëndronte dot në një qoshk lepuri me iriqin...

Po ky djalë ç'u bë?

Genci kishte shastisur pas zogjve të qoshkut.

Të gjyshit mendja i fluturoi te mëllenjat, që zinte në fëmijërinë e tij, te gjoni, që këndonte natë për natë

në një kopsht pranë shtëpisë dhe që ai s'e kishte parë dot kurrë; te një çerdhe kumurie...

— More, po ç'u bë djali?

Djali i shtrëngonte dorën fort dhe kishte mbetur gojëhapur nga zogjtë, të cilëve u përziheshin pendë, ngjyra, këngë. Genci seç kërkonte që s'e gjente nëpër mahnitjen e tij.

— Përse s'ka dallëndyshe këtu? — pyeti ai.

Plaku mezi doli nga porta e thellë e kujtimeve. Ai tha si për vete:

— Dallëndyshet nuk jetojnë të mbyllura. Këtu s'paska as garguj, as kumuri.

— Se mos janë të bukur ata, — tha fëmija.

— Përkundrazi, — tha gjyshi.

— Zogjtë e mëdhenj s'dinë të këndojnë, baba.

— Kumuritë janë si pëllumbat, — ndoqi mendimin e tij plaku.

— Pëllumbat vetëm gu-gu dinë të bëjnë, — përçmoi zërin e fytyrën Genci.

Plaku bëri «hëm-hëm» me vete. Atij i vinte keq që këtu nuk kishte as garguj, as kumuri, as ndonjë gjeraqinë, le të mos kishte domosdo dhe një iriq. Ç'dinë fëmijët e qytetit nga qeniet e gjalla?

Një viç kishte qëndruar e po shikonte zogjtë në qoshk. I vështronte me dy sy të mëdhenj e të çuditur, me kokën si mënjanë, me veshët një pëllëmbë, që sikur thithnin tërë meloditë e cicërimave. Po viçi pëlliti, sikur të thoshte:

«Muzikë është kjo që bëni ju atje brenda, more shokë zogj? Apo ziheni me njëri-tjetrin? Apo qani fatin tuaj, që nuk shpëtoni dot nga këto rrjeta teli, që ju paskan rrethuar? Pa shihni si bredh unë! E patë atë pulëbardhën midis plepave, që shkonte përmbi xhade si një aeroplan? Thashë se do ulet, po s'u ul. E patë atë plakun me bastun, që desh e shtypi makina dhe që shoferi, duke bërë stop te hunda e tij, e shau me një fjalë të rëndë? Më patë mua se si, nga inati, eca mu në mes të xhadesë dhe u bëra problem për qarkullimin, aq sa u mblodhën katër policë, me katër bilbilë, dhe unë

s'desha t'ia di fare? Po thuajini një kënge në kor, more zogj, se na shurdhuat veshët!»

Zogjtë s'e kishin mendjen fare te viçi. Ky shkundi veshët, i vështroi me keqardhje e u largua.

Genci i tundi dorën të gjyshit e i pëshpëriti:

— Baba Riti, shih një viç!

Baba Riti, ktheu kokën, po nuk iu duk si viç. Iu duk si mëz. Ku ta dinë fëmija se ç'është një mëz?

Genci e tundi përsëri nga dora të gjyshin dhe e pyeti:

— Baba Riti, përse i kanë vënë në kafaz ata zogjtë e verdhë?

Vërtet, na paska edhe dy kafazë në këtë qoshk, me nga një çift kanarina. Ç'punë kjo? Në qoshk brenda dhe brenda në kafaz më vete!

— Janë kanarina ata zogj. Kanarinat janë zogj të verdhë, — shpjegoi plaku.

— Si bilbilat, — vërejti i vogli.

Po ky shejtan, nga e di që bilbilat janë të verdhë?

— Gargujt janë me tërë ngjyrat përzier, po nuk dinë të këndojnë, thotë edukatorja, — shtoi Genci.

Ja edhe gargujt i njohka! More!

— Guguçet kanë një rreth të zi në qafë. Po ti, more baba Riti, përse u thua kumuri? Ato bëjnë gu-gu-ftu-gu-gu ftu — përçmoi zërin dhe fytyrën i vogli.

Ja dhe kumuritë i ditka! Iriqin sigurisht që do ta njohë. Njeh plot gjëra qerratai! Fëmijë i zgjuar shumë, ta rrëmben fjalën nga goja.

Viçi pëlliti atje matanë. Djali ktheu kokën. Në xhade kishin qëndruar tërë ato makina dhe viçi nuk lozte vendit. Shoferët u binin borive. I vogli trokiti duart e qeshi me të madhe.

Baba Riti shikonte të dy çiftet me kanarina e i prishej zemra për robërinë dyfishe që ato vuanin brenda në qoshk e prapë brenda në kafaz. Sa të lumtur dukeshin zogjtë që fluturonin përreth të dy kafazeve dhe sidomos harabelat!

Harabelat si harabelat, mjafton t'u hedhësh të ha-

në. Mendjen s'e vrasin fare, po vetëm fluturojnë. Të shurdhojnë me disa cicërime pa përmbajtje.

Djali tundi të gjyshin nga palloja.

— Baba Riti, përse ato kanarinat te kafazi lart këndojnë dhe ato poshtë nuk këndojnë?

Vërtet, plaku as këtë s'e kishte vënë re, që kanarinat te kafazi lart këndonin dhe ato te kafazi poshtë nuk këndonin.

Ai u mallëngjye dhe nuk mundi t'i përgjigjej të nipit, po tha me vete se, edhe midis zogjve, ka që janë më optimistë, ka që janë më pak, ka që s'durojnë dhe të tjerë që bëhen pesimistë. Kanarina është një shpend kafazi, prandaj edhe s'e prish terezinë, po këndon. Ta lëshosh prej kafazi, ajo e humb fare dhe s'e ka të gjatë. Po ja këto dy kanarina, që kyçin sqepin në hidhërim. Mos mendojnë me dhembje te liria e stërgjyshërve të tyre të largët?

Fëmija e tundi prapë të gjyshin prej palloje.

— Baba Riti, pa shih si rrinë ato të dyja që s'këndojnë.

Dy kanarinat te kafazi poshtë, si të mpira, mbajnë kokën përpjetë, indiferente ndaj cicërimave dhe ndaj këngëve të shoqeve të tyre pendëverdha dhe kafazin përsipër. Është kujtimi i çuditshëm shekullor i lirisë që e vret zogun thellë në shpirt, kujtimi i asaj lumturie në ishujt me gjelbërim të përhershëm Kanarie, midis oqeanit blu.

— Rrinë si ata që zemërohen, — vërejtji Genci me një gjysmë zëri dhe ngriti kokën të shohë baba Ritin.

Plaku u çudit shumë nga këto fjalë. Ai përkuli kokën dhe hasi në sytë e mjeruar të vogëlushit.

— Edhe ti, baba Riti, kur zemërohesh me nënën, ashtu qëndron.

Plaku ngriu. Ja tek e paska pasur i vogli!

Ai vështroi të dy zogjtë, secilin në një cep të kafazit e që i kishte kthyer shpinën tjetrit, me kokën përpjetë. Prandaj nuk këndonin kanarinat!

Përse të jenë zemëruar kaq keq midis tyre këta zogj të bukur e delikatë? Ku ta dish!

U përpoq plaku të kujtonte çfarë kishte lexuar mbi inatet e meritë e kafshëve e të shpendëve. Ai kishte qenë kurdoherë një njeri i butë. Kur lindte ndonjë mosmarrëveshje midis tij dhe së shoqes, ai tërhiqej i pari.

I vogli e shkundi prapë nga palltoja, duke e vështruar me ata sytë e tij të mjeruar e duke pëshpëritur:

— Janë të zemëruar shumë, baba!

Plaku nuk e uli kokën, po nuk deshë ta shohë në sy të nipin. Nervoz ai nxori nga xhepi paketën e ndezi një cigare me çakmakun që mezi mori. I ra kapela nga koka. I vogli nxitoi e e mori dhe e fshiu, duke hetuar të gjyshin përmes tymit të duhanit.

— Merre, baba.

— Ç'ka ky shpirt që është kaq i trishtuar? — u dëgjua një zë gruaje pas tyre.

Gjyshi dhe nipi kthyen kokën e panë një plakë.

— Mirëdita, shoku Margarit, — përshëndeti plaka.

Po kjo grua?

— Turp më vjen, — i tha Margariti, — po s'më kujtohet se ku jemi njohur.

— Nuk njihemi, — qeshi pa të keq gruaja. — Nuk jemi takuar ndonjëherë, po ju kam parë në fotografi, në gazetë, kur ju morët Çmimin e Republikës ka pesë vjet. Ndërtimet tuaja kush s'i njeh? T'ju prezantohem. Marianthi Zeqo.

— Gëzohem shumë, — i shtrëngoi dorën e u përkul me nderim arkitekti.

— Tani merrem me këta zogj. S'ka gjë më të këndshme, — u përgjërua mësuesja e vjetër. — Tërë jetën jam marrë me zogjtë, që posa u martova. Ka qenë e para martesë e një myslimani me një të krishterë në Shqipëri. Nuk ju kujtohet? Bëri bujë më 1929. Unë bijë prifti dhe ai bir hoxhe!

Plakut diçka iu kujtua si nëpër tym.

— Im shoq ishte një rritës i zoti kanarinash, — vazhdoi mësuesja. — Tani në pleqëri, pas pensionit, gjeta këtë punë si më të mirë dhe merrem me kënaqësi të madhe me të. Me këmbënguljen time e ndërtoi këtë

qoshk komunalja. Zogjtë i kam mbledhur vetë. I mbaj e i shumëzoi. Do t'u jepja një çift kanarinash, po të donit. Ky vogëlushi i dashka fort. Po ç'është kaq i trishtuar? Ç'ke, more bir? — u ul gruaja e e puthi çunin.

— Asgjë me rëndësi, — tha gjyshi. — Më solli vetë këtu me qejf të madh për zogjtë. Erdhëm, u gëzua, po ja tani ka varur buzët për ata dy zogj që kanë qëndruar në të tillë mënyrë në atë kafazin poshtë, si në mëri me shoqi-shoqin.

Gruaja hapi sytë, se nuk i mori vesh këto fjalë. Plaku nuk u pikas fare për atë që kishte thënë. Të nipit i erdhi keq e nxitoi ta korrigjonte:

— Si gjyshi me nënën.

Plaka ia krisi të qeshurit, po pastaj e mbajti gazin e tha e trishtuar:

— Ka vërtet diçka të tillë në këta zogj, i nderuari shok. I shihni ato dy kanarinat lart sa të hareshme që janë? Janë midis tyre. Këta zogj, kur bëhen çift, nuk e këmbejnë shoqi-shoqin. Ne i ngatërruam dhe s'na këndonin as ata lart, as këta poshtë. Po njërit atje lart i mbeti koka poshtë dhe njërit këtu poshtë i mbeti koka lart. I bashkuam dhe ja se si këndojnë. Do kemi vezë. Andaj i mbajmë akoma në kafaz. Këta të dy këtu poshtë, femër e mashkull janë, po s'janë të shoqi-shoqit. U gënjyem kur i blemë. Na i shitën si çift, po nuk ishin, — tha me pikëllim gruaja.

— E si u bëhet tani halli? — u prek shumë Margariti.

Mësuesja tundi kokën dëshpërueshëm, ngriti të voglin në krahë dhe i tregoi kafazin lart.

— Nëna do të të japë dy kanarina si ato.

— Tani? — u hodh Genci gjithë shend.

— Tani, posi, — e puthi plaka.

— Të blesh një kafaz, baba Riti, — e urdhëroi i vogli të gjyshin.

Natë prilli në Kulmak

Kjo që do të tregoj ka ngjarë te Gryka, në Qafë të Kulmakut, në Tomor. Vendin e quajnë Grykë, siç më kanë thënë, po vetë s'e kam parë. Ma kanë përshkruar, po më ka dalë nga mendja, se tjetër të ta përshkruajnë e tjetër ta kesh parë vetë. Po e përfytyroj një vend të thellë në mal, rreth të cilit dielli vërtitet e nuk hyn. Në atë vend dëbora zë dëborën në ca zgaure të mëdha e nuk shkrin kurrë. Dhe njeriu, doemos, i ka vënë edhe ato zgaure me dëborë të përhershme në shërbim të tij.

Ngjarja nuk fillon aty, po ca më poshtë se Gryka. Një kompani e Brigadës IV kishte luftuar dy ditë rresht me gjermanët e ballistët, kishte vrarë sa kishte mundur, po për pak desh kishte mbetur e rrethuar, po të mos ishte gjendur një bari, i cili ato vise i kishte të tijat. Bariu i futi në një shteg, nga i nxori në një anë të Qafës së Kulmakut. Në atë shteg, edhe po ta dinte, armiku s'kishte për t'u futur kurrë. I kishte parë bariu se s'qenë vetëm të rraskapitur, po dhe të pangrënë partizanët. Ata duhej së pari të hanin, pastaj të shplodheshin, që prapë të hidheshin në luftë. U tha:

— Ecni pas meje. Edhe armiqtë na e humbin tragën, edhe hani, edhe shplodheni. Kini besim tek unë?

I patën besim. Ishte një djalë që s'kishte filluar të rruhej akoma dhe gjithë i qeshur e hokatar. Edhe kur ai

u tregoi se do të kishte dashur të bashkohej me partizanët, po nënën e kishte uloke dhe babanë s'e kishte fare. E u tha:

— Do t'ju shpie te nënokja sonte, do të trembet pak ndoshta, po këto dy shoqet tuaja do të dinë t'ia marrin zemrën, se dhe zemrën e jep lehtë për dy shoqe të tilla nënokja ime.

Ai kishte qeshur, partizanet kishin vështruar njëra-tjetrën. Dhe ia kishin plasur gazit.

Çamaraku kishte thënë:

— Mos ma vini re mua, kam ojna unë. Po armikut ia humbim tragën sot, një gosti të mirë do t'ju shtrij, se jua kam borxh, ju gjej edhe një vend të mirë për të fjetur, që të merrni fuqi sa për një muaj luftë, — fol e shkëlqyerin ai herë nga shokët, herë nga shoqet. — Sa për ju, moj motrani, ju do të merrni një mësim të vlefshëm, po të doni. Se do ju gostit unë me një mish, që të mos e keni ngrënë kurrë dhe mirë ju bën të mësoni se si gatuhet ai mish. Veç në qofshi nga malet e në u martofshi në male dhe në një vend që të ketë një grykë si kjo jona dhe ca guva të thella, ku dëborat nuk shkrin kurrë. Kështu, ju hëngërsha dasmën.

Drejo djalë!

Kur arritën te vendi i quajtur Grykë, bariu i futi në një shpellë jo kaq të madhe. Në fund të shpellës, në një shtrat druri, ishte shtrirë nëna e djalit, një grua akoma e re, por e dobësuar shumë. Pranë saj ishte një turrë me dru dhe pranë zjarri i ndezur. Mjaft të zgjatej nëna e t'i shtonte ndonjë dru zjarrit, me pak kujdes që të mos digjej. Tym kishte, po me tymin njeriu mësohet. Dritë kishte pak, se pak hynte nga jashtë, dhe ai zjarr nuk e ndriçonte mirë vendin.

— Të kam sjellë shokë, — i tha djali nënës.

— Mirë se të vijnë, — tha nëna pak si me drojë.

— Edhe dy shoqe.

— Çupat e nënës! — u gëzua ajo, i mori të dyja në grykë e i puthi, duke i vështruar me habi se si ishin veshur e ngjeshur, si djemtë e me pushkë.

— Janë partizanka, — shpjegoi djali.

— E kuptova, — tha nëna.
 — Kanë luftuar me gjermanët e ballistët.
 — Ata u shofshin, more bir!
 — Kanë vrarë dhe s'e kanë ngopur akoma xhanin.
 — E ngopshin, more Hilmi.
 — Ja ky është komandanti dhe komisari ai.
 — Ju paça sa malet, more djem. Mirë se më erdhët.
 — Do të rrinë këtu sonte.
 — Të rrinë edhe nesër e pasnesër e sa t'u rrihet.
 — Doemos dhe nesër, nënë, se janë lodhur ca e janë të urët.

— Kafshitën do ta ndajmë bashkë sa të kemi.
 — Kafshitë dhe mishin e nazarit¹⁾, nënoke.

Këtë radhë nëna s'foli, po e pa të birin me frikë të vërtetë. Djali tha:

— Ballist është babai, moj nënë.
 — Atë gabim e ka bërë, — psherëtiu e ëma.
 — Ka lyer duart me gjak, thosh ajo komunikata që të këndova njëdizaj.
 — Të jetë e vërtetë, more shokë? — pyeti gruaja duke hetuar në sy partizanët.

— Që kur e merr komunikata, gënjeshtër s'mund të jetë, — u përgjigj i biri.

— Po mishtë, more bir,... — deshi të thotë diçka nëna dhe heshti e frikësuar.

— Nëna e babait nuk të zë, moj nënoke, si s'të kanë zënë as uratat e nuskat e tij.

— Mos fol kështu, more Hilmi!

— Pastaj babai është ballist, moj nënoke. Edhe në zënçin nëmat e baballarëve, të ballistëve nuk zënë.

— Mos fol kështu, more Hilmi, se bie në gjynah të madh!

— Në gjynah bie po të mos hamë sonte mishin e nazarit! — u nxeh dhe sikur plasi nga brenda Hilmiu.
 — Kemi një muaj në këtë shpellë, ti uloke, unë që të shpëtoj dhitë. Të mos ishe ti, ja me cilët do të isha! Sa

1) Babai bektashi.

për nazarin, jo vetëm që ia ha mishtë e shterpave të guvës, po atë vetë e ha të gjallë, të kem ta shtie në dorë, more vesh?

— Po mos kështu, more Hilmiu i xhanit!

— Si, moj, mos? — dridhej ai i tëri, kurse partizanët, gjer atë çast, nuk kishin thënë dot një fjalë e s'dinin ç'të thoshin, po mbanin vesh të hutuar.

Djali e mori veten shpejt. Ai nisi të qeshte si pa të keq, e zuri kolla, shau tymin, i futi zjarrit dru. Pastaj u kthye nga partizanët e tha:

— Urdhëroni e rrinë si në konakun tuaj. Për këto shoqet i kam dy postiqe; për ju, ja fronat, — tregoi ai disa gurë të mëdhenj përtokë dhe qeshi me të madhe. — Nënokë, nazari na marrtë të keqen, më keq se ç'ka për të na e marrë. Ne sonte do t'ia shtrojmë dhe ti Hilmiut mos ia prish, se e ke djalë të vetëm. Kur tjetër herë do na vijnë kaq shokë në këtë të zezë shpellë?

— I shtrenjti i nënës! — tha gruaja e u përpoq t'i buzëqeshte.

— Hajt të të puth dorën, se jam fajtor e bërtita shumë. Apo jo, more shokë dhe shoqe? — pyeti ai partizanët e vajti i puthi dorën s'ëmës, e cila e pushtoi fort e fort.

Djali tha pastaj:

— Tani, gjynahqar s'bëhem dot vetëm. Dua edhe dy shokë. Cili vjen me mua? S'vemi larg: ja, atje përtej.

Komandanti ua bëri me sy dy shokëve dhe ata dolën pas bariut.

Nëna donte të fliste, po nuk fliste dot. Partizanët ishin akoma pak të hutuar. Komandanti tha:

— Ç'djalë të gjallë që ke, moj shoqe! Dhe trim.

— Trim është, — tha gruaja me një zë të fikur.

— Po ti, ke vjet kështu? — e pyeti njëra nga partizanet.

— Plot dy vjet.

— Po si kështu?

— As unë s'e di. As nazari nuk më ka bërë derman.

- Në doktor s'je parë?
- Ç'doktor ka këtej, moj bijë? Duhet të shkosh në Berat.
- Nuk të ka shpënë djali?
- Deshi, po s'më shpuri dot.
- Po burri, kur të ka vdekur? — e pyeti partizania e dytë.
- Ka vjet. Përcillte babanë një natë, kaluan lumin, hyri me kalin e babait për dore, u plevitos.
- As atij s'i bëri derman nazari, — pëshpëriti shumë e prekur shoqja.
- Punët e perëndisë, moj bijë, — fshiu gruaja lotët që po i rridhnin.
- Ky babai ballist, për të cilin foli Hilmiu, ka qenë?
- Ky, moj bijë.
- Po ai mish i babait, ç'është? — pyeti komandanti.
- Këtu pranë i mban shterpat nazari?
- S'more vesh gjë, more shok, — qeshi gruaja më në fund. — Janë shterpa të therura. Është një zakon këtej: therin në vjeshtë të parë shterpat më të mira, i mbushin me ç'erë të mirë që kanë ca lule të këtij mali, që nga rigoni e gjer te zhumbrica, majdanos e dafinë po domosdo, pastaj piper të zi dhe çfarë harroj. E lidhin atë mish e e bëjnë, si të them, njësh të tërë, e futin në një mushama të fortë, e lidhin mirë në të prapë dhe vënë e e futin në ato guvat e thella, në atë dëborën që nuk shkrin kurrë. Kjo është koleja. Kur bën prilli më të hyrë, prilli allaturka, venë e nxjerrin kolenë dhe e hanë.
- Si punë pastërmaje, — tha njëra partizane.
- Jo, moj bijë, ç'pastërma? Kole. Mishin edhe ta kishe zier, edhe ta kishe pjekur, nuk bëhej më i butë e më i mirë. Duhet ta hash, që ta thuash.
- Nga ai mish do hamë?
- Gruaja psherëtiu:
- Nga ai.
- Kështu hani ju këtej?
- Ha kush ka, moj bijë. Shterpa s'ka cilido.

— Po nazari ku i gjen?

— Po i shpiem ne.

— E sheh se Hilmiu ka të drejtë! — ndërhyri komandanti.

— Kam, si s'kam të drejtë, more shok, — foli djali duke hyrë në shpellë me një peshë të madhe në duar. — Kjo nënoke thotë «mishtë e babait», «mishtë e nazarit»! Po ne do hamë sonte dy shterpa dhe njëra ka qenë imja, kurse tjetra e Manes se Kasos, një më trokë¹⁾ se unë. Nesër do shohim se cilat shterpa do hamë. Dhe na bëfshin mirë! Pa mbani erë këtu, se e çela njërën.

Në shpellë u përhap së pari një erë e rëndë, s'ajo e pastërmasë, po e përzier me erën e dafinës e të zhumbricës. Pastaj era e rëndë u zhduk dhe një erë zhumbrice e dafine e kushedi ç'tjetre përzier e kundërmoi vendin. Hilmiu nxori e hapi thikën që ndriti, e çau për së gjati mushamanë, me të cilën ishte mbështjellë mishi, doli një kofshë, futi thikën në të dhe preu një thelë të madhe, nga e cila preu tri rriska dhe u ngrit e njërën ia dha s'ëmës.

— Ti të bësh me shëndet e para, — i tha. — Është nga mishi i Kaprolles sonë. Të kujtohet ç'dhi ka qenë? Edhe mishin si të kaprolles, e ka. Të bëftë mirë!

Pasi nëna, deshi s'deshi, e kafshoi dhe e përtypi mishin, djaloshi u kthye e u dha nga një rriskë të dy shoqeve e tha:

— Tani, po të ketë njeri që të më ndihmojë, do më bëjë nder.

— Po bukën, more bir? — pyeti nëna.

— Bukën e zënë këto shoqet. Ja mielli, ja dhe çerepi, moj motra. Dini?

— Dimë, si s'dimë? — thanë partizanet.


1) Më keq, më i varfër.

SHËNIM

Në pjesën e parë të këtij libri, autori është përpjekur të plotësojë, me tema të reja, tregimet e një fëmije dhe të një të riu të dekadave para Çlirimit. Këto tregime s'janë rrëfime as kujtime, edhe pse janë vënë në vetën e parë. Ato u drejtohen moshave të reja për të njohur kohën në të cilën vendosen, dhe janë vazhdim i vëllimit «60 tregime në një», që u botua pak kohë më parë.

Tregimet e tjera u drejtohen po atyre moshave, po nuk kanë lidhje me pjesën e parë.

DHIMITËR S. SHUTERIQI



PASQYRA E LËNDËS

I. KUR RENDTE HËNA NËPËR RE

- Njeriu rrjedh nga majmuni	5
- Një tjetër tregim për Vangjushin	10
- Përrallë me keca	14
- Im gjysh nga nëna	19
- Mani i vogël	24
- E Ema e Vatrës	31
- S'e kam fjalën për çdo ceremoni	37
- Hëna dhe Perihëna	41
- Njëherë te ne erdhi një sheh	48
- Kur rendte hëna nëpër re	54
- Dajë Murati, një tjetër furrtar	58
- Një mësim nga im atë	64
- Ada Albani	68
- Një javë pranë ministrash	73
- Kufomat e gjalla	81
- Baba Tomori	91
- Një udhëtim fantastik	99
- «Fitorja e Samothrakës»	109
- «Kësulëkuqja» e ritreguar	114
- Jaja jonë	119
- Eremiti i Krastës	127
- Skënderbeu në lqen të Ohrit	138

- Natë shkurti me dëborë dhe akull	144
- Konspirata e parë	153
- Për kujtim të Migjenit	165
- Derri në pallat	171
- Mesjeta	187
- Një takim	189

II. TREGIME TË REJA

- Karakaftja	197
- Letër që nga fundi i dynjasë	205
- Kuçina	210
- Nishani im i parë	213
- Nëna dhe armët	220
- Kumbullat e zerdelitë	227
- Midis zogjve	230
- Natë prilli në Kulmak	237

Shuteriqi, Dh. S.

Kur rendte hëna nëpër re.
Tregime. [Red.: O. Grillo] T.,
«Naim Frashëri», 1982.

248 f.

(B.m.) dhe

(B.v.) : 891.983-93-32

Sh 97

Tirazhi 8000 kopje

Formati 78x109/32

Stash 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re,
Tiranë, 1982